

**Strategjia**  
**Kombëtare**  
**e Mjedisit**

## Mirënjohe

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit  
Ministria e Integrimit European  
Ministria e Brendeshme  
Ministria e Financës  
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës  
Ministria e Drejtësisë  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës  
Ministria e Shëndetësisë  
Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta  
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit  
Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve  
Departamenti i Strategjisë dhe Koordinimit – Qeveria e Shqipërisë  
Komisionet Parlamentare  
Drejtoria e Pëgjithshme e Standarteve  
Institutet e Mjedisit, i Studimit të Tokave, Hidrometeorologjisë, Pyjeve dhe Kullotave, Kërkimeve Biologjike, Shëndetit Publik, Fizikës Bërthamore, Gjeografik i Hartave dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës  
Agjencitë Rajonale të Mjedisit  
Bashkitë dhe Këshillat e Qarqeve  
Grupi i Veprimit në Mjedis, Shoqatat e Biznesit dhe ato Profesionale, OJF-të, Policia Ndërtimore, dhe të gjithë njerëzit që kanë marrë pjesë në konsultimet e bëra mbi SKM në të gjithë vendin.  
Ekipi i Projektit ELPA.

## Informacion për Publikimin

Ky dokument u publikua nga:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Në emër të Qeverisë Shqiptare

Data: Nëntor 2006

Printimi: Phoenix +, Tiranë, Shqipëri

Dizenjimi: Studio Design BlueLine

## Mirënjohe

Qeveria Shqiptare shpreh mirënjohjen për mbështetjen dhe asistencën e organizatave dhe institucioneve të mëposhtme për përgatitjen e kësaj strategjie:

Lista për tu plotësuar me pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

European Union CARDS project:

Environmental Legislation and Planning, Albania

EuropeAid/118904/C/SV/AL



## Tabela e Përmbajtjes

1	Marrëdhëniet ndërmjet Ekonomisë, Zhvillimit Shoqëror dhe Mjedisit	27
1.1	Aspekti njerëzor	28
1.2	Zhvillimi i Burimeve Ekonomike	29
1.3	Zhvillimi i Qëndrueshëm	31
1.4	Angazhimet Kombëtare	32
1.5	Vendi i Shqipërisë në Europë dhe në Botë	34
1.6	Si është e organizuar kjo Strategji	35
2	Probleme të Mjedisit	37
2.1	Metodologjia	37
2.2	Identifikimi i problemeve	38
2.3	Veprimtaritë e zhvillimit dhe presionet që ato ushtrojnë mbi mjedisin	39
2.3.1	Industria, energjia dhe transporti	39
2.3.2	Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	46
2.3.3	Zhvillimi Urban	49
2.3.4	Turizmi	50
2.3.5	Trashëgimia e së kaluarës	51
2.4	Komponentët e mjedisit dhe ndikimet e presioneve që ushtrohen mbi ta	53
2.4.1	Cilësia e ajrit dhe Ndryshimi i Klimës	53
2.4.2	Uji	55
2.4.3	Tokat	58
2.4.4	Mbetjet	59
2.4.5	Zhurmat	63
2.4.6	Biodiversiteti dhe Peizazhi	64
2.4.7	Zonat e mbrojtura dhe peizazhi	65
2.5	Përmbledhje e problemeve kyçe të mjedisit dhe shkaqet e tyre	68
2.6	Faktorë të përbashkët	68
3	Objektivat dhe Masat Përkatëse	73
3.1	Metoda e Ndarjes në Faza	73
3.2	Objektivat	74
3.2.1	Objektivat e Përgjithshme	74
3.2.2	Objektivat e përkohshme	74
3.2.3	Përcaktimi i Synimeve	75
3.2.4	Prioritarizmi	76
3.2.5	Vendosja e kriterëve për prioritetet	77
3.3	Përmirësimi i Mjedisit	78
3.3.1	Cilësia e Ajrit	78
3.3.2	Ndryshimi i Klimës	89
3.3.3	Administrimi i Mbetjeve	96
3.3.4	Administrimi i Burimeve Ujore	105
3.3.5	Mbrojtja e Tokës	117
3.3.6	Biodiversiteti	123
3.3.7	Planifikimi dhe Administrimi i Përdorimit të Tokës	132
3.3.8	Dëmi Mjedisor	143
3.3.9	Zhurma dhe Rrezatimi	150
4.	Mjetet e Arritjes së Objektivave	157
4.1.	Përfshirja i Çështjeve Mjedisore në Procesin e Zhvillimit	157
4.2	Legjislacioni	159
4.2.1	Situata Ekzistuese	159
4.2.2	Përmirësimi i situatës	160
4.3	Zbatimi	161
4.3.1	Pajisja me Personel e Sektorit të Administrimit Mjedisor	161

4.3.2	Zbatimi i Ciklit të Administrimit Mjedisor	162
4.3.3	Mbështetja ndaj ciklit të administrimit	164
4.4	Instrumentat Ekonomike	164
4.4.1	Tipat e instrumenteve	165
4.4.2	Prioritarizimi i instrumenteve ekonomike	167
4.4.3	Fondi Mjedisor	167
4.5	Investimi në Infrastrukturën Mjedisore	169
4.5.1	Nevojat	169
4.5.2	Mënyra për Plotësimin e Nevojave	170
4.5.3	Përcaktimi dhe Zbatimi i Prioriteteve në Investime	171
4.5.4.	Roli i Autoriteteve dhe Sektorit Privat	172
4.5.5	Zbatimi i një Sistemi investimi	173
4.6	Informacioni dhe Pjesëmarrja	175
4.6.1	Informacioni dhe Komunikimi	176
4.6.2	Arsimimi dhe Trainimi	179
5	Zhvillimi i Administrimit Mjedisor	183
5.1.	Integrimi	185
5.2	Ligji mbi Mjedisin – rishikimi, transpozimi dhe zbatimi	191
5.3	Përgatitja dhe dhënia e lejeve	192
5.4	Verifikimi dhe Inspektimi	194
5.5	Aplikimi i masave detyruese dhe apelimet	195
5.6	Përforcimi i sistemeve të monitorimit	198
5.7	Investimet në infrastrukturën komunale dhe Fondi për Mjedisin	201
5.8	Administrimi dhe monitorimi	202
5.9	Administrimi i Informacionit	204
5.10	Komunikimi	206
5.10.1	Administrimi i Komunikimit	206
5.10.2	Komunikimi i Politikës Mjedisore	207
5.10.3	Detyrat e Komunikimit dhe Informacionit Mjedisor	213
5.11	Arsimi dhe Trajnimet pa shkëputje nga puna	214
5.12	Kapaciteti Institucional, nevojat për personel	215
5.13	Implikimet Burimore dhe Financimi	218
6	Koordinimi, Monitorimi dhe Raportimi	223
6.1	Koordinimi	224
6.1.1	Komisioni Mjedisor	224
6.1.2	Grupet e Posaçme Ndërministrrore	225
6.1.3	Njësitë Mjedisore dhe Ekspertët Mjedisorë	226
6.2	Monitorimi i ecurisë	226
6.3	Raportimi i ecurisë	229

**SHKURTIMI****SHPJEGIMI**

ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
ABU	Administrimi i Burimeve Ujore
Acquis	
Communaautaire	Kuadri Ligjor i Komunitetit European
AIZB	Administrimi i Integruar i Zonës Bregdetare
ARUK	Agjensia Rurale e Ujësjiellës-Kanalizimeve
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi European
DPK	Di-fenilet e Poli Klorinuar
DPS	Drejtoria e Përgjithëshme e Standardeve
DTUZU	Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane
FGM	Fondi Global për Mjedisin
FSHPGJEK	Forcat Shtytëse, Presionet, Gjendja, Efekti mbi Mjedisin dhe Kundërpërgjigja
FSHPGJE	Forcat SHtytëse të ndryshimit mjedisor (p. sh. prodhimi industrial); Presioni mbi mjedisin (p. sh. shkarkimi i ujërave të zeza); Gjendja e mjedisit (p. sh. cilësia e ujit në lumenj e liqene); Efektet mbi popullatën, ekonominë dhe ekosistemet (p.sh.ujë i papërshtatshëm për tu pirë)
GPPUN	Grupet e Përbashkëta të Punës për Ujërat Nëntokësore
AAMM	Agjencia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit
IPU	Instituti i Projektmeve Urbane
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni European
KEKBE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën
KIPN	Kontrolli i Integruar për Parandalimin e Ndotjeve
KKKBNK	Konventa Kuadër e kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
KM	Këshilli i Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
KMRr	Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi
KNER	Këshilli për Ndihmë Ekonomike Reciproke
KPMB	Kodi i Praktikës së Mirë Bujqësore
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencave
MBPV	Ministria e Brendshme dhe Pushteti Vendor
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Integritimit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPÇSSHb	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NJAZP	Njësia e Administrimit dhe Zbatimit të Projektit
NTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OMZH	Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillim
PAP	Plani për Administrimin e Pyjeve
PKAMN	Plani Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta
PKB	Produkti Kombëtar Bruto

PKBM	Program i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PKPL	Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit në Mjedis
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
PRVM	Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis
PZHKB	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
RrBUPRrM	Rrjeti Ballkanik për Ushtrimin dhe Përputhjen e Rregullores mbi Mjedisin
RrUPMA	Rrjetit të Ushtrimit dhe Përputhjes Mjedisore për Aderim
SAIM	Sistemi i Administrimit të Informacionit Mjedisor
SAIM	Sistemi i Administrimit të Informacionit Mjedisor
SBPV	Strategjia për Biodiversitetin dhe Plani i Veprimit
SCM	Standardet e Cilësisë së Mjedisit
SIGJ	Sistemi i Informacionit Gjeografik
SKM	Strategjia Kombëtare e Mjedisit
SKP	Specialist me Kohë të Plotë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKZHSE	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Social Ekonomik
SAIM	Sistemi i Administrimit të Informacionit Mjedisor
SQKU	Sistemet e Qëndrueshme të Kullimit Urban
TMD	Teknologjia më e Mirë e Disponueshme
Transpozim	Përfshirja Formale e Detyrimeve që Përmban acquis brenda Kuadrit Ligjor Kombëtar
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe
UNFCCC	Unitide Nations Framework Conventional Climate Change
US EPA	United States Environment Protection Agency,
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimin Strategjik Mjedisor
ZM	Zonë e Mbrojtur

## Përmbledhje

*“Mjedisi është burimi i çdo gjëje që njerëzve u duhet për të jetuar dhe për t’u zhvilluar.”<sup>1</sup>*

Qëllimet kryesore të politikës së qeverisë janë:

### Zhvillim i Qëndrueshëm

### Hyrja në Bashkimin Europian

Zbatimi i kësaj, Strategjie të Dytë Kombëtare e Mjedisit, do të jetë një kontribut i madh në arritjen e këtyre qëllimeve.

Administrimi efikas i mjedisit dhe arritja e zhvillimit të qëndrueshëm është një sfidë e madhe. Gjatë viteve të fundit, është arritur një përparim i madh, megjithatë:

*“Qëndrueshmëria e zhvillimit të Shqipërisë, shpesh herë është vënë në pikëpyetje ....”*

*Degradimi rural dhe varfëria, zgjerimi urban, ndotja mjedisore dhe dëmtimet në burimet natyrore janë vetëm disa nga problemet ... Rikthimi i vendit në rrugën e zhvillimit të shpejtë, por të qëndrueshëm dhe të balancuar, është me rëndësi jetike ... Synimi i Qeverisë do të arrihet nëpërmjet një shkrirjeje të politikave specifike sektoriale në një trajtim të integruar...”<sup>2</sup>*

Trajtimi i integruar, kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në një mënyrë të përforcuar reciprokisht. Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit të shfrytëzimit të mjedisit dhe mbrojtjes së tij. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë së tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, do të çojnë në një rritje të madhe të kostos së përgjithshme të zhvillimit ekonomik.

Kjo Strategji Kombëtare e Mjedisit, është në vetvete pjesë e trajtimit të integruar që po kryhet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo duhet parë në kontekstin e politikës kombëtare në tërësi. Shumë nga politikat dhe masat e kësaj strategjie, mbështeten nga programet e veprimet të përcaktuar në strategjitë sektoriale, siç janë uji, energjia dhe bujqësia. Për më tepër, ato mbështeten gjithashtu nga programe veprimi më të hollësishme që trajtojnë çështje specifike, siç janë Strategjia dhe Plani i Veprimit të Biodiversitetit si dhe Plani i Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve. Kjo Strategji Kombëtare e Mjedisit bashkon elementët më të rëndësishëm të këtyre veprimeve në një tërësi të vetme e koherente.

Zbatimi i kësaj Strategjie, do të sjellë përfitime shumë të mëdha për shëndetin dhe mirëqenien e vendit. Sidoqoftë, që të realizohen këto përfitime, do të duhet angazhim si nga ana praktike ashtu dhe nga ajo financiare. Ne duhet të jemi të gatshëm t’i përmbushim këto angazhime nëse dëshirojmë të arrijmë synimet tona të zhvillimit të qëndrueshëm dhe anëtarësimit në Komunitetin Europian.



<sup>1</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomiko-Social (SKZHES), Raporti Progresiv për Implementimin 2002, Objektivat dhe Vizioni Afat-Gjatë i SKZHES, Plan Prioritar i Veprimit 2003, Tiranë 8 Maj, 2003

<sup>2</sup> Program i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë 2005 - 2009

## I. Kushtet Aktuale

Kushtet aktuale në fushën e Mjedisit mund të vlerësohen duke ju patur parasysh faktin se:

1. Gjendja e mjedisit në lidhje me cilësinë sipas standardeve kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare – rezultatet e monitorimit tregojnë mospërputhje me këto standarde në një numër komponentësh mjedisorë, përfshirë ajrin dhe ujin.
2. Shkalla dhe niveli i ndikimit mjedisor që krijohet për njësi të aktivitetit të vendbanimeve dhe ndërmarrjeve shqiptare “efiçensa mjedisore e aktiviteteve”, me përjashtim të prodhimit të energjisë elektrike, është përgjithësisht i lartë.
3. Niveli i shpenzimeve, si në të ardhura ashtu edhe në kapital, për parandalimin e degradimit mjedisor dhe efekteve shoqëruese shëndetësore – si i sektorit publik ashtu edhe i atij privat është krahasimisht i ulët.
4. Shkalla e përputhjes midis legjislacionit shqiptar dhe atij European në fushën e mjedisit është e një niveli mesatar.
5. Niveli i zbatimit dhe i respektimit të këtij legjislacioni, përfshirë edhe ekzistencën e infrastrukturës mjedisore, sikurse sistemet e mbledhjes së ujërave të mbetura – tani për tani shumë nga ligjet që i presupozojnë mbrojtjen e mjedisit nuk imponohen ose nuk zbatohen mirë.

### Gjendja e Mjedisit

Rezultatet e monitoruar të cilësisë së ajrit të mjedisit, vërtetojnë qartë që standardet e cilësisë së ajrit nuk arrihen në shumicën e zonave urbane të vendit. Veçanërisht nivelet e grimcave-pezuilli të hasura në qytetet kryesore, i kalojnë standardet ligjore të vendosur në legjislacionin kombëtar duke rritur në këtë mënyrë nivelin e sëmundjeve të sistemit të frymë-marrjes.

Niveli i përputhjes me standardet e ujit për larje është mesatar deri i ulët. Ndonëse vlerat mesatare tregojnë përputhje me standardet bazë për ujërat e larjes, vlerat e këtyre parametrave në stinën e verës nuk përputhen me standardet dhe shumica e mostrave nuk i arrijnë nivelet rreptësisht të përcaktuar nga legjislacioni i Bashkimit European (Udhëzimet).

Uji i pijshëm nuk sigurohet gjatë gjithë kohës, për gjithë vendbanimet. Cilësia e ujit me të cilin furnizohen konsumatorët është gjithashtu e ndryshme dhe në shumë raste nuk përputhet me standardet Europiane.

Të dhënat e monitorimit të ujërave nëntokësore janë të pamjaftueshme për të paraqitur një vlerësim tërësor për gjendjen aktuale. Sidoqoftë, si tej-shfrytëzimi i burimeve në zonat bregdetare ashtu edhe ndotja e ujëmbajtësve të cekët ndodhin në shumë zona.

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore është i pamjaftueshëm për të paraqitur një vlerësim të plotë. Sidoqoftë, të dhënat që kemi në dispozicion flasin për një ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore në mënyrë të veçantë të atyre që ndodhen në afërsi të burimeve të mëdha të ndotjes; qyteteve, kantierëve industriale ekzistuese, komplekseve të dikurshme industriale dhe komplekseve të nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve.

Në Shqipëri ka probleme edhe me mbrojtjen e tokave. Erozioni i tokës njihet gjerësisht si një problem i madh që shkaktohet nga pyjet e paqendrueshëm dhe praktikat bujqësore. Nivelet e ndotjes kimike janë të ulëta në shumicën e tokave bujqësore; sidoqoftë, sipërfaqe të mëdha të tokave me ndotje industriale janë ende të parestauruara. Disa nga këto toka janë zënë nga të ardhurit të cilët kanë ndërtuar banesa mbi këto toka e për pasojë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të mëdha që shkaktohen nga ndotjet në këto zona.

6% e territorit të vendit gëzon statusin e zonës së mbrojtur. Megjithatë, ky rrjet kombëtar, është tepër i vogël për të pasur një ndikim efektiv afatgjatë në mbrojtjen e biodiversitetit. Për ta krahasuar e vlen të



theksohet se 18% e territorit të Shteteve Anëtare të BE është përfshirë në rrjetin e "Natura 2000" të mbrojtjes së natyrës. Madje shumë specialistë e konsiderojnë këtë si të pamjaftueshme. Megjithatë mbulimi aktual i zonave të mbrojtura nuk është i barabartë dhe nuk përfaqëson tipat e ndryshëm të habitatit që ekzistojnë në vend. Niveli i mbrojtjes i arritur në shumë zona të mbrojtura nuk është gjithashtu i përshtatshëm dhe as i mjaftueshëm, pasi në të është ende mjaft i përhapur ndërtimi informal dhe gjuetia ilegale.

Zhurmat janë një problem i zakonshëm urban. Burimet e tyre kryesore janë transporti, ndërtimet, industria dhe disa aktivitete tregtare si lokalet dhe klubet. Deri tani, nuk është nxjerrë ndonjë standard për nivelet e lejuar të zhurmës nga ndonjë burim dhe nuk ekzistojnë standarde për nivelin e zhurmës në zonat e banimit. Faktikisht nuk ka kufizime zyrtare.

Efekti i zhvillimit mbi vendet dhe objektet e trashëgimisë kulturore, zakonisht përfshihet në kriteret e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Në Shqipëri, Monumentet e Kulturës mbrohen në bazë të Ligjit Nr.9048, 07.04 2003. Megjithatë ky ligj ka mangësi, dhe pikërisht për këtë arsye, mund të pohojmë me bindje që ky ligj, në shumë nene dhe pika të tij e shikon monumentin të palidhur me mjedisin. Ka shumë raste të monumenteve të përcaktuara që po dëmtohen ndonëse ky ligj është në fuqi.

### **Efikasiteti i Shfrytëzimit të Resurseve**

Efikasiteti me të cilin shfrytëzohen burimet mjedisore për aktivitete ekonomike dhe joekonomike, është një faktor kritik për përcaktimin e ndikimit të përgjithshëm të aktiviteteve. Aktivitetet kyçe përfshijnë:

- Zhvillimin Urban, përfshirë zhvillimin dhe përdorimin e pronës private dhe tregtare;
- Industrinë, përfshirë minierat dhe industrinë përpunuese;
- Transporti: rrugët, transporti hekurudhor dhe ajror;
- Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi;
- Energjia, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike;
- Turizmi.

Përveç kësaj, duhet theksuar se ndikimet ndaj mjedisit shkaktohen ende nga një numër i madh i aktiviteteve të mëparshme, në mënyrë të veçantë nga ndërmarrjet e mëparshme industriale dhe ato të nxjerrjes së mineraleve.

### **Zhvillimi Urban**

Gjatë dy dekadave të fundit, ka pasur një rritje dramatike në numrin e aktiviteteve ndërtimore. Ndonëse kjo është përqendruar kryesisht në zonat ekzistuese urbane dhe në zonat bregdetare, një numër i madh shtëpish janë ndërtuar në ngastrat e vogla në zona të shpërndara dhe në rrafshinat bregdetare. Ky "bum në ndërtim" është planifikuar dhe rregulluar shumë keq. Një numër i madh ndërtimesh janë kryer në mënyrë joformale dhe pa leje. Në kushtet e praktikave të tilla zhvillimore, praktikat për sigurimin e infrastrukturës komunale për mbrojtjen e mjedisit, në mënyrë të veçantë për furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen dhe përpunimin e ujërave të zeza dhe grumbullim - depozitimin e mbetjeve të ngurta janë tepër të vështira dhe shumë më të kushtueshme sesa mund të ishin në rastin kur në vend të këtij zhvillimi të shpërndarë dhe kaotik të kishim një vendosje në zona banimi të organizuara, planifikuara e sistemuara sipas parametrave standarde.

Zhvillimi aktual urban shkakton dëmtime të mëdha nëpërmjet ndikimit në:

- Cilësinë e ajrit – pluhur nga ndërtimet, çlirime nga gjeneratorët dhe/ose nga pajisjet për ngrohjen e banesave;
- Burimet ujore – nxjerrja e ujit nuk bëhet siç duhet dhe nuk i përmbahet asnjë rregulli, përqindja e rrjedhjeve vlerësohet se arrin deri në 75% në shumë nga sistemet e shpërndarjes.
- Cilësia e ujit – ekziston një infrastrukturë e pamjaftueshme e grumbullimit të ujërave të zeza, kanalet e ujërave të zeza rrjedhin dhe shumë pika shkarkimi janë të lidhura me sistemin e

kullimit të ujërave sipërfaqësore, gjithashtu ekziston edhe një mungesë e përgjithshme e trajtimit të ujërave të mbetura, ndonëse me ndihmën e asistencës së huaj janë ndërtuar disa impiante për këtë qëllim – mungesa e grumbullimit dhe trajtimit të përshtatshëm të ujërave të mbetura nuk përpunohet si me kërkesat ligjore kombëtare dhe ato Europiane.

- Peizazhi – zhvillimi i parregullt ka çuar në krijimin e vendbanimeve të shpërndarë, gjë që sjell një erozion tepër të dallueshëm midis zonave urbane dhe rurale dhe zhvlerësimin e vlerave të peizazhit.

Ndikimi mjedisor i zhvillimit urban në kushtet aktuale është relativisht i lartë në krahasim me standardin e jetesës.

## **Industria**

Niveli i aktivitetit industrial është shumë më i ulët se në dekadat e mëparshme. Megjithatë, ndikimi i aktiviteteve që kanë mbetur dhe i të rejave që janë krijuar është i lartë në krahasim me vlerat e rezultateve. Kështu për shembull, informacioni i paraqitur në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike tregon se shkarkimet e CO<sub>2</sub> për banorë janë shumë më të ulëta se në shumicën e vendeve të industrializuara, por që shkarkimet e CO<sub>2</sub> për njësi të GDP janë shumë më të larta sesa ato të vendeve të industrializuara.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) janë normalisht të sigurta në infrastrukturën komunale për shërbimet e grumbullimit të ujërave të mbetura dhe mbetjeve të ngurta. Sidoqoftë, në mungesë të një infrastrukture të tillë, SME<sup>te</sup> kanë dy mundësi bazë: ose mund të investojnë shumë në pajisjet e tyre të kontrollit të ndotjes duke bërë në këtë mënyrë që të jenë më pak konkurruese ose ato mund të vazhdojnë të ndotin më shumë nga standardet e lejuara.

Për industrinë e mëdha është siguruar një farë përparimi përfshirë edhe sigurimin e përmirësuar të trajtimit të ujërave të mbetura në rafinerinë e Ballshit si dhe instalimin e filtrave të pluhurit në fabrikën e çimentos së Elbasanit. Megjithatë rafineria e Ballshit dhe Industria e Naftës mbeten në përgjithësi joefikase dhe të vjetruara që çojnë në nivele të larta të dëmtimit të mjedisit për njësi të prodhimit, nëpërmjet shkarkimeve në ajër, pikimeve, rrjedhjeve dhe shkarkimeve në ujë.

Industria e ndërtimit, përfshirë edhe furnizuesit e lëndëve të para është rritur me shpejtësi të madhe gjatë viteve të fundit. Performanca mjedisore e kësaj industrie është shumë e keqe pasi ka shumë vende ndërtimi që shkaktojnë nivele të larta shqetësimesh në formën e zhurmës, pluhurit, shqetësimeve të përgjithshme siç është për shembull dëmtimi në vende të ndryshme të rrugëve. Dëmtime janë shkaktuar gjithashtu edhe nga rregullimi i pamjaftueshëm ligjor i funksionimit të guroreve dhe/ose lavatriçeve të inerteve që shfrytëzojnë zhavorrin e lumenjëve.

## **Transporti**

Transporti dominohet nga sektori rrugor. Niveli i transportit hekurudhor është i ulët dhe nuk parashikohet të rritet<sup>3</sup>. Volumi i trafikut ajror është gjithashtu relativisht i ulët në krahasim me shumicën e vendeve Europiane por ai parashikohet të rritet. Ndikimet kryesore mjedisore që shkaktohen nga transporti shoqërohen me zhvillimin dhe shfrytëzimin e rrjetit të transportit rrugor. Ndonëse rrjeti aktual është relativisht i vogël dhe i shtrirë/rrallë në krahasim me vendet e tjera Europiane, është planifikuar të investohet në shumë rrugë të reja dhe në ato që do të zgjerohen gjatë viteve të ardhshme. Kjo do të ketë ndikime të tjera mbi peizazhin dhe biodiversitetin. Pronësia e mjeteve të transportit, 57 për 1000, në Shqipëri është e ulët në krahasim me shumicën e vendeve Europiane (Vendet e EEA: mbi 50 për 1000 banorë në vitin 2000)<sup>4</sup>. Po ashtu, numri i kilometrave për person është gjithashtu i ulët. Sidoqoftë, transporti po shkakton ndikime serioze në zonat urbane. Në mënyrë të veçantë cilësia e ajrit të qytetit është dëmtuar keqas. Nëse niveli i pronësisë së mjeteve të

<sup>3</sup> Plani Kombëtar i Transportit Shqipëtar, 2004

<sup>4</sup> Agjencia Europiane e Mjedisit

transportit rritet deri në atë të vendeve të tjera Europiane, këto ndikime do të jenë edhe më të forta e më negative. Nivelet e larta të shkarkimeve për km të përshkuar shkaktohen nga:

- Cilësia e dobët e karburantit të përdorur – standardet aktuale të karburanteve janë më pak të rrepta se sa standardet e BE;
- Moshë mesatare relativisht e madhe e mjeteve të transportit (mbi 10 vjet) në krahasim me mesataren e vendeve të BE që është 7 vjet;
- Përdorimi i automjeteve të mëdha dhe pak efikase;
- Standardi i keq i mirëmbajtjes së automjeteve<sup>5</sup>;
- Administrim jo-efikas i trafikut që çon në dyndje dhe kohë të gjatë pritjeje në trafik;
- Kushte të këqija të rrugëve gjë që çon në ecjen me shpejtësi shumë të ulët si dhe në nivele të larta të përkeqësimit të gjendjes teknike të automjeteve.

## Bujqësia

Intensiteti i bujqësisë konsiderohet i ulët krahasuar me dekadat e shkuara. Konsumi i plehrave kimike dhe pesticideve është relativisht i ulët dhe përdorimi i ujit për vaditje është më i ulët se më parë. Megjithatë, janë bërë investime të konsiderueshme në rindërtimin e rrjetit të vaditjes dhe kullimit dhe ekziston një mundësi për ri-intensifikimin e sektorit bujqësor, subjekt i zhvillimit të tregut të lirë të tokës. Praktikë aktuale të kultivimit nuk janë të përshtatshme, siç është për shembull plugimi jo në drejtimin e duhur i tokës në shpatet e kodrave, gjë që i bën këto zona subjekt të një erozioni të fortë. Për më tepër, shfrytëzimi i varieteteve vendase po vjen duke u pakësuar.

## Energjia

Sasia më e madhe e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet. Ky është një burim i pastër i energjisë dhe ka nivele të ulëta të dëmtimit të mjedisit. Megjithatë kapaciteti i prodhimit është i pamjaftueshëm për të përmbushur të gjithë nevojat e vendit gjatë gjithë vitit. Gjatë viteve të fundit, kjo situatë ka çuar në periudha relativisht të gjata të mungesës së energjisë. Konsumatorët vendas i janë drejtuar shfrytëzimit të sistemeve ndihmëse në formën e gjeneratorëve me naftë për furnizimin me energji elektrike të banesave ose aktiviteteve të tyre tregtare. Këta gjeneratorë e shtojnë nivelin e shkarkimeve në ajër në zonat urbane. Ekziston një nevojë e identifikuar qartë për kapacitete të reja të prodhimit të energjisë.

Sistemi i shpërndarjes së elektricitetit ka nevojë për modernizim dhe në sistem ka shumë lidhje dhe ndërhyrje të parregullta. Përdorimi i elektricitetit për frymë të popullsisë përse i përket mesatares është relativisht i ulët (1 427 kWh konsum në 2003 në krahasim me mbi 5 000 në Itali). Megjithatë, kërkesa po shtohet me shpejtësi (1 165 kWh më 2000)<sup>6</sup>. Nivelet e efikasitetit të energjisë janë relativisht të ulëta. Në veçanti, ndërtesat janë të izoluara keq dhe shumë pajisje, siç janë ato të ajrit të kondicionuar dhe frigoriferët, janë të një efikasiteti teknik të ulët.

## Turizmi

Një numër aktivitete të shoqëruara me industrinë e turizmit, po kontribuojnë me ndikime të ngjashme si dhe ato të zhvillimit urban, veçanërisht përgjatë zonave bregdetare. Kjo industri karakterizohet nga një numër i madh zhvillimesh të planifikuara keq, të cilave u mungon infrastruktura e duhur komunale, veçanërisht furnizimi me ujë dhe grumbullimi e trajtimi i mbetjeve, si atyre të lëngëta (ujërat e zeza) ashtu edhe atyre të ngurta.

---

<sup>5</sup> Sistemi i testimit të automjeteve është në funksion, por kontrolli i shkarkimeve të gazeve të dëmshëm në atmosferë nuk është i rreptë dhe është larg kërkesave të BE

<sup>6</sup> Të dhëna nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike

## Aktivitetet e tjera

Të tjerë aktivitetet po shkaktojnë gjithashtu dëmtime të mëdha mjedisore. Gjuetia ilegale e zogjve dhe sisorëve është duke i sabotuar të gjitha përpjekjet që po bëhen për një administrim të kujdesshëm e të qëndrueshëm të biodiversitetit. Industria e peshkimit detar është gjithashtu e rrezikuar, veçanërisht si pasojë e peshkimit intensiv në zonën afër bregdetit, për shkak të nivelit të ulët të perfeksionimit të flotës së peshkimit.

## Aktivitetet e së shkuarës

Toka e ndotur në formën e mbetjeve industriale të braktitura, ndërmarrjet minerare dhe hedhjet e mbetjeve përbëjnë një problem të madh. Ndonëse është ndërmarrë një farë aktiviteti përmirësues i këtyre zonave, shumica e tyre përsëri përbëjnë një kërcënim për shëndetin e njerëzve dhe nuk janë në kushte të përshtatshme për zhvillim. Vendet e depozitimit të mbetjeve nuk janë pajisur me masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe përveç kësaj administrohen shumë keq.

## Mbetjet

Niveli aktual i prodhimit të mbetjeve për frymë të popullsisë nuk dihet meqenëse shumica e pikave të grumbullimit dhe depozitimit të tyre nuk kanë pajisje të peshimit. Normat e adoptuara për prodhimin e mbetjeve arrijnë një mesatare prej 280 kg për frymë të popullsisë në vit, në zonat urbane dhe 110 kg për frymë të popullsisë në vit, në zonat rurale<sup>7</sup>, gjë që është shumë më e ulët krahasuar me nivelin e 500 kg mbetje/banor/vit që haset në shumicën e vendeve antare të BE.

Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel të ulët. Sisteme për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane janë siguruar në shumicën e qyteteve, por riciklimi i mbetjeve është shumë minimal. Metoda kryesore për depozitimin e mbetjeve është hedhja në vendet e caktuara për to. Në vend nuk ka vendgrumbullime të mbetjeve (land-fille) të cilët të jenë projektuar e ndërtuar në bazë të kërkesave e standardeve inxhinierike të kohës. Në zonat rurale dhe në qytetet e vogla nuk ka sisteme grumbullimi. Shumica e mbetjeve në këto zona hidhet në kanale, përrenj, ose buzë rrugëve ku merren nga uji ose nga era dhe transportohen në vende të tjera, duke përfunduar në rrjedhat ujore. Nuk ka asnjë sistem për administrimin e sigurtë të mbetjeve të rrezikshme (qofshin ato shtëpiake apo tregtare).

## Burimet Kushtuar Administrimit të Mjedisit

Gjatë viteve të fundit, janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar administrimin mjedisor. Krijimi i Ministrisë së Mjedisit, e cila tani është zgjeruar dhe është bërë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ishte një hap i madh përpara. Kjo Ministri mbështetet nga një numër i madh institucionesh, përfshirë Agjencinë Mjedisit dhe Pyjeve dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit. Megjithatë, shumë Ministri dhe Institucione të tjera janë përfshirë në administrimin e mjedisit. Për këtë arsye, është e vështirë të vlerësohet me një shkallë të arsyeshme saktësie niveli total i shpenzimeve publike në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Megjithatë, disa tregues të këtij angazhimi që po bëhet, mund të përftohesh duke marrë parasysh madhësinë e administratës në lidhje me popullsinë dhe nivelin e shpenzimeve kapitale.

Numri total i personelit të angazhuar në programin e mbrojtjes së mjedisit të MMPAU është afërsisht 200 vetë. Ky përbën një raport prej afërsisht 1 anëtar i stafit për 14 000 banorë. Ky raport është i ulët. Shtetet e rinj, anëtar të Bashkimit Europian, kanë një raport prej 1 : 4 000. Ndërkohë që krahasime të tilla nuk janë shumë të sakta, meqenëse përkufizimi i mbrojtjes së mjedisit është i ndryshëm për vende të ndryshme, numri i stafit është qartësisht më i ulët sesa ai që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme nga një shtet që aspirohet dhe pret antarësimin në BE.

Niveli i kapacitetit të imponimit të zbatimit të ligjit është krahasimisht i ulët. Detyrat e inspektimit mjedisor u janë ngarkuar Agjencive Rajonale të Mjedisit, të cilat kanë një personel prej 40 vetësh

---

<sup>7</sup> Prodhimi i mbetjeve në vendet e BE arrin përafërsisht 500 kg për frymë të popullsisë në vit.

gjithsej. Përveç numrit të ulët, ky personel nuk është i pajisur me infrastrukturën e mjaftueshme për të kryer, në mënyrë efikase, detyrat e veta. Shumica e tyre nuk kanë mjete transporti, telekomunikacioni ose pajisje të tjera zyre, të domosdoshme për kryerjen e detyrës.

Shpenzimet për monitorimin mjedisor janë respektivisht të ulëta dhe përbëjnë një përqindje të vogël të asaj që do të kërkohet për t'u përshtatur dhe respektuar kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Europian apo ato të legjislacionit kombëtar.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) administron një program investimesh kapitale i cili kontribuon në ngritjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mjedisore komunale përfshirë furnizimin me ujë të pijshëm, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të mbetura dhe administrimin e mbetjeve të ngurta. Shpenzimi total në sektorin e pastrimit (mbledhja e ujërave të bardha e të zeza, përpunimi i ujërave të zeza, mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve të ngurta) në këtë program të investimeve kapitale, për vitin 2006<sup>8</sup>, është 381 milion Lekë (rreth 120 Lekë/frymë/vit).

Kostoja totale e investimeve publike, që duhen bërë në sektorët e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të mbetura dhe në administrimin e mbetjeve të ngurta, për të arritur standardet e Komunitetit Europian, është e vështirë të përlogaritet me saktësi. Megjithatë, nëse kjo kosto është e njejtë me atë të vendeve të reja që hynë së fundi në BE, atëherë duhen pritur investime prej më shumë se 1 miliard Eurosh sipas çmimeve aktuale. E thënë thjeshtë, që të arrihet ky nivel investimesh për një periudhë 20 vjeçare, do të duheshin investime prej 50 milion Eurosh në vit në infrastrukturën e ujërave të mbetura dhe në atë të mbetjeve të ngurta. Aktualisht kjo nuk po arrihet.

Mbështetja e donatorëve është siguruar për disa vite, veçanërisht për sektorin e ujit. Investime të shumta që arrijnë disa qindra milionë Euro janë siguruar si grante dhe huara për projekte në sektorin e ujit gjatë 5 viteve të fundit. Fusha e prioritetit për këto investime ka qenë furnizimi me ujë, ndonëse edhe një numër investimesh tanimë janë përfunduar në fushën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të mbetura. Një sasi shumë më e vogël është siguruar për administrimin e mbetjeve të ngurta.

Po ashtu shpenzime të rëndësishme janë bërë nga qeveria dhe donatorët për përmirësimin e zonave të ndotura të shkaktuara nga veprimtaritë e braktisura industriale. Me gjithë këto përpjekje, një numër i madh i këtyre "zonave të nxehta" nuk janë restauruar plotësisht përfshirë këtu komplekset industriale në Elbasan, Fier, Vlorë, Durrës, Laç dhe Rubik.

Statistikat lidhur me nivelin e investimeve nga sektori privat në mbrojtjen e mjedisit tani për tani nuk janë të disponueshme. Tarifat e paguara nga konsumatorët për shërbime mjedisore komunale janë të ulëta. Ndërsa sistemi i vendosjes së tarifave lejon rigjenerimin e kostove operative, të ardhurat e siguruar janë të pamjaftueshme që të lejojnë realizimin e ndonjë investimi kapital të rëndësishëm nga operatorët e shërbimeve bashkiake. Tarifat mund të ngrihen. Megjithatë, edhe nëse tarifat do të ngriheshin deri në cakun përgjithësisht të mundshëm e të përballueshëm, të ardhurat që do të siguroheshin do të ishin përsëri të pamjaftueshme për të siguruar një investim kapital të rëndësishëm e të vazhdueshëm.

Duhet theksuar se ka shumë lidhje "informale" në rrjetin e furnizimit me ujë, të cilat nuk janë rregulluar ende. Sasia e të ardhurave të grumbulluara nga pagesat për furnizimin me ujë dhe grumbullimin e ujërave të mbetura dihet se janë ende relativisht të ulëta. Si rezultat i këtyre faktorëve shumë investime apo ndërhyrje të sektorit ujor nuk janë të qendrueshëm nga ana financiare në formën e tyre të tanishme.

Një mundësi potenciale për rritjen e nivelit të investimeve do të ishte privatizimi i këtij sektori. Kjo ka filluar tashmë nëpërmjet të komercializimit të funksionimit të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve. Megjithatë, niveli i ulët i të ardhurave i krijuar nga aktivitetet e shërbimeve komunale e bën

---

<sup>8</sup> Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

privatizimin “më të thellë” nëpërmjet të shitjes së asetëve të pazbatueshëm dhe të pasuksesshëm, përderisa duket një aktivitet jo tërheqës për investitorët.

Shfrytëzimi i koordinuar i ndihmës së donatorëve ka qenë gjithashtu një çështje shqetësuese gjatë viteve të fundit. Zhvillimi i Tryezave të Rrumbullakëta një herë në tre muaj midis Donatorëve dhe Qeverisë si dhe puna e Departamentit të Koordinimit të Donatorëve dhe Strategjive kanë ndihmuar shumë për trajtimin e kësaj çështjeje. Megjithatë, ka ende nevojë për një trajtim të orientuar më shumë drejt përfitimeve në shfrytëzimin e mbështetjes së donatorëve.

Nivelet e ndërgjegjësimit të publikut janë të ulëta dhe komunikimi për çështjet mjedisore është relativisht i dobët. Kjo është një fushë, e cila mund dhe duhet të rritet me një kosto relativisht të ulët.

## **Përputhja Legjislative**

Dokumenti kryesor i politikave për arritjen e përputhjes legjislative është Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL).<sup>9</sup> Ashtu si edhe për sektorët e tjerë, seksioni që merret me mjedisin tregon një numër shumë të madh ndryshimesh legjislative, që kërkohen për të arritur përputhjen e Legjislacionit Shëqiptar me atë të BE<sup>së</sup>.

Një rishikim i fundit i legjislacionit mjedisor shqiptar tregon se:

- Legjislacioni kryesor është i gjërë për nga fusha e synimet, ndonëse nuk i mbulon të gjitha fushat e *acquis-it*
- Shfrytëzon shumë nga mjetet rregullatore në dispozicion;
- Regjimi i Komandës dhe Kontrollit i ofruar nga ky legjislacion mjedisor nuk është efikas në sigurimin e përputhjes; dhe
- Shfaq probleme strukturore – pjesërisht legjislacioni nuk është i qartë dhe në shumë raste, rregullat që kërkon të imponojë ai nuk janë realiste ose të drejta. Së fundi, problemi është se rregullat që krijon legjislacioni si dhe mekanizmat e imponimit të këtyre rregullave nuk janë funksionalë.

Mbi bazën e këtij vlerësimi është e qartë se:

- Ka një hendek të konsiderueshëm midis legjislacionit aktual shqiptar dhe atij të Komunitetit Euripian;
- Duhet bërë një rishikim i legjislacionit ekzistues, para se të arrihet një progres si me transpozimin ashtu edhe me zbatimin e tij.

## **Zbatimi i Legjislacionit**

Zbatimi me sukses i legjislacionit varet nga një mori faktorësh, nga të cilët më të rëndësishmit janë:

- Cilësia e legjislacionit;
- Përpjekjet e bëra për të inkurajuar përputhjen me legjislacionin;
- Shkalla e respektit për ligjin, nga popullata;
- Investimet financiare të bëra nga grupet relevante të interesit;
- Niveli i përpjekjeve të shpenzuara për imponimin e legjislacionit;
- Strukturat institucionale, që janë krijuar për të siguruar zbatimin e tij.

Sikurse është theksuar më sipër, ka mangësi në një numër fushash. Ka probleme strukturore, që kanë të bëjnë me legjislacionin aktual shqiptar. Për më tepër, niveli i përhapjes së legjislacionit dhe ndërgjegjësimit të popullatës në këtë fushë është relativisht i ulët. Drejtimi dhe këshillimi për grupet e interesit, në shërbim të reklamimit të akteve ligjore dhe standardeve të rinj është shumë i rrallë. Për

---

<sup>9</sup> Përditësimi më i fundit – Korrik 2006

pasojë niveli i njohjes së ligjit është i ulët. Ky faktor, midis të tjerëve, ndihmon në pasjen dhe demonstrimin e një niveli relativisht të ulët të respektit për legjislacionin mjedisor.

Janë ndërmarrë veprime për të trajtuar shkeljet e legjislacionit. Megjithatë, shumë prej gjobave financiare që u vihen shkelësve, aktualisht nuk janë vjelur.

## **Përfundime**

Gjatë viteve të fundit është bërë një përparim i konsiderueshëm në fushën e administrimit të mjedisit. Në veçanti duhet theksuar se është krijuar një numër i madh ligjesh mjedisore, janë krijuar institucione dhe tani po bëhen disa investime në infrastrukturën mjedisore komunale. Megjithatë, mbeten përsëri një numër pengesash për arritjen e një zhvillimi të qendrueshëm si dhe në arritjen e niveleve të mbrojtjes së mjedisit, të cilat mund të konsiderohen si të përshtatshme veçanërisht për një shtet që kërkon të hyjnë në BE, dhe veçanërisht:

- Niveli i shpenzimeve publike për kostot operative të mbrojtjes së mjedisit është shumë i ulët për të siguruar komunikimin e përshtatshëm, drejtimin, ndërgjegjësimin dhe/ose imponimin e ligjit;
- Niveli i shpenzimeve publike në infrastrukturën për mbrojtjen e mjedisit është shumë i ulët për të arritur standardet Europiane në një të ardhme të parashikueshme;
- Aktivitetet ekonomike, veçanërisht transporti, janë relativisht jo efikas dhe shkaktojnë një nivel të lartë të ndikimit të mjedisit për njësi të aktivitetit.

Si pasojë e këtyre problemeve gjendja e mjedisit nuk është, në shumë raste, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar ose Europian dhe është në rrezik të përkeqësohet më tej, duke dëmtuar shëndetin e njerëzve, duke prekur potencialin zhvillimor e duke pakësuar potencialin e aktiviteteve me përfitim ekonomik, sikurse është një turizmi me vlera të larta.

## **II. Vizioni dhe Prioritetet**

*“Zhvillimi i shpejtë dhe i qendrueshëm është objektivi bazë i qeverisë së re.*

Për të arritur hyrjen në Bashkimin Europian, vendi ka nevojë që gjatë dekadës së ardhshme të realizojë përputhjen me legjislacionin e Komunitetit Europian në fushën e mjedisit. Në disa raste, veçanërisht në elementët e legjislacionit të Komunitetit që kanë si kusht “investime të rënda”, përputhja e plotë nuk do të përfundojë deri në një farë kohe pas hyrjes, sikurse edhe në rastin e shumë prej shteteve të reja anëtare. Sidoqoftë, edhe në këto fusha duhet bërë një progres i konsiderueshëm. Mjedisi është një nga komponentët më të mëdhenj të legjislacionit të Komunitetit Europian dhe vërtetohet se është një nga fushat më të vështira, për të arritur përputhshmëri.

Programi i Qeverisë për periudhën 2005 – 2009 përcakton prioritetet në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimin e qendrueshëm të burimeve natyrore. Në mënyrë të përmbledhur këto prioritete janë:

1. Forcimi i disiplinës së ligjit në mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht për aktivitetet që shkaktojnë ndotje të ajrit dhe/ose ujit, prekin potencialet e turizmit, dëmtojnë pyjet dhe shkaktojnë erozion të tokës;
2. Ulje e ndjeshme e nivelit të ndotjes së ajrit në zonat urbane;
3. Eliminimi i shembujve/burimeve më seriozë të ndotjes së ujërave sipërfaqësore;
4. Rehabilitimi i “Pikave të Nxehta” mjedisore, të shkaktuara nga industritë e vjetra e të braktisura;
5. Parandalimi i erozionit të tokës dhe rehabilitimi i digave mbrojtëse, pyjeve dhe kullotave;
6. Përmirësime në administrimin e mbetjeve, për të ulur humbjen e burimeve dhe minimizuar ndotjen;

7. Krahas forcimit të disiplinës, për një sjellje miqësore me mjedisin, do të vihen në përdorim stimujt në shërbim të uljes së ndotjes të shkaktuar nga aktivitetet ekonomike dhe individët, investimeve në “teknologji të pastra”, ruajtje të energjisë, përdorim efikas të burimeve natyrore dhe investimeve në mjedis;
8. Vendojen e një Fondi të veçantë për Mjedisin, i cili do të shërbejë për financimin e projekteve për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimet teknologjike që përmirësojnë gjendjen e mjedisit;
9. Përmirësimin e përkufizimit të së drejtës së pronësisë dhe garantimi i zbatimit të saj, përfshirë transferimin e pronës dhe të drejtën e përdorimit të disa burimeve mjedisore të komunitetit, si pyje, kullota, ujërat dhe/ose tokat;
10. Parandalimi i shfrytëzimit pa kriter dhe i paqëndrueshëm i faunës së egër, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve monitoruese dhe mbrojtëse dhe rritjes së masave shtrënguese e ndëshkimore për shkelësit e ligjit;
11. Dyfishimi i sipërfaqes së zonave të mbrojtura me ligj, duke garatuar jo vetëm mbrojtjen e tyre, por edhe një zhvillim të metejshëm, duke gjetur mënyrat dhe instrumentet e duhur ekonomike dhe mjedisore;
12. Shfrytëzimi racional dhe efikas i burimeve minerare, nëpërmjet liberalizimit të tregut dhe duke ofruar lehtësira konçensionare për investitorët vendas dhe të huaj. Këto konçensionare do të përfshijnë edhe kushtet që garantojnë njëkohësisht edhe mbrojtjen dhe rimëkëmbjen e mjedisit;
13. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi gjendjen reale të mjedisit, duke nxitur pjesëmarrjen e publikut nëpërmjet shoqërisë civile dhe organizatave të pavarura;
14. Përmirësimi i procedurave të ankimit administrativ dhe gjyqësor, për të përmirësuar dhe rritur në këtë mënyrë mundësinë e pro-mjedisore dhe qytetarëve të thjeshtë të kërkojnë mbrojtjen e mjedisit dhe t'i drejtohen gjykatës për probleme mjedisore.

### **III. Problemet dhe Politikat**

Prioritetet e përcaktuara nga Programi i Qeverisë, duhet të konsiderohen nga një numër problemesh dhe politikash të përgjithshme.

#### **Imponimi i Respektimit/Zbatimit të Legjislacionit Mjedisor**

Imponimi i zbatimit të legjislacionit dhe shtimi i masave ndëshkuese ndaj shkelësve të legjislacionit mjedisor, është padyshim i nevojshëm. Imponimi i zbatimit të legjislacionit aktualisht është i dobët. Një imponim më i madh do të kërkojë burime shtesë që duhet t'u jepen Agjencive Rajonale të Mjedisit. Përforcimi i Agjencive Rajonale të Mjedisit do t'i ndihmojë ato gjithashtu të veprojnë dhe funksionojnë si një mjet lidhës për komunikimin midis nivelit qendror/kombëtar dhe atij vendor, i cili do të jetë gjithmonë e më i rëndësishëm, ndërkohë që vazhdon procesi i decentralizimit. Për më tepër, ARM<sup>te</sup> do të jenë në gjendje të veprojnë si një kapacitet këshillimor për të ndihmuar autoritetet vendore në plotësimin e detyrimeve të tyre në sektorin mjedisor dhe të mund të luajnë një rol më aktiv në ndërgjegjësimin e mëtejshëm të popullatës së rajonit të tyre.

Po ashtu kërkohet një imponim apo detyrim i zbatimit të rreptë të ligjit kundër aktiviteteve ekonomike të paligjëshme. Megjithatë, imponimi i suksesshëm do të kërkojë përmirësime në sistemin e lejeve, i cili është mekanizmi kryesor i kontrollit. Ndërsa përmirësimet në dhënien e lejeve dhe imponimi do të krijojë përfitime mjedisore, përmirësime të tilla duhet të jenë realiste dhe të arritshme në linjë me nocionin e “teknologjisë më të mirë të disponueshme” ku industritë dhe njësitë e tjera ekonomike mund t'i planifikojnë investimet e tyre në teknologjinë e re dhe masat e mbrojtjes mjedisore. Nuk është e përshtatshme që t'u kërkohej aktiviteteve ekonomike që të kompensojnë mungesën e infrastrukturës së shërbimeve komunale siç janë kanalet e ujërave të zeza.



Aktualisht niveli i respektit për ligjin mjedisor është disi i ulët. Arritja e ndryshimeve në sjellje dhe ndryshime të individëve dhe të njësive tregtare do të kërkojë një numër masash përfshirë këtu përmirësimet në legjislacion dhe komunikim. Sidoqoftë, një nga elementet kyç duhet të jetë imponimi dhe ndëshkimi i rreptë e i dukshëm ndaj shkelësve të ligjit. Një sërë fushatash imponimi për të trajtuar probleme specifike janë mëse të domosdoshme.

Ashtu sikurse është theksuar, niveli aktual i burimeve administrative që i kushtohet mbrojtjes së mjedisit është i pamjaftueshëm për të arritur nivelin e kërkuar të imponimit. Përforsimi i 12 inspektorateve rajonale kërkohet me urgjencë. Aktualisht janë vetëm 40 inspektorë në të gjithë vendin dhe shumë prej tyre nuk kanë mjete transporti. Inspektoratet kanë nevojë të kenë personel dhe infrastrukturë të mjaftueshme, për të demonstruar sa më qartë vullnetin e shtetit për parandalimin dhe luftën kundër krimit mjedisor. Sasia e personelit të kërkuar për të siguruar një frenim të tillë është i vështirë të vlerësohet meqenëse ky fakt varet shumë nga shkalla e respektimit të ligjit. Krahasimi me numrin e personelit në organizata të ngjashme në vendet e përfshira në valën aktuale të pranimit në BE, sugjeron se një minimum prej 10 personash për rajon është i përshtatshëm. Kjo do të detyrojë një rritje të stafit nga 40 që është aktualisht në 120. Një rritje e tillë nuk është e mundur për një periudhë afatshkurtër. Prandaj, një rritje më e moderuar/pranueshme e personelit me 20 punonjës, gjatë tre viteve që vijnë do të synohet të zbatohet. Kjo do të shoqërohet me parashikimin dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme, përfshirë makina, kompiuterë, dhe pajisje komunikimi.

### **Adoptimi i Standardeve Ligjore të Komunitetit European**

Adoptimi i standardeve të Komunitetit European si për shkarkimet dhe cilësinë e mjedisit të ambientit është një kërkesë e procesit të pranimit në BE. Veprimet që duhen ndërmarrë për të arritur këtë janë për t'u specifikuar në planin kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL). Sikurse theksohet në PKPL, transpozimi dhe implementimi i standardeve të BE do të kërkojë një rritje të burimeve në sektorin publik që merret me çështjet mjedisore. Megjithatë, edhe me këto burime të shtuar, nuk është e mundur as për sektorin publik dhe as për atë privat, t'i plotësojë të gjithë këto standarde gjatë periudhës afatshkurtër ose afatmesme. Shkalla e ndryshimeve dhe investimeve të kërkuara është tepër e madhe.

Prandaj legjislacioni i ri, përfshirë edhe atë të përcaktuar nga Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit ka nevojë të përcaktojë objektivat e përkohshme që krijojnë një trajtim të ndarë në faza për arritjen e Standardeve të Komunitetit European në një Periudhë më afatgjatë. Me qëllim që të sigurojmë një balancim, midis mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik, standardet e përkohshme duhet të dalin mbi bazën e një analize financiare dhe ekonomike të implikimeve të çdo pjese të legjislacionit. Zbatimi i "të tilla vlerësimeve të kostove të përputhjes" do të lejojë zbatimin e disa standardeve të ndërmjetme, të cilët do ti japin mundësi industrisë së vendit që të pajiset me një mjedis rregullator më të mirë, në të cilin do të bëjnë planet e biznesit dhe do të marrin vendimet për investime.

### **Cilësia e Ajrit**

Një nga objektivat kyçe e përfshirë në Program është pakësimi i ndotjes së ajrit. Një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit në zonat urbane janë automjetet e transportit rrugor. Flota aktuale e automjeteve në Shqipëri është relativisht e vjetër. Ripërtëritja e kësaj flote do të kërkojë një kohë të gjatë dhe shumë shpenzime, kryesisht për sektorin privat dhe individët. Stimujt për të blerë automjete më të reja dhe, më efikase përsa i përket efikasitetit të djegies së karburantit së bashku me imponimin e standardeve të rrugëve si dhe normat e shkarkimit të automjeteve do të vazhdojë për një periudhë vitesh për arritjen e pakësimeve të qenësishme të shkarkimeve për km të përshkuar. Megjithatë, kërkesa për transport është në rritje. Nëse fokusi i politikës së transportit për automjetet rrugore do të vazhdojë të jetë i njëjtë, atëherë niveli i ndotjes ka shumë gjasa që të mbetet i lartë meqenëse edhe numri i automjeteve do të vazhdojë të rritet. Për këtë arsye një strategji afatgjatë për futjen e sistemeve efektive të transportit publik është e nevojshme për zonat urbane, së bashku me përmirësimet për planifikimin urban dhe kontrollin e zhvillimit. Në një periudhë afatshkurtër, shkarkimet nga automjetet duhen kontrolluar më mirë, nëpërmjet të futjes së standardeve të karburanteve dhe

kërkesave të shkarkimit të automjeteve. Kostot e sektorit publik të shoqëruara me masa të tilla janë të kufizuara në administrimin e kontrolleve të tilla. Kosto të tilla, përfshirë edhe ato që shoqërohen me inspektime të shtuara të automjeteve si dhe zbatimin e plotë të kushteve të kontrollit të shkarkimeve ligjore, trajtohen nga Ministria e PPTT. Kostoja për sektorin privat, duke përdorur karburante të cilësisë së mirë, nuk do të jetë e lartë, meqenëse diferenca midis cilësive të ndryshme të karburantit është relativisht e ulët.

Kontrolli i përmirësuar i shkarkimeve nga pajisjet dhe qendrat industriale, veprimtaritë e ndërtimit, vend-depozitimeve të mbetjeve dhe godinave e lokaleve më të vogla, do të jenë të nevojshme në shumë zona. Përmirësime të tilla do t'i imponojnë kosto të qenësishme sektorit privat. Kostot e kontrollit dhe inspektimit do të përballohen nga sektori publik.

Vlerësimet e kostos për sektorin privat për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit në zonat urbane, janë subjekt i një niveli të lartë pasigurie. Vështirësitë për bërjen e këtyre vlerësimeve shkaktohen, në pjesën më të madhe, për shkak se nivelet e sakta të shkarkimeve nga sektorë të ndryshëm dhe kushtet mjedisore të ambientit nuk monitorohen. Prandaj, kërkohen kapacitete shtesë për monitorimin e mjedisit. Vlerësimi i kostove për probleme të tilla po përgatitet nën përkujdesjen e projektit StEMA të Programit CARDS të BE.

## Cilësia e Ujit

Investimet e kërkuara për të arritur standardet e BE në sektorin e ujit, pranohet se janë disa nga më të lartat në procesin e pranimit në BE. Shumicës së Shteteve të reja anëtare ju lejua një kohë shtesë (periudhë tranzicioni), gjatë së cilës duhej të arrinin këto standarde. Kjo strategji përcakton objektiva që do të sigurojnë arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit më 2015 dhe standardet e Bashkimit Europian në sektorin e ujit më 2020.

### **Objektivat e Sektorit të Ujit**

Objektivat	Treguesit e Rezultateve	2002	2004	2010	2015	2020
		<b>Faza Fillestare</b>			<b>OMZH</b>	
<b>Uji në Zonat Urbane</b>						
Të arrihen synimet e OZHM-së në Shqipëri: Furnizim i qëndrueshëm me ujë të pastër dhe mundësi për përmirësimin e situatës në fushën e kanalizimeve.	<b>(a) Cilësia e ujit</b>	80	85	95	98	98
	Përqindja e popullatës së shërbyer e cila furnizohet me ujë të pastër					
	<b>(b) Sasia minimale</b>	3	4	12	18	20
	Numri mesatar i orëve të furnizimit me ujë në ditë					
	<b>(c) Përmirësim i Sistemit të Kanalizimeve</b>	68	70	78	85	90
	Përqindja e popullsisë e lidhur me rrjetin e kanalizimeve/shkarkimit të ujërave të zeza					
	<b>(d) Përpunimi i Ujërave të Zeza</b>		2	25	58	90
Përqindja e popullsisë e lidhur me pajisjet e përpunimit të ujërave të zeza, të cilat plotësojnë standardet bazë të përpunimit .						
<b>Uji në Zonat Rurale</b>						
Të arrihen synimet e OMZH-së Shqipëri: Furnizim i qëndrueshëm me ujë të pastër dhe mundësi për përmirësimin e situatës në fushën e kanalizimeve.	<b>(a) Cilësia e ujit</b>			86	90	95
	Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pastër					
	<b>(b) Sasia minimale</b>	3	4	7	10	12
	Numri mesatar i orëve të furnizimit me ujë në ditë					
	<b>(c) Higjienë më e lartë</b>	37	40	55	65	75
Përqindja e popullsisë e lidhur me rrjetin e kanalizimit të shkarkimit të ujërave të zeza ose sistemet septike.						

Kostot e shoqëruara me arritjen e këtyre objektivave janë vlerësuar më poshtë. Investime kërkohen gjithashtu edhe nga sektori privat. Për instalimet që janë larg nga zonat urbane, ujërat e mbetura duhet të trajtohen sipas standardeve të larta me qëllim që të përputhen me legjislacionin e BE. Si dhe me përmirësimet e tjera, ndryshime të tilla mund të kenë nevojë të bëhen me faza gjatë një kohe të caktuar. Për ndërmarrjet industriale të vendosura në zonat urbane, do të ishte e paarsyeshme të kërkohej që

sektori privat të trajtonte ujërat e tyre të mbetura në bazë të standardeve shumë të larta, meqenëse ata do t'i trajtonin ato zakonisht sipas një standardi mesatar dhe pastaj t'i shkarkonin në kanalet e ujërave të zeza.

Investimet e kësaj shkalle do të kërkonin:

- Një mekanizëm për identifikimin dhe zhvillimin e propozimeve për zgjidhjet më efikase në çdo zonë gjeografike: një sistem planifikimi të investimeve;
- Një proces për mbështetjen e institucioneve vendore në kryerjen e këtyre investimeve: Fondi Mjedisor dhe një Njësia e Zbatimit dhe Administrimit të Projektit;
- Angazhim financiar nga ana e Qeverisë për të bashkërenditur dhe inkurajuar mbështetjen nga donatorët.

**Kostot e Përafërta të Programit të administrimit të Ujërave dhe Ujërave të Zeza (Milion €)**

Sektori	2006-2010	2011-2015	2016-2020	Gjithsej
<b>Furnizimi i Qyteteve me Ujë të Pijshëm</b>				
Lidhja me një ujësjellës të sigurtë	63.8	33.5	14.7	112
Përmirësim is herbimit (zgjatje e kohës së furnizimit më ujë)	72.7	79.4	82.3	234
<b>Furnizimi i Zonës Rurale me Ujë të Pijshëm</b>				
Lidhja me një ujësjellës të sigurtë	28.0	14.7	21.0	64
Përmirësim is herbimit (zgjatje e kohës së furnizimit më ujë)	72.7	75.6	79.8	228
<i><b>Totali për Programet e Furnizimit me Ujë (në milion €)</b></i>				<b>638</b>
<b>Shkarkimi i Ujërave të Zeza në Zonat Urbane</b>				
Lidhja me rrjetin e shkarkimeve	60.6	60.5	79.9	201
Paisjet për përpunimin e ujërave të zeza që i përmbushin standardet bazë të DTUZ (Direktivës së Trajtimit të Ujrave të Zeza Urbane).	71.0	120.0	135.0	326
<b>Shkarkimi i Ujërave të Zeza në zonat Rurale</b>				
Lidhja me rrjetin e kanaleve të shkarkimit të ujërave të zeza ose gropat septike	80.7	117.0	101.6	299
<i><b>Totali për Programet e Kanalizimit të Ujërave të Zeza (në million €)</b></i>				<b>826</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>				<b>1 464</b>

## Administrimi i Mbetjeve

Administrimi i mbetjeve është një çështje kyç për mbrojtjen e mjedisit. Ndonëse përdorimi i gropave për hedhjen e mbetjeve të përziara, në Europë është duke u pakësuar si pasojë e Direktivës së Landfilleve (1999/31/EC), në periudhën afatshkurtër nuk është e realizueshme të adoptohet në Shqipëri. Prandaj, hedhja e tyre në vendgrumbullime do të duhet të vazhdojë deri në periudhën afatmesme. Kostot e sakta të zbatimit të një sistemi efikas të grumbullimit të mbetjeve, riciklimit dhe depozitimit të tyre janë tepër të vështira për t'u vlerësuar pa ndërmarrë studime të hollësishme për infrastrukturën ekzistuese të grumbullimit. Megjithatë, një e dhënë për shkallën e investimeve që nevojiten, mund të sigurohet duke marrë parasysh koston e ndërtimit të një vendgrumbullimi (landfill) standard. Kostot rreth 5 € për m<sup>3</sup> hapësirë, të ndërtuara sipas standardeve Europiane, janë të zakonshme në këtë rajon. Duke supozuar se sasia e prodhimit të mbetjeve do të jetë midis 300 kg dhe 500 kg për frymë të popullsisë në vit në periudhën afatmesme dhe një jetëgjatësi prej 15 vjetësh të landfillit, atëherë mund të kemi një kosto totale prej përafërsisht 50 milionë Eurosh për çdo landfill të ndërtuar. Duhet theksuar se ky vlerësim nuk merr parasysh mbetjet industriale, tregtare, të ndërtimit, apo mbetjet që rezultojnë nga rehabilitimi i zonave të ndotura. Për këto raste, duhen bërë përllogaritje të tjera. Po ashtu ky vlerësim nuk merr gjithashtu parasysh investimet që do të nevojiteshin për pajisjet e grumbullimit siç janë kontenerët dhe automjetet e grumbullimit ose të pajisjeve të riciklimit.

## Investimi Kapital në Mbrojtjen e Mjedisit

Nevojat bazë për investime kapitale në infrastrukturën mjedisore komunale janë shqyrtuar më lart. Nivelet aktuale të investimeve nuk janë të mjaftueshme për të përballuar këto nevoja gjatë një periudhe afat-shkurtër. Për pasojë është vendimtare që programi aktual i investimeve të përforcohet dhe sa më shpejt që rë jetë e mundur, të zhvillohet një program i qendrueshëm dhe i prioritarizuar investimesh afatgjata, duke pasur parasysh arritjen e standardeve të Komunitetit Europian gjatë 20 vjetëve të ardhshme.

Një program i tillë investimesh publike duhet të trajtojë:

- Furnizimin me ujë të pijshëm – i besueshëm, i mjaftueshëm dhe i një cilësie të përshtatshme;
- Mbledhjen e Ujërave të Mbetura – kanalizime në të gjitha qytezat me një popullsi më të madhe se 2000 banorë;
- Trajtimin e Ujërave të Mbetura – trajtimi dytësor i ujërave të mbetura të mbledhura për të gjithë qytetet;
- Mbetjet e Ngurta – grumbullim, riciklim dhe groposje (vendgroposje dhe djegie).
- Zonat e Ndotura – përmirësim/rehabilitim i “zonave të nxehta”
- Përmirësimin teknologjik të industrive shtetërore

Kostoja e një programi të tillë do të jetë e konsiderueshme – që e tejkalon koston e investimeve prej 1 miliardë Eurosh vetëm për ujërat e mbetura dhe mbetjet e ngurta. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve duhen bërë prej sektorit publik. Ndonëse komercializimi i shërbimeve të grumbullimit të ujërave dhe e shfrytëzimit të ujësjellësave është arritur në disa zona, nuk ka gjasa që privatizimi i infrastrukturës, duke pasur parasysh tërheqjen e investimeve të sektorit privat, do të jetë i suksesshëm. Tarifat aktuale të paguara për shërbime të tilla janë relativisht të ulëta dhe nuk mund të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të bërë investime financiare të suksesshme për një operator komercial. Për pasojë, shumë nga këto investime do të duhet të bëhen nëpërmjet sektorit publik. Shpenzimet aktuale publike për elementet e këtij programi janë të pamjaftueshme për të arritur një gjë të tillë gjatë periudhës 20 vjeçare të cituar më lart.

Investime do të kërkohen gjithashtu dhe nga Sektori Privat. Arritja e standardeve nga industria private duhet të jenë subjekt i kushteve/detyrimeve ligjore, por ato mund të mbështeten gjithashtu edhe nga përdorimi i stimuljeve fiskale ose instrumentave të tjerë ekonomikë. Shpenzimet nga qytetarët/familjet do të kërkohen gjithashtu përfshirë këtu edhe ripërtëritjen e flotës së automjeteve të cilës i jemi referuar më sipër dhe në masat për përdorimin efikas të energjisë siç janë përmirësimi i izolimit të banesave, ose blerjen e pajisjeve të reja me efikasitet më të lartë.

Në përcaktimin e investimeve më të domosdoshme duhen marrë gjithashtu parasysh edhe kostot operative të shoqëruara me investime. Kështu për shembull, zbatimi i një teknologjie ekstensive të trajtimit të ujërave të mbetura mund të kërkojë më shumë tokë për zbatimin e tij, por kostot operative janë shumë më të ulëta, duke lejuar kështu për tarifa më të përshtatshme të mbulimit të kostove, gjë që nuk është në disavantazh as të konsumatorit as të siguresit të shërbimeve.

## Fondi i Mjedisit

Programi zotohet të krijojë një Fond Mjedisor të aftë për të mbuluar financimin e projekteve të investimeve mjedisore, të cilët janë kometencë e disa minsitrive, ku përfshihen zëra të tillë si administrimi i mbetjeve të ngurta, mbledhja dhe trajtimi i ujërave të mbetura dhe efikasiteti i energjisë dhe, përveç këtyre zërave në mënyrë specifike në mbështetje të programit të Mbrojtjes së Mjedisit, nën kujdesin e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Fondi i Mjedisit është krijuar në një numër shtetesh siç janë Bosnja dhe Republika Çeke. Në të dy rastet fondi është krijuar si një njësi financiare “që operon më vetë” i përcaktuar me ligj, i cili administrohet nga një bord ekzekutiv i përbërë nga Ministra dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Një model i tillë do të ndiqet këtu. Burimet administrative dhe volumi financiar i punës do të kërkojë amendime buxhetore të rëndësishme dhe një ndarje të përgjegjësive midis disa Ministrive.

Fondi do të jetë përgjegjës për përpunimin e aplikimeve të projekteve si dhe thithjen e mbështetjes së jashtme për projekte të tilla. Projektet do të prioritarizohen duke përdorur kriteret e shprehura qartë dhe në mënyrë transparente për përzgjedhjen e iniciativave më fitimprurëse si nga ana ekonomike ashtu dhe ajo mjedisore. Duke pasur parasysh transferimin e përgjegjësive tek autoritetet vendore dhe rajonale, shumë prej këtyre projekteve do të propozohen nga autoritetet vendore. Me qëllim që të identifikohen investimet e duhura dhe masat e administrimit, duhen prezantuar sisteme planifikimi për:

- Cilësinë e Ajrit Urban
- Administrimin e Mbetjeve të Ngurta Vendore
- Planifikimin e industrisë së ujit

## **Administrimi i Burimeve Mjedisore**

Programi trajton një numër çështjesh lidhur me administrimin e burimeve mjedisore përfshirë:

- Shfrytëzimin e Burimeve Minerare;
- Administrimin e tokës – kontrollin e zhvillimit;
- Zonat e mbrojtura – rritje në zonat të përcaktuara dhe përmirësime në administrimin e këtyre zonave;
- Mbrojtja e tokës – parandalimi i erozionit;
- Mbrojtja e faunës – parandalim i humbjeve të florës dhe faunës si pasojë e shfrytëzimit të paqëndrueshëm;
- Burimet ujore dhe të drejtat ujore.

Baza për administrimin e burimeve mjedisore duhet të jenë një kuadër i qartë i komandës dhe kontrollit ligjor, që zbatohet nëpërmjet një sistemi lejesh të monitoruar dhe të drejtuara saktë. Kjo është njësoj e aplikueshme për si burimet minerale ashtu siç është për burimet ujore ose tokën. Sistemet e tanishme janë relativisht efikase dhe kanë nevojë të përmirësohen. Në veçanti procesi i alokimit të burimeve dhe i lejeve duhet bërë më shumë transparent dhe i hapur për publikun. Një sistem më i plotë i bazës ligjore mbi shfrytëzimin e tokës/planifikimin hapësinor është duke u hartuar nga MPPTT dhe mbështetet fuqimisht nga MMPAU. Kontrolli i përdorimit të tokës është një nga elementët më thelbësorë, për të bërë të mundur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm e afat-gjatë.

Koncesionet e burimeve minerare ekzistuese do të rinovohen dhe përditësohen për t’u siguruar për faktin që nga koncesionarët kërkohen masa mbrojtëse të përshtatshme dhe efikase. Po ashtu, të gjithë koncesionet e reja, duhet t’u nënshtrohen kushteve të tilla.

Kërkohej një sistem planifikimi për burimet ujore. Planet e krijuara nga sistemi do të drejtojnë më pas dhënien e burimeve ujore për qëllime specifike përfshirë:

- Furnizimin me ujë;
- Aktivitetet komerciale/industriale;
- Bujqësinë.

Një shpërndarje e qëndrueshme burimeve ujore do të bëhet në çdo sektor. Zbatimi i një sistemi të tillë planifikimi do të kërkojë përforsimin e Autoriteteve të Baseneve Lumore aktualë.

Shkaqet e erozionit, dmth, praktikave të paqëndrueshme mjedisore në fushat e bujqësisë dhe pyjtarisë kanë gjithashtu nevojë të trajtohen nëpërmjet planifikimit të administrimit, përfshirë:

- Kodin e praktikave të mira bujqësore;
- Planet e administrimit të pyjtarisë.

Procese planifikimi kërkojnë gjithashtu për zonat dhe speciet e mbrojtura. Forcimi i administrimit të zonave të mbrojtura do të realizohet në mënyrë që të ndihmohet përgatitja e këtyre planeve.

Çështja më e rëndësishme dhe më shqetësuese më të cilën përballet sot globi është ndryshimi i klimës. Shqipëria do të luajë pjesën e saj të rolit në minimizimin e çlirimeve të gazeve serrë, nëpërmjet adoptimit të masave për rritjen e efikasitetit të burimeve të energjisë dhe instalimit të teknologjive të reja, për të siguruar një sektor energjie, të besueshëm, e fikas dhe me shkarkime minimale.

Sikurse u diskutua më lart, efikasiteti i sistemeve të tilla mbështetet në imponimin të legjislacionit dhe në një nivel të lartë të respektit për ligjin. Kjo është trajtuar më sipër lidhur me imponimin dhe më poshtë lidhur me komunikacionin.

## **Komunikimi dhe Ndërgjegjësimi**

Niveli aktual i ndërgjegjësimit mjedisor është i ulët. Kjo rezulton në sjelljen dëmtuese nga ana e qytetarëve. Masat me një kosto relativisht të ulët për të ngritur ndërgjegjen publike mund të ushtrojnë një ndikim të rëndësishëm mbi kushtet e mjedisit. Në veçanti vëmendje u duhet kushtuar masave të cilat:

- Sigurojnë informacion për publikun në një nivel kombëtar dhe vendor;
- Krisin ndërgjegjësimin ndaj kërkesave ligjore;
- Promovojnë një sjellje miqësore ndaj mjedisit.

Janë bërë disa përparime në arritjen e komunikimeve efikase në fushën e mjedisit, por ato kanë nevojë të konsolidohen dhe burimet e departamentit të komunikimit të MMPAU duhen përforcuar për të arritur synimet e programit.

Në një periudhë afatgjatë, ndërgjegjësimi do të rritet nëpërmjet sistemit arsimor dhe integritit më të shumtë të temave mjedisore në programet shkollore dhe në programet e arsimit të lartë.

## **Decentralizimi dhe Pronësia**

Nga programi qeveritar lindin dy çështje kritike, decentralizimi dhe pronësia.

Decentralizimi në kontekstin e administrimit mjedisor do të çojë në një rol shumë më të madh për autoritetet vendore në financimin dhe administrimin e shërbimeve mjedisore vendore përfshirë administrimin e ujit, ujërave të mbetura dhe të mbetjeve të ngurta. Autoritetet vendore aktualisht nuk i kanë burimet financiare me të cilat mund të modernizojnë këto shërbime. Ato kanë nevojë për mbështetje si nga ana e qeverisë vendore ashtu dhe nga donatorët e jashtëm.

Sikurse pohohet në Programin e Qeverisë:

*Funksionet e përbashkëta në fushat e arsimit, shëndetësisë, mjedisit, strehimit, shërbimeve sociale, rendit publik dhe trafikut do të zbatohen plotësisht. Qeveritë vendore do të marrin vendime të pavarura brenda kuadrit të juridiksionit të tyre dhe të bashkëpunojnë sipas parimet të autonomisë, vartësisë dhe partneritetit, me qeverinë qendrore si edhe midis tyre, për arritjen e objektivave kombëtare në këta sektorë, sipas prioriteteve të tyre vendore. Dhënia e fondeve qeverive vendore në këto sektorë publikë, do të zbatohet objektivisht dhe me transparencë, që do të synojnë të ngushtojnë pabarazitë ekzistuese rajonale.*

Ky pohim përputhet me nevojën për të përcaktuar një Fond me bazë të gjerë të Mjedisit që do të shërbejë për të dhënë fondet në një mënyrë transparente dhe objektive që përputhet me shëndetësinë, mjedisin dhe prioritetet e zhvillimit të identifikuar në strategjitë e sektorit.

Autoritetet vendore zotërojnë një pjesë, por jo të gjithë ekspertizën e duhur për të ndërmarrë këto përgjegjësi. Duhet dhënë asistencë teknike si në formën e rregulloreve të shkruara ashtu dhe në

mundësinë e kontaktit me ekspertizën teknike të vazhdueshme në nivel rajonal ose kombëtar. Një program trajnimi do të vihet në dispozicion nga MMPAU dhe ARM<sup>te</sup>.

Pronësia e tokës është gjithashtu një çështje jetike për administrimin mjedisor. Me qëllim që të maksimizojmë përfitimin e siguruar nga toka si për ekonominë ashtu dhe për popullin, duhet bërë një planifikim hapësinor dhe i shfrytëzimit të tokës. Megjithatë, një sistem i tillë do të japë një shfrytëzim fitimprurës vetëm nëse do të kemi një treg funksional të tokës. Një treg i tillë varet nga një sistem i besueshëm dhe i sigurt i pronësisë së tokës. Tani për tani një gjë e tillë nuk ekziston. Në mungesë të klauzolave të tilla është bërë një zhvillim i pakontrolluar dhe i papërshtatshëm. Në veçanti janë ndërtuar shumë banesa në ngastra të vogla të shpërndara në të gjithë zonat e vendit. Sigurimi i shërbimeve për vendbanime të tilla të shpërndara është në mënyrë të konsiderueshme shumë më i kushtueshëm sesa po të ishin të përqendruara në një vendbanim të vetëm.

Shkurt, pronësia e sigurt – që funksionon si treg i tokës – lejon kombinimin e forcave ekonomike dhe rregullatore, krijon mundësi për të gjithë entitetet ta përdorin tokën për qëllime shumë të përshtatshme dhe të maksimizojë përfitimin e përgjithshëm që lind prej saj.

#### **IV. Zbatimi Praktik**

Zbatimi praktik i këtyre politikave do të arrihet nëpërmjet katër masave kryesore:

- Forcimit Institucional
  - o Shtimi i numrit të specialistëve të fushës që do të merren me mbrojtjen mjedisit si në MMPAU ashtu dhe në ministritë e tjera kyç.
  - o Zgjerimi i organizatave mbështetëse përfshirë Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Agjencinë për Mjedisin dhe Pyjet si dhe Autoritetet e Baseneve të Lumenjve.
  - o Sigurimi i mbështetjes së specializuar për autoritetet vendore.
- Dispozitat ligjore
  - o Përmirësime strukturore në sistemin e ligjit mjedisor dhe të ligjeve për kontrollin e shfrytëzimit të tokës dhe të planifikimit hapësinor.
  - o Prezantim i vazhdueshëm i masave ligjore që gjenden në PKPL.
  - o Përforsim i drejtorisë ligjore në MMPAU dhe paraqitja e një sistemi rregullator të vlerësimit të ndikimit (vlerësim i kostos së përputhshmërisë) për të siguruar standardet e përshtatshme në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.
  - o Integrim zyrtar i konsideratave mjedisore në planifikimin qendror dhe vendor dhe proceset strategjike të zhvillimit.
- Administrim i përmirësuar i mjedisit, përfshirë:
  - o Shtim i monitorimit mjedisor për të siguruar informacion më të mirë për vendimmarrjen e përmirësuar.
  - o Shtim i komunikimit dhe edukimit për çështjet mjedisore.
  - o Zbatim i drejtë dhe transparent i legjislacionit mjedisor.
  - o Sisteme për planifikim në fushat e ujit, mbetjeve, ajrit dhe biodiversitetit.
- Program investimi në infrastrukturën komunale dhe përmirësimin e tokave të ndotura:
  - o Krijimi i një Fondi të Mjedisit dhe i Njësisë së Zbatimit dhe Administrimit të Projektit.
  - o Akordimi i një fondi prej 0.6% të shpenzimeve të Qeverisë për investimet në Mjedis – që do të administrohet nëpërmjet Fondit.

- Koordinim dhe dialog më i zgjeruar me institucionet ndërkombëtare financuese dhe donatorët për të siguruar një mbështetje maksimale për programet e investimeve.

Integrimi i masave mjedisore në të gjitha politikat shtetërore, përbën një hap vendimtar, i cili nuk mund të realizohet vetëm nëpërmjet të legjislacionit. Ai do të kërkojë komunikim të përforcuar ndërinstitucional dhe procese konsultimesh në të gjitha nivelet e punës së administratës. Për pasojë, duhen caktuar masa që të sigurohet zbatimi i koordinuar i kësaj strategjie si një e tërë.

## Koordinimi

Shumë prej masave, që duhet të merren për zbatimin e kësaj strategjie, përfshijnë punën e një varg ministrish dhe institucioneve ndihmëse. Për shembull, për të siguruar ruajtjen e biodiversitetit duhet të merren masa kryesisht nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, por gjithashtu kërkohet edhe mbështetja e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe institucioneve të tyre mbështetëse. Administrimi i mbetjeve urbane është përgjegjësi e pushtetit vendor, por ata do të kenë nevojë si për ndihmën e Autoriteteve Rajonale ashtu edhe të institucioneve qendrore duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Fondit të Mjedisit.

Këto janë vetëm dy shembuj, të shkëputur nga shumë të tjerë. Ndihet qartë nevoja për bashkëpunim ndërministror dhe ndër-institucional për zbatimin e kësaj strategjie dhe arritjen e dy objektivave kryesore të saj që janë një zhvillimi i qëndrueshëm dhe pranimi në Bashkimin Europian. Ky koordinim dhe bashkëpunim duhet të realizohet si në nivel ekspertësh ashtu edhe në nivele të larta të hierarkisë zyrtare.

Një Komision i ri Ndërministror për Mjedisin do të krijohet, bazuar në Komitetin Ndërministror i cili u ngrit më 2006 për përgatitjen e SKZHI. Komisioni i Mjedisit do të merret me koordinimin në nivelin më të lartë vendimmarrës. Megjithatë, duhet shtuar edhe bashkëpunimi operativ në nivelin e specialistëve. Për këtë arsye, në çdo Ministri do të krijohen Njësi të Administrimit të Mjedisit. Ato do të jenë me madhësi të ndryshme, në bazë të nivelit të përgjegjësisë dhe kompetencave për çështjet mjedisore, që i janë dhënë çdo Ministrie.

Komisioni i Mjedisit do të kryesohet nga Kryeministri dhe çdo Ministër do të jetë anëtar i këtij Komisioni. Komisioni i Mjedisit do të jetë forca shtytëse pas zbatimit të kësaj strategjie. Ndërkohë, që ai nuk mund e nuk duhet në asnjë mënyrë të minojë apo ndërhyjë në kompetencat e Ministrive të veçanta, ai duhet të lejojë ndarjen e barrës për zbatim dhe arritjen e përfitimeve efikase. Në veçanti, Komisionit do t'i jepet autoritet të krijojë *Task Grupet Ndërministrore*, që do ta mbështesin Komisionin dhe Ministrat, në ndërmarrjen e detyrave, që përbëjnë shqetësime dhe janë brenda kompetencave ligjore të më shumë se një Ministrie. Ministrat do të mbështeten gjithashtu nga Njësitë e Mjedisit dhe Zyrtarët e Mjedisit brenda Ministrive të tyre.

Task Grupet Ndërministrore do të krijohen për të trajtuar zbatimin e masave të identifikuar në këtë strategji, që kërkojnë veprimin, ekspertizën dhe angazhimin e më shumë se një Ministrie dhe/ose institucioneve mbështetëse.

Ndonëse MMPAU është Ministria drejtuese për përgjegjësinë e administrimit të mjedisit, këto përgjegjësi janë ndarë midis shumë ministrive. Për t'u siguruar që marrëveshjet e përcaktuara në këtë Strategji, zbatohen plotësisht në një mënyrë të bashkërenduar, në çdo Ministri do të ngrihet një Njësi e Mjedisit. Çdo Njësi e Mjedisit do të drejtohet nga Zyrtari i Mjedisit, i cili do të raportojë drejtpërdrejtë te Ministri ose Sekretari i Përgjithshëm. Qëllimi kryesor i Njësive të Mjedisit do të jetë të mbështesë zbatimin e masave dhe detyrat e caktuara në këtë Strategji, brenda Ministrive të tyre, nëpërmjet sigurimit të këshillimit të ekspertëve në departamentin e specialistëve, shkëmbimit të informacioneve, monitorimit dhe raportimit.



Monitorimi i zbatimit të kësaj Strategjie do të ndërmerret nga përdorimi i një game treguesish. Problemet thelbësore do të raportohen vazhdimisht, përfshirë katër tipa treguesish.


- Gjendja e Treguesve të mjedisit;
- Treguesit e Performancës së infrastrukturës mjedisore;
- Treguesit Financiarë;
- Treguesit Administrativë.

Informacionet e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit dhe zbatimit të strategjisë, nuk do të jenë të dobishme, nëse ato nuk ndahen hapur dhe nuk raportohet për to.

Publiku, industria, tregtia, OJF-të, agjencitë ndërkombëtare dhe donatorët janë të gjithë pjesëmarrës e të domosdoshëm në këtë strategji. Ata duhet të jenë të informuar. Në emër të Komisionit të Mjedisit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit do të botojë rregullisht buletine mbi zbatimin e strategjisë dhe gjendjen e mjedisit, përfshirë edhe një raport vjetor.

*Të nënvlerësojmë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm, ta shikojmë mjedisin si një çështje që u takon vetëm ambientalistëve, të mos njohim ndarjen e përgjegjësisë që kanë gjithë sektorët për gjendjen e ajrit, ujit, tokës; të gjithë këto përbëjnë gabime të rënda, për të cilat brezat e ardhshëm do të paguajnë një çmim të madh.*

*Mjedisi është një çështje e mbarë popullit; të gjithë duhet të luajnë rolin e tyre në administrimin e mjedisit dhe realizimin e objektivave të kësaj strategjie. Ashtu siç do person që duhet të përmbushë detyrën e vet, po ashtu duhet të veprojnë edhe çdo institucion dhe organizatë, tek e cila ne kemi investuar besim demokratik- institucionet qeveritare. Për ta bërë këtë gjë në mënyrë efikase, institucionet duhet t'i bashkërendojnë politikat dhe veprimet e tyre, kështu që ligjet, administrata dhe investimet të jenë koherente dhe efikase. Kjo Strategji është instrumenti për këto veprime.*



# 1 Marrëdhëniet ndërmjet Ekonomisë, Zhvillimit Shoqëror dhe Mjedisit

*“Mjedisi është burimi i gjithçkaje për të cilën njerëzit kanë nevojë për të jetuar dhe për t’u zhvilluar.”<sup>1</sup>*

Pasuria e një kombi përbëhet nga tre elementë: njerëzit, burimet ekonomike dhe mjedisi ku ata ndërveprojnë. Të tre këta elemente janë pashmangshmërisht të lidhur dhe nuk mund të shqyrtohen veçmas. Degradimi i mjedisit ndikon negativisht në shëndetin e popullsisë dhe zvogëlon mundësitë e zhvillimit ekonomik. Parandalimi i ndotjes dhe administrimi i burimeve natyrore kanë rëndësi të madhe për uljen e varfërisë dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm. Nocioni i shprehur shpesh, se administrimi i mjedisit është një luks që duhet përvetësuar vetëm pasi të jenë arritur standardet “perëndimore” të jetesës, është i gabur.

Tashmë Qeveria është e ndërgjegjësuar për këtë sfidë dhe ka deklaruar se:

*“Zhvillimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm është një objektiv thelbësor për qeverinë e re. Shpesh herë është vënë në pikëpyetje qëndrueshmëria e zhvillimit të Shqipërisë.... Degradimi dhe varfëria e zonave rurale, zhvillimi i çrregullt i zonave urbane, degradimi mjedisor dhe dëmtimi i burimeve natyrore janë vetëm disa nga problemet e shumta.... Prandaj, rikthimi i vëndit në rrugën e një zhvillimi të shpejtë por të qëndrueshëm, merr rëndësi të veçantë. Ky zhvillim do të udhëhiqet nga vizioni dhe strategjitë e qeverisë, gjë që do të sigurojë zhvillimin e integruar të zonave rurale dhe urbane, duke mbështetur njëkohësisht mbrojtjen mjedisit. Qëllimi i qeverisë do të arrihet nëpërmjet bashkërendimit efikas të politikave të veçanta sektoriale në një strategji integruar....”<sup>2</sup>*

Zbatimi reciprok i politikave ekonomike, shoqërore dhe mjedisore është mënyra më e mirë për të arritur progres. Vonesat në adoptimin e kësaj strategjie të integruar dhe zhvillimi i mëtejshëm i veprimtarive të cilat dëmtojnë mjedisin dhe ulin cilësinë e jetesës, do të rezultojnë në një rritje drastike të kostos totale të zhvillimit ekonomik. Gjithmonë kushton më shumë të zgjidhësh sesa të shmangësh një problem.

Dokumenti “Strategjia Kombëtare e Mjedisore e Shqipërisë” e dyta e këtij lloji<sup>3</sup>, përbën një hap të rëndësishëm të qeverisë drejt zbatimit të strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm.

## **Angazhimi kushtetues**

“...Një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe ata që do të vijnë”.

## **Situata aktuale: shembuj problemesh shëndetësore dhe mjedisore**

Në ish-zonat industriale të ndotura me mbetje toksike, janë ndërtuar shtëpi banimi, duke rezultuar kështu në një rritje të rasteve me sëmundje të ndryshme, veçanërisht në difekte të lindur, tek fëmijët që jetojnë në këto zona dhe ato përreth.

Në shumë zona, lumenjtë, liqenet dhe ujërat nëntokësorë janë ndotur si rezultat i derdhjes në to, të ujërave të patrajtuara, nga vendbanimet apo komplekset industriale përreth. Ky fenomen ndikon negativisht si në cilësinë e ujit të pijshëm ashtu dhe në shëndetin e njeriut.

Ndotja e ajrit të Tiranë dhe Elbasan i ka kaluar të gjitha caqet e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Si rezultat hasen gjithmonë e më tepër raste të sëmundjeve në rrugët e frymëmarrjes apo probleme të tjera.

<sup>1</sup> Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Socio-Ekonomik (SKZHSE), Raporti i Ecurisë për Implementimin 2002, Objektivat dhe Vizioni Afatgjatë i SKZHSE-së, Plani i Veprimit Prioritar 2003, Tiranë 8Maj, 2003

<sup>2</sup> Programi i qeverisë shqiptare 2005 - 2009

## 1.1 Aspekti njerëzor

Qytetarët e Shqipërisë kanë të drejtë të thithin ajër të pastër, të pijnë ujë të pijshëm, të notojnë në det pa patur frikën e infeksioneve dhe të hanë ushqim të sigurtë. Kjo është ajo që shkruhet në kushtetutë. Por cilësia aktuale e mjedisit në Shqipëri nuk i lejon qytetarët të gëzojnë gjithë këto të drejta. Kjo situatë ka nevojë për zgjidhje.

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Socio-Ekonomik (SKZHSE) e evidenton këtë nevojë dhe ka përcaktuar si prioritare ndërhyrjet në zonat ku:

- është vënë re një nivel i lartë i ekspozimit të popullsisë ndaj rreziqeve mjedisore,
- vlera të çmuara mjedisore dhe burime të rëndësishme janë në rrezik,
- pasojat e dëmtimit bien kryesisht mbi shtresën e varfër të popullsisë.

Prioriteti i fundit ka rëndësi të veçantë. Degradimi mjedisor është një nga shkaqet e varfërisë. Në veçanti, zvogëlimi i bazës së burimeve natyrore dhe ndotja e tokës dhe e ujit bëjnë që vendi të mos jetë tërheqës në sytë e investitorëve. Varfëria është gjithashtu burim i degradimit mjedisor: qytetarët e varfër nuk kanë mundësi tjetër veç angazhimit në veprimtari që dëmtojnë mjedisin, si, për shembull, prerja në masë e drurëve në pyje për ngrohje apo gatim.

Ndërveprimi i popullësisë me mjedisin është një marrëdhënie e dyanëshme. Cilësia e jetesës ndikohet nga kushtet e mjedisit dhe cilësia e mjedisit ndikohet nga sjellja e njerëzve. Politikat tona qeveritare e pasqyrojnë më së miri këtë marrëdhënie. SKZHSE-ja synon në radhë të parë t'i vijë në ndihmë popullësisë dhe ekonomisë duke patur parasysh kërkesat mjedisore, ndërsa kjo Strategji Kombëtare e Mjedisit ka për synim të përmirësojë mjedisin duke patur parasysh kërkesat shoqërore dhe ekonomike.

Për rrjedhojë, kjo strategji nuk i përket vetëm drejtuesve të çështjeve mjedisore, ajo ka rëndësi për të gjithë ne. Kjo strategji është element thelbësor i programit të masave përmirësuese që qeveria ka për popullsinë. Si SKM-ja dhe SKZHSE-ja kanë si synime mjedisore të përbashkëta ato të eliminimit të ndotjes së deritanishme, minimizimit të ndotjes në të ardhmen dhe sigurimit të një përdorimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

### Mjedisi dhe zhvillimi

**Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit** të Kombeve të Bashkuara kërkojnë angazhimin “për sigurimin e një Zhvillimi të Qëndrueshëm Mjedisor” si një nga tetë qëllimet e tyre. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Socio-Ekonomik të Shqipërisë (SKZHSE) përcakton se “Mjedisi është një element kyç i zhvillimit dhe gjithashtu përcakton objektivat për të arritur këtë qëllim duke përfshirë:

- OBJEKTIVI 16:** Të integrojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit si dhe të rifitojë humbjet në burimet mjedisore.
- OBJEKTIVI 17:** Të reduktojë përqindjen e njerëzve të cilëve u mungon shërbimi i ujit të pijshëm apo infrastruktura e kanalizimeve të përshtatshme të ujërave të zeza.

<sup>3</sup> Strategjia e parë Kombëtare Mjedisore u hartua në vitin 1993 me asistencën e Bankës Botërore

## 1.2 Zhvillimi i Burimeve Ekonomike

Rritja ekonomike kumulative e Shqipërisë që prej vitit 1990 ka qenë ndër më të lartat e gjithë ekonomive në tranzicion. Megjithatë, ka shqetësime për qëndrueshmërinë e kësaj rritjeje. Pjesë të rëndësishme të ekonomisë bazohen ende në prodhimin e paefektshëm dhe ndotës të materialeve që dëmtojnë kushtet e jetesës<sup>4</sup>. Është e nevojshme të ndërmerren masa dhe të bëhen përpjekje më të mëdha në lidhje me modernizimin, përfshirë këtu edhe reduktimin e dëmeve mjedisore të shkaktuara nga aktivitetet ekonomike.

Sipas këndvështrimeve të vjetëruara, modernizimi luan rolin e një barriere ndaj rritjes ekonomike për shkak të kostove që ai mbart, por sot po kuptohet gjithmonë e më tepër se kjo gjë nuk është më e vërtetë. Politikat e logjikshme mjedisore mund të shtojnë ritmet e rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së zgjidhjeve të reja teknologjike ose kanalizimit drejt prodhimit të mallrave që janë më të lirë për t'u përdorur në krahasim me paraardhësit e tyre "të ndotur". Pra, është e qartë se përmirësimet mjedisore mbartin kosto që lidhen me investimet fillestare por nga ana tjetër këto kosto rikuperohen si rezultat i rritjes së efektshmërisë ose krijimit të vendeve të reja të punës në industri që sigurojnë njëkohësisht teknologji dhe shërbime më të pastra nga pikpamja mjedisore. Zgjerimi i tregjeve të eksportit ka një varësi të drejtëpërdrejtë nga fakti nëse kompanitë operojnë në nivelet më të larta të standarteve ndërkombëtare aq sa të jenë në gjendje të sigurojnë konkurrueshmëri në çmim, cilësi dhe pranueshmëri në treg. Pranueshmëri do të thotë të njihesh

### Rritja ekonomike, përfitimet mjedisore - tri mundësi në sektorin e mbetjeve

Aktualisht, industria e përpunimit të drurit prodhon mbetje drusore të cilat hidhen. Në të njëjtën kohë produkte të tilla si pllakt me mbetje druri të presuar importohen. Këto produkte mund të prodhohen lehtësisht nga mbetje të tilla. Aktualisht mungon mundësia për të zhvilluar një industri të re e cila do të siguronte vende pune dhe do të pakësonte mbetjet dhe importet.

Mbetjet plastike nuk riciklohen. Rrugët dhe zonat rurale janë të mbushura me shishe dhe qese plastike të hedhura. Mbledhja dhe riciklimi i këtyre materialeve mund të përbëjnë bazën e një industrie të re, që do të siguronte lëndë të parë për fabrikat vendase, për një sërë produktesh, duke reduktuar në të njëjtën kohë nivelin e mbetjeve.

Mbetjet organike gjithashtu, si ato nga vendbanimet njerëzore ashtu edhe ato që vijnë nga aktivitetet industriale dhe bujqësore hidhen në mjedis pa farë kujdesi. Këto mbetje mund të mblidhen, kompostohen dhe të trajtohen shumë thjeshtë për të prodhuar më pas pleh me përmbajtje të lartë organike, i cili mund të përdoren më pas, për të plotësuar nevojat për lëndë organike të tokave bujqësore.

për arritjen e standarteve specifike ndërkombëtare që kanë të bëjnë me zbatimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore të tilla si ato të përcaktuara në ISO 14000. Sot është provuar se normat e rritjes afatëgjatë varen kryesisht nga normat e progresit teknologjik.

Në këtë mënyrë, integrimi i drejtimit mjedisor në zhvillimin ekonomik do të ndihmojë në zbutjen e disa prej barrierave drejt një rritjeje të qëndrueshme. Ashtu siç ilustron edhe nga shembujt e mëposhtëm, ekzistojnë një sërë mundësish.

Së pari, industria e lëkurës dhe këpucëve është tashmë një burim të ardhurash nga eksporti, por për ta zhvilluar më tej atë, ka nevojë për përmirësime të infrastrukturës, përfshi këtu furnizimin me ujë të pastër, kullimin dhe trajtimin e ujërave të mbetura, trajtimin e mbetjeve të ngurta, energjinë dhe transportin - të cilat do të mbështesin zhvillimin e kësaj industrie në kushte konkurruese. Në mungesë të këtyre lehtësirave, investitorët e huaj do të ngurrojnë ta konsiderojnë Shqipërinë si një vend të mundshëm të bizneseve të tyre.

<sup>4</sup> Memorandumi Ekonomik i Bankës Botërore, Shqipëria – Rritja e Qëndrueshme pas Tranzicionit, Raporti Nr. 29257-AL, 27 Dhjetor 2004

Të favorizuara do të jenë vende të tjera që arrijnë të sigurojnë këto shërbime.

Së dyti, Shqipëria është e bekuar me një nga vijat bregdetare më të bukura të Europës. Strategjia e Zhvillimit të Turizmit parashikon në vizionin e saj, vitin 2012 si vit në të cilin Shqipëria zë një pozicion konkurrues në tregun ndërkombëtar të turizmit në Mesdhe. Po kjo strategji gjithashtu, vë në dukje faktin se ky potencial mund të realizohet vetëm nëse sigurohet dhe mirëmbahet një mjedis i cilësisë së lartë, i cili të jetë tërheqës për turistët, veçanërisht për ata që sjellin në vend valutë e, që kanë kërkesa gjithmonë në rritje. Kjo gjë në vetvete varet nga:

- Një planifikim dhe zhvillim i qartë politikash të cilat do të mbrojnë vijën bregdetare nga dëmtime të mëtejshme dhe ndërtimet e papërshtatshme; dhe
- Investime të konsiderueshme në shërbimet sanitare dhe pjesën tjetër të infrastrukturës së komunave, për të siguruar ato kushte jetese që turistët kërkojnë dhe presin të gjejnë kudo.

Së treti, bujqësia është një nga elementët kryesorë të ekonomisë, por nga ana tjetër 20% e importeve përbëhet nga ushqimet, pijet dhe duhani<sup>5</sup>. Sipërfaqe të mëdha të tokës bujqësore janë braktisur dhe zona të tjera administrohen në mënyrë jo të efektshme. Shumë sisteme të kanaleve të vaditjes janë në gjendje të mjerë, prodhimtaria dhe të ardhurat janë të ulëta dhe emigrimi rural po shkakton probleme punësimi në zonat urbane. Pasojat mjedisore të kësaj situate përfshijnë varfërimin e cilësisë së tokës bujqësore, erozionin, humbje të biodiversitetit dhe ndotje në rritje si pasojë e aktiviteteve urbane, siç është hedhja e mbetjeve, etj. Ringjallja e ekonomisë bujqësore do të sigurojë përfitime sociale, ekonomike dhe mjedisore, duke ulur në të njëjtën kohë varësinë nga importet.

#### **Rregullat e reja mjedisore mund të:**

- reduktojnë kostot për industrinë dhe biznesin;
- krijojnë tregje për mallra dhe shërbime mjedisore;
- nxisin përmirësime teknologjike;
- reduktojnë rreziqet e biznesit dhe rrisin besimin e tregjeve të investimit dhe shoqërive të sigurimeve;
- mbështesin avantazhet konkurruese dhe krijojnë tregje konkurruese;
- krijojnë vende të reja pune dhe ruajnë ato ekzistuese;
- përmirësojnë shëndetin e krahut aktiv të punës dhe të një publiku më të gjerë;
- ruajnë burimet natyrore nga të cilat varen të gjitha bizneset.

Një administrim i mirë mjedisor, i bazuar në rregulla të qarta, nuk e pengon konkurrencën e përgjithshme dhe zhvillimin ekonomik, përkundrazi ai mund të sjellë përfitime, nëpërmjet trysnisë që ushtron, gjë që nxit përmirësimet teknologjike dhe paralajmëron bizneset si për paefektshmërinë e burimeve ashtu edhe për mundësitë e reja<sup>6</sup>



<sup>5</sup> Shqipëria në Shifra, Tiranë 2005, (fq. 52)

<sup>6</sup> Kontributi i Rregulloreve të Mira Mjedisore në Konkurrencë – Dokument i hartuar nga Rrjeti i Drejtuesve të Agjencive Europiane të Mbrojtjes së Mjedisit - Nëntor 2005

### 1.3 Zhvillimi i Qëndrueshëm

Zhvillimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm është synimi kryesor për Programin Qeveritar 2005 - 2009. Ligji organik mbi Mjedisin shpall<sup>7</sup> se:

*“Zhvillim i qëndrueshëm” do të thotë zhvillim që përmbush nevojat e së tashmes, pa kufizuar apo ndikuar mbi mundësitë dhe kapacitetet, që brezat e ardhshëm kanë, për të përmbushur nevojat e tyre.”*

Për të arritur në praktikë një synim të tillë kërkohet një analizim i koordinuar i efekteve ekonomike, shoqërore dhe mjedisore të të gjithë politikave qeveritare, me qëllim marrjen e një vendimi optimal, i cili respekton nevojat e të gjithë sektorëve. Ky është një ndryshim rrënjësor në mënyrën e hartimit të politikave. Megjithatë, këto ndryshime janë duke u zbatuar në Vendet Anëtare të Bashkimit Europian dhe inkurajohen me forcë nga Këshilli i Europës<sup>8</sup>.

Në Shqipëri, pasojat e një kalimi të tillë do të shfaqen në transformimin e SKZHSE-së, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) dhe Strategjisë Kombëtare të Mjedisit (SKM) në një të vetme të quajtur “Strategjia Kombëtare për Zhvillim të Qëndrueshëm” (SKZHQ), e cila do të pasqyrojë nevojat për zhvillim të secilit prej sektorëve kyç të shoqërisë dhe ekonomisë sonë, ndërkohë që do të përfshijë plotësisht konsideratat e duhura mjedisore. Në një periudhë afatshkurtër këto dy strategji, do të ekzistojnë paralelisht - dhe është e rëndësishme të sigurohemi që ato të jenë koherente, ndërkohë që në një periudhë afatgjatë ato do të duhet të kombinohen në një strategji të vetme të koordinuar.

Sot, SKZHSE-ja (SKZHQ) mbështeten dhe zbatohen nëpërmjet një sërë strategjish të një niveli më të ulët dhe plane veprimesh të cilët klasifikohen në njërin prej dy grupeve të ilustruar në Skemën 1: *Të përgjithshme – strategji dhe plane të cilët trajtojnë çështje të një rëndësie të përgjithshme dhe që prekin sektorë specifike, të tillë si shëndeti, arsimi dhe mjedisi.*


*Specifike sektoriale – strategji dhe plane të cilët trajtojnë zhvillimin në sektorë të veçantë të ekonomisë të tillë si bujqësia, industria, turizmi dhe transporti.*

*Strategjitë aktuale të qeverisë janë listuar në Aneksin I.*



<sup>7</sup> Neni 2. 25 i Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit Nr.8934, datë 5. 09. 2002

<sup>8</sup> Konkluzionet e Presidencës së Këshillit të Europës në Gothenburg, 15 dhe 16 Qershor 2001, (paragrafi 23)



Skema 1 – Kuadri konceptual i politikave

Në një periudhë afatgjatë do të jetë e nevojshme që analiza e këtyre ndërveprimeve dhe identifikimi i zgjidhjeve optimale të përfshihet brenda procesit të planifikimit dhe zbatimit. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (**MMPAU**) do të luajë një rol të rëndësishëm në sigurimin e kësaj të fundit, nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të vazhdueshëm të Planeve të Veprimit në Mjedis. Këto plane ofrojnë rrugëzgjidhje për problemet kryesore të administrimit të mjedisit, përfshi këtu identifikimin dhe krijimin e lehtësirave për investimet në infrastrukturën mjedisore. Megjithatë, një qëndrueshmëri e vërtetë, ka nevojë për pjesëmarrje të njëjtë nga ana e institucioneve kombëtare, rajonale dhe lokale, si edhe nga komuniteti më i gjerë, në procesin e planifikimit dhe zbatimit. Mungesa e një bashkëveprimi të tillë mund të sjellë si rezultat politika dhe iniciativa jo-koherente dhe konfliktuale në sektorë dhe zona të ndryshme.

### 1.4 Angazhimet Kombëtare

Kjo ide, pra ajo e ndarjes së përgjegjësisë për administrimin e mjedisit, është e mishëruar në Kushtetutë, e cila përcakton tre objektiva në lidhje me qëndrueshmërinë:

- një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm nga ana ekologjike për brezat e tashëm dhe të ardhshëm;<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Neni 59.1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë - pika e



- shfrytëzim racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm;<sup>10</sup>
- çdokush ka të drejtën të jetë i informuar mbi me gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij<sup>11</sup>

**Tabela 1 – Progresi në arritjen e disa objektivave kyç të përcaktuar nga Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit**

Objektivat	Progresi	Cështjet
Përdorimi racional i mjedisit, reduktimi i nivelit të mbetjeve dhe ndotjes së mjedisit, parandalimi i dëmtimit të tij, rehabilitimi dhe kthimi në gjendjen e mëparshme të mjedisit të dëmtuar.	Janë krijuar sistemet e dhënies së lejeve me qëllim rregullimin e pasojave të aktiviteteve mbi mjedisin. Janë ndërmarrë hapa konkrete në drejtim të trajtimit të ndotjeve historike.	Imponimi i ligjit nuk është ende efektiv dhe dëmtimi i mjedisit vazhdon. Një sërë “pikash të nxehta” kanë ende nevojë për t’u sjellë në gjendjen e mëparshme.
Përmirësimi i kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e jetesës dhe mbrojtjen e shëndetit publik.	Ndotja e ajrit, ndotja e ujit dhe prodhimi i mbetjeve të rrezikshme ka pësuar rënie që prej vitit 1990.	Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës janë duke ndikuar ende negativisht mbi shëndetin e popullësisë.
Ruajtja dhe mirëmbajtja e burimeve natyrore të rinovueshme dhe të parinovueshme, administrim racional dhe efikas i burimeve, duke siguruar rigjenerimin e burimeve të rinovueshme.	Janë prezantuar programet për mbrojtjen e zonave me vlera të larta mjedisore dhe kontrolli ligjor mbi përdorimin e burimeve natyrore; zonat me vlera të larta natyrore janë pajisur me statusin e “zonave të mbrojtura”, si dhe janë hartuar plane për ruajtjen dhe administrimin e tyre.	Administrimi i zonave të mbrojtura mbetet i dobët dhe shpesh shkelen kontrollat ligjore; burimet vazhdojnë të shkatërrohen dhe degradohen.
Koordinimi i aktiviteteve shtetërore me qëllim përbushjen e kërkesave për mbrojtjen e mjedisit.	Janë krijuar mekanizma koordinimi ndër-ministeriale, siç është Këshilli Kombëtar i Ujërave.	Mekanizmat e krijuar nuk funksionojnë mirë dhe shumë nga organet qeveritare po përpiqen të përbushin përgjegjësitë e tyre mjedisore.
Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes mjedisore.	Shumica e Konventave më të rendësishme të Kombeve të Bashkuara dhe Konventa të tjera Ndërkombëtare janë ratifikuar.	Përvoja në lidhje me procesin e zbatimit të shumicës së këtyre konventave është e pakët; burimet aktuale njerëzore dhe financiare në shërbim të plotësisht të këtyre detyrimeve, nuk janë plotësisht të mjaftueshme.
Nxitja e publikut për të marrë pjesë në aktivitetet e mbrojtjes së mjedisit.	Publiku ka nisur të përfshihet në hartimin e politikave mjedisore, veçanërisht në nivel vendor.	Në krahasim me vendet e tjera Europiane, niveli i ndërgjegjësimit mjedisor të publikut, dhe i pjesëmarrjes së tij në hartimin e politikave mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit është shumë i ulët.
Koordinimi i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.	Janë vendosur dy taksa mjedisore (karboni/karburanti dhe plastika) dhe është krijuar një kuadër ligjor që lejon edhe vendosjen e taksave të tjera.	Vetëm një pjesë e vogël e të ardhurave nga taksimi mjedisor përdoret për mbrojtjen mjedisore. Është e nevojshme të forcohet kuadri ligjor.
Krijimi dhe forcimi i sistemit institucional të mbrojtjes së mjedisit në nivel kombëtar dhe lokal.	Në të gjithë vendin janë krijuar Agjensitë Rajonale të Mjedisit – ARM <sup>te</sup>	ARM <sup>te</sup> nuk janë plotësisht të trajnuara, kanë mungesa në personel, nuk kanë buxhet e pajisje të mjaftueshme dhe nuk kanë mjete për të përbushur detyrimet e tyre në mënyrë efektive; niveli i bashkëpunimit me autoritetet lokale mbetet i ulët

<sup>10</sup> Neni 59.1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë - pika f

<sup>11</sup> Neni 56 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Një pjesë e madhe e legjislacionit, përfshi Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit, është përshtatur tashmë, për të ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave. Institucionet janë organizuar ose po organizohen për të zbatuar, monitoruar dhe zbatuar ligjet, por ka ende një rrugë të gjatë për të bërë, drejt arritjes së qëndrueshmërisë. Tabela 1 përmbledh progresin e bërë në drejtim të arritjes së objektivave kyçe të përcaktuar nga Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit.

## 1.5 Vendi i Shqipërisë në Europë dhe në Botë

*"Mendo globalisht, vepro lokalisht"*<sup>12</sup>

Synimi i Shqipërisë është që të bëhet pjesë e Bashkimit Europian. Procesi i integritimit Europian është një drejtim i rëndësishëm strategjik për qeverinë dhe pasqyron një konsensus ndërmjet gjithë forcave politike në vend. Arritja e këtij synimi ka të bëjë me një sërë hapash dhe shumë përpjekjesh, për të paktën pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme, të cilat nuk janë më të pakta në fushën e mjedisit dhe që përfshijnë disa nga kërkesat më komplekse nga legjislacioni i Komunitetit Europian.

Kohët e fundit, pas 3 vjet negociatash, me firmosjen nga ana e Shqipërisë dhe Komisionit Europian në 18 Shkurt 2006, të **Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit**<sup>13</sup>, është ndërmarrë një hap kritik.

Përpara kësaj, hapi më i rëndësishëm në këtë proces, ishte Marrëveshja Europiane e Partneritetit, adoptuar nga Këshilli Europian në Qershor 2004. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Shqipërisë i kërkohet që brenda një periudhe të shkurtër të *"forcojë kapacitetet administrative dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar e vendor; të adoptojë një strategji për përshtatjen e mëtejshme të legjislacionit mjedisor me atë të Komunitetit Europian dhe të zbatojë ashtu siç duhet legjislacionin ekzistues, veçanërisht lidhur me imponimin e tij."*

**Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit Europian**<sup>14</sup> parashikon reagimin e qeverisë dhe përmban paketa masash për:

- fuqizimin institucional dhe të kapaciteteve të administratës publike;
- zbatimin e një drejtimi të bazuar tek rezultatet e procesit të integritimit;
- shpejtimin e hapave të reformës;
- vendosjen e një sistemi monitorues gjithëpërfshirës; dhe
- Përafrimin e legjislacionit shqiptar, me atë të Bashkimit Europian.

Objekti i fundit është edhe objekt i **Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL)**, i adoptuar në Qershor 2005<sup>15</sup>. PKPL-ja përcakton, se si dhe kur do t'i përafrojë Shqipëria ligjet e saj me ato të Komunitetit Europian dhe se si do të garantojë ajo, zbatimin e këtyre ligjeve.

Kjo **Strategji Kombëtare e Mjedisit** ka të bëjë me të gjitha objektivat, përfshi përafrimin e legjislacionit, dhe synimi primar i saj, përmbledhet në Programin e Gjashtë të Veprimit për Mjedisin të Komunitetit Europian, Mjedisit 2010 "E Ardhmja Jonë, Zgjedhja Jonë":

*"Kalimi drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm, është një synim strategjik për Bashkimin Europian. Ky është një proces afatëgjatë që kërkon ndryshime strukturore në ekonominë dhe shoqërinë tonë, por gjithashtu edhe në mënyrën sesi ne, i zhvillojmë dhe i zbatojmë politikat."*<sup>16</sup>

<sup>12</sup> René Dubos si një këshilltar i Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor në 1972

<sup>13</sup> <http://www.seeurope.net>

<sup>14</sup> Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Plani i Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit Europian, Tetor 2004

<sup>15</sup> Plani Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit, Ministria e Integritimit Europian të Shqipërisë, Qershor 2005

Ndërsa shumë prej ligjeve mjedisore të miratuara nga Shtetet Anëtare rrjedhin nga Legjislacioni i Komuniteti European (KE), me rëndësi është fakti që të pranohet se legjislacioni i KE-së nuk i mbulon të gjitha aspektet e administrimit mjedisor. Ka disa aspekte të rëndësishme të menaxhimit mjedisor dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, siç është, për shembull, menaxhimi i shfrytëzimit të tokës, që nuk trajtohen nga legjislacioni i Komunitetit. Ky duhet trajtuar në mënyrë individuale nga çdo vend.

Përveç marrëveshjeve Europiane, Shqipëria ka nënshkruar gjithashtu një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare mjedisore, përfshi ato që kanë të bëjnë me ndryshimet klimaterike, mbrojtjen e biodiversitetit, transportin e mbetjeve të rrezikshme dhe ujërat ndërkombëtare. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve do të jetë një tregues kyç për integrimin e suksesshëm të vendit në komunitetin ndërkombëtar.

### **1.6** *Si është organizuar kjo Strategji*

Kjo strategji synon ta trajtojë mjedisin në kontekstin e nevojave të popullsisë shqiptare, ekonomisë, pozicionit të vendit në Europë dhe rolit të tij si anëtar i një komuniteti më të gjerë ndërkombëtar. Forcat drejtuese të aktivitetit ekonomik, presioni i ushtruar mbi mjedisin nga ky aktivitet dhe ndikimet e zhvillimeve ekzistuese dhe të planifikuara mbi secilin prej komponentëve mjedisorë, analizohen në Kapitullin 2.

Duke marrë në konsideratë aktivitetin e ardhshëm ekonomik, janë vlerësuar edhe strategjitë sektoriale specifike, përfshi midis të tjerash ato për bujqësinë, zhvillimin rural, industrinë, energjinë, biznesin e vogël dhe të mesëm, turizmin, transportin, zhvillimin urban, pyjet dhe peshkimin. Në analizimin e strategjive, ne kemi marrë në konsideratë:

- objektivat e tyre,
- ndërveprimin e këtyre objektivave me ato të një administrimi të logjikshëm mjedisor,
- mënyrën aktuale të trajtimit të pasojave mjedisore që vijnë nga zbatimi i këtyre strategjive,
- Mënyrat me të cilat ky trajtim mund të përmirësohej për të patur përfitime si nga ana mjedisore ashtu edhe nga ana e zhvillimit.

U analizua gjithashtu edhe gjendja aktuale e mjedisit shqiptar dhe bazuar mbi këto konsiderata të zhvillimit dhe mjedisit të marra së bashku, u arrit në një grup objektivash, afatshkurtër dhe afatmesëm, për përmirësimin mjedisor. (Kapitulli 3). Mjetet që ekzistojnë ose duhet të krijohen për të arritur këto objektiva janë paraqitur në Kapitullin 4. Mekanizmat që duhen përdorur për monitorimin dhe raportimin e progresit të zbatimit të kësaj strategjie janë paraqitur në Kapitullin 5.

---

<sup>16</sup> Programi i Gjashtë i Veprimit për Mjedisin i Komunitetit European



## 2 Probleme të Mjedisit

Në këtë kapitull identifikohen problemet e mjedisit në Shqipëri. Masat kyçe që duhen ndërmarrë për t'iu përgjigjur këtyre problemeve jepen të përmbledhura në çdo seksion dhe shtjellohen më tej në kapitujt 3 dhe 4. Në kapitullin 3 shqyrtohen prioritetet dhe identifikohen objektivat e synimet për secilin nga problemet kryesore të mjedisit. Kapitulli 4 përshkruan programin e veprimeve për arritjen e objektivave dhe synimeve të caktuara.

### 2.1 Metodologjia

Metoda FSHPGJEK<sup>17</sup> e hartuar nga Agjencia Europiane e Mjedisit siguron një kuadër konceptual për përshkrimin e lidhjes midis veprimtarive njerëzore dhe mjedisit. Skematikisht ajo jepet e përmbledhur në Tabelën 2-1. Kjo metodë, përdoret për identifikimin në mënyrë të strukturuar të problemeve mjedisore aktuale dhe ato që mund të paraqiten potencialisht, në periudha të ndryshme kohore. Ajo merr parasysh nevojat e shqiptarëve, ekonominë dhe vendin që zë Shqipëria në Europë si dhe rolin e saj si pjesëtare e një komuniteti më të gjerë ndërkombëtar.

**Tabela 2-1 Paraqitje Skematike e FSHPGJEK**

Termi	Shpjegimi	Shembulli
<i>Në Seksionin 2.3:</i>		
Forcat shtytëse	Cilat janë nevojat dhe synimet tona personale, ekonomike, sociale dhe ato të zhvillimit që na shtyjnë të ndërmarrim veprimtari të ndryshme?	Makinat përdoren për të siguruar Lëvizjen.
Presionet	Cilët janë presionet kryesorë që ushtrohen mbi komponentin mjedisor e që rrjedhin nga veprimtaritë tona?	Makinat që përdoren janë të vjetra dhe shkarkojnë pluhur e tym në ajër. Makinat po përdoren gjithnjë e më shumë.
<i>Në Seksionin 2.4:</i>		
Gjendja e mjedisit	Në ç'gjendjeje ndodhet mjedisi ynë si rezultat i presioneve që ne ushtrojmë mbi të?	Cilësia e ajrit në zonat urbane është e dobët dhe po përkeqësohet për shkak të shkarkimeve që lëshojnë gjithnjë e më shumë makinat e vjetra.
Ndikimi	Si ndikon gjendja aktuale e mjedisit mbi shëndetin dhe aftësinë tonë për të zhvilluar ekonominë e vendit tonë?	Në zonat urbane hasen raste të shumta të njerëzve që vuajnë nga sëmundje të rrugëve të frymëmarrjes dhe, për pasojë, me aftësi të kufizuara për të punuar.
<i>Shtjellohen më tej në Kapitujt 3 dhe 4:</i>		
Kundërpërgjigjja	Cilat janë mënyrat e administrimit për minimizimin e presioneve dhe ndikimeve mbi mjedisin ku ne jetojmë?	Po aplikohet një sistem për rregullimin me ligj të niveleve të lejuara të shkarkimeve të gazeve dhe tymrave nga automjetet.

Skema përdoret për kryerjen e vlerësimit të presioneve kryesore që shkaktojnë përkeqësimin e mjedisit në Shqipëri. Njohja e këtyre marrëdhënieve shkak-pasojë mundëson nivel më të lartë të të kuptuarit të problemeve aktuale dhe na krijon mundësi më të mëdha për të parashikuar problemet që mund të shfaqen në të ardhmen. Të dhënat mbi gjendjen e mjedisit sot dhe njohja e presioneve që ushtrojmë ne, si dhe ndikimet e tyre mjedisore na ndihmojnë në parashikimin e mënyrës së

<sup>17</sup> FSHPGJEK – Forcat Shtytëse, Presionet, Gjendja, Ndikimi mbi Mjedisin dhe Kundërpërgjigjja – Agjencia Europiane e Mjedisit [www.eea.eu.int](http://www.eea.eu.int)

evoluimit të këtyre presioneve dhe kundërpërgjigjeve, duke bërë të mundur kështu t'i jepet përgjigje pyetjes: "Çfarë rreziqesh i kanosen mjedisit nëse nuk zbatojmë një Strategji të përshtatshme Kombëtare për Mjedisin?"

Aftësia për ta marrë përsipër, me përpikmëri dhe saktësi këtë analizë, është në varësi të të dhënave që disponohen. Aktualisht disponohen të dhëna të mjaftueshme në bazë të të cilave identifikohen problemet kryesore dhe nevojat për veprim. Megjithatë, në disa zona, statistikave që disponojmë nuk janë plotësisht të mjaftueshme, nuk janë të besueshme dhe nuk pasqyrojnë plotësisht situatën e vërtetë. Kjo nënkupton nevojën për të përmirësuar grumbullimin e informacioneve, në mënyrë që kur të përdoret në të ardhmen kjo strategji, të mund të përcaktohen më saktësisht problemet dhe zgjidhjet më të përshtatshme për t'i kapërcyer ato.

### 2.2 Identifikimi i problemeve

Të gjitha veprimtaritë njerëzore kanë ndikim mbi mjedisin. Ndonjëherë këto ndikime janë të vogla apo të parëndësishme, por shpesh ato janë të dëmshme, madje nganjëherë shumë të dëmshme. Qëllimi i analizës FSHPGJEK është identifikimi i *aktiviteteve të zhvillimit* që kanë më shumë gjasa të shkaktojnë dëme të tilla serioze, *komponentët mjedisorë* që rrezikohen si pasojë e ndikimeve që paraqesin këto rreziqe për shëndetin dhe zhvillimin social-ekonomik.

Aktivitetet shqyrtohen sipas zërave përkatës në seksionin 2.3:

- Industria e rëndë – industritë e mëdha të prodhimit dhe përpunimit si p.sh. nxjerrja e mineraleve, prodhimi i hekurit dhe çelikut, siderurgjia dhe prodhimi i çimentos;
- Industri të tjera – industri të mesme dhe të vogla si p.sh. industria e përpunimit dhe prodhimit të produkteve ushqimore, industria e prodhimit të lëndës drusore dhe plastike, përpunimit të lëkurës, prodhimit të këpucëve dhe veshmbathjeve;
- Energjia – infrastrukturë për prodhimin e termo-elektro energjisë (TEC<sup>et</sup>) dhe sistemet e ngrohjes si dhe lëndëve djegëse, duke përfshirë naftën dhe gazin;
- Transporti – transport rrugor, hekurudhor, ajror dhe ujor;
- Bujqësia – përdorimi i tokës dhe i ujit për prodhimin e mallrave përfshirë këtu pylltarinë, peshkimin, drithrat, blegtorinë, frutat dhe perimet;
- Zhvillimi urban – veprimtaritë bazë të një zone urbane, përfshirë këtu veprimtaritë e ndërimit, strehimit, veprimtaritë tregtare, institucionale dhe të industrisë së lehtë;
- Turizmi – hotele, hotele e restorante familjare, restorante, klube dhe aktivitete turistike; dhe
- Trashëgimia – aktivitete të ndërprera, por që kanë lënë pas dëme në mjedis si p.sh. fabrika të braktisura, vend-depozitime të mbetjeve, miniera dhe gurore.

*Komponentët kryesorë të mjedisit* që preken nga këto veprimtari përkruhen në seksionin 2.4:

- Ajri dhe klima – cilësia e ajrit që thithim dhe substancat ndotëse që çlirohen në atmosferë;
- Cilësia e ujit – cilësia e ujërave të ëmbla sipërfaqësore, nëntokësore dhe ujërave bregdetare;
- Sasia e ujit – disponibiliteti i burimeve ujore;
- Mbetjet – llojet dhe sasi të substancave dhe materialeve që hidhen;
- Toka – gjendja kimike, struktura dhe aftësia prodhuese e tokave;
- Zhurma – niveli i zhurmës në zonat e banuara dhe në mjedis;
- Biodiversiteti – gjendja e habitateve natyrore dhe specieve në vend;
- Peizazhi – gjendja e natyrës duke përfshirë malet, bregdetet, pyjet dhe kullotat; dhe
- Trashëgimia – gjendja e monumenteve natyrore, historikë dhe kulturorë.

Informacion më i zgjeruar në lidhje me gjendjen e secilit prej këtyre përbërësve jepet në Shtojcën IV dhe në raportet mbi Gjendjen e Mjedisit botuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Kapitulli mbyllet me një vlerësim të faktorëve të përbashkët, të cilët ndikojnë në procesin e zhvillimit dhe efektin e këtyre faktorëve në administrimin e mjedisit si një i tërë.


### 2.3 Veprimtaritë e zhvillimit dhe presionet që ato ushtrojnë mbi mjedisin

Prodhimi i kombëtar bruto në Shqipëri po rritet me shpejtësi<sup>18</sup>

Në Miliona Lekë	2002	2003
Prodhimi i Kombëtar Bruto	624,718	682,669
Prodhimi i Kombëtar Bruto për frymë	1,441	1,800

Pjesa e PKB e gjeneruar nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë kombëtare ilustruhet në Fig. 2.3.1.

Grafiku 2.3.1 – Pjesa e PKB sipas sektorëve



#### 2.3.1 Industria, energjia dhe transporti

Historinë e Shqipërisë së këtyre viteve të fundit, (pas viteve 1990<sup>te</sup>) e karakterizon një transformim rrenjësor i sistemit ekonomik dhe proceseve të zhvillimit. Ka mundësi që shkalla dhe ritmi i këtij ndryshimi të jetë më i madh në krahasim me vendet antarë të KNER-it (Këshilli për Ndhimë Ekonomike Reciproke), të cilët tani janë anëtarë të Bashkimit Europian. Në vitin 1990 industria jepte më shumë se 37% të PKB-së. Më pas, shumë nga ndërmarrjet e mëdha u shkatërruan, saqë në vitin 2003, kontributi i industrisë në PKB ra në nivelin e 13%. Në periudhën para ndryshimeve, sektorët që dominonin ishin minierat dhe metalurgjia, ndërsa sot, sektori kryesor është Industria Ushqimore.

Industria e ndërtimit ka lulëzuar si në ekonominë formale ashtu edhe në atë informale. Në të parën kryesisht në përpjekje për të plotësuar kërkesën e familjeve për zgjerim dhe në të dytën shpesh për t'iu përgjigjur lëvizjeve të popullsisë nga zonat rurale në drejtim të qyteteve.

Sektorët e shërbimit, të cilët thuajse nuk ekzistonin përpara vitit 1990, tashmë janë zgjeruar shumë, duke përfshirë veprimtari të ndryshme tregtare, turizmin dhe argëtimin.

<sup>18</sup> Të gjithë të dhënat janë marrë nga "Shqipëria në Shifra", botim i INSTAT, Tiranë 2004.

Transporti privat thuhet se nuk ekzistonte përpara vitit 1990, por që nga kjo kohë gjërat kanë ndryshuar shumë në këtë drejtim.

Nga pikëpamja e mjedisit, ndryshimet e ndodhura kanë lënë pas ndotjen historike, të shoqëruar me rënie të ndjeshme të ndotjes së shkaktuar nga industria aktive, si dhe rritje të dukshme në format e ndryshme të ndotjes të shkaktuar nga automjetet dhe zonat e urbanizuara.

### Industria e rëndë

Nga të gjithë sektorët e ekonomisë, **industria e rëndë** ka pësuar rënien më të thellë, për sa i përket prodhimit dhe punësimit. *Nxjerrja* e qymyrgurit ka pësuar rënie të ndjeshme në raport me periudhën përpara vitit 1990. Cilësia e dobët dhe kushtet e vështira të nxjerrjes së mineraleve çojnë në kosto të lartë të prodhimit, gjë që do të vazhdojë të pengojë shndërrimin e tij në një degë me të vërtetë rentabël. Prodhimi i metaleve me ngjyra, si p. sh. kromi dhe nikeli, të cilët kanë patur rëndësi në të shkuarën, mund ta marrë veten me investimin e duhur dhe kushtet e favorshme të tregut ndërkombëtar. Prodhimi i çelikut, pas rënies që pësoi, po rritet si rezultat i investimeve të kryera në Elbasan. Pasurimi i bakrit vazhdon të kryhet.



Figura 2-1 Elbasan 2006

Industria metalurgjike e ndot rëndë mjedisin. Gazet e tymrat që çlirohen në ajër e në ujë janë në sasi të konsiderueshme. Edhe mbetjet e ngurta që prodhohen janë në sasi të mëdha. Këto emetime në atmosferë nuk janë kontrolluar dhe administruar mirë në të kaluarën, duke shkaktuar ndotje të rëndë lokale të ajrit, tokës dhe ujit gjë që ka sjellë në këtë mënyrë probleme në shëndetin publik.<sup>19</sup>



Ndryshe nga kjo, nxjerrja e **materialeve të ndërtimit** është shtuar shumë, përfshirë këtu zhavorrin e lumit, argjilën, gipsin dhe gurët gëlqerorë. Nxjerrja e zhavorrit po ndikon seriozisht te lumenjtë, duke ndryshuar regjimin e tyre hidrik, duke shkaktuar erozion në brigjet e lumit në disa vende dhe shtresa sedimentesh diku tjetër. Nxjerrja e gurit gëlqeror e shkatërron peizazhin në ato vende ku kryhet, krijon pluhur dhe lë pas mbetje. Procesi i prodhimit të çimentos në furra e rrit në mënyrë të konsiderueshme ndotjen e atmosferës.

<sup>19</sup> Burimi: <http://see.oneworld.net/article/view/118558/1/>



Numri i të punësuarve në *industrinë mekanike* ka rënë nga 45 000 persona që ishte në vitin 1990 në gati 3 000 sot. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të mëdha janë vazhdim i industrive të mëparshme dhe shfrytëzohen në nivele shumë më të ulta se kapaciteti i tyre fillestar. 700 punishte të tjera të vogla të përpunimit të metaleve dhe punimeve mekanike ofrojnë shërbime artizanale, por jo prodhimin tradicional.

Rregullimi i këtyre aktiviteteve nga pikëpamja e mjedisit ka filluar shumë vonë. Zotërohet informacion tepër i kufizuar, i nxjerrë nga monitorimet, si edhe njohuri të kufizuara për efektet e sakta të këtyre veprimtarive mbi mjedisin. Substancat ndotëse përfshijnë jo vetëm metalet dhe materialet e tjera të përdorura, por edhe kimikatet e përdorur në proceset e prodhimeve industriale përfshirë këtu acidet, vajrat dhe substanca të tjera me shkallë të lartë toksiciteti.

Shqipëria ka kaluar nga eksportimi i dikurshëm i naftës bruto dhe nënprodukteve të përpunuara të saj, në importimin e 70% të sasive të domosdoshme për plotësimin e nevojave të ekonomisë së vendit. *Nxjerrja e naftës dhe e gazit* kryhet duke përdorur teknologjinë sovjetike dhe kineze, e cila nuk është aspak efikase dhe ndot mjedisin. Modernizimi është realizuar në nivele të kufizuara. Produktet e naftës përpunohen në Rafinerinë e Ballshit, e cila aktualisht punon me rreth 30% të kapacitetit fillestar.

Teknologjitë e prodhimit dhe përpunimit, të cilat ndotin në mënyrë të veçantë, përfshijnë:

- Puset e hapur nga të cilët çlirohen gaze shoqëruese në atmosferë;
- Depozitat e hapura grumbulluese dhe matëse që lejojnë avullimin e fraksioneve më të larta (dhe që mund të jenë të vlefshme) të hidrokarbureve, sidomos në kushtet e temperaturave të larta gjatë periudhës së verës;
- Djegia e gazit të tepërt dhe çlirimi i gazeve serrë që ndodh gjatë saj; dhe
- Derdhja e pakontrolluar në kanalet e hapur të kullim/vaditjes, e ujërave të formacioneve që përmbajnë gaze sulfhidrike toksike dhe ngarkesa të tjera ndotëse.

Skemat e rehabilitimit kanë nisur dhe marrëveshjet e kohëve të fundit për ndarjen e prodhimit përfshijnë klauzola për mjedisin. Me pak fjalë, zhvillimet e fundit janë më pak të dëmshme, por ka ende shumë punë për të bërë për të kapërcyer ndotjen e trashëguar nga e kaluara dhe atë të krijuar tani.

Njësia e vetme *kimike* që ka mbijetuar nga shtatë të tilla që funksiononin në vitin 1990 është ajo e kripës në Vlorë. Pjesa e tjetër e sektorit përbëhet nga Ndërmarrje të Vogla e të Mesme (NVM) që prodhojnë bojra, pluhura larës dhe kimikate të përgjithshme (sfungjer, vajra lubrifikantë, letër higjienike dhe materiale ngjitëse).

Disponohet shumë pak informacion lidhur me metodat e prodhimit dhe ndikimin që ka në mjedis sektori i mbijetuar i prodhimit të kimikateve në vend, sidomos në lidhje me efektin e përbërësve organikë, të cilët nga vetë natyra e tyre janë ndotës. Ndikimet mjedisore mendohet të jenë relativisht të vogla dhe të lokalizuara në vende të caktuara për shkak të volumit të vogël të punës.

Prodhohen gjithashtu edhe produkte farmaceutike. Prodhuesit kryesorë kanë procese të kontrollit të cilësisë, të një standardi të lartë si dhe një personel të kualifikuar.

### **Industritë e tjera**

*Industria e përpunimit të drurit* punësonte më parë rreth 12 000 punëtorë. Produktet e këtij sektori përfshinin lëndë druri, dërrasa, rimeso, kompensatë, pllaka zdrukthi e fibre, arka ambalazhi, fuçi, mobilje dhe rrëshirë. Privatizimi dhe krijimi i ndërmarrjeve të reja të përbashkëta, sidomos e NVM-ve, e ka bërë këtë sektor më fitimprurës dhe konkurrent, të aftë që t'i përshtatet më mirë

kushteve të ekonomisë së tregut, por me një ulje drastike të numrit të punonjësve deri në më pak se 3 000 veta.

Megjithatë, shumica e ndërmarrjeve përdorin ende teknologji të vjetër, nxjerrin produkte të një cilësie mesatare dhe gjenerojnë sasi të mëdha mbetjesh. Këto mbetje digjen ose hidhen, për shkak të mungesës së impianteve grumbulluese dhe mundësive për ripërdorim, gjë që ashtu sikurse përmendet në Kapitullin 1, përbën një mundësi ekonomike të humbur për të minimizuar mbetjet dhe për të ulur varësinë nga importi.

**Industria e përpunimit të produkteve ushqimeve** dhe agro-industria përfaqësojnë rreth 15% të vlerës totale të prodhimit bujqësor bruto dhe 2% të PKB-së. Vërehet një rritje në investime, prodhim dhe punësim në ndërmarrjet e vogla, të cilat janë të shumta në numër dhe në ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, të cilat janë të pakta në numër.

Po shtohet intensivisht numri i fermave dhe prodhimi i produkteve blegtorale në to. Krahas prodhimit të mishit dhe bulmetit, me sasi të mëdha të plehut të prodhuar prej tyre, ato përbëjnë ndotësit kryesorë në këtë sektor, megjithëse edhe nga përpunimi i vajit, duhanit dhe veprimtarive të tjera përpunuese dalin sasi të konsiderueshme mbetjesh.

Ujërat e mbetura shkarkohen kryesisht të patrajtuar në kanalet e tyre dhe prej këtej në ujërat sipërfaqësore, ose direkt në ujërat sipërfaqësore. Edhe pse këto ujëra, zakonisht nuk janë toksike apo të rrezikshme, përmbajtja organike dhe e lëndëve ushqyese në to është e lartë, gjë që ndikon shumë negativisht në cilësinë e ujërave ku ato derdhen. Një prej zgjidhjeve të këtij problemi mund të jetë instalimi i impianteve të përpunimit dhe trajtimit të këtyre ujërave nga sipërmarrjet private. Megjithatë, nevojat e çdo ndërmarrjeje për investime do të ishin relativisht të mëdha. Një zgjidhje më ekonomike do të ishte e mundur, nëse ndërmarrjet bashkoheshin në një vend, duke krijuar zona industriale të organizuara, rrjedhimisht mundësojnë konsolidimin dhe përqendrimin në këtë sektor si dhe përdorimin e pajisjeve të përbashkëta të përpunimit e trajtimit. Mbetjet e ngurta nga ky sektor, për shembull, nga përpunimi i mishit, paraqesin gjithashtu probleme serioze për mjedisin.

Numuri i **fabrikave të lëkurës** është rritur në mënyrë që t'i përgjigjet kërkesës së industrisë së rilindur të **lëkurës**, pjesërisht nëpërmjet futjes përsëri në punë të fabrikave të vjetra dhe pjesërisht nëpërmjet zhvillimit të njësive të reja më të vogla. Ky është një aktivitet që, nëqoftëse nuk administrohet siç duhet, paraqet rreziqe të konsiderueshme për mjedisin, për shkak të larmisë së madhe të kimikateve që çlirohen, në të cilat përfshihen acide organike, surfaktantë dhe produkte të tjerë të kimisë organike. Kripërat toksike të kromit shpesh të përdorura në proceset e përpunimit të lëkurës mund të përbëjnë gjithashtu një problem serioz.

Sektorët e tjerë industrialë përfshijnë sektorin e tekstit, plastikës, qeramikës dhe qelqit. Këta kanë treguar një ecuri të ngjashme me atë të thujse gjithë sektorëve të tjerë, domethënë një rënie të theksuar të punës pas vitit 1990, si dhe disa ndryshime në mënyrën e funksionimit dhe larmisë së produkteve të NVM-ve që prej asaj kohe. Problemet e tyre mjedisore janë aq të larmishme sa edhe produktet e tyre. Çështjet e shfaqura në këtë sektor përfshijnë mungesën e informacionit, mungesën e një administrimi efikas dhe të një rregulloreje për të kontrolluar nivelin e ndotjes.

Si përfundim, problemet kryesore të mjedisit të shfaqura në sektorin industrial janë ndotja e ajrit, ndotja e ujit, hedhja e mbetjeve të ngurta dhe ndotja e tokës. Përveç këtyre, ka edhe një sërë problemesh të shëndetit dhe sigurisë të ndeshura në lidhje me praktikën aktuale të funksionimit.

**Problemet kyçe të industrisë** – Ndotja e tokës dhe ujërave nëntokësore, ndotja e ajrit, çlirimi i gazeve të efektit serrë, administrimi i mbetjeve e sidomos gjenerimi dhe hedhja e mbetjeve të rrezikshme, shkarkimi i ujërave të ndotura, probleme të shëndetit dhe sigurisë.

**Prirjet** - me zhvillimin e ekonomisë, do të shtohet edhe dëmi ndaj mjedisit me pasoja për burimet natyrore, botën e kafshëve të egra dhe shëndetin publik. Ky dëm ndaj mjedisit gjithashtu do të:

- kufizojë mundësinë e zhvillimit të disa industrive të reja si turizmi;
- krijojë probleme të tjera që do të kushtojnë jashtëzakonisht shumë për t'u ndrequr (siç tregohet nga 'pikat e nxehta' ekzistuese); dhe
- kufizojë ndjeshëm mundësitë për tregti ndërkombëtare, si rezultat i mosarritjes së standardeve të caktuara nga Komuniteti Europian për mjedisin.

#### **Masat që duhen marrë:**

Në lidhje me industrinë - Është e domosdoshme që industria të zbatojë praktika të mira të administrimit të mjedisit dhe të investojë në atë teknologji që do të bëjë të mundur kontrollin e ndotjes, uljen e sasisë së mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe si rrjedhim nxjerrjen e fitimeve më të mëdha.

Roli drejtues i qeverisë – Qeveria duhet të sigurojë stimuj për përdorimin e praktikave të mira, nëpërmjet legjislationit, standardeve, mekanizmave zbatues dhe monitorimit. Megjithatë, qeveria duhet ta mbështesë gjithashtu industrinë edhe në kryerjen e ndryshimeve të nevojshme nëpërmjet ndërgjegjësimit të njerëzve, trajnimeve të organizuara dhe mundësive për të marrë fonde mbështetëse, nëse do që të ndikojë seriozisht në zbatimin e masave në lidhje me industrinë.

#### **Energjia**

Burimi kryesor i *prodhimit të energjisë elektrike* në Shqipëri janë hidrocentralet. Ata përfaqësojnë mbi 90% të kapacitetit të instaluar prodhues. Prodhimi i energjisë me këtë mënyrë ndikon minimalisht në ndotjen atmosferike, si rezultat i së cilës Shqipëria ka nivel të ulët të çlirimit, për frymë, të gazeve të efektit serrë. Megjithatë, hidrocentralet e kanë transformuar hidrologjinë dhe ekologjinë e lumenjve në vendet ku janë ndërtuar.

Niveli aktual i prodhimit të energjisë është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat e vendit dhe mungesa e energjisë mbulohet duke kombinuar ndërprerjen e energjisë elektrike me furnizimin nga vendet fqinje. Në vitet pa reshje shiu (si viti 2005), situata përkeqësohet, sepse nuk ka ujë të mjaftueshëm nëpër rezervuare në mënyrë që të shfrytëzohet në maksimum kapaciteti i instaluar.

Ekziston mundësia për të ndërtuar hidrocentrale të tjera, por një gjë e tillë sa vjen e bëhet më e kushtueshme, pasi vendet më të mira tashmë janë përdorur. Për më tepër, kjo nuk do të zgjidhë problemin e mungesës së energjisë, për shkak të periudhave të thata. Për të kompensuar mungesën në energjinë hidrike nevojitet shfrytëzimi i energjisë termike. Prodhimi aktual i energjisë termike është i kufizuar. Pavarësisht nga kjo, termocentrali i vetëm ekzistues përbën çliruesin kryesor të substancave ndotëse të ajrit dhe prodhuesin e hirit. Çlirimi në sasi të mëdha (dhe i dëmshëm) i squfurit në ajër, vjen nga përdorimi i karburantit me përmbajtje jashtëzakonisht të lartë squfuri (6 deri në 8%).

Është planifikuar ndërtimi i një termo-centrali të ri e të madh në mënyrë që të kompensojë mangësitë në prodhimin e energjisë. Ky termo-central mendohet të përdorë solar për një periudhë afatshkurtër, por në një periudhë afatgjatë, duhet synuar që të përdorë gaz më të pastër natyror. Ka rëndësi që të merren masa në mënyrë që karburanti i përdorur të ketë përmbajtje shumë më të ulët squfuri sesa ai që përdoret tani.<sup>20</sup>

<sup>20</sup> Direktiva 1999/32/EC përcakton një limit për përmbajtjen për solarin në Komunitetin Europian prej 1% nga masa.

Mënyra e re e prodhimit të energjisë përbën zgjidhje të kushtueshme e nuk mjafton përdorimi i vetëm atij për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Ai duhet të kombinohet me efikasitetin e energjisë dhe masat për zvogëlimin e humbjes, të cilat ndihmojnë për të kapërcyer shpërdorimin në masë të energjisë sot, sidomos në sektorin industrial dhe të transportit, të cilët kohët e fundit karakterizohen nga përdorimi i pajisjeve të vjetra dhe investimeve të pamjaftueshme.

Edhe pse përdorimi i *linjtit* ka rënë ndjeshëm që nga fillimi i viteve 1990, djegia e tij mbetet problem i madh për vendin, për shkak të vlerës së tij të ulët kalorifike, çlirimit në sasi të mëdha të squfurit dhe përmbajtjes së lartë të hirit.

Përdorimi në shkallë të gjerë i *drurit* si lëndë djegëse në furra është shpërdorim dhe nuk është aspak efikas. Përgjithësisht përdoren furra me efikasitet të ulët që çlirojnë gaze të efektit serrë dhe hidrokarbure poliaromatike që krijojnë rrezikun e shfaqjes së kancerit. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e druve që përdoren si lëndë djegëse vjen nga zonat me dru të fortë të tipit shkurre, të cilët rigjenerohen në një cikël relativisht të ngadaltë<sup>21</sup> Mbishfrytëzimi i zonave të tilla i ekspozon tokat ndaj erozionit. Vitet e vështira pas ndryshimit të regjimit u shoqëruan nga ndërprerje të vazhdueshme të energjisë, gjë që shkaktoi përdorimin edhe më shumë të drurit si lëndë djegëse në shtëpi, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke përshpejtuar në mënyrë të konsiderueshme ritmin e paqëndrueshëm të prerjes së lëndës drusore.

Pemët e mbjella rishtas shpesh kanë qenë drurë që rriten shpejt dhe me vlerë kalorifike më të ulët (plepa, robinia, pisha, shelgje). Disa prej këtyre llojeve nuk janë autoktone, si rrjedhim, përgjithësisht do të thotë humbje e biodiversitetit aty ku janë mbjellë.

**Problemët kyçe** - Ndotja e ajrit dhe çlirimi në atmosferë i gazeve të efektit serrë nga termoelektrocentralet, niveli i ulët i burimeve ujore që ndikon në nivelin e energjisë së prodhuar nëpërmjet përdorimit të burimeve hidrike, familjet që përdorin lëndë djegëse të ngurta nga zonat pyjore të paadministruara, impjante djegës joefikasë, shpyllëzimi dhe erozioni nga zonat pyjore që administrohen në mënyrë jo të qëndrueshme dhe pa përfillur mjedisin, të cilat ndikojnë të biodiversiteti, administrimi i ujit dhe shfrytëzimi i tokës.

**Prirjet** – Kërkesa për energji ka filluar të rritet krahas me zhvillimin ekonomik – burimet e reja energjitike ka të ngjarë të jenë termike, të shoqëruara me ndotjen gjithnjë e më të madhe të ajrit dhe çlirimin e gazeve të efektit serrë.

#### **Masat që duhen ndërmarrë**

Impiantet ekzistuese të energjisë termike – përdorimi i lëndëve djegëse më të pastra, investime në pajisje për uljen e shkallës së ndotjes së ajrit, futjen në përdorim të sistemeve për administrimin e mjedisit.


Efikasitet më i lartë i energjisë – sidomos nga industria dhe institucione të mëdha – ndërgjegjësim më i madh lidhur me nevojën për një efikasitet më të lartë dhe me përfitimet nga ky efikasitet. Sigurimi i stimujve të përshtatshëm ekonomikë.

Sigurimi i energjisë në të ardhmen – të merren masa në mënyrë që të mbahen parasysh aspektet e mjedisit në shqyrtimin e alternativave të reja të prodhimit të energjisë: të shfrytëzohet vlerësimi strategjik i efekteve mjedisore, si pjesë integrale e planifikimit strategjik dhe e vlerësimit të ndikimit në mjedis për projekte të veçantë.

<sup>21</sup> 40 vjet për pyllin e krasitur me lisa (studim i i strategjisë për mjedisin nga Banka Botërore 1993)

## Transporti

Përpara viteve 1990, lëvizja njerëzve ishte e kufizuar. Pas kësaj kohe, lëvizjet janë shtuar shumë. Është rritur shfrytëzimi i të gjitha formave të transportit, me përjashtim të atij hekurudhor për transportin e udhëtarëve. Ai që mbizotëron është transporti rrugor. Numri i automjeteve në përdorim është rritur ndjeshëm dhe parashikohet të rritet edhe më, madje deri në 2015, ka mundësi që të trefishohet.



Grafiku 2-2 Numri i Makinave të Regjistruara nga 1997 deri 2005<sup>22</sup>

Strategjia që ndjek Shqipëria në lidhje me transportin<sup>23</sup> mbështetet shumë te rrugët, duke konfirmuar kështu prirjen aktuale. Me qëllim që të jetë i sukseshëm, rrjeti ekzistues duhet të zgjerohet dhe përmirësohet. Megjithatë, transporti rrugor mund të shkaktojë probleme të konsiderueshme në mjedis, shëndet dhe aspektin social, të cilat duhen kuptuar dhe zbutur.

Pjesa më e madhe e gazeve që çlirohen në atmosferë vijnë nga sektori i transportit dhe pikërisht nga mjetet e transportit rrugor. Karakteristikë e automjeteve në Shqipëri është përdorimi i karburantit të cilësisë së dobët dhe mosha e madhe e automjeteve së bashku me një prirje për të përdorur makina me motorë të përmasave të mëdha. Ndërthurja e këtyre tre faktorëve rrit në mënyrë të jashtëzakonshme ndotjen në krahasim me vendet e tjera europiane. Përveç kësaj, gjendja e rrjetit rrugor është e dobët dhe shpejtësia e automjeteve është e ulët. Automjetet operojnë thuhet gjatë gjithë kohës në një cikël "urban", duke ulur efikasitetin e lëndës djegëse dhe duke shtuar edhe më shumë gazet e çliruar për çdo kilometër të kryer. Zonat urbane janë më të prekura.

Taksat e importit për kategoritë më ndotëse të automjeteve dhe funksionimi i një skeme matëse e testuese të gazeve të çliruar synojnë të minimizojnë problemin, por përmirësimi i vërtetë varet nga zëvendësimi thuhet i plotë i makinave ekzistuese dhe nga përmirësimi i konsiderueshëm i cilësisë së rrugëve. Të dyja përfaqësojnë investime madhore që kërkojnë kohë të realizohen.

**Problemet kyçe** – Ndotja e ajrit në zonat urbane, kryesisht nga shkarkimi i gazeve të djegur të automjeteve (p. sh. NO<sub>x</sub>, CO, SO<sub>2</sub> dhe PM<sub>10</sub>) dhe pluhuri i rrugëve ndikojnë në shëndetin publik. Nivel i ulët i pajisjeve të transportit publik.

**Prirjet** – Përdorimi i automjeteve vazhdon të rritet me hapa të shpejtë, automjetet janë të vjetra dhe dominojnë motorët me fuqi të madhe motorike.

**Masat që duhen marrë** – Të përdoren lëndë djegëse më të pastra, të kontrollohen shkarkimet e gazeve të makinave dhe gradualisht të hiqen nga përdorimi makinat e vjetra që janë më ndotëse, të parandalohet importimi i makinave të vjetra të importuara nga vendet e tjera, të nxitet dhe mundësisht të stimulohet përdorimi i motorëve me fuqi motorike më të vogël dhe mjete më pak ndotëse, si dhe të ofrohen variante alternative të transportit publik me shkarkime të vogla, të përmirësohen sipërfaqet e rrugëve dhe të kontrollohet pluhuri i tyre.

<sup>22</sup> Të dhëna sipas Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

<sup>23</sup> Plani Kombëtar i Transportit të Shqipërisë

### **2.3.2 Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi**

Pavarësisht nga natyra komplekse e gjeologjisë, peizazhit dhe klimës së Shqipërisë, vendi mund të shikohet si i përbërë nga dy zona të dallueshme qartë: zonën e ulët fushore, e cila zë 25% të vendit, e që është e përshtatshme për bujqësi dhe shtrihet përgjatë bregdetit Adriatik dhe 75% e vendit që përbëhet nga zonë malore, shumë pak e dobishme për prodhim bujqësor. Në zonën e parë ka breza kodrash joprodhuese dhe shumë lugina pjellore në të dytën, por ndarja e përgjithshme mund të shihet qartë në hartat topografike.

Modernizimi i *ekonomisë bujqësore* nisi me futjen e prodhimit bujqësor për shitje në vitet 1920 dhe 1930, një ndryshim rrënjësor ky nga format e bujqësisë së sigurimit të ushqimeve për ekonominë familjare, të cilat qenë dominuese deri në atë kohë. Në periudhën mes viteve 1950 dhe 1975, u bënë investime të mëdha për shtimin e zonave të kultivuara si pjesë e një vendimi politik për ta bërë Shqipërinë të pavarur nga produktet bujqësore të importit. Këto investime përfshinë vaditjen në shkallë të gjerë, ngritjen e një sistemi kullimi dhe kthimin e tokave në tokë bujqësore, që sollën shkatërrimin e shumë ligatinave dhe i dhanë rëndësi atyre që mbetën. Këto masa për administrimin e ujit, kanë ndikuar në rrjedhën e lumenjve dhe sistemin e përmbytjeve dhe kanë ndikuar në morfologjinë bregdetare duke ndryshuar strukturën e erozionit dhe shtresave të sedimenteve. Këto zhvillime u shoqëruan me shtimin e metodave të prodhimit që përfshinin futjen dhe përdorimin masiv dhe të tepruar të kimikateve, si plehurat kimike dhe biocidet, disa prej të cilëve tashmë janë ndaluar në rang ndërkombëtar për shkak të dëmit që i sjellin mjedisit.

Qëllimi i investimeve ishte zgjerimi në maksimum i zonës së prodhimit më shumë sesa rritja e efektivitetit. Në sektorin e vaditjes, 40% e ujit të sjellë llogaritej e humbur. Uji që rridhte nga sistemi i kullimit dhe i drenazhimit ishte i ndotur nga kimikatet bujqësore, por nuk ka një informacion të saktë për sa i përket nivelit të vërtetë të ndotjes, sepse në atë kohë, cilësia e ujit nuk monitorohej.

Përveç këtyre efekteve në zonat fushore, kthimi i kullotave alpine dhe sub-alpine në tokë bujqësore me qëllim shtimin e sipërfaqes së tokës së punueshme ka pasur gjithashtu një ndikim serioz negativ në biodiversitetin dhe ka çuar në erozion më të madh të tokës në zonat malore.

Pakësimi i përpjekjeve nga ana e shtetit për të mbajtur lart prodhimin në mënyrë artificiale u pasua nga një rënie e pjesshme e ekonomisë bujqësore. Kudo pati migrim të pupullsisë nga zonat rurale bujqësore drejt vendbanimeve urbane. Prishja e sistemit të grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit solli dëme të konsiderueshme në infrastrukturën e ujit dhe kullimit dhe çoi në braktisjen e saj. Mungesa e mirëmbajtjes së sistemeve të kullimit çoi në uljen e pjellorisë së disa tokave dhe në një rrezik më të madh përmbytjeje.

Aktiviteti bujqësor aktual, vazhdon të krijojë probleme. Në mënyrë të vaçantë praktikatat e papërshtatshme të plugimit të shpateve, shkaktojnë erozion të mëtejshëm. Copëzimi i tokave si rezultat i presioneve të urbanizimit dhe ndryshimeve në pronësinë e tokave ka penguar modernizimin e këtij sektori.

Kanë filluar tashmë programet e riparimit dhe përmirësimit për të kthyer në gjendje pune infrastrukturën që ka mbijetuar, të sistemit të kullimit dhe vaditjes. Edhe pse niveli i pritshëm i nevojave për ujë (rreth 600 000 m<sup>3</sup>), teorikisht është brenda kufijve të mundësisë së furnizimit (rreth një milion m<sup>3</sup>), kjo përlllogaritje e thjeshtë nuk u përgjigjet ndryshimeve sezonale dhe vjetore në sasinë e ujit që disponohet, gjë që do të thotë se vaditja e plotë nuk do të jetë plotësisht e mundur në të gjitha vitet.

Niveli i përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve ra në mënyrë të ndjeshme pas vitit 1990 dhe tani është më e ulët në krahasim me praktikën e ndjekur në Europë. Ndikimi i tyre në mjedis është

përkatesisht i vogël. Megjithatë, intensifikimi i ekonomisë bujqësore po çon drejt një përtëritjeje të përdorimit të tyre dhe ka të ngjarë të paraqesë probleme mjedisore në zonat e ulëta fushore dhe bregdetare ku pasurimi me lëndë ushqyese mund të çojë në eutrofikimin si të ujërave të ëmbla ashtu edhe atyre të kripura.

**Pylltaria** është një çështje e rëndësishme në Shqipëri. Një milion hektarë ose 37% e sipërfaqes së tokës së Shqipërisë klasifikohet si e pyllëzuar. Edhe pse statistikave të kohëve të fundit tregojnë se kjo sipërfaqe është relativisht e qëndrueshme, prodhimtaria e saj ka pësuar rënie të konsiderueshme si pasojë e prerjeve pa leje. Para vitit 1990, një pjesë e madhe e drurëve të prerë përdorej për industrinë e përpunimit dhe prodhimeve prej druri. Aktualisht një pjesë shumë e madhe përdoret si lëndë djegëse në shtëpi.

Ndikimi kryesor në mjedis i aktiviteteve të paadministruara pyjore është erozioni i tokës që sterilizon zona të mëdha malore dhe dëmton cilësinë e ujit duke shtuar ngarkesën e tij me sedimente. Humbja e sipërfaqes së mbuluar me dru, ndikon gjithashtu, shumë negativisht në dëmtimin e biodiversitetit duke zhdukur shumë habitate për një mori specimesh të botës bimore dhe shtazore.




Problemet lidhur me administrimin e pyjeve janë identifikuar qysh në fillim të viteve 1990. Këto probleme janë trajtuar kohët e fundit në Strategjinë e Zhvillimit Pyjor (2004) dhe në ligjet e reja (mbi Shërbimet Pyjore dhe Policinë Pyjore, Maj 2005). Të dy këta instrumente përforcojnë parimin e decentralizimit dhe nevojën për administrim të mirë duke ia kaluar pronësinë e pyjeve pushtetit vendor, me kusht që të hartojnë e të marrin masa për zbatimin e Planeve për Administrimin e Pyjeve. Po fillon të funksionojë një Kadastër Pyjore dhe zyrtar Rajonale të Pyjeve po pajisen me teknologjinë e duhur.

Këto veprime do të ndihmojnë në ruajtjen dhe në fund rikthimin e prodhimtarisë së pyjeve, por për të ruajtur zonat dhe peizazhet e mbetura që mbrohen me ligj, për qëllime argëtimi, çlodhjeje e turizmi por edhe për ruajtjen e biodiversitetit është e domosdoshme të ndërmerren edhe veprime të tjera.

Sektori i **peshkimit** detar është i dobët. Shumica e anijeve janë të afta të operojnë vetëm në ujëra afër bregut të detit. 30% e flotës së regjistruar është e papërdorshme. Një pjesë e madhe e aktivitetit është e palicensuar dhe kufizimet në peshkim nuk zbatohen si duhet. Problemet përfshijnë përdorimin e tepruar të rrjetave fundore që dëmtojnë habitatet në fund të detit (e si pasojë kapacitetin riprodhues të specieve që jetojnë e ushqehen në fund të detit) dhe përdorimin e rrjetave të imta që zënë peshq të vegjël pa ndonjë leverdi ekonomike.

Qendrat e peshkimit në ujërat e ëmbla, kanë qenë gjithashtu subjekt i shumë aktiviteteve të paligjësme, megjithëse krijimi i Shoqatave të Administrimit të Peshkimit, ka ndihmuar në zbutjen e tyre. Specie të caktuara, siç është Korani i liqenit të Ohrit, kanë qenë jo vetëm objekt i peshkimit të paligjshëm dhe pa kriter, por edhe objekt i një presioni të fortë gjenetik, duke çuar deri në zhvillime degjenerative, siç është kryqëzimi i tij me varietete të tjera të troftës.



Korani = "Salmo Letnica"

Ujërat, tepër të rëndësishëm për peshkim, po ndoten ose dëmtohen. Liqeni i Shkodrës rrezikon të ndotet nga një sërë burimesh, përfshirë edhe impiantin e përpunimit të aluminit në Mal të Zi<sup>24</sup>. Livadhet nënujore në breg të detit, aq të rëndësishëm për riprodhimin e peshkut po dëmtohen apo shkatërrohen nga përdorimi i metodave të papërshtatshme të peshkimit si edhe nga ndryshimet në cilësinë e ujit, përfshirë prurje të mëdha të sedimenteve.

Rritja e peshkut është e përqendruar në 6 000 rezervuarë të vegjël të grumbullimit të ujit për vaditje, të cilët përdoren për prodhimin e krapit. Rritja në shkallë të gjerë e karkalecëve dhe molusqeve praktikohet në lagunat bregdetare. Pjesa më e madhe e këtyre lagunave janë pjesë e tokave të ujshme (moçalore) bregdetare me ekosisteme të ndjeshme që gëzojnë mbrojtje të përgjithshme. Megjithatë, edhe këto janë nën presion nga turizmi dhe zhvillimi urban.

Rritja e peshkut mund të sjellë ndotjen e ujit si nga lëndët ushqyese të shtuara në ushqimet e kombinuara, të prodhuara nga Industria e Ushimeve për Blegtorinë, ashtu edhe nga përdorimi i pesticideve dhe insekticideve, të përdorur për të luftuar insektet e dëmshme dhe sëmundjet e ndryshme. Këto paraqesin një rrezik të veçantë në lagunat bregdetare, të cilat kanë ekologji të pasur dhe delikate, si dhe në liqenet malore, ku nevoja për ruajtjen e specieve, që gjenden vetëm në atë vend, si korani mund të bjerë ndesh me presionet ekonomike për të prodhuar produkte të tjera që ecin në treg si trofta.

**Problemet kyçe** – Erozioni i tokës i shkaktuar nga uji dhe era, kërkesat për shfrytëzimin e burimeve të ujit, ndotja e ujit, rënia e cilësisë së peizazhit dhe humbja e biodiversitetit, shpyllëzimi për dru për djegie, pakësimi i rezervave të peshkut, konflikte me mundësitë për çlodhje, argëtim dhe për zhvillimin e turizmit, ndërtimi i godinave private të banimit në tokë bujqësore, copëzimi në parcela të vogla i tokës bujqësore, etj.

**Prirjet** – Intensifikimi i bujqësisë me praktika të dobëta kultivimi dhe mbishfrytëzimi i pyjeve dhe kapaciteteve të peshkimit. Shpyllëzimi dhe erozioni shtojnë presionin mbi tokën e mbetur.

**Masat që duhen marrë** – Rritje e ndërgjegjësimit për efektet e praktikave të dobëta (të paqëndrueshme) të prodhimit bujqësor, pyjor dhe të peshkimit, zbatim më të rreptë të dispozitave ekzistuese ligjore, përkrahje të praktikave që nuk dëmtojnë mjedisin, zhvillim të vazhdueshëm të planeve për administrimin e peshkimit dhe pylltarisë, hartime planesh për administrimin e zonave të ndjeshme, planifikim për administrimin e basenit të lumit

<sup>24</sup> Pakësimi i rreziqeve ndaj Mjedisit dhe Sigurisë që vijnë nga Gërmimi në Sektorin e Europës Juglindore - studim vlerësimi për Projektin e Nismës për Mjedisin dhe Sigurinë, Philip Peck, Nëntor 2004, Zyra Rajonale e PKBM -së për Europën dhe Sektori i Teknologjisë, Industrisë dhe Ekonomisë së PKBM -së



### 2.3.3 Zhvillimi Urban

Para viteve 1990, lëvizja e popullsisë dhe ndërtimet kontrolloheshin rreptësisht nga shteti. Në vitin 1991, u miratua Ligji për Lëvizjen e Lirë dhe në të njëjtën kohë humbi kontrolli mbi ndërtimet e bëra. Pasojat ishin, një shpërngulje e shpejtë nga zonat malore për t'u vendosur në periferi të qyteteve, shoqëruar kjo me një bum ndërtimesh, për të ulur presionin e mbipopullimit të zonave urbane.

Korridori Tiranë-Durrës ka përjetuar procesin më të shpejtë të urbanizimit, edhe pse qytete a qyteza të tjera në zona fushore kanë pësuar gjithashtu rritje të konsiderueshme. Si pasojë e këtij zhvillimi të shfrenuar, qytetet duhet të përballen me probleme madhore për sa i përket ofrimit të shërbimeve dhe sigurimit të infrastrukturës.

Shumë prej zonave periferike janë zona informale të paregjistruara apo pa tapi toke, duke shmangur kështu taksat mbi pronën dhe shtëpinë. Në këtë mënyrë ato nuk mund të përfitojnë shërbimet urbane. Po kështu, mungesa e të ardhurave të pushtetit vendor, do të thotë që në shumë raste autoritetet vendore nuk janë në gjendje t'i sigurojnë shërbime të tilla për shkak të mungesës së një infrastrukture dhe fondeve për investime. Vlera e këtyre ndërtimeve të pa legalizuara për sigurimin e një strehimi pranohet nga qeveria, e cila ka filluar një proces për të bindur njerëzit që të regjistrojnë shtëpitë, të marrin tapitë dhe kështu të kenë të drejtën për të përdorur shërbimet, sidomos atë të mbledhjes së mbetjeve, furnizimin me ujë dhe shërbimet sociale përfshirë shkollat, në këmbim të pagesës së taksave përkatëse.

Përforcimi i kontrolleve ligjore në procesin e zhvillimit, bashkë me decentralizimin e përgjegjësive e kalimin e tyre tek autoritetet vendore po ofron mundësi për administrim më të mirë të zonave urbane. Krijimi i firmave bashkiake për të siguruar shërbime për infrastrukturën, veçanërisht ujin e pijshëm, është një masë tjetër e rëndësishme që po merret. Por, me qëllim që këto reforma të shfrytëzohen në maksimum, pushteti vendor ka nevojë për personelin e të ardhurat e duhura, që në përgjithësi tani për tani nuk janë jo vetëm në nivelin e duhur, por shumë minimale. Edhe më i rëndësishëm është fakti se autoritetet vendore duhet të kenë kontroll mbi procesin e planifikimit dhe ndërtimit nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të planeve të zhvillimit lokal për zonat e tyre.

Legjislacioni aktual parashtron procedura miratimi për planifikimin e zonave të ndërtimit dhe zbatimin e ndërtimeve, por nuk siguron një instrument të fortë për të ndihmuar në drejtimin e ndërtimeve në një mënyrë që nuk dëmton mjedisin. Sistemi aktual e vë pushtetin vendor në një pozitë kundërvepruese, pa i dhënë mundësinë që të marrë parasysh konsideratat ekonomike apo problemet e infrastrukturës sociale a mjedisore.

Ky proces i reaksionit zinxhir nuk ka qenë në gjendje të merret me aspekte të tjera të rëndësishme të zhvillimit në vitet e fundit. Ngrihen, veçanërisht tre shqetësime:

- Dispozitat ligjore, por që nuk janë në dobi të mjedisit, sipas të cilave një shtëpi mund të ndërtohet në çdo ngastër toke prej më pak se një hektar, gjë që çon në një vendosje të banesave larg nga njëra tjetra me një kosto jashtëzakonisht të lartë për ofrimin e shërbimeve për sa i përket infrastrukturës së mjedisit dhe efektet negative të të cilave mbi sistemin e shfrytëzimit të tokës bujqësore mund të jenë dramatike, pasi gjithnjë e më shumë sipërfaqe toke relativisht të mëdha nuk japin më prodhim;
- Zaptimi në shkallë të gjerë dhe shpesh pa kriter, i zonave bregdetare dhe atyre buzë liqenjve, nga spekullatorë dhe për qëllime tregtie, pa infrastrukturën e mjaftueshme (sidomos sistemin e shkarkimit të ujërave të zeza), po shkatërron mundësinë e ndërtimit të një turizmi me cilësi të lartë, që do t'i sjellë vendit valutën aq të nevojshme nëpërmjet klientëve të huaj;

- Zaptimi i paplanifikuar industrial dhe tregtar i tokave përgjatë rrugëve kryesore, sidomos korridorit Tiranë-Durrës, jo vetëm që kufizon kapacitetin e tyre, por gjithashtu ka kosto të konsiderueshme për sigurimin e infrastrukturës (është gjithmonë shumë më e kushtueshme të përpiqesh të ofrosh shërbime, pasi ndërtimi është realizuar, sesa t'i sigurosh ato para ndërtimit).

Cilësia e dobët e infrastrukturës urbane në të gjithë qytetet dhe fshatrat është një burim i rëndësishëm ndotjeje, qoftë pluhur nga rrugë të pashtuara ose të shtruara keq apo mbetje rrethqarkë të pamjaftueshëm të mbetjeve, që shërbejnë si vatra shumimi për parazitë, ose kanale ujërash të zeza më të vegjël se normalja, me pamundësi përballimi të ujërave të ndotura, ujin e shiut dhe mbetjet e ngurta që marrin rrugës.

**Problemet kyçe** – Ndërtime të pakontrolluara, të paligjshme dhe të planifikuara keq për sa i përket shërbimeve për popullsinë, rënia e cilësisë së peisazhit dhe shtimi i ndotjes, humbjet përkatëse të mundësive për zhvillim ekonomik në mënyrë të veçantë për zhvillimin e turizmit.

**Prirjet** – Urbanizim i shpejtë, shpërndarje e zonave rurale, ndërtime në bregdet.

**Masat** – Kontroll efikas i planifikimit urban e territorial, bazuar në planet e zhvillimit që janë gati, duke pasur parasysh kufizimet mjedisore, mundësitë ekonomike dhe konsultimin me komunitetin.

#### 2.3.4 Turizmi

Turizmi ndërkombëtar mund të shndërrohet në një kontribues i rëndësishëm për ekonominë dhe bazën e punësimit, drejtpërdrejt në vetë sektorin dhe në mënyrë indirekte nëpërmjet artizanatit dhe mundësive për tregti që ofron ai. Dy zonat kryesore me mundësi zhvillimi janë malet dhe bregdetet. Edhe liqenet e zonës juglindore dhe veriore ofrojnë gjithashtu mundësi të shumta.

Kushtet e ashpra klimatiko-gjeografike në *zonat malore* dhe prodhimtaria e pakët e tokave krijojnë mundësi sfiduese por edhe delikate për turizmin. Largësia e konsiderueshme, mungesa e infrastrukturës bazë, shpyllëzimi, erozioni i tokës, gjuetia e tepruar dhe zhvillimi i papërshtatshëm, të gjitha këto duhet të merren parasysh kur shqyrtohen mënyrat sesi të përfitohet sa më shumë nga këto mundësi në këto zona.

Liqenet kufitare (Prespa, Ohri dhe deri në një farë mase Shkodra) ofrojnë mundësi turizmi ku gjen të kombinuara disa prej avantazheve të të dyja zonave, si bregdetare ashtu edhe malore, por edhe shumë prej vështirësive që paraqesin ato. Largësia relative, zhvillimi i papërshtatshëm, infrastruktura dhe shërbimet e papërshtatshme, ndotja, shpyllëzimi dhe prishja e peizazheve natyrore, të gjitha këto, shërbejnë për të kufizuar mundësitë për një turizëm të qëndrueshëm që sjell të ardhura në valutë.

*Plazhet* me rërë të detit Adriatik dhe *bregdeti* shkëmbor i detit Jon ofrojnë mundësi zhvillimi, por prishja nga bonifikimi dhe ndotja industriale, së bashku me urbanizimin pa kriter, të papërshtatshëm e shpesh të paligjshëm, çojnë në pakësimin e këtyre mundësive. Kjo është pasojë e një planifikimi të dobët dhe e dobësisë së kontrollit të zhvillimit, mungesës së infrastrukturës së përshtatshme dhe shërbimeve e problemeve që sjell pronësia e dyshimtë e tokës.

Mundësitë për një përfitim financiar në një periudhë afatshkurtër nga rritja e kërkesës në vend për objekte shërbimi e pushimi në zonën bregdetare, rrisin presionin për zhvillime të pakontrolluara dhe të paligjshme. Autoritetet vendore nuk janë të përgatitur për t'iu bërë ballë këtyre presioneve. Ata edhe mund t'i inkurajojnë ato, për shkak të vendeve të punës që hapen si dhe shtimit të të ardhurave që mund të sjellin.

Mungesa e informacionit, si pasojë e mos parashikimit dhe mos përllogaritjes së dëmit real dhe atij potencial që po i shkaktohet bregdetit shqiptar, maleve dhe trashëgimisë kulturore e natyrore, dhe mungesa apo zbatimi i dobët i politikave në nivel lokal dhe kombëtar po u shkaktojnë dëme të shumta pikërisht vetë burimeve nga të cilat varet turizmi ndërkombëtar i një vlere më të lartë.

Ka një mungesë njohurish dhe përvoja nga ana e qarqeve zhvilluesve por edhe atyre rregullatore dhe vendimmarrëse, rreth mësimave që duhen nxjerrë nga zhvillimi i kaluar dhe tendencave të së ardhmes të turizmit për qark detit Mesdhe. Shqipëria rrezikon të bëjë të njëjtat gabime që ka bërë Spanja, Malta dhe vende të tjera duke ndërtuar një industri turizmi mbi shfrytëzimin e shpejtë e të lirë të bregdetit për fitime në periudha afatshkurtra.

Këto faktorë do të pengojnë aplikimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe fitimprurës në valutë.

Strategjia që ka miratuar qeveria për zhvillimin e turizmit tregon se vetëm një proces zhvillimi që nuk dëmton mjedisin mund të jetë një bazë për zhvillimin e një turizmi ekonomikisht të suksesshëm, por strategjia përdor një metodë për zhvillimin e biznesit, prioriteti i së cilës është arritja e objektivave makro-ekonomike, duke përshpejtuar aktivitetet ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe nxjerrjen e të ardhurave dhe duke rritur të ardhurat në valutë. Kontributi i peizazhit natyror shqiptar dhe vendeve tërheqëse natyrore dhe kulturore si bazë për nxitjen e turizmit dhe rëndësinë e mjedisit lokal për një industri të sukseshme turizmi, nuk janë patur plotësisht në konsideratë nga politikat dhe rekomandimet që bëhen në atë strategji. Kjo pasqyron një mungesë vlerësimi të rolit gjithnjë e më të rëndësishëm të mjedisit cilësor për të tërhequr turizmin ndërkombëtar.

Turizmi i qëndrueshëm është *“Turizëm që merr parasysh mirë ndikimet aktuale e të ardhshme ekonomike, shoqërore dhe mjedisore, që u përgjigjet nevojave të vizitorëve, industrisë, mjedisit dhe komuniteteve mikpritëse.”*<sup>25</sup>

**Problemet kryesore** – Mundësia për një turizëm afatgjatë po dëmtohet nga kontrolli i dobët i zhvillimit, ndotja dhe administrimi i paqëndrueshëm i burimeve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

**Prirjet** – Numër në rritje i objekteve turistike të keqplanifikuar e të keqprojektuar në funksion të turistëve dhe pa mbështetjen e duhur të infrastrukturës.

**Masat** – Masat për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm – duhen lidhur me planifikimin e kontrollin e zhvillimit si edhe kontrollin e ndotjes, investimet në shërbimet komunale si p.sh. sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza, furnizimin me ujë dhe trajtimin e tij, administrimin e mbetjeve dhe planifikimin e marketingut të veçantë për turizmin.

### 2.3.5 Trashëgimia e së kaluarës

Modeli socialist i zhvillimit përqëndrohej në industrinë e rëndë dhe prodhimin e produkteve të papërpunuara. Ai nuk merrte parasysh seriozisht ndikimet mjedisore të këtyre zhvillimeve. Përfshinte një sektor të rëndësishëm kimik që prodhonte plehra azotike dhe fosfatike, pesticide, karbonat natriumi, pigmente, bojra e tretësa; prodhimin dhe përpunimin e naftës, kombine metalurgjike për shkrirjen e hekurit dhe pasurimin e mineraleve (bakër, krom, nikel), prodhim makinerish, prodhimin e çimentos; industrinë e drurit dhe letrës. Edhe pse shumë uzina tani janë mbyllur, vazhdojnë të ndotin mjedisin e të ndikojnë negativisht në shëndetin e popullsisë vendase.

<sup>25</sup> Përkufizim në “Për një turizëm më të qëndrueshëm – Manual udhëzues për politikë-bërësit”, Organizata Botërore e Turizmit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, 2005

Braktisja e pjesës më të madhe të kësaj infrastrukture industriale si pasojë e ndryshimeve ekonomike në vitet '90 ka lënë shumë zona me tokë të ndotur rëndë. Llojet kryesore të problemeve të ndeshura kanë të bëjnë me:

- *Ndotjen e tokës në dhe përfaqëson zonave industriale nëpërmjet derdhjeve, rrjedhjeve, që mund të përhapen gjithandej në rastin e depozitimeve të metaleve të rënda, nëpërmjet pluhurit që mbart ajri apo transportit të hidrokarbureve nga uji;*
- *Depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve industriale, një pjesë e madhe e të cilave është toksike ose e rrezikshme dhe që mund të kalojë si në ujrat sipërfaqësore ashtu edhe në ato nëntokësore (pastrimi i ujrave të ndotur nëntokësore është jashtëzakonisht i kushtueshëm dhe i ngadaltë);*
- *Minierat e braktisura, të prirura ndaj shembjes dhe uzinat industriale që shpesh përmbajnë materiale të rrezikshme;*
- *Pirgje mbetjesh dhe depozitime të mineraleve të mbetura nga punimet minerare që kanë lidhje me galeritë e minierave, me përqendrim të lartë të metaleve të rënda, të cilat janë potencialisht burim i ndotjes si të tokës ashtu edhe të ujit;*
- *Vende të pakontrolluara dhe të paadministruara për hedhjen e mbetjeve, të cilët përmbajnë përzierje të mbetjeve familjare dhe tregtare përfshirë edhe mbetjet industriale, të përpunimit të ushqimeve dhe të spitaleve.*

Në vitin 2000, PKBM<sup>26</sup>-ja (Program i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin) analizoi kushtet e një numri zonash industriale nga më të ndoturat në Shqipëri. Përfundimet e këtij studimi, identifikojnë qartë ndotjen aktuale serioze dhe rreziqet që i kanosen shëndetit publik, sidomos nëpërmjet ndotjes së ujit.

**Tabla 2-2 Përmbledhje e Vlerësimit të Pikave të Nxehta**

<b>Vendndodhja</b>	<b>Problemet Kyçe</b>
Uzina e Pesticideve dhe bikromatit, Durrës	Një sipërfaqe prej disa kilometrash katrorë është e ndotur rëndë nga kimikate dhe mbetje të rrezikshme nga uzinat e mëparshme kimike, një vend mbetjesh, dhe një magazinë e braktisur ku mbaheshin kimikate. Në zonën e ndotur jeton një popullsi e ardhur. Rreziqe serioze i kanosen shëndetit të njerëzve, ujrave nëntokësore dhe mjedisit detar.
Uzina e Sodës dhe e PVC, Vlorë	Nuk janë marrë masa për parandalimin e ndotjes së mjedisit nga zhiva e hedhur aty afër. Familjet dhe kafshët e tyre shtëpiake po jetojnë në kushte të rrezikshme nga ndotja e zonës me zhivë. Përpjekjet e qeverisë për zhvendosjen e këtyre familjeve kanë qenë pa rezultat.
Fusha e naftës në Patos - Marinëz	Ujrat nëntokësore po ndoten rëndë nga nafta e puseve, pompave e tubacioneve të naftës dhe pajisjeve të trajtimit paraprak. Çlirimet e gazit sulfurik dhe hidrokarbonit po ndotin atmosferën përfaqëson. Familjet që jetojnë në afërsi të fushave të naftës janë të ekspozuara ndaj rreziqeve serioze për shëndetin.
Rafineria e naftës, Ballsh	Sasi të mëdha të naftës dhe gazeve të rafinerisë derdhen dhe/ose çlirohen në mjedisin përreth. Mbetjet ujore që përmbajnë papastëri të naftës shkarkohen në një kanal, duke ndotur Lumin e Gjanicës, duke depërtuar ndoshta edhe në sistemin e furnizimit me ujë të popullsisë lokale. Rafineria çliron disa ndotës toksikë të ajrit në atmosferë.
Vend-depozitimi i mbetjeve urbane në Sharë	Për shkak të mungesës së pajisjeve të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme në vend, mendohet dhe besohet që mbetjet urbane përmbajnë ndotës toksikë. Nga djegja e mbetjeve të hedhura çlirohet tym dhe pluhur toksik, duke i ekspozuar kështu banorët vendas ndaj rreziqeve serioze për shëndetin. Ujrat e zeza që rrjedhin nga fusha e grumbullimit të mbetjeve, ndotin ujrat përreth.

<sup>26</sup> Raporti Teknik për Ballkanin nga PKBM, Rezultatet Analitike të PKBM të Kampioneve të marrë nga Pikat e Nxehta Industriale në Shqipëri, Nëntor 2000, Dokumenti Bazë

<i>Vendndodhja</i>	<i>Problemet Kyçe</i>
Uzina e Plehrave Azotike, Fier	Toka dhe ujrata e cekëta nëntokësore janë ndotur me nivele të larta arseniku. Ujrata nëntokësore ushqejnë lumin që furnizon pusët e ujit të pijshëm të zonës. Ujërat e ndotura e të patrajtuara shkarkohen në lumë.
Kombinati Metalurgjik, Elbasan	Mbetjet e hedhura që përmbajnë përqendrime të larta të metaleve të rënda, ndoshta po ndotin burimet e ujit të pijshëm aty afër. Uji teknologjik i uzinës, i patrajtuar derdhet në lumë/Shkumbin.
Uzina e Bakrit, Rubik	Rezervat e mbetjeve, të pasura në bakër, ndoshta po ndotin rezervat e furnizimit me ujë të pijshëm të zonës duke rrezikuar shëndetin e banorëve të saj.
Uzina e superfosfatit, Laç	Mendohet se nga grumbujt e mbetjeve rrjedh arsenik dhe bakër, të cilët përfundojnë në ujrata nëntokësore duke ndotur kështu burimet e ujit të pijshëm të zonës.

**Problemet** – Rreziqe serioze për mjedisin dhe shëndetin publik nga ndotja e tokës dhe ujit. Dëmtim i zonave përreth vendeve ku janë bërë këto ndërtime.

**Prirjet** – Tashmë janë identifikuar “pikat e nxehta” që përbëjnë prioritet. Janë ndërmarrë disa veprime që synojnë kompensimin e dëmeve që i janë bërë mjedisit. Punimet e mëtejshme të kufizuara nga mungesa e fondeve, mungesa e vendeve të përshtatshme për trajtimin dhe hedhjen e mbetjeve – pa kontroll të efikasitetit të industrisë dhe pa pasur mundësi më të mira për hedhjen e mbetjeve të rrezikshme, “pika të nxehta” të reja mund të krijohen në të ardhmen.

**Masat** – Të bëhet një studim i mëtejshëm për të siguruar fondet për projekte pastrimi dhe pastrimin e vendeve që konsiderohen “pika të nxehta”, monitorim afatgjatë, identifikim i vendeve të tjera që kanë nevojë për pastrim, planifikim i administrimit të mbetjeve.

## 2.4 Komponentët e mjedisit dhe ndikimet e presioneve që ushtrohen mbi ta

Veprimtaritë njerëzore e transformojnë mjedisin. Disa prej ndryshimeve janë të vogla dhe të parrezikshme, disa të tjera serioze. Disa do të ndjehen menjëherë, të tjera do të formohen gradualisht me kalimin e kohës. Disa veprojnë tek një komponent, të tjera tek disa të tjerë. Ky seksion synon të shpjegojë efektet kryesore që janë pasojë e veprimtarive të diskutuara më sipër.

Për thjeshtësi, komponentët e ndryshëm të mjedisit përshkruhen në mënyrë individuale në këtë seksion, por duhet të kihet parasysh që ata ndërveprojnë gjerësisht dhe në njëfarë mënyre janë të lidhur, madje shpesh të ndërvarur nga njëri-tjetri. Për shembull, çlirimi i grimcave dhe pluhurit në ajër do të ndikojë tek e fundit tek uji e madje edhe toka pasi këto materiale depozitohen në to, ose ndryshimet në cilësinë e ujit dhe tokës do të kenë efekte të drejtpërdrejta dhe nganjëherë dramatike mbi biodiversitetin.

### 2.4.1 Cilësia e ajrit dhe Ndryshimi i Klimës

Të gjitha veprimtaritë kanë pjesën e tyre të çlirimit të gazeve në atmosferë: makinat çlirojnë dioksid karboni dhe ndotës të tjerë, fabrikat çlirojnë një mori lëndësh ndotëse, ndërsa lopët që ripërtypin ushqimin çlirojnë metan. Ato ndikojnë në cilësinë e ajrit që ne thithim (ajrit të ambjentit) si edhe të shtresës së sipërme të atmosferës, ku mund të ndikohet në klimën globale, ose në shtresën e ozonit e cila na mbron nga disa prej efekteve më të dëmshme të rrezeve të diellit.

Veprimtaritë që shkaktojnë ndotjen më të madhe janë transporti, industria, sektori i energjisë (prodhimi dhe përpunimi i naftës dhe gazit e rafinimit si edhe prodhimi i energjisë termike) dhe zhvillimi urban. Çlirimet në atmosferë vijnë gjithashtu nga veprimtaritë bujqësore, hedhja e mbetjeve si dhe veprimtari të tjera njerëzore.

### Cilësia e ajrit të ambientit

Në Shqipëri kryhet një monitorim i kufizuar i cilësisë së ajrit. Sasia e informacionit të grumbulluar nuk është e mjaftueshme për të realizuar një program kompjuterik që do të ndihmonte në përcaktimin me hollësi të lidhjes shkak-pasojë ndërmjet shkarkimeve dhe cilësisë së ajrit. Megjithatë, ka të dhëna dhe njohuri empirike të mjaftueshme për të krijuar një tablo gjysëm-sasiore të gjendjes aktuale.

Shkarkimet nga automjetet dhe pluhuri që krijohet nga rrugët urbane të pashtuara dhe ndërtimet e ndryshme kontribuojnë shumë në ndotjen e ajrit me grimca të ngurta (pluhur), gjë që shkakton shumë probleme me frymëmarrjen, sidomos te moshat shumë të reja dhe të moshuarit. Ngrohja urbane me naftë apo linjit, por edhe ajo me dru ka mundësi të jetë një faktor tjetër kontribues. Industria gjithashtu kontribuon në shkallë të lartë në ndotjen lokale. Përqendrimet e lëndëve ndotëse janë më serioze në Tiranë dhe Elbasan, ku ndotësit kryesorë janë të niveleve dy deri në pesë herë më të mëdha se nivelet e lejuara.

**Tabela 2.3: Përqendrimet e pjesëzave ngurta të ambientit**

2004 µg/m <sup>3</sup>	Tirana					Durrësi	Elbasani			Fieri		Korça	Shkodra	Vlora	Standardi Shqiptar
SPM	280	233	151	965	219	209	244	468	201	227	117	137	229	157	140
PM <sub>10</sub>	126	108	67	432	99	95	112	157	88	105	46	56	103	69	60

Të dhëna të tjera epidemiologjike nga rrethinat e “pikave të nxehta”, të rezultuara nga matjet në tre vende, ku cilësia e ajrit është e dobët, tregojnë se nivelet e astmës, çrregullimeve të mushkërve dhe pleumonitë bronkiale, janë pesë deri në pesëdhjetë herë më të larta se sa mesatarja e tyre në nivel kombëtar.

### Ndryshimi i Klimës

Nivelet e çlirimit të gazeve të efektit serrë në Shqipëri janë rreth katër deri pesë herë më të ulëta sesa nivelet mesatare ndërkombëtare. Kjo ndodh sepse një përqindje shumë e lartë e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet, por edhe sepse konsumi i energjisë për frymë është i vogël dhe prodhimi i produkteve industriale ka rënë shumë.

Megjithatë, është shumë e rëndësishme të përmendet se çlirimi në atmosferë i CO<sub>2</sub> për njësi të PKB-së është gati 10 - 12 herë më i lartë se vlera mesatare në shumë vende europiane. Kjo vjen si pasojë e përdorimit të teknologjisë së vjetër industriale, me rendiment të ulët, por dhe për shkak se një pjesë e madhe e energjisë përdoret në sektorin e banesave dhe jo në industri, gjë që do të prodhonte vlerë më të lartë të PKB-së.

Shqipëria ka nivele shumë të ulëta prodhimi dhe përdorimi të substancave që ndikojnë në hollimin e shtresës së ozonit. Vendi vepron në përputhje me detyrimet e tij ndërkombëtare për sa i përket eliminimit të ngadalshëm të substancave që hollojnë shtresën e ozonit.

### Hapat në vijim: Administrimi i Cilësisë së Ajrit

Vitet e fundit janë miratuar ligje për mbrojtjen e mjedisit dhe të ajrit. Po ndërmerren hapa për të përmirësuar zbatimin e këtij kuadri ligjor dhe për të rritur cilësinë dhe frekuencën e monitorimit të cilësisë së ajrit. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin më në detaje, se në ç’skallë po përmbushen normat e çlirimit dhe standardet e cilësisë së mjedisit dhe në identifikimin e investimeve që nevojiten për të kapërcyer problemet.

Shkarkimet në ajër nga mjetet e transportit përbëjnë një çështje kombëtare kryesore. Shkarkimet për km të përshkuar janë të larta. Këto duhet të ulen nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse me

cilësi më të lartë, inspektime të përforcuara të automjeteve me qëllim që të veprohet duke iu përmbajtur standardeve të shkarkimeve, përmirësimeve në infrastrukturën urbane, duke përfshirë administrimin e trafikut dhe uljen e sasisë së pluhurit të gjeneruar. Përveç këtyre, duhet të merren masa për të ulur moshën dhe madhësinë e automjeteve aktuale. Duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për të kufizuar importin e mjeteve që ndotin rëndë ambjentin dhe për të nxitur përdorimin e mjeteve me nivel të ulët shkarkimi. Duhet të merren gjithashtu masa për përdorimin sa më pak të makinave private në qytete, përfshirë këtu edhe sigurimin e standardeve të larta të shërbimit të transportit publik.

Përmirësimi i nivelit aktual të shkarkimeve do të jetë i vështirë dhe i kushtueshëm jo vetëm për shkak të kostos së zëvendësimit të mjeteve të vjetra që nuk mund t'i plotësojnë standardet përkatëse, por edhe sepse niveli i përdorimit të mjeteve do të rritet gjatë viteve të ardhshme. Kjo e pengon fuqishëm, një planifikim të ndarë në faza për zbatimin e standardeve ligjore, në mënyrë që të jetë e përballeshme për popullatën.

Një argument i ngjashëm vlen për industrinë, ku pakësimi i shkarkimeve dhe teknologjitë e uljes së sasisë së pluhurit me qëllim që t'u përmbahen standardeve që kërkon ligji, mund të jenë shumë të kushtueshme.

#### **2.4.2 Uji**

Shqipëria është një vend i bekuar nga perëndia, pasi zotëron burime të bollshme uji. Por, nga ana tjetër, vërehet me shqetësim fakti që edhe pse sasi të e ujit janë të mjaftueshme për nevojat aktuale, cilësia e tyre, për shkak të ndotjes së tanishme dhe asaj historike/të trashëguar, shpesh është problem, sidomos në zonat e ulëta fushore ku jeton pjesa më e madhe e popullsisë dhe ku zhvillohen pjesa më e madhe e aktiviteteve industriale dhe bujqësore.

##### **Burimet**

Burimet e përgjithshme, të ripërtëritshme, të ujit në Shqipëri llogariten të jenë rreth 13 300 m<sup>3</sup> për njeri në vit. Këto burime përdoren për qëllime urbane, industriale dhe bujqësore si edhe për sigurimin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet. Ujrat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore janë të lidhur dhe varen nga njëri tjetri, por konsiderohen burime të ndara.

Ka gjashtë basene kryesore lumenjsh, që dalin nga kufinj të shteteve fqinje dhe përshkojnë Shqipërinë. Ato përfshijnë katër liqene kryesorë dhe tre rezervuarë të mëdhenj. Vëllimi i përgjithshëm i rrjedhjes në det është 39 220 milion m<sup>3</sup> në vit. Rrjedhjet, si reshjet e shiut nga të cilat varen, nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë gjatë gjithë vitit. Mesatarisht, nivelet në verë përbëjnë rreth 30% të niveleve vjetore. Ujrat sipërfaqësore shfrytëzohen kryesisht për tre qëllime: energji elektrike, bujqësi dhe furnizimin e Tiranës me ujë (51 milion m<sup>3</sup> në vit nga rezervuarët e ujit në malet në lindje të qytetit).

Shqipëria është e pasur edhe me ujra të nëndheshëm. Burimi i përtëritshëm llogaritet të jetë 1 250 milion m<sup>3</sup> në vit në shtatë formacione kryesore gjeologjike. Ka rreth 200 pika kryesore nxjerrjeje, kryesisht për qëllime urbane por edhe industriale. Përveç kësaj, një numër i paidentifikuar individësh e nxjerrin ujin nga puse të cekët, por në disa raste edhe të thellë, për përdorim familjar apo bujqësor. Dihet që në bregdet, për shkak të nevojave për ujë, po bëhet një mbishfrytëzim i rezervave ujore të ujit nëntokësor. Në zonat ku shkalla e shfrytëzimit të mundshëm është tejkaluar tashmë, uji i ëmbël po zëvendësohet me ujë deti që nuk pihet, si në zonën e cekët ashtu edhe në shtresat më të thella ujore me gurë gëlqerorë<sup>27</sup>. Me zhvillimin e turizmit rritet edhe

<sup>27</sup> Kumtesë – Disa konsiderata mbi lidhjen ujë i kripur deti-ujë i ëmbël në Zonat Bregdetare në Shqipëri, R. Eftimi, ITA Consult, Rr. Reshit Çollaku, pll.10/3/18, Tiranë, Shqipëri

kërkesa për ujë në zonat bregdetare. Prandaj, pavarësisht nga bollëku i burimeve ujore në përgjithësi, ekziston edhe një numër problemesh në rritje dhe që ka nevojë për zgjidhje.

### Cilësia e Ujit

Ndotja e ujrave sipërfaqësorë dhe atyre të nëndheshëm është pasojë e thujtë të gjitha veprimtarive aktuale urbane, industriale dhe bujqësore. Ndotja historike po kontribuon gjithashtu në cilësinë e ulët të shumë ujrave sipërfaqësore. Ujrat e mbetura urbane paraqesin probleme të veçanta si pasojë e grumbullimit jo të plotë dhe aspak efikas dhe mungesës së trajtimit të tyre<sup>28</sup>. Rrjetet ekzistuese nuk janë mirëmbajtur dhe as nuk janë zgjeruar për të përballuar urbanizimin e shpejtë që ka ndodhur këto dhjetë vitet e fundit, një pjesë e madhe e të cilit është i shpërndarë, duke e bërë kështu infrastrukturën të vështirë e të kushtueshme për ta siguruar.

Pjesa më e madhe e qyteteve, kombinojnë sistemet e kanalizimit të ujrave të zeza dhe mbledhjes së ujit të shirave të rrëmbyeshëm që shkarkohen direkt në ujin sipërfaqësor. Kanalet e ujërave të zeza shpesh janë më të vegjël se përmasat normale, dhe për pasojë janë çarë ose bllokuar, si pasojë edhe e mirëmbajtjes së dobët. Rrjedhjet nga këto kanale bartin rrezikun e ndotjes së rrjetit të ujit të pijshëm dhe ato gjithashtu ndotin tokën dhe ujrat nëntokësore të cekëta. Ndërmarrjet tregtare dhe industriale që prodhojnë lloje të tjera mbetjesh kimike dhe që mund të shkaktojnë forma serioze ndotjeje lidhen gjithashtu me këto sisteme.

Rrjedhja e largimi i ujit të ndotur nga aktivitetet si p.sh. pastrimi i automjeteve dhe servisi, mbetjet bujqësore ku hyjnë, si plehu i kafshëve, ashtu edhe pesticidet e ruajtura keq apo të braktisura dhe kimikate të tjera, ose nga hedhjet e pakontrolluara të mbetjeve i shtohen problemeve të sipërfaqes dhe atyre të nëndheshme. Hedhja e paligjshme e mbetjeve të gropave septike drejt e në përrenj, kanale apo toka të hapura dhe pa u trajtuar në mënyrë të përshtatshme e rëndon situatën.

Përcaktimi i gjendjes së krijuar të mjedisit ujqor është çështje komplekse dhe ndoshta këtu përfshihen edhe mijëra kimikate të ndryshme. Vlerësimi i efekteve të ndotjes është po aq kompleks për shkak të gamës së gjerë të kushteve ekologjike të lumenjve dhe liqeneve. Kushtet e përgjithshme të ujrave sipërfaqësore, mund të vlerësohen nga niveli i konduktivitetit (treguesi i kripëzimit), oksigjenimi (treguesi i ndotjes organike) dhe turbullira (tregues të trupave të ngurtë në pezulli nga erozioni dhe burime të tjera).

Kripëzimi është problem i lokalizuar, për shembull, lumi Ishëm nuk konsiderohet i përshtatshëm për t'u përdorur për vaditje për shkak të kripësisë së tij, dhe kripëzimi në disa nivele i shtresave ujëmbajtëse bregdetare po shtohet, në një kohë që uji i detit zë vendin e ujit të ëmbël të mbi-shfrytëzuar.

Nivelet ideale të përqendrimit të oksigjenit të tretur në ujë për shumë peshq janë ndërmjet 7 dhe 9 mg/l edhe pse 9-12 mg/l nevojitet për troftën e rritur ngjyrë kafe. Shumë pak peshq mund të mbijetojnë në përqendrime poshtë 3 mg/l të oksigjenit të tretur në ujë. Standardi prej 8 mg/l përfaqëson standardin mesatar që zbatohet në legjislacionin e Komunitetit Europian në sipërfaqet ujore me peshq të zonave të ulëta<sup>29</sup>. Momentalisht nivelet e regjistruara në disa lumenj të Shqipërisë janë poshtë këtyre niveleve. Këto përbëjnë vlerën mesatare dhe kushtet variojnë

---

<sup>28</sup> Faza e parë e impiantit të parë modern të trajtimit të ujërave të zeza në Shqipëri është kryer kohët e fundit në Kavajë. Po kryhen studime për projekte në pjesën më të madhe të qyteteve kryesore.

<sup>29</sup> Direktivë e Këshillit të Europës, më 18 Korrik 1978 mbi cilësinë e ujrave të ëmbël që kanë nevojë për mbrojtje apo përmirësim me qëllim që të mbështetet jeta e peshqve (78/659/EEC), (OJ L 222, 14.8.1978, p. 1) - Aneks I, Pika 2, vlera mesatare udhëzuese për ujrat ku rritet ciprinidi (lloj krapi).



përgjatë gjatësisë së lumit. Situata në drejtim të rrymës, në të gjitha zonat urbane është gjithmonë e më e keqe, pasi derdhja e ujrave të zeza ndikon në nivelin e oksigjenit.

Niveli i turbullirës së lumit është përgjithësisht i lartë. Edhe pse turbullimi krijohet vetvetiu ai shtohet në mënyrë artificiale nga ndotja në zonat urbane dhe erozioni i tokës. Nivelet më të larta janë regjistruar në lumenjtë: Erzen, Tiranë dhe Seman.

Nivele të larta të substancave ushqyese në ujë, sidomos azot dhe fosfor nga ujrata e zeza ose mbetjet bujqësore, mund të bëhen shkas për rritje të shpejtë të bimëve, algave dhe bakterieve. Ky eutrofikim sjell shterimin e oksigjenit në ujë dhe çlirim të toksinave. Lagunat e bregut dhe pellgje të tjerë të cekët me ujë të ndenjtur përbëjnë rrezik të veçantë sidomos në verë.

Përzierjet toksike organike dhe metalet që nxirren nga gjurmimi dhe aktiviteti industrial paraqesin probleme të tjera. Lumenjtë e Shkumbinit dhe Fanit janë prekur shumë në mënyrë të veçantë nga përqendrimet e metaleve të rënda. Lumenjtë Gjanica dhe Seman ndoten në masë nga mbetjet ujore që formohen nga nxjerrja dhe përpunimi i naftës dhe përmbajnë përqendrime fenoli që i tejkalon standardet e Komunitetit Europian. Në rajonin e Ballshit, kanalet e ujitjes dhe kullimit kanë përmbajtje tolueni dhe benzine disa herë më të lartë se këto standarde.

Aktualisht, cilësia e burimeve të ujrave nëntokësore të shfrytëzuar është e mirë, por nga rezultatet e monitorimit të fundit, dalin disa tregues të prishjes së cilësisë së tij. Kthimi në gjendje të pastër është tepër i kushtueshëm dhe i ngadaltë. Duke pasur parasysh se furnizimi ynë me ujë të pijshëm varet kryesisht nga këto burime, është e domosdoshme të shmangët ndotja e mëtejshme, sidomos në ato basene ku rreziqet janë të larta, si p.sh. në rrethinat e Tiranës.

### **Kushtet e ujit të pijshëm**

Furnizimi me ujë në disa zona urbane kryhet me ndërprerje për shkak të gjendjes së keqe të infrastrukturës. Edhe pse aktualisht nuk janë mbledhur të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e ujit të pijshëm në të gjitha vendet, të dhënat e disponueshme për momentin tregojnë se ka probleme serioze me cilësinë e ujit të pijshëm. Në shumë raste, ujit të pijshëm i mungon trajtimi dhe dezinfektimi i duhur. Mirëmbajtja e sistemeve të shpërndarjes në dekadën e fundit ka qenë e pamjaftueshme, duke sjellë humbje të tepërta të ujit, sëmundje që transmetohen nga uji dhe heraherës edhe raste epidemie.<sup>30</sup> Niveli i ndotjes bakteriale është i lartë dhe niveli i klorit të mbetur shumë i ulët.

### **Cilësia e ujërave për t'u larë/notuar**

Ujrat që përdoren për t'u larë në qendrat kryesore, kontrollohet rregullisht për ngarkesën bakteriale. Shumica e rezultateve janë brenda kufijve maksimalë, që konsiderohen të domosdoshme në Direktivën mbi Ujin për të Notuar nga Komuniteti Europian<sup>31</sup>, por shumica e tyre nuk i plotëson standardet më të rrepta.

Nëse do të zhvillohet një industri e turizmit bregdetar për të tërhequr turistë të huaj, do të ishte e rëndësishme t'i jepej zgjidhje këtij problemi.

<sup>30</sup> Banka Botërore, 3<sup>rd</sup> Shkurt 2003, [www.worldbank.org.al](http://www.worldbank.org.al)

<sup>31</sup> Direktiva e Këshillit me datë 8 Dhjetor 1975 në lidhje me cilësinë e ujit për të notuar (76/160/KEE) OJ L 31, 5.2.1976, p. 1)

### **Hapat në vijim: Administrimi i burimeve, kontrolli dhe pakësimi i ndotjes së ujit**

Legjislacioni për mbrojtjen e cilësisë dhe burimeve të ujit është miratuar; janë krijuar strukturat për administrimin e tij, duke përfshirë në këtë kontekst Këshillin Kombëtar të Ujit dhe Sekretariatit Teknik të tij. Janë krijuar njësi të vogla administrimi për secilën nga gjashtë zonat kryesore të baseneve të lumenjve. Por ende nuk është arritur përmirësimi i cilësisë dhe mbrojtja efikas e tij. Janë miratuar strategjitë për sektorin e furnizimit me ujë dhe sektorin e higjienës publike për zonat urbane dhe rurale<sup>32</sup>.

Janë bërë disa investime, por duhet bërë edhe më shumë, me qëllim që jo vetëm të ndalohej rënia e cilësisë së ujit sipërfaqësor por përkundrazi, të përmirësohet ajo.

Nevojat mund të ndahen në pesë grupe kryesore:

- Legjislacioni ekzistues ka nevojë për përmirësim dhe zgjerim me qëllim që të shërbejë si bazë për administrimin dhe veprimet mbrojtëse;
- Strukturat institucionale për këtë administrim dhe mbrojtje duhet të përforcohen në mënyrë që të zbatohet si duhet legjislacioni;
- Planet e administrimit të zonave ujë-mbledhëse, që merren me të gjitha aspektet e përdorimit të ujit, janë një instrument i domosdoshëm në procesin e administrimit dhe në përcaktimin e mënyrës më të mirë për zbatimin e detyrimeve ligjore;
- Duhet të përgatiten studimet e fizibilitetit në mënyrë që të zbatohen skemat prioritare të përmirësimit;
- Nevojiten sasi të konsiderueshme fondesh për t'i vënë në praktikë këto kërkesa.

Përveç nevojës për planifikim e veprime strategjike afatgjata, duhet të zgjidhen edhe problemet e veçanta të efekteve të pikave të nxehta.

### **2.4.3 Tokat**

Gjendja e tokave është e rëndësishme për bujqësinë, pylltarinë dhe biodiversitetin. Nga ana e tyre këta janë të rëndësishme për ekonominë, shëndetin publik dhe turizmin. Dy janë problemet kryesore dhe më shqetësuese: Erozioni dhe prishja e cilësisë së tokës.

#### **Erozioni**

Erozioni është procesi natyror i veprimit të ujit dhe erës mbi tokën. Megjithatë, shkalla e erozionit mund të rritet shumë nga aktivitetet e papërshtatshme të njerëzve. Nivelet e larta të erozionit paraqesin një sërë problemesh dhe të gjitha janë të pranishme sot në Shqipëri, përkatësisht:

- *Prishja e cilësisë e tokës dhe humbja e pjellorisë;*
- *Është shtuar rreziku i rrëshqitjeve të tokës dhe humbjes së saj;*
- *Depozitimi i sedimentit në lumenj, që ndryshon rrjedhën dhe ekologjinë e tyre natyrore;*
- *Grumbullimi i trupave të ngurtë prapa digave, duke ulur sasinë e ujit në liqene dhe rrjedhimisht kapacitetin prodhues të impjanteve të prodhimit të energjisë elektrike ose vëllimin e ujit në dispozicion të furnizimit të përgjithshëm me ujë të pijshëm apo për vaditje;*
- *Transportimi nga uji i sedimenteve në zonat bregdetare, duke ndikuar tek ligatinat, jetën nën-ujore bregdetare dhe gjendjen e plazheve.*

<sup>32</sup> Ministria e Rregullimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Shtator 2003

Shpyllëzimi, kthimi i sipërfaqeve kodrinore në toka të punueshme, mbikullotja, zhdukja e sipërfaqeve me dru frutorë dhe ndërtime, sidomos i rrugëve, të gjitha këto zvogëlojnë sipërfaqet me bimësi dhe si pasojë rrisin erozionin.

Humbja e tokës në një vit varion nga një minimum 20 ton/hektarë në zonat malore me *borë* në periudhën e dimrit, në një maksimum prej 40 ton/hektarë në zonat më të ulëta e me shira në dimër. Humbjet llogariten të jenë 1.2 deri 2.3 herë më të larta në zonat pa bimësi në krahasim me zonat nën kulturë.

Pjesa më e madhe e sedimentit të gërryer përfundon në lumenj. Funkcionet natyrore të zonave që përmythen, në shpërndarjen e këtij sedimenti kanë ndryshuar, pasi lumenjve u është hapur shtrati për mbrojtje ndaj përmytjeve dhe për qëllime bonifikimi të tokës dhe shumica e sedimentit tani transportohet në det, gjë që rrit nivelin e turbullirës dhe dëmton faunën dhe florën e vlefshme.

Praktika e nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i lumenjëve kontribuon gjithashtu në shtimin e problemeve të erozionit, duke ndryshuar karakteristikat e kanaleve të lumit dhe ngarkesën e sedimenteve.

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme, është llogaritur që afërsisht 16 milion ton materiale të ngurta ose 4 m<sup>3</sup>/person/vit, derdhet në det. Këto të dhëna tregojnë, edhe një herë për një nivel të lartë të lëndës organike në sedimentet, dëshmi e faktit që pjesa më e madhe materialit organik është *shtresa e punueshme*, aq e domosdoshme për bujqësinë.

### **Cilësia e tokës**

Në terma të përgjithshme, tokat bujqësore duket se janë në gjendje të pranueshme. Megjithatë, ka zona që u janë nënshtruar ndotjes ekstreme si pasojë e aktiviteteve industriale, me pasojë për shëndetin, ku substancat ndotëse arrijnë të futen në zinxhirin e ushqimit. Kështu ndodh përreth Elbasanit, Shkodrës apo pikave të nxehta, për shembull në zonën e prodhimit të naftës. Rrezik paraqet gjithashtu, edhe hedhja e pakontrolluar e mbetjeve në fshat, të cilat më së shumti shërbejnë si ushqim për bagëtinë ose ndosin tokën.

#### **Hapat në vijim: administrimi i tokës**

Kontrulli i erozionit është kërkesa kryesore, e shoqëruar nga praktikatat e administrimit të baseneve të lumenjëve, të cilat ulin efektet negative të transportimit dhe depozitimit të sedimenteve.

Masat që kërkohet të merren për të përmbushur këto kërkesa përfshijnë:

- Ndryshimin e legjislacionit dhe forcimin e institucioneve për të mundësuar zbatimin e ligjit;
- Aktivitetet alternative apo mundësitë për të zëvendësuar shkakun kryesor të erozionit, që është shpyllëzimi nga ndjekja e praktikave të papërshtatshme apo të paligjshme pyjore, sidomos përdorimi i druve si lëndë djegëse;
- Masat për administrimin e rrjedhave të lumenjëve, për të shmangur efektet negative të sedimentimeve nga erozioni i tokave malore (që do të vazhdojë edhe me praktika më të mira administrimi);
- Zbatimi i standardeve të përcaktuara drejtë dhe praktikave vepruese, ku veprime të ndryshme mund të shkaktojnë erozion ose prishje të cilësisë së tokës, si p.sh. ndërtime rrugësh apo depozitim i mbetjeve;
- Shërbimet këshillimore bujqësore, përfshirë sigurimin e informacionit mbi praktikatat e përshtatshme të plugimit të tokës;
- Investime të domosdoshme, për shembull, në mbjellje mbrojtëse apo përforcimin e brigjeve të lumit.

#### **2.4.4 Mbetjet**

Problemet e gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit të tyre janë të shumta dhe të larmishme. Sasi të mëdha të mbetjeve të gjeneruara (nga pesha) priren të jenë substanca inerte, sidomos mbetje nga ndërtime, por rreziqet më të mëdha lidhen me sasi më të vogla të mbetjeve të

rezikshme (kryesisht industriale). Për mbetjet e qytetit (të familjeve apo bizneseve) kërkohet një organizim në shkallë të gjerë e i kushtueshëm për grumbullimin, transportimin dhe asgjësimin e tyre. Për kategori të veçanta, si p.sh. mbetjet klinike, vlejné disa kushte të veçanta.

Ky sektor paraqet disa prej sfidave më të rëndësishme me të cilat duhet të përballet Shqipëria. Raporti më i fundit i Gjendjes së Mjedisit përmbledh çështjet e mëposhtme:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe aspak efikase;
- Nuk mund të merren vendime të sakta për alternativat e grumbullimit dhe hedhjes, në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Nuk ka traditë në drejtim të hedhjes, grumbullimit dhe trajtimit të përshtatshëm të mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;
- Mungon ndërgjegjësimi i publikut për dëmin e shkaktuar nga keqadministrimi i mbetjeve.

### Mbetjet e Urbane

Ekziston shumë pak informacion për sa i përket sasive apo përbërjes së mbetjeve që prodhohen në zonat urbane. Informacioni ekzistues (për Tiranën, Durrësin, Fierin dhe Shkodrën) tregon se Shqipëria prodhon rreth gjysmën e vëllimit mesatar për frymë në krahasim me vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe se këto mbetje përmbajnë një përqindje më të lartë të lëndës organike, krahasuar me vendet anëtare të kësaj organizate. Sasi të konsiderueshme të mbetjeve klinike përfshihen në mbetjet urbane, në vende ku ka spitale dhe klinika, edhe pse një pjesë e mbetjeve klinike të Tiranës digjet në vende të veçanta/posaçme. Me zhvillimin e ekonomisë, ky vëllim do të shtohet.



Përgjegjësia për grumbullimin e mbetjeve urbane i takon autoriteteve vendore. Janë lidhur kontrata sipas të cilave grumbullimi i mbetjeve duhet të merret përsipër nga firmat private.

Shpesh nuk ka kazanë të mjaftueshëm mbetjesh, dhe ato që janë, shpesh janë në gjendje shumë të keqe. Shpeshtësia e heqjes së mbetjeve dhe rrjedhimisht koha e qëndrimit është shumë e ndryshueshme.

Problemet e ndeshura në organizimin aktual të heqjes së mbetjeve janë:

- *Automjetet e grumbullimit janë të një standardi shumë të ulët;*
- *Kazanët e grumbullimit të mbetjeve janë në gjendje të keqe;*
- *Heqja jo e shpeshtë e mbetjeve çon në tejmbushje, madje edhe derdhje të kazanëve;*
- *Mbetjet në rrugë shkaktojnë erë të rëndë dhe bezdi.*

Në komunat e vogla nuk ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbetjeve dhe individët janë vetë përgjegjës për heqjen dhe eliminimin e mbetjeve të tyre.

Kjo shpesh çon në hedhjen e mbetjeve kuturu në anë të rrugës apo në djegien e tyre në natyrë.



Mbetjet urbane hidhen kryesisht në vende të caktuara për këtë qëllim, por sasi të konsiderueshme hidhen edhe në vende të paautorizuara, buzë vendbanimesh dhe përgjatë rrugëve.

Në shumicën e rasteve, vendet e caktuara nuk janë projektuar për këtë qëllim apo nuk administrohen mirë. Janë krijuar pa infrastrukturën e nevojshme apo masat teknike për grumbullimin e tyre dhe çlirojnë gaze të prodhuar prej djegies së mbetjeve të groposura dhe lëng që depozitohet në fund të gropave. Shumë prej këtyre vendeve të grumbullimit nuk janë të sigurtë dhe nuk janë mjetet e mjaftueshme për administrimin e tyre të qëndrueshëm, të tilla si zyrë në vendndodhje, pajisje për stafin, peshore, lavazh apo ndriçim. Si pasojë, hyrja në to dhe hedhja e paautorizuar është gjë e zakonshme, ashtu sikurse janë edhe zjarret. Inspektimi i mbetjeve hyrëse nuk praktikohet. Nuk mbahet procerverbal për depozitimet e bëra.

Investimet në këtë sektor, deri tani ka qenë shumë të kufizuara. Megjithatë, po merren masa për modernizimin e një prej vendeve kryesore të grumbullimit të mbetjeve, atij të Sharrës, që i shërben qytetit të Tiranës<sup>33</sup>.

Hedhja e paautorizuar zakonisht bëhet në tokë dhe në kanalet e ujrërave, sidomos buzë vendbanimeve të vogla. Materialet shpesh i merr uji apo era dhe i shpërndan në mjedis, duke ndotur tokën dhe rrjedhën e ujit ku bien.

Nuk ka impjante të licensuara për djegien e mbetjeve në mënyrë që të eliminohen mbetjet urbane. Megjithatë, zakonisht mbetjet e shtëpisë apo mbetje të tjera digjen në natyrë, duke çliruar gaze toksikë. Disa mbetje, përfshirë gomat e përdorura dhe mbetjet drusore digjen në furra gëlqereje, duke çliruar dioksinë dhe substanca të tjera ndotëse.

Nuk bëhet asnjë ndarje formale e mbetjeve nga ana e familjeve apo njësive tregtare para mbledhjes së tyre. Megjithatë, në qytetet më të mëdha bëhet një ndarje dhe mbledhje jo zyrtare e materialeve për riciklim. Kjo bëhet kryesisht nga grupe që rrëmojnë në mbetje në rrugë në kërkim të kanaçeve

<sup>33</sup> Strategjia Lokale për një Mjedis të Shëndetshëm në Qytetin e Tiranës 2005 – 2008, Bashkia e Tiranës, Qendra EDEN

prej alumini që pastaj shiten për riciklim. Riciklime të tjera jo zyrtare ndodhin në vendet e hedhjes së mbetjeve ku grupe të paautorizuar njerëzish rrëmojnë në kërkim të mbetjeve metalike, plastike, prej letre ose prej druri.

Afërsisht i njëjti vëllim i mbetjeve nga ndërtimet krijohet si mbetje urbane. Shumë prej tyre janë inerte, por përmbajnë gjithashtu metale, asbest, bojra dhe/ose sasi të vogla materialesh të tjera jo inerte. Vëllimi do të rritet me rritjen e industrisë së ndërtimit. Një pjesë e madhe e tyre hidhet në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane. Ato përfaqësojnë gjysmën e sasisë që hidhet në Sharrë. Megjithatë, në shumë zona, mbetjet e ndërtimit hidhen në vende të paautorizuara.

### **Mbetjet industriale**

Grumbullimi dhe heqja e mbetjeve industriale është përgjegjësi e prodhuesit. Nuk ekziston ndonjë informacion mbi sasinë apo llojet e mbetjeve industriale. Nuk ka informacion të saktë se ku përfundojnë ato, edhe pse dihet se shumë prej tyre hidhen në vendet e mbetjeve të caktuara nga bashkia, disa prej tyre mbahen në vendin e prodhimit, por të tjera hidhen edhe në vende të paautorizuara.

Duke bërë një krahasim me vendet e tjera dhe duke supozuar se prodhimi i mbetjeve është në përpjestim me PKB-në, niveli i prodhimit të mbetjeve industriale në Shqipëri llogaritet të jetë diku te 170 000 ton në vit, nga të cilat një pjesë do klasifikohet si e rrezikshme.

### **Mbetjet e rrezikshme**

Kohët e fundit është propozuar legjislacioni përkatës për zgjidhjen e problemit të administrimit të mbetjeve të rrezikshme në Shqipëri. Megjithatë, tani për tani nuk ka të dhëna të besueshme lidhur me nivelin e mbetjeve të rrezikshme që prodhohen në të vërtetë.

Studimet e bëra kohët e fundit në lidhje me përgatitjet për ndërtimin e një vendi të projektuar sipas standardeve, për grumbullimin dhe groposjen e mbetjeve të rrezikshme tregojnë se rreth 3 - 4% e mbetjeve industriale është e rrezikshme (duke përjashtuar mbetjet klinike dhe elementët e rrezikshëm të mbetjeve shtëpiake), një nivel ky i krahasueshëm me atë të vendeve të tjera mesdhetare.

Një çështje kritike, që ngrihet në këtë kontekst, është mënyra e zgjidhjes së problemit të mbetjeve të trashëguara nga e kaluara, përfshirë hedhjen e pakontrolluar të mbetjeve të rrezikshme, ndotjen e pikave të nxehta dhe mbajtjen në magazina të kimikateve të papërdorur, të vjetruar apo ndaluar.

### **“Varrezat” e Automjeteve**

“Varrezat” e automjeteve përbëjnë një tjetër çështje me rëndësi për t’u shqyrtuar. Ato përmbajnë sasi të konsiderueshme substancash me shkallë të lartë ndotjeje përfshirë naftën, vajrat, tretës dhe produkte të tjera petrokimike. Edhe pse në të gjithë Shqipërinë ka qendra dhe reparte për çmonitimin e automjeteve të tilla, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të pajisura me masat e mjaftueshme për parandalimin e ndotjes ose praktika të sigurtat pune.



**Hapat në vijim: Administrimi i mbetjeve**

Është miratuar legjislacioni për zgjidhjen e shumë problemeve të sektorit të mbetjeve. Aktualisht është në studim e sipër një sistem licensues për grumbullimin, ruajtjen dhe rikuperimin e mbetjeve për rishkrirje nga operatorë privatë dhe janë identifikuar tetë vende për ripërpunimin e automjeteve. Në Tiranë, Strategjia Lokale për një Mjedis të Shëndetshëm përqendrohet në mbetjet urbane si një prej pesë prioriteteve të saj dhe kohët e fundit janë miratuar kredi për të mbështetur objektivat e administrimit në këtë sektor.

Gjithashtu janë ndërmarrë studime të fizibilitetit për:

- Eliminimin e pikave të nxehta;
- Përgatitjen për vendin e grumbullimit e groposjes së mbetjeve të rrezikshme;
- Vendet e caktuara nga bashkia për hedhjen a groposjen e mbetjeve lokale dhe rajonale.

Megjithatë, progresi ka qenë i ngadaltë: nuk ka ende pika për grumbullimin e mbetjeve të projektuara në vend, edhe pse grupi i parë i studimeve të fizibilitetit u përfundua në 1997.

Përprojekjet e bëra në këtë sektor kanë qenë të pamjaftueshme dhe të pakoordinuara. Ndjehet një nevojë urgjente për hartim të planeve në rang kombëtar dhe lokal për administrimin e mbetjeve në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, që përfshijnë:

- Një kuadër kombëtar për zhvillimin e planeve lokale dhe rajonale në të cilin përcaktohen parimet, trajtohen çështje të rëndësishme kombëtare si p.sh. administrimi i mbetjeve të rrezikshme dhe atyre klinike, veprime të specializuara për rikuperimin dhe riciklimin (si p.sh. goma apo produkte plastike); dhe
- Planet lokale për administrimin e mbetjeve që kanë si fokus grumbullimin dhe hedhjen e mbetjeve urbane, përfshirë edhe ndarjen e mbetjeve dhe masat e marra për riciklim. Këto plane shpesh do të kërkojnë të koordinohen ndërmjet dy apo më shumë autoriteteve vendore.

Planet duhet të përfshijnë:

- Procedura të përshtatshme dhe efikase për grumbullimin dhe transportimin e tyre;
- Një inventar të vendeve ekzistuese për hedhjen e mbetjeve, për gjendjen e tyre dhe planet për përmirësime;
- Standarde të përballueshme për ndërtimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve që minimizojnë ndotjen;
- Mekanizma për rritjen e të ardhurave nga mbledhja e mbetjeve; dhe
- Hapa për ndërgjegjësimin e publikut mbi dëmet e shkaktuara nga hedhja pa kriter e mbetjeve.

**2.4.5 Zhurmat**

Zhurmat janë një problem i zakonshëm urban. Burimet e tyre kryesore janë transporti, ndërtimet, industria dhe disa aktivitete tregtare si lokalet dhe klubet. Deri tani, nuk është nxjerrë ndonjë standard për nivelet e lejuara të zhurmës nga ndonjë burim dhe nuk ekzistojnë standarde për nivelin e zhurmës në zonat e banimit. Faktikisht nuk ka kufizime zyrtare.

Zhurma nga trafiku është shtuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Edhe në zonat e banimit ku kalon autostrada, nuk janë përdorur masa të tilla si monitorë akustikë ose shtrim të rrugëve me shtresë të posaçme për të ulur zhurmën shqetësuese.

Niveli i zhurmës i shkaktuar nga aktivitete industriale nuk matet apo kontrollohet direkt.

#### Administrimi i zhurmave

Kjo çështje duhet zgjidhur në tërësinë e saj. Hapi i parë duhet të jetë propozimi për legjislacionin kontrollues të zhurmave që vjen nga burime të veçanta, si dhe për të vendosur standarde në lidhje me nivelet e pranueshme të zhurmave në mjedis. Kur të jetë gati legjislacioni do të nevojiten sistemet e zbatimit të kontrollit mbi zhurmën e makinerive, automjeteve dhe burimeve të tjera kryesore të zhurmës. Duhet të forcohet sidomos kontrolli i nivelit të zhurmës së automjetit si pjesë e skemës së kontrollit teknik të tyre, me anë të të cilit përcaktohet nëse automjeti është në gjendje pune apo jo. Përveç pakësimit të zhurmës nga burime të veçanta, duhet të merren masa për uljen e shkallës së zhurmës që mbetet nëpërmjet, për shembull, veçorive të përshtatshme të projektimit të rrugëve ose kufizimeve në përdorimin dhe/ose shfrytëzimin e tyre.

#### 2.4.6 Biodiversiteti dhe Peizazhi

Nëqoftëse i referohemi përmasave të saj, Shqipëria ka një mjedis natyror të larmishëm. Përzierja e ekosistemeve dhe habitateve përfshin ato detare, bregdetare, ligatinat, deltat e lumenjve, dunat e rërës, liqenet, lumenjtë, shkurret mesdhetare, pyjet gjethegjërë, halorë dhe të përzier, kullotat alpine dhe nën-alpine, livadhet dhe zonat e larta malore. Secili ofron larmi të pasur specimesh në bimë dhe kafshë. Sistemi i lagunave bregdetare përbën një prej komplekseve më të rëndësishme të ligatinave në rajonin e Mesdheut.

Shumëllojshmëria është pasqyrim i gamës së gjerë të peizazheve që nga malet e larta tek fushat bregdetare, përmes të të cilave masat ajrore kontinentale ndeshen me ndikimet mesdhetare dhe formohet një klimë e ndryshueshme, por përgjithësisht kontinentale.

#### Biodiversiteti

Edhe pse informacioni i hollësishëm mbi speciet është i kufizuar, mendohet se në Shqipëri gjendet rreth një e treta e të gjitha specieve të florës europiane dhe një llojshmëri po aq mbresëlënëse e faunës. Numri i madh i specieve që gjenden vetëm në Shqipëri dhe ato tipike në rajone të caktuara të përbashkëta me shtetet fqinje të Ballkanit dhe me Greqinë, bashkë me praninë e specieve detare karakteristike për Adriatikun theksojnë rëndësinë rajonale dhe globale të Shqipërisë për mbrojtjen e biodiversitetit.

Kjo shumëllojshmëri ka vuajtur nga një sërë presionesh njerëzore dhe kjo vazhdon. Edhe pse praktikat bujqësore ka mundësi të jenë më pak dëmtouese tani në raport me të kaluarën, modelet e tanishme të zhvillimit ekonomik dhe fizik përbëjnë një kërcënim madhor në shumë zona. Problemet thelbësore janë praktikat e papërshtatshme të ndjekura në zonat malore, sidomos shpyllëzimi, dhe ndërtime në bregdet, veçanërisht ato që kanë lidhje me turizmin.



Presione të tjera përfshijnë ndërtime të pakontrolluara në breg të liqeneve, ndotjen dhe eutrofikimin që vjen nga ujërat e zeza të patrajtuara dhe nga mbetje të produkteve bujqësore të hedhura, rrëshqitje dhe gërryerje të tokës, mbetje nga impiantet e rritjes së peshkut, praktikat e paqëndrueshme të peshkimit dhe gjuetisë, dhe ndryshime në hidrologjinë e lagunave. Një numër deltat bregdetare kanë pësuar gjithashtu erozion serioz për shkak të ndryshimeve në prurjet e sedimenteve si pasojë e aktiviteteve të ndryshme, legale e jo legale, në pjesët e sipërme të rrjedhave të tyre. (p.sh. digat e hidrocentraleve dhe modifikimet e kanaleve).

Të kërcënuar janë edhe habitatet detare gjithashtu. Shtrirja e saktë e livadheve bimore nënujore në afërsi të bregut të detit në Shqipëri nuk njihet, por mendohet të kenë ndodhur zhdukje lokale.

Zhdukje të tjera janë regjistruar dhe një numër në rritje i specieve konsiderohet në rrezik. Numri i zogjve shtegëtarë po pakësohet, sikurse po ndodh edhe me numrin e specieve që dimërojnë, sidomos në habitatet e lagunave.



Një prej arsyeve për pakësimin e larmisë e specieve është shkalla e shtrirjes së “sporteve” të paligjshme *gjetisë dhe peshkimit*, që prej rënies së kontrolleve të efektshme pas vitit 1990.

<p>Pyjet kanë qenë prë e spastrimit dhe dëmtimit masiv si pasojë e prerjeve si të ligjshme ashtu edhe të paligjshme të druve. Që prej viteve 1950, sipërfaqja pyjore është zvogëluar nga 45% në 36% (UNECE, 2002<sup>34</sup>). Lartësia mesatare e kurorës ka rënë me 50%. Pyjet me pisha, plepa, bli, lisa, mështekën dhe ah rrezikohen në rang kombëtar. Prerjet e pastuduara dhe praktikatat e kultivimit në zonat malore kanë shkatuar erozion të rëndë të tokës.</p>	
	<p>Habitatet bregdetare, përfshirë ligatinat, lagunat, dunat e rërës dhe pyjet kërcënohen në mënyrë të veçantë për shkak të përqendrimin të lartë të aktivitetit njerëzor në këto zona. Vlerësimet mbi humbjen e ligatinave bregdetare janë përafërsisht rreth 60,000 hektarë.</p>

Burimet gjenetike të Shqipërisë janë të kërcënuara nga rënia e interesit për racat dhe speciet vendase të kafshëve dhe bimëve në sektorin bujqësor. Kjo po çon në ulje të llojshmërisë së specieve dhe pakësim të vendeve piktoreske në zonat rurale. pjesërisht si pasojë e pakësimit të racave vendase dhe përhapjes së pakontrolluar të specieve të kultivuara. Llogaritjet e erozionit gjenetik për periudhën 1943-1993 janë rreth 50-70% për disa prodhime bujqësore. Megjithatë, projektet mbështetëse për mbrojtjen e buallicave dhe disa varieteteve të drithit, janë hartuar dhe zbatuar nga Ministria e Bujqësisë.

#### **2.4.7 Zonat e mbrojtura dhe peizazhi**

Shumë zona me vlera të mëdha natyrore dhe piktoreske kanë mbijetuar, pavarësisht nga presionet që janë ushtruar mbi to. Këto zona kanë nevojë të mbrohen, me qëllim që të ruhet diversiteti biologjik i mbijetuar dhe bukuria natyrore e peizazheve për brezat që do të vijnë.

Një hap i rëndësishëm është marrë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të mjedisit, duke i dhënë rreth 6% të territorit të vendit statusin e zonës së mbrojtur nga shteti në 58 zona. Megjithatë, ky rrjet kombëtar ndoshta është shumë i vogël për të ndikuar në mënyrë të efektshme në periudha afatgjata në ruajtjen e biodiversitetit. Për të bërë një krahasim, është e rëndësishme të thuhet se ekspertët dyshojnë që 18% e sipërfaqes së tokës së KE-së, aktualisht e përcaktuar në bazë të rrjetit Natura 2000, do të jetë e mjaftueshme për këtë qëllim.

Shpërndarja e zonave të mbrojtura favorizon dukshëm habitatet pyjore dhe nuk pëqas sa duhet habitatet bregdetare dhe ato afër bregdetit. Ekuilibri do të lëvizë, por nuk do të kthehet në gjendjen e mëparshme, nëse dy zona detare të propozuara për mbrojtje janë miratuar si pjesë e rregullores së propozuar për peshkimin. Zona të rëndësishme si p.sh. Liqeni i Prespës kanë qënë objekt pune i një sërë studimesh, por nuk është miratuar asnjë plan zyrtar për mbrojtjen e tij.

<sup>34</sup> UNECE (2002) Rishikim mbi ecurinë e mjedisit në Shqipëri për sesionin e 8-të të Komisionit për Politikën Mjedisore, Nëntor 2002. <http://www.unece.org/env/epr/studies/albania/>

Agjencitë ekzistuese nuk kanë buxhet për përgatitjen e planeve apo për zbatimin e kërkesave të tyre dhe i varin shpresat tek përkrahja e donatorëve.

Deri tani është arritur pak progres në zbatimin e rekomandimeve të bëra në Plan Veprimin dhe Strategjinë e Biodiversitetit 1999, përgatitur në përgjigje të angazhimeve të Shqipërisë në përputhje me Konventën për Diversitetin Biologjik. Arsyet kryesore për këtë janë mungesa e fondeve dhe strukturave të përshtatshme të planifikimit dhe administrimit.

Efekti i zhvillimit mbi vendet dhe objektet e trashëgimisë kulturore, zakonisht përfshihet në kriteret e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Në Shqipëri, Monumentet e Kulturës mbrohen në bazë të **Ligjit Nr.9048, 07.04 2003**. Megjithatë, ky ligj ka mangësi. Shkaqet për dëmtimin mjedisor janë të ndryshme.

- Ndërtimet e reja të pakontrolluara kanë shfrytëzuar mangësitë e nenit 28; pika 3 dhe standardet e ndërtimit nuk janë respektuar. Në përgjithësi distanca e zonës “bufrike” është injoruar dhe ndërtimi minon kështu, integritetin e monumentit. Shembull i tillë janë disa objekte në qytetin e Durrësit, dhe pikërisht në zonën e mbrojtur të kalasë antike dhe portit të vjetër të qytetit. Aplikimi i gjobave për shkelje të ligjit ka qenë minimal.
- Marrja e zhavorrit nga shtretërit e lumenjëve mund të shkaktojë dëmtime dhe përmytje të monumenteve. Kështu, marrja e zhavorrit nga shtrati i Bunës, ka shkakuar përmytjen dhe dëmtimin e Kishës së Shirgjit e cila ka qenë ndërtuar në shekullin e XIII në Shkodër. Përmytjet e shkaktuara nga Drini (për shkak të shkarkimeve ujore të kaskadës së tij, në skemën e hidrocentraleve të ndërtuar mbi të), ka dëmtuar rëndë si Mozaikun e Shkodrës, i cili ndodhet në breg të Drinit, poshtë Kalasë së Rozafës ashtu edhe Xhaminë e Plumbit gjithashtu në qytetin e Shkodrës.
- Shpyllëzimi, erozioni i forte dhe rrëshqitjet e dheut, po rrezikojnë seriozisht Kalanë e shekullit të XV dhe Kishën e shekullit të XII në Kepin e Rodonit.
- Shiu acid, i shkaktuar nga avujt ndotës të uzinës së Rubikut, është duke dëmtuar një Afresk të shekullit të XIII në Kishën e Shën Mërisë në këtë qytet. Ajri i ndotur nga fabrikat, po gërryen përditë relievet prej guri në kishën e Shën Mërisë në Elbasan si dhe Ikonat e Onufrit që ndodhen në Kishën e Shën Nikollit, e ndërtuar në shekullin e XVI.



### Hapat në vijim: biodiversiteti dhe peizazhi - mbrojtja dhe administrimi

Shqipëria ka një detyrim të hartojë plane veprimi për habitatet dhe speciet në gjendje kritike në bazë të Konventës së Diversitetit Biologjik, e cila kërkon hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit për ruajtjen, mbrojtjen dhe rritjen e diversitetit biologjik.

Planet e veprimit shikohen si instrumente kyç në mbrojtjen e habitateve dhe specieve të rëndësishme që kanë nevojë të ruhen. Ata vendosin objektiva të matshme ruajtjeje, identifikojnë masat specifike dhe përcaktojnë përgjegjësitë për veprim.

Fondet e administrimit dhe kapaciteti për zbatimin e objektivave të ruajtjes janë të pamjaftueshme, kështu që edhe ato zona të përfshira në planifikim nuk e kanë domosdoshmërisht nivelin e duhur të mbrojtjes. Ende nuk ka një sistem monitorimi të disponueshëm për ta përdorur, kështu që nuk ka rrugë të besueshme për të gjykuar nëse biodiversiteti po përmirësohet apo keqësohet.

Ministria përgjegjëse për administrimin e zonave të mbrojtura (Bujqësia deri në mes të vitit 2005, Mjedisi sot) ka nisur diskutimet lidhur me integrimin e zonave të mbrojtura shqiptare në rrjetet Europiane me qëllim përshtetimin e identifikimit dhe krijimin e hartës së rrjetit ekologjik europian, rritjen e bashkëveprimit ndërkombëtar dhe ndër-kufitar mes shteteve dhe rajoneve, ruajtjen e zonave të rëndësishme të natyrës dhe informimin e publikut lidhur me veprimet e ndërmarra për speciet dhe zonat përkatëse. Këto përfshijnë propozime për të zgjeruar sipërfaqen e zonave të mbrojtura nga 6 deri në 14% në një periudhë afatshkurtër dhe 25% në një periudhë më afatgjatë.



**2.5** *Përmbledhje e problemeve kyçe të mjedisit dhe shkaqet e tyre*

Kushtet e secilit përbërës të mjedisit dhe shkaqet kryesore të keqësimit të tyre jepen në tabelën e mëposhtme

**Tabela 2-3 Mjedisit - Gjendja, Ndërveprimet dhe Prioritet**

	Gjendja	Industria e rëndë	Industria tjera	Energjia	Bujqësia	Transporti	Zhvillimi urban	Turizmi	Trashëgimia
Ajri	☹️	➡️		➡️	⬆️	⬆️	⬆️		🟢
Cilësia e ujit	☹️	➡️	⬆️		⬆️	⬆️	⬆️	⬆️	🔴 ➡️
Sasia e ujit	☺️	➡️	⬆️	⬆️	⬆️	🟢	⬆️	⬆️	🟢
Mbetjet	☹️	➡️	⬆️		⬆️	⬆️	⬆️	⬆️	🔴 ➡️
Toka	☹️				⬆️	⬆️	⬆️		🔴 ➡️
Zhurma	☹️	➡️		🟢	🟢	⬆️	⬆️		🟢
Biodiversiteti	☹️		⬆️		⬆️	⬆️	⬆️	➡️	
Peizazhi	☹️				⬆️	⬆️	⬆️	⬆️	

**Treguesi**

**Simboli**

**Domethënia e simboleve**

Cila është gjendja e secili komponent të mjedisit tonë?	Ngjyra	Bad	Poor	Moderate	Good
A po përmirësohet apo keqësohet gjendja e secilit komponent?	Shprehja	☹️ Duke u përkeqësuar	☹️ E qëndrueshme	☺️ E qëndrueshme	☺️ Duke u përmirësuar
Cilat janë aktivitetet kryesore që po ndikojnë tek mjedisit?	Ngjyra	E fortë	Mesatare	E dobët	Zero
A po shtohen apo pakësohen efektet mbi mjedisin nga këto aktivitete?	Shigjeta	⬆️ Në rritje	E qëndrueshme	➡️ Në rënie	➡️

## 2.6 Faktorë të përbashkët

Mund të identifikohen një numër faktorësh të përbashkët, të cilët kanë ndikim në procesin e zhvillimit dhe në përbërësit mjedisorë. Propozimet për zgjidhjen e disa prej këtyre çështjeve mund të bëhen në këtë strategji, por të tjerat mbeten përgjegjësi e qeverisë dhe e shoqërisë si një e tërë.

### Ritmi i ndryshimit

Në më pak se dy dekada Shqipëria ka pësuar ndryshime rrënjësore shoqërore dhe ekonomike. Rrëzimi i sistemit të mëparshëm politik ka sjellë shumë ndryshime, përfshirë kalimin në një ekonomi moderne të tregut. Ritmi i ndryshimeve ka qenë shumë i shpejtë, dhe kjo "turrije drejt zhvillimit" nuk ka qënë pa probleme, pjesërisht sepse u ndërmor pa kufizime efikase ligjore dhe institucionale. Disa prej gabimeve të asaj periudhe duhet të korrigjohen tani.

### Kompetenca Legjislative

Po futet në veprim legjislacioni për kontrollin e aktiviteteve të zhvillimit. Megjithatë, ai është i pamundur për t'u zbatuar dhe ka një nivel të ulët përputhjeje:

- **Mungesa e transparencës** – kuptimi i saktë dhe detyrimet që lindin nga legjislacioni janë shpesh të paqarta. Kjo mungesë transparence sjell keqkuptime dhe lë hapësirë për zbatime të papajtueshme të ligjit, ose shmangien e plotë të tij. Kapitulli 4 jep rekomandime për përmirësime.
- **Nivel i ulët i zbatimit të legjislacionit** – mungesa e kapacitetit institucional dhe nganjëherë mungesa e qartësisë në ligj do të thotë se detyrimet ekzistuese legjislative nuk zbatohen apo imponohen në mënyrë efikase. Kur ka mospajtim në shkallë të gjerë, humbet respekti për ligjin dhe është jashtëzakonisht e vështirë të rifitohet. Në këtë strategji bëhen edhe rekomandime, por problemi duhet kapur e trajtuar sistematikisht jo vetëm në të gjithë sistemin ligjor në përgjithësi, por dhe në të gjitha hallkat e shoqërisë.
- **Pengesat burokratike** – proceset burokratike mund të jenë të ngadalta dhe të stërgjatura. Shumë institucione nuk kanë personelin e mjaftueshëm dhe disa kanë mbivendosje të detyrave dhe përgjegjësi, gjë që do të thotë përdorim jo efikas i fondeve publike dhe pështjellim në popull. Kjo gjithashtu krijon pengesa për zhvillimin duke ulur interesin për nxitjen e aktiviteteve të reja.
- **Mungesa e sqarimit dhe publicitetit** – popullsia nuk është e mirëinformuar rreth legjislacionit apo pasojave të tij te qytetarët. Ky përbën pjesërisht një problem për administratën shtetërore, e cila duhet të sigurohet që informacioni është i disponueshëm dhe i paraqitur mirë, por është problem edhe i trashëgimisë komuniste, sipas së cilës më shumë përkrahej shmangia e ligjit sesa ndërgjegjësimi aktiv i qytetarëve. Në këtë strategji bëhen rekomandime, por problemi duhet të trajtohet sistematikisht në të gjithë sistemin ligjor në tërësi.
- **Korrupsioni** – sfida e heqjes së praktikave korruptive nga sektorët publikë dhe privatë ende duhet përballuar, duke përdorur një numër masash si shpërblimin për punë të mirë, përmirësimin e mundësive në strukturat e karrierës ose stimujt financiarë për rritjen e gjasave për ndëshkim të sukseshëm të atyre që shkelin ligjin.

### Pronësia mbi tokën

Procesi i rikalimit të tokës shtetërore në pronësi private është larg përfundimit. Tokat e ndara pronarëve të rinj shpesh janë objekt i pretendimeve të pronarëve të mëparshëm dhe ka shumë mosmarrëveshje. Këto pasiguri pengojnë funksionimin e një tregu të sukseshëm të tokës. Kjo nga

ana e saj, ndikon në aftësinë për të zbatuar zonat e planifikimit hapësinor dhe për të përfutur fonde për infrastrukturën.

Në shumë raste popullsia ka marrë përsipër rrezikun e investimit që përbën ndërtimi i shtëpive apo bizneseve në toka që ata nuk i zotërojnë ligjërisht ose statusi i të cilave mbetet i pasigurt.

### **Zhvillim i paautorizuar**

Ndryshimi në regjimin politik, i dha mundësi popullit t'i përgjigjet kërkesës së madhe e të ndrydhur për shtëpi. Krahas me lëvizjen në shkallë të gjërë të popullsisë rurale drejt periferive të zonave urbane, u bë një zgjerim i shpejtë, i paplanifikuar, i paligjshëm dhe fare i pakontrolluar i zonave të banuara, nga njerëz pa asnjë titull pronësie dhe që shpesh është bërë në vende të papërshtatshme. Për shembull, ndërtesat që janë ndërtuar aty ku ishte planifikuar të ndërtohet një rrugë ose në një vend të ndotur, më pas ose është dashur të shëmben, ose do të shëmben. Probleme të tilla kanë një efekt dyfish negativ, meqë burimet dhe materialet që u përdorën në ndërtimin e tyre shkojnë dëm.

### **Mungesa e Infrastrukturës së Komunitetit**

Shumë banesa dhe biznese nuk janë të lidhura me shërbimet komunale, si furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujrave të zeza. Mundësia e përdorimit zyrtar të këtyre shërbimeve është në varësi të ligjshmërisë së ndërtesës. Edhe pse mund të jetë e mundur të realizohet një lidhje me rrjetin e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet një kablli ajror, do të dalin probleme për të bërë lidhjen me rrjetin e furnizimit me ujë dhe kanaleve të ujrave të zeza. Të përballur me këto probleme, shumë banesa e marrin ujin nga puse të cekëta, që rrezikojnë të ndoten nga ujrata e zeza të patrajtuara, që shkarkohen nga ndërtesa, ose në rastin më të mirë në një grope septike. Mbetjet e ngurta hidhen në pikën më të afërt të mundshme të grumbullimit të mbetjeve. Me pak fjalë, pushteti qendror dhe vendor nuk ka qenë në gjendje të sigurojë shërbime komunale për të mbështetur ndërtimet e banesave, ato tregtare dhe ndërtimeve të lehta të karakterit industrial, që kanë ndodhur pak a shumë gjatë këtij dhjetëvjeçari të fundit. Ata, as nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, përderisa banorët e paligjshëm nuk paguajnë taksa për sigurimin e këtyre shërbimeve.

Këto probleme pasqyrojnë si mungesën e parave ashtu edhe një mungesë planifikimi dhe kontrolli të procesit të zhvillimit. Zgjidhjet ofrohen në plane veprimi specifik të sektorit, por nevojiten përmirësime sistematike në kapacitetin e Shqipërisë për të administruar fondet për investimet në infrastrukturë.

### **Ndërgjegjësimit i dobët i publikut**

Edhe pse janë ndërmarrë hapa për të rritur nivelin e informacionit të disponueshëm mbi mjedisin nga nivelet qendrore e locale të qeverisë dhe nga institucionet arsimore, ende nuk kuptohet lidhja mes veprimeve të individëve dhe efektit të tyre në mjedis. Ndërgjegjësimi për mjedisin duhet të zhvillohet në të gjitha nivelet. Një kuptim i pakët i problemeve të mjedisit kontribuon në një sërë problemesh, përfshirë prerjen e paqëndrueshme të pemëve, ndotjen e puseve të cekët të ujit të pijshëm, si pasojë e praktikave të dobëta të eliminimit të mbetjeve të kafshëve apo njerëzve, ose hedhjen e mbetjeve të ngurta në kanalet e kullimit dhe/ose vaditjes.

Ndoshta shembulli më i spikatur i ndërgjegjësimit të pakët lidhur me çështjet e mjedisit paraqitet nga industria e turizmit. Në 1990 Shqipëria kishte një prej vijave bregdetare më të paprishura në Europë, një burim që asnjë vend europian nuk e zotëronte. Mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe kontrolli i pa mjaftueshëm të planifikimit, kanë çuar në hapësira të mëdha me ndërtime të planifikuara keq dhe të shëmtuara në pamje, të cilat kanë shkatërruar një pjesë të madhe të bukurisë, e cila do të kishte tërhequr turistë të huaj dhe bashkë me ta edhe valutë. Këto ndërtime,

ashtu si shumë të tjera rreth qyteteve të vogla e të mëdha, janë ndërtuar me shumë pak infrastrukturë mjedisore si p.sh. furnizim me ujë, mbledhje dhe trajtim të ujrave të zeza dhe administrim të mbetjeve të ngurta, të cilat e rëndojnë shumë situatën.

### **Varfëria**

Varfëria është gjithashtu një faktor kontribues në këtë drejtim. Në zonat më të varfëra të vendit, njerëz që jetojnë në kushte minimale jetese mund të kryejnë veprimtari dëmtoese për mjedisin, me qëllim që të plotësojnë nevojat e tyre jetike bazë. Për shembull, prerja e pyjeve për dru zjarri apo djegia e mbetjeve, shpesh shihet si mundësia e vetme për familjet me të ardhura të pakta për të përballuar jetën, pavarësisht nga dëmi afatgjatë që këto veprime mund t'u shkaktojnë shëndetit dhe mjedisit. Nxitja e zhvillimit të integruar rural do të sigurojë burime alternative të ardhurash dhe do të ulë shpyllëzimin dhe erozionin.

### **Planifikimi i Investimit Publik**

Në përgjithësi, gjendja e infrastrukturës komunale është e dobët. Për zgjidhjen e këtij problemi kërkohen investime publike të mëdha. Një pjesë e madhe e këtij investimi do të kërkojë mbështetjen e burimeve të jashtme si të Komunitetit European, Bankës Botërore, BERZH-it apo agjencive donatore dypalëshe. Do të duhen shumë vite për t'i bërë këto investime. Kërkohen strategji afatgjata investimi, për një sërë çështjesh, në mënyrë të veçantë ato të ujit, mbetjeve dhe tokave të ndotura. Janë identifikuar projekte për secilën prej këtyre zonave dhe disa prej tyre janë zbatuar ose janë në fazën e zbatimit. Megjithatë, identifikimi sistematik i nevojave për investim, përparësive dhe potencialit bashkë-financues nuk është një metodë e zakonshme veprimi. Kërkohen strategji afatgjata të bazuara në planifikimin efikas, të ndërmarra në nivel lokal dhe rajonal për të siguruar përgatitjen e strategjive gjithpërfshirëse.

Ekzistojnë probleme edhe në lidhje me zbatimin në nivel lokal. Si pjesë e procesit të decentralizimit, përgjegjësia për sigurimin e infrastrukturës komunale tani i mbetet pushtetit vendor. Megjithatë, pjesës më të madhe të këtyre autoriteteve u mungon kapaciteti për të planifikuar dhe zbatuar projekte të mëdha investimi në përputhje me standardet ndërkombëtare. Duhet të gjenden mekanizma për të organizuar, mbështetur dhe mbikqyrur projekte të tilla, nëqoftëse Shqipëria dëshiron të arrijë nivelet Europiane të mbrojtjes së mjedisit.







## 3 Objektivat dhe Masat Përkatëse

Ky kapitull paraqet objektivat e kësaj strategjie dhe masat që duhen ndërmarrë lidhur me komponentët specifikë të mjedisit. Mjetet për zbatimin praktik të strategjisë jepen në Kapitullin 4. Objektivat dhe masat janë hartuar në mënyrë të tillë që të jenë në përputhje dhe të japin zgjidhje për problemet e identifikuar në:

- Programin e Qeverisë Shqiptare – 2005 deri 2009;
- Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit;
- Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Social-Ekonomik;
- Planin e Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit Europian; dhe
- Analiza e cila është dhënë e përmbledhur në Kapitullin 2.

### 3.1 Metoda e Ndarjes në Faza

Objektivat mjedisore që identifikohen në këtë kapitull së pari përqendrohen në fushat që paraqesin probleme; të konstatuara këto në programin e Qeverisë për periudhën 2005 - 2009. Megjithatë, veprimet që duhet të ndërmerren për të arritur objektivat finale të zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor si dhe në përputhje me legjislacionin europian do të kërkojnë shumë më tepër kohë. Prandaj, objektivat duhet të hartohen për periudha afatmesme dhe afatgjata. Për qëllimet e kësaj strategjie periudha afatmesme është periudha 2010 – 2015, ndërsa periudha afatgjatë 2015 – 2020. Gjithashtu, viti 2020 merret si viti i fundit i afatit, i synuar ky për të plotësuar vetëm kërkesat më të vështira të investimeve, që përmban *acquis communitare*<sup>35</sup> mjedisor aktual. Masat e identifikuar këtu dhe në Kapitullin 4 jepen me hollësi për periudhën afatshkurtër dhe të përmbledhura për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.




Figura 3-1 Perspektiva dhe Rishikimi i SKM

Zhvillimi i mundshëm në të ardhmen në çdo sektor kryesor të ekonomisë shqiptare është menduar të parashikojë ndryshimet e mundshme në kushtet e presionit të ushtruar ndaj mjedisit. Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se parashikime të tilla janë shumë të pasigurta. Si faktorët e jashtëm, ashtu dhe ata të brendshëm të Shqipërisë mund të jenë objekt ndryshimi, gjë që mund të çojë në krijimin e problemeve të reja ose pakësimin e atyre ekzistuese. Duke pasur

<sup>35</sup> As teksti dhe as shifrat e dhëna këtu nuk duhet të interpretohen si vendosja e një date të synuar për pranimit. Ato i referohen datës së synuar për përmbushjen e detyrimeve *acquis* (të BE-së). Data e pranimit është një çështje që do të zgjidhet nëpërmjet negociatave të ardhshme ndërmjet Komunitetit Europian dhe Republikës së Shqipërisë.

parasysh këtë fakt, kjo strategji dhe plani i saj i zbatimit do t'i nënshtrohen një procesi rishikimi e ndryshimi, i cili bën të mundur përshtatjen ndaj këtyre ndryshimeve.

Nga fundi i programit afatshkurtër, strategjia do të ketë nevojë për rishikim, me qëllim që të vendoset ecuria e zbatimit dhe të bëhet planifikimi më me hollësi për periudhën e mëpasme. Në veçanti, rishikimi duhet të synojë:

- Kapërcimin e dobësive të identifikuara; dhe
- Realizimin e qëllimeve të reja ose ato të ndryshuara.

### 3.2 *Objektivat*

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie është të përmirësojë kushtet mjedisore në Republikën e Shqipërisë si për të respektuar angazhimet e përcaktuara në Kushtetutë ashtu dhe për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të anëtarësisë në Komunitetin Europian. Kjo është një ndërmarrje e përmasave shumë të mëdha, që nuk mund të arrihet në një periudhë afatshkurtër. Për pasojë, objektivat dhe masat kanë nevojë të prioritarizohen.

#### 3.2.1 **Objektivat e Përgjithshme**

Në mënyrë të përmbledhur objektivat e kësaj strategjie janë:

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit në të gjithë Shqipërinë, që përputhet me nivelet e standardeve Kombëtare, të KE-së dhe OBSH-së;
- Ulja e nivelit të çlirimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese, me qëllim që të kontribuohet për parandalimin e ndryshimit të klimës;
- Përmirësimi i administrimit të mbetjeve, me qëllim që të pakësohen rreziqet që i kanosen shëndetit njerëzor, mjedisor dhe tregtisë duke përmbushur edhe kërkesat e KE;
- Sigurimi i aksesit në ujë dhe pijshëm për të gjithë popullatën;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për përdorim aktual dhe në të ardhmen;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës, me qëllim që të shtohet në maksimum pjelloria, të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë në përputhje me angazhimet tona europiane dhe ndërkombëtare;
- Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit hapësinor dhe i zhvillimit, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore;
- Riparimin dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme të mëdha mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, si rezultat i këtyre dëmtimeve; dhe
- Kontrolli i nivelit të zhurmave, rrezatimit dhe stresit mjedisor, me të cilat përballet popullata, dhe vendosja e tyre në nivele të sigurta për shëndetin.

#### 3.2.2 **Objektivat e përkohshme**

Objektivat e përkohshme që duhen realizuar, në shërbim të arritjes së objektivave afatgjata, dalin nga analiza FSHPGJEK (Forcat Shtytëse, Presionet, Gjendja, Efekti mbi Mjedisin dhe Kundërpërgjigjja), që përmendet më sipër. Për shembull, me qëllim që të përmirësohet cilësia e

ajrit është e nevojshme të identifikohen burimet e ndotjes së ajrit dhe rëndësia përkatëse e secilit prej këtyre burimeve dhe më pas gjendet zgjidhja.

Objektivat e përkohshme dalin me përmbushjen e ciklit FSHPGJEK – ato janë niveli i parë i kundërpërgjigjes. Meqenëse janë niveli i parë, ato specifikohen si angazhime të vazhdueshme të cilat nuk kanë afate të veçanta. Meqenëse ato përbëjnë nivelin e parë, objektivat e përkohshme specifikohen se angazhime në vazhdimësi, që nuk u nënshtrohen afateve të caktuara. Objektivat e përkohshme synojnë të drejtojnë adoptimin e objektivave në një varg sektorësh.

### 3.2.3 Përcaktimi i Synimeve

Standardet mjedisore mund të përcaktohen në një sërë mënyrash. Dy mënyrat më të zakonshme janë:

- Vendosja e një kufiri në sasinë e presionit që ushtrohet mbi mjedisin; ose
- Përcaktimi i kushteve të mjedisit që kërkohet.

Këto dy metoda aplikohen në legjisllacionin për parandalimin e ndotjes:

- *Standardet e kufirit të lejueshëm të çlirimit të gazeve*, ku niveli i ndotjes që vjen nga një aktivitet i caktuar kufizohet mbi bazën e një "norme" ose një niveli të vendosur në një "standard procesi". Kjo metodë siguron një "zonë të niveluar" në të cilën secila prej dy njësive që përdorin të njëjtat procese do të ketë të njëjtat kërkesa, pavarësisht nga vendndodhja e tyre;
- *Standardet e cilësisë së mjedisit (SCM)* të cilët përcaktojnë kufirin e nivelit të ndotjes ose të degradimit që është i pranueshëm për mjedisin. Kjo mund të specifikohet si një përqendrim minimal ose maksimal i një elementi kimik në një komponent të mjedisit, ose si një kusht ekologjik i cili shpesh vlerësohet duke monitoruar praninë ose mungesën e specieve kryesore treguese. SCM-të shpesh vendosen për të mbrojtur shëndetin njerëzor dhe ekologjik, dhe mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin në varësi të ndjeshmërisë së mjedisit<sup>36</sup>.

Të dy konceptet bashkohen bazuar në *metodën e kombinuar*<sup>37</sup>, sipas së cilës, vlerat e kufirit të shkarkimeve në atmosferë që janë vendosur në lejet e dhëna për veprimtari të caktuara, mbështeten në teknologjinë më të mirë të disponueshme (TMD), në normat e çlirimeve si dhe në nevojën për të arritur Standardin Cilësor Mjedisor. Nëse arritja e një standardi të vendosur për sasinë e gazit të çliruar në atmosferë nuk mjafton për të arritur standardin e cilësisë së ajrit në mjedis, atëherë aplikohet një vlerë kufi më strikte për këto çlirime.

Megjithatë, për të zbatuar me efikasitet metodën e kombinuar, duhen të dhëna të mjaftueshme, të nxjerra nga monitorimet lidhur me çlirimet e gazeve në atmosferë dhe gjendjen e mjedisit, për të mundësuar vlerësimin sasior të lidhjes shkak-pasojë dhe për përpjesëtimin e ngarkesës<sup>38</sup>. Për shumicën e problemeve në Shqipëri nuk gjenden të dhëna të tilla për momentin dhe një prioritet i hershëm ka qenë rritja e nivelit të monitorimit të bërë, për të dy presionet dhe të gjendjes së mjedisit, në mënyrë që të ketë një informacion më të mirë për administrimin, mbi të cilin të bazohen vendimet e politikës dhe kushtet individuale të lejuara.

<sup>36</sup> Për shembull, zonat e mbrojtjes së veçantë për mbrojtjen e ajrit, ujit ose natyrës

<sup>37</sup> Shiko për shembull Nenin 10 të Direktivës Europiane të Kuadrit për Ujin (2000/60/KE)

<sup>38</sup> Përpjesëtimi i ngarkesës është procesi me anë të të cilit ndahet ngarkesa e lejuar e mjedisit në sektorë të ndryshëm, me qëllim që të vendosen vlerat kufi të çlirimeve sipas metodës së kombinuar – për shembull shiko metodën [US EPA](http://www.epa.gov/owow/tmdl/overviewfs.html) për kontrollin e ndotjes së ujit - <http://www.epa.gov/owow/tmdl/overviewfs.html>

Prandaj dhe synimet afatshkurtra që janë vendosur në këtë strategji, pikë së pari përqendrohen në pakësimin e presioneve, me qëllim që të arrihen standardet limite të vendosura për çlirimin e gazit në atmosferë. Gjithashtu, strategjia synon të realizojë aktivitetet e nevojshme të monitorimit, në mënyrë që metoda e kombinuar të mund të aplikohet në përmirësimet e mundëshme të strategjisë në të ardhmen. Përputhja me objektivat e cilësisë së mjedisit do të arrihet plotësisht në të gjitha vendet, vetëm kur kjo metodë të vihet në zbatim.

### **3.2.4. Prioritarizimi**

Sado të angazhuar të jemi në arritjen e secilit prej këtyre objektivave dhe qëllimeve në këtë strategji, ne nuk mund të shpresojmë t'i arrijmë ato plotësisht brenda periudhës afatshkurtër. Prandaj, ne duhet të përzgjedhim ato që janë më të rëndësishme dhe më urgjente. Duhet të vendosim cilat janë prioritetet tona. Nuk janë vendosur afate për objektivat e përgjithshme dhe objektivat e përkohshme të strategjisë, meqenëse këto janë të vazhdueshme dhe aplikohen në vazhdimësi. Megjithatë, objektivat dhe masat duhet të përcaktohen me saktësi, përndryshe ato nuk do të shërbejnë si një program praktik veprimi. Procesi i përcaktimit të objektivave që do të vendosen dhe masat që duhen marrë është i përsëritur. Përcaktimi i objektivave varet nga realizueshmëria dhe praktikiteti i masave të disponueshme, ndërkohë që masat sigurisht duhet të zgjidhen për të arritur objektivat në një mënyrë kost-efektive.

Gjithashtu është e nevojshme të dallojmë dy llojet bazë të objektivave dhe masave:

- Ato *veprime fizike dhe teknike* dhe investimet që duhet të kryhen, me qëllim që të arrihet përmirësimi material në kushtet mjedisore – në fakt, këto janë gjërat të cilat do ta ndryshojnë gjendjen e mjedisit; dhe
- Ato veprime të cilët kanë si synim krijimin e *kuadrit administrativ, ligjor dhe ekonomik*, i cili nevojitet për të siguruar që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme fizike dhe teknike: këtu përfshihen dhe detyrat procedurale dhe institucionale, të cilat përmirësojnë sistemet tona për administrimin e mjedisit.

Jo të gjitha masat janë përgjegjësi e administratës apo institucioneve të tjera publike; në këtë proces janë të përfshirë edhe industria dhe sektorët e tjerë ekonomikë si dhe publiku në përgjithësi. Në shumë raste, palëve të interesuara do t'u kërkohet të ndryshojnë proceset dhe praktikat e tyre ekzistuese, me qëllim që të arrijnë standardet e vendosura në legjislacion dhe të arrijnë ato që janë vendosur në *acquis*. Për përcaktimin e objektivave në këtë strategji duhet të merren në konsideratë edhe kushtet mbizotëruese në sektorët ekonomikë dhe sektorët e qeverisë.

#### **Për infrastrukturën komunale dhe shërbimet**

Grumbullimi dhe përpunimi i ujërave të mbetura dhe administrimi i mbetjeve të ngurta janë dy fushat kryesore problematike. Për të arritur standardet e Komunitetit Europian në këto fusha do të nevojiten investime të shumta, që do ta tejkalojnë shumën prej 1 miliard Euro. Për këtë arsye nevojitet një metodë e ndarë në faza. Kjo metodë duhet të marrë parasysh jo vetëm koston e investimeve kapital, por dhe koston operative e cila do të mbulohet me pagesat që bëjnë konsumatorët për këto shërbime. Si rrjedhim, janë vendosur objektivat dhe masat që duhet të ndërmerren në periudhën afatshkurtër për të maksimizuar efektshmërinë e investimeve në lidhje me sigurimin e shërbimeve dhe mbrojtjen e mjedisit brenda kufijve të mundshëm, edhe nëse këto masa mund të mos i përmbushin së pari standardet aktuale të Komunitetit Europian.

#### **Për transportin**

Problemet e transportit kanë nevojë për vëmendje të veçantë, për shkak të nevojës për të përmirësuar gjendjen teknike të automjeteve në tërësi, me qëllim që të ulen niveli i shkarkimit të

gazeve në atmosferë. Meqë shumica e makinave janë pronë private, kostoja e këtyre ndryshimeve do të bjerë në mënyrë të konsiderueshme mbi individët më shumë se sa mbi shtetin apo ndërmarrjet. Duhet të merret parasysh gjithashtu edhe aftësia për të përballuar ndryshime të tilla.

### **Për industrinë**

Aktualisht, shumë impiante operojnë nën standardet që kërkohen nga *acquis*. Përmirësimi i impianteve në mënyrë të tillë që të arrijnë standardet kërkon kohë. Kjo strategji synon të nxisë një ndryshim realist dhe të arritshëm, që do të çojë në përmbushjen e pjesës më të madhe të standardeve aktuale europiane deri në 2015 dhe realizim të plotë në 2020.

### **Administratën shtetërore**

Ekzistenca e një administrate shtetërore moderne e efikase, e pajisur me gjithçka nevojitet që ta çojë administrimin mjedisor në një standard më të lartë, është kusht për të arritur objektivat mjedisorë. Sikurse do të diskutohet më me hollësi më poshtë, niveli aktual i administratës shtetërore që i është kushtuar administrimit mjedisor në Shqipëri është relativisht i ulët. Duke qenë se edhe të ardhurat e qeverisë janë relativisht të ulta, do të duhet kohë për ta përmirësuar këtë situatë. Strategjia jep rekomandime për hapat më të rëndësishme që duhet të ndërmerren në periudhën afatshkurtër dhe përqendrohet në ato masa të cilat janë të domosdoshme për arritjen e përmirësimeve më urgjente mjedisore.

### **3.2.5 Vendosja e kriterëve për prioritetet**

Duke pasur parasysh kufizimet që vendos niveli i të dhënave të disponueshme, është përdorur një numër i vogël kriteresh të thjeshta për të vendosur prioritetet për veprim. Kjo do të sigurojë që, masat që do të përzgjidhen, do të trajtojnë dy objektivat kryesore të strategjisë, një zhvillim të qëndrueshëm dhe zbatimin e legjislacionit të Komunitetit Europian. Hapi i parë në procesin e vendimmarrjes, është përcaktimi i masave të mundshme për të arritur qëllimet e identifikuara. Më pas, masat e mundshme vlerësohen për të përcaktuar efikasitetin e tyre:

- A do ta përmirësojnë shëndetin e njeriut këto masa, ose a do të krijojnë kushte më të mira në të cilat, shëndeti i njeriut mund të përmirësohet?
- A i ul masa nivelet aktuale ose ato të pritshme të ndotjes, ose a ndihmon ajo në krijimin e kushteve në të cilat ndotja mund të ulet?
- A ndihmon masa në ruajtjen apo në rivendosjen e ekuilibrit mjedisor natyral, në nxitjen e ruajtjes së biodiversitetit, në mirëmbajtjen apo përmirësimin e peizazhit apo të mjedisit urban ku jetojmë?
- A e nxit një masë e tillë zhvillimin ekonomik, a është neutrale në efektin e saj apo ka mundësi ta pengojë atë?

Në momentin që vërtetohet efikasiteti i një mase, është e domosdoshme të vlerësohet dhe realizueshmëria e saj:

- A kërkon kjo masë nivele të larta të shpenzimeve të kapitalit për t'u realizuar; a do të ketë nevojë për shpenzime të larta për vënien në veprim dhe për mirëmbajtjen e saj?
- A ka kosto të lartë për popullsinë?
- A kërkon ndryshime të mëdha institucionale të cilat mund të kërkojnë shumë kohë deri sa të hyjnë në fuqi?
- A është masa nën kompetencën ligjore të një numri të madh institucioneesh, të cilët mund ta bëjnë më të ndërlikuar zbatimin e saj?

### 3.3 Përmirësimi i Mjedisit

Objektivat dhe synimet specifike për secilin komponent të mjedisit janë përshkruar më poshtë. Janë vendosur gjithashtu objektiva afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata si dhe janë identifikuar disa tregues kryesorë të cilët do të përdoren për të matur ecurinë. Qëllimet janë menduar të jenë realiste, të arritshme dhe të tilla që të nxisin progresin drejt objektivave afatgjata. Objektivat, veçanërisht ato afatmesme dhe afatgjata, do duhet të rishikohen, përditësohen dhe të përpunohen më tej nëpërmjet përvojës së fituar me zbatimin e programit afatshkurtër të masave. Me sigurimin e një informacioni më të saktë nga monitorimi i mjedisit, do të jetë e mundur që objektivat të përpunohen më tej dhe masat të përshtaten si duhet.

Pjesa më e madhe e masave që lidhen me këto qëllime dhe objektiva kanë në fokusin e tyre përmirësimin e mjedisit, d.m.th. zgjidhjen e problemeve ekzistuese. Megjithatë, me qëllim që këto masa të jenë plotësisht efikase, ato duhet të shoqërohen me masat për të parandaluar krijimin e problemeve të reja e në veçanti të atyre që mund të dalin nga zhvillimi i industrive dhe ndërmarrjeve të reja.

Si rrjedhim, tek impiantet e reja do të aplikohet politika e përgjithshme e mëposhtme:

Për impiantet e reja do të kërkohen standardet e Komunitetit Europian që në fillim të funksionimit. Megjithatë, zbatimi i hollësishëm i këtyre standardeve do të duhet të marrë parasysh nivelin e ulët aktual të infrastrukturës dhe shërbimeve komunale. Shqipëria ende nuk ka një infrastrukturë të administrimit të ujërave të mbetura dhe të mbetjeve të ngurta me të cilën të mbështesë arritjen e standardeve të plota nga ana e kompanive të reja dhe për sa kohë që qeveria nuk i vendos ato në veprim, nuk është realiste të presësh, që biznesi të përballojë të gjithë koston e parandalimit të ndotjes në nivelet e Standardeve të Komunitetit Europian.

#### 3.3.1 Cilësia e Ajrit

##### *Përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit në të gjithë Shqipërinë në nivelet e standardeve të BE-së dhe OBSH-së*

Aktualisht, nivelet e ndotjes së ajrit në një numër zonash urbane i tejkalojnë standardet e cilësisë mjedisore. Gjithashtu ka prova që këto nivele të ndotjes po ndikojnë shumë negativisht në shëndetin e njerëzve. Numri i faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ajrit, veçanërisht përdorimi i automjeteve, është duke u rritur. Prandaj duhet vepruar urgjentisht.

**Objektivi** i përgjithshëm është përmirësimi i cilësisë së ajrit, veçanërisht në zonat urbane dhe rrotull uzinave industriale, me qëllim mbrojtjen e shëndetit njerëzor dhe përmbushjen e direktivave të BE-së dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare për cilësinë e ajrit të ambientit dhe për kufizimin e sasisë së gazit të çliruar në atmosferë. **Problemet** dhe **prirjet** kryesore që duhet të trajtohen, nëse ky objektivi arrihet, përfshijnë:

- Shkarkimet në ajër si pasojë e transportit lidhen me disa ndryshore, sikurse janë: karburanti që përdoret nga automjetet private/komerciale, numri i automjeteve, distancat e përshkuara, mosha dhe fuqia e motorit të automjeteve, mirëmbajtja, cilësia e rrugëve, mënyrat alternative të transportit. Përveç automjeteve, cilësia e keqe e rrugëve kontribuon në rritjen e nivelit të pluhurave dhe rrit shkarkimet nga automjetet. Numri i automjeteve është rritur shumë në 10 vitet e fundit dhe ka të ngjarë që me zhvillimin ekonomik të vendit, të rritet më tej.
- Pluhuri që vjen nga aktivitetet e ndërtimit dhe nga rrugët e paasfaltuara/balta nëpër rrugë. Si ndërtimet ashtu dhe trafiku rrugor pritet të shtohen me rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

- Shkarkimet e substancave ndotëse në ajër nga industrinë – megjithëse përgjithësisht ka pasur rënie, pasi shumë industri të mëdha tashmë nuk funksionojnë, shkarkimet në ajër të substancave ndotëse mund të rriten prapë me zhvillimin e ekonomisë, rritjen e prodhimit industrial dhe kërkesës për energji.

Për më tepër, shkarkimet shtohen edhe nga djegia e mbetjeve në natyrë dhe nga përdorimi i lëndëve djegëse të ngurta në pajisjet shtëpiake. Gjithashtu, ka dhe një mungesë informacioni të besueshëm në lidhje me cilësinë e ajrit gjë që duhet ndryshuar duke përmirësuar monitorimin.

**Përfitimet** nga ndërmarrja e veprimeve për të kontrolluar ndotjen e ajrit, përfshijnë pakësimin e rreziqeve ndaj shëndetit publik në sasi të konsiderueshme si dhe kanë bërë që gradualisht aktivitetet dhe shkarkimet në atmosferë të arrijnë standardet dhe Direktivat e BE-së.

Zbatimi i plotë i legjislacionit të Komunitetit European në këtë fushë, brenda periudhës afatshkurtër nuk është e mundur. Strategjia e adoptuar këtu është:

- Ulja e nivele të shkarkimeve nga burime fikse dhe të lëvizshme drejt limiteve të përcaktuara nga legjislacioni i Komunitetit;
- Përmirësimi i rregullimeve monitoruese, me qëllim që të sigurohet informacion, me anë të të cilit të mund të ndërmerret planifikimi i administrimit të cilësisë së ajrit;
- Vendosja e një sistemi të planifikimit të menaxhimit të cilësisë së ajrit dhe kontrollit, të cilët do të përcaktojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme për të arritur standardet e cilësisë mjedisore të ajrit,

Për arritjen e këtyre objektivave të përgjithshme janë identifikuar pesë objektiva të përkohshme:

- CA1 Monitorimi i cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e BE;
- CA2 Kontrolli dhe ulja e nivelit të shkarkimeve të gazeve në ajër nga automjetet e qarkullimit rrugor;
- CA3 Kontrolli dhe ulja e nivelit të shkarkimit të substancave ndotëse nga impiantet industriale;
- CA4 Kontrolli dhe ulja e nivelit të sasisë së pluhurit që krijohet nga ndërtimet;
- CA5 Ulja e nivelit të sasisë së pluhurit që ngrihet nga burime të tjera duke përfshirë rrugë të pashtuara, ambiente jo-industriale dhe djegie jashtë në natyrë;
- CA6 Planifikimi i cilësisë së ajrit dhe sistemi i kontrollit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit European.

Për arritjen e secilit nga këto objektiva të ndërmjetmë/përkohëshme janë caktuar një sërë masash. Treguesit kryesorë të efektshmërisë së këtyre synimeve në arritjen e objektivave të përkohshme, do të jetë cilësia më e mirë e ajrit që matet duke përdorur rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit.

Kërkesat<sup>39</sup> kryesore të transpozimit në segmentin e cilësisë së ajrit në *acquis* përse i përket synimeve afatshkurtra janë si më poshtë:

---

<sup>39</sup> Duhet të shënohet se janë cituar referimet e legjislacionit real – këto referime duhen kuptuar si të tilla që i përfshijnë ndryshimet që u janë bërë këtyre instrumenteve.

- Direktiva kuadër e cilësisë së ajrit (96/62/BE) – aspektet e monitorimit: kjo bëhet në përputhje me PKPL
- Direktivat e standardeve të karburantit (1998/70/BE duke përfshirë 93/12/BE) – objektivat e propozuara kërkojnë që në programin e NPAL-it të sugjerohet transpozicioni i këtyre instrumenteve
- Direktiva lidhur me kontrollin periodik të makinave (1996/96/BE) – synimet e propozuara kërkojnë të avancohen në programin e PKPL –së dhe të sugjerohet transpozimi i këtyre instrumenteve.

### CA1 Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në përputhje me kërkesat e monitorimit të BE

Niveli aktual i informacionit të monitorimit të cilësisë së ajrit është i ulët në krahasim me Vendet e tjera Europiane. Standardi, frekuenca dhe densiteti i monitorimit ka nevojë të rritet me qëllim që të përputhet me kërkesat ligjore dhe të sigurojë informacion për planifikimin e menaxhimit të cilësisë së ajrit (shikoni CA6).

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenzimet Kapitale <sup>40</sup>	Shpenzimet Operative Vjetore <sup>41</sup>
CA1.1	Monitorimi i cilësisë së ajrit nga sektori publik në përputhje me kërkesat e BE-së në 6 qytete (Tirana, Durres, Vlora, Fier, Elbasan, Shkodra – 6 stacione të automatizuara në Tirana (1 për 150,000) plus një për secilin qytet tjetër)	MMPAU Ministria e Shëndetësisë Projekti i Monitorimit CARDS/(StEMA) Institucionet Monitoruese	III/2007	IV/2008	76	12

Specifikimi i saktë dhe marrëveshjet për zbatimin e saj si dhe masat pasuese lidhur me monitorimin e cilësisë së ajrit do të varen nga rezultati i projektit StEMA (Mbështetja e Monitorimit të Mjedisit në Shqipëri – CARDS BE), i cili është në procesin e përpilimit të programit afatgjatë për monitorimin e cilësisë së ajrit. Financimi për shpenzimet kapitale pritet të bëhet nga projekti Cards i BE.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpen,Kp <sup>42</sup>	Shp.O.V <sup>43</sup>
CA1.2	Monitorimi i shkarkimeve në ajër në të gjitha instalimet e burimeve të mëdha të fiksuar e të lejuara	MMPAU	II/2007	IV/2008		

Kjo masë do të kërkojë që MMPAU të shqyrtojë lejet për gjithë impiantet e mëdhenj (që i nënshtrohen klauzolave të IPPC<sup>44</sup>) në një mënyrë të tillë ashtu siç kërkohet për instalimin dhe

<sup>40</sup> Në miliona Lek

<sup>41</sup> Në miliona Lek

<sup>42</sup> (Investime) Shpenzime Kapitale

<sup>43</sup> Shpenzime operative (vjetore në vazhdimësi)



vënien në veprim të pajisjeve të përshtatshme të monitorimit të shkarkimeve në ajër. Rezultatet e monitorimit do t'i dorëzohem Ministrisë dhe do të botohen. Kostoja e rishqyrtimit të lejeve nuk është specifikuar këtu, meqenëse është një proces veprimi në vazhdimësi që po ndërmerret tanimë nga Ministria. Megjithatë, duhet theksuar se instalimi dhe vënia në veprim e kësaj pajisjeje do të imponojë një kosto për mbajtësin e lejes. Duke u nisur nga fakti që kjo masë do të zbatohet vetëm për instalimet e mëdha, nuk ka shumë gjasa që kostot e pajisjeve monitoruese të jenë të konsiderueshme në krahasim me koston e përgjithshme operative të instalimit e, kështu që nuk ka shumë gjasa që të ketë një ndikim të rëndësishëm ekonomik. Procesi i rishqyrtimit të lejeve është planifikuar për gjysmën e dytë të vitit 2007. Operatorët e instalimeve do të lejohen atëherë të kenë në dispozicion një vit kalendarik që të blejnë, të instalojnë dhe të porositin pajisjet e monitorimit.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
CA1.3	Futja e inventarit të shkarkimeve ajrore Kombëtare, që do të përfshijnë një bazë të dhënash të aksesit publik që përmban informacion (si i raportuar ashtu dhe i vlerësuar) për të gjitha shkarkimet e rëndësishme në ajër nga burime fikse dhe të lëvizshme.	MMPAU Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve StEMA	I/2008	IV/2008		

Ndërmarrja e inventarit është gjithashtu një rezultat i specifikuar i projektit StEMA. Duke pasur parasysh një gjë të tillë, këto kosto nuk janë përfshirë këtu, pasi pritet që ato të përfshihen në kostot e projektit. Qëllimi i këtij inventari është së pari që ai të përputhet me kërkesat e raportuara të BE-së dhe Legjislacionit Ndërkombëtar dhe të mbështesë

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
CA1.4	Monitorimi i cilësisë së ajrit nga sektori publik në përputhje me BE në të gjitha qendrat urbane/ zonat e industrializuara duke bërë të detyrueshme edhe instalimin e dhjetë stacioneve të tjera të automatizuara	MMPAU Ministria e Shëndetësisë Institucionet Monitoruese	I/2009	IV/2010	69	11

Kjo masë do të specifikohet në më shumë hollësi nga programi i monitorimit të cilësisë së ajrit e përcaktuar nga projekti StEMA, të cilit iu referuam më lart. Në këtë rast, ka shumë pak gjasa që kostoja kapitale do të përballohet nga projekti. Për këtë arsye, financimi ka nevojë të nxirret nga burimet publike dhe kontributet e donatorëve.

<sup>44</sup> Kontrolli dhe Pandalimi i Ndotjes së Integruar Direktiva 96/61/EC

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA1.5	Monitorimi i cilësisë së ajrit nga sektori public në përputhje me BE në të gjitha vendet duke bërë të detyrueshme instalimin e 5 stacioneve të tjerë të automatizuar	MMPAU Ministria e Shëndetësisë Institucionet Monitoruese	I/2011	IV/2012	35	6

Kjo masë do të kompletojë ndërtimin e rrjetit monitorizues të automatizuar për cilësinë e ajrit në Shqipëri. Në tërësi do të jenë vendosur 26 stacione monitorimi të automatizuara. Sa për krahasim në Mbretërinë e Bashkuar aktualisht ka 100 sisteme monitorimi automatike, që bëjnë regjistrimet gjatë çdo ore dhe ka gjithashtu edhe 1500 monitore joautomatikë, të cilët krahasojnë nivelet e ndotjes së ajrit, mbi bazë ditore, javore ose edhe mujore.<sup>45</sup>

Kostoja operative për rrjetin, përjashtojë këtu koston e stafit të institucioneve monitoruese, është afërsisht gjithsej 30 milionë në vit.

### CA2 Kontroll dhe pakësim i shkarkimeve në ajër nga automjetet e motorizuara

Ndonëse një analizë e hollësishme e burimeve të shkarkimeve në ajër, ende nuk është ndërmarrë, gjerësisht pranohet, se shkarkimet në ajër nga automjetet me motor, janë një nga shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit në zonat urbane. Aktualisht sektori i transportit rrugor nuk përputhet me kërkesat e detyrueshme të legjislacionit të Komunitetit, veçanërisht lidhur me cilësinë e karburantit dhe testimin dhe rregullat shkarkime në ajër të automjeteve. Hapi i parë është arritja e përputhshmërisë me këto kërkesa të detyrueshme. Niveli, në të cilin duhen kontrolluar këto shkarkime në ajër, përtej klauzolave të detyrueshme nuk do të jenë të njohura derisa klauzolat për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe të inventarit kombëtar të shkarkimeve në ajër të mos jenë përfunduar dhe përderisa procesi i planifikimit të menaxhimit të cilësisë së ajrit lokal të mos jetë realizuar.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA2.1	Paraqitja e një afati të detyruar ligjrisht për heqjen gradualisht nga shitja të karburanteve që nuk përputhen për automjetet rrugore - Rregullorja e Këshillit të Ministrave që kufizon tregtimin e përdorimin e karburanteve për automjetete rrugore në ato që përputhen me standardet e Komunitetit Europian që u nënshtrohen masave të mëposhtme të tranzicionit lidhur me sasinë e squfurit në naftë:  350 mg/l – koncentrimi maksimum – 2009 50 mg/l – koncentrimi maksimum – 2012 10 mg/l – koncentrim maksimum - 2015	METE MMPAU MPPTT KM	I/2007	I/2009		

<sup>45</sup> Informacion nga Arkivi kombëtar i Informacionit të Cilësisë së Ajrit i Mbretërisë së Bashkuar - <http://www.airquality.co.uk/archive/index.php>

Kostoja e sektorit publik për futjen e kësaj mase do të jetë e kufizuar si pasojë e vazhdimësisë së sistemit ekzistues për testimin dhe inspektimin e përputhshmërisë së karburanteve me specifikimet ligjore. Një projekt i financuar nga CARDS të BE e ka trajtuar këtë çështje nëpërmjet të rekomandimeve të veta për masat e mbikëqyrjes së tregut. Si të tilla ato identifikohen këtu për zbatimin e kësaj mase si “kosto jo shtojcë”. Megjithatë, duhet theksuar se kjo masë do të ketë pasoja të rëndësishme financiare jashtë sektorit të administratës publike.

Vendosja e masave më të rrepta për standardet e naftës do të shpjerë në një rritje të kostos së karburanteve për konsumatorët. Shkalla e kësaj rritjeje ka gjasa që të jetë e rëndësishme. Çmimi aktual i naftës në Shqipëri është ndërmjet 110-120 Lekë për litër. Ndonëse kjo rritje (përafërsisht 10%) është e rëndësishme. Këtu duhet theksuar se ajo të ndodhë gjatë një periudhe 8 vjeçare dhe se niveli i rritjes përputhet me luhatjet e periudhës afatshkurtër në çmimet e karburanteve që përjetojnë në mbarë botën si rezultat i paqëndrueshmërisë së çmimeve të karburanteve të papërpunuar.

Një rritje në çmimet e karburanteve mund të ndikojë si një frenim për përdorimin e automjeteve private, e cila nga ana e vet do të pakësojë nivelet si të ndotjes së ajrit, ashtu dhe rëndimit të trafikut.

Impianti i rafinimit që ka mbetur në Ballsh, aktualisht nuk është në gjendje të prodhojë naftë, e cila do të përmbushë standardet e sqfurit të përcaktuara për 2012. Duke pasur parasysh këtë, kjo uzinë duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve të mëdha në formën e investimeve, pakësimit në veprimtarinë e saj ose mbylljes.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA2.2	Testimi i shkarkimeve të detyrueshme efikase në ajër për të gjitha automjetet rrugore në përputhje me standardet e Komuniteti Europian.	MMPAU MPPTT MB Policia Rrugore	II/2007	IV/2009	150	Shih më poshtë

Kjo masë do të imponojë veprimet e mëposhtme:

- Amendimin e legjislacionit të regjistrimit të automjeteve për të bërë testimin në përputhje me standardet e BE – për të siguruar përputhjen me klauzolat e testimit të shkarkimeve në ajër të Direktivës 1996/96/BE në testimin e automjeteve të përshtatshme për të udhëtuar. Udhëzimet aktuale lejojnë nivele më të larta sesa nivelet e lejueshme nga legjislacioni i BE të shkarkimit të gazeve në natyrë si nga automjetet me benzinë ashtu edhe me naftë. Si nivelet e monoksidit të karbonit për mjetet me motor benzine ashtu dhe nivelet e patejdukshmërisë për mjetet me naftë duhet të ulen.
- Specifikim për pajisjet e kontrollit (testimit) të shkarkimit të gazeve për qendrat e kontrollit të mjeteve – për të siguruar respektimin e legjislacionit të BE
- Ofrimi i trajnimeve për qendrat e kontrollit të automjeteve – Udhëzime dhe këshilla për qendrat e kontrollit të automjeteve të regjistruara në monitorimin e shkarkimeve
- Ndërgjegjësimi i pronarëve të automjeteve - fushatë ndërgjegjësimi për futjen në veprim të regjimit të kontrollit

- Program për kontrollin në anë të rrugës të automjeteve - program i planifikuar nga policia rrugore për kontrollin e automjeteve në anë të rrugës përfshirë kontrollin auditues të qendrave të kontrollit të mjeteve
- Burimet për programin e kontrollit në anë të rrugës – Pajisje dhe trajnime për policinë rrugore

Testimi i automjeteve dhe funksionimi i pajisjeve të monitorimit duhet të jetë vetëfinancues si nga një perspektivë private ashtu edhe në linjë me “parimin që ndotësi paguan”. Tarifat e paguara nga pronarët e makinave për kryerjen e testeve të domosdoshme duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar kostot e shkaktuara nga entiteti i kontrollit (qoftë ai publik apo privat). Megjithatë, përqindja aktuale e tarifës që paguhet për kontrollin e automjetit është e pamjaftueshme për të bërë investimet në pajisjet e domosdoshme. Për këtë arsye janë marrë masa për shpenzimet kapitale për pajisjet e kontrollit, por jo për kostot operationale të cilat duhet të mbulohej nga tarifat që merren për testimin. Vlerësimi i shpenzimeve kapitale bazohet në sigurimin e 45 kompleteve testuese, ku çdo komplet përmban një dinamometër për kontrollin e shkarkimeve të Nox me peshë (përfshirë këtu kompjuterat dhe programet e tyre si dhe trajnimi) dhe një analizues i të pestë gazrave (përfshirë trajnimin).

Privatizimi i funksionit të kontrollit të automjeteve edhe mund të shqyrtohet. Megjithatë kjo do të kërkojë një rritje të qenësishme të nivelit të tarifave që duhen paguar nga pronarët e automjeteve për testim për të mbuluar kostot e investimeve nga sektori privat.

Imponimi i regjimit të revizionuar të kontrollit duhet në vetvete të nxitë pronarët e automjeteve për t'i mbajtur automjetet në gjendje më të mirë me qëllim që të sigurohen që ato janë në gjendje të përputhen me kërkesat e kontrollit. Kjo duhet rritur më tej me një fushatë reklame për pronarët e automjeteve – fletëpalosje, intervale në radio, artikuj në gazetë, intervale për reklama në TV dhe reklama të tjera për të theksuar metodat dhe avantazhet e uljes së nivelit të shkarkimeve nga automjetet në ajër nëpërmjet mirëmbajtjes së përmirësuar të automjetit. Do të sigurohen gjithashtu udhëzime për të gjithë qendrat e regjistruara të shërbimeve në formën e manualëve praktikë për garazhe më të vogla të përjashtuara nga taksat jo për tregti dhe qendrat e shërbimit për masat e thjeshta dhe jo të kushtueshme për përmirësimin e mirëmbajtjes së automjeteve përfshirë konsumin e karburantit dhe shkarkimet e gazeve e tymrave.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA2.3	Masat fiskale për të inkurajuar përdorimin e automjeteve më të reja dhe më efikase	MF MB MPPTT MMPAU	I/2007	IV/2008		

Masat e mëposhtme duhen të fillojnë brenda dy viteve të ardhshme:

- Moslejimi i importimit të tipave të automjeteve për të cilat nuk është lëshuar një certifikatë miratimi nga Komuniteti Europian.
- Rritja e taksës për automjetet e vjetra – Rregullorja e KM vendos nivele më të larta të taksës së regjistrimit për automjetet më të vjetra
- Parapëlqimi i vendosjes së taksës së importit për makinat e reja - Rregullorja e KM vendos nivele më të larta të taksës së importit për automjetet më të vjetra

- Rritja e taksës për makinat më pak efikente - Rregullorja e KM vendos nivele më të larta të taksës së regjistrimit për automjetet që harxhojnë më shumë karburant
- Parapëlqimi i vendosjes së taksës së importit për makina më të pastra - Rregullorja e KM vendos nivele më të larta të taksës së importit për automjetet që kanë efikasitet më të ulët karburanti.

Kufizimet e importit për automjetet e një tipi për të cilin është lëshuar një certifikatë miratimi nga KE, duhen aplikuar jo vetëm për automjetet që udhëtojnë në rrugë por dhe për traktorët dhe makineritë e tjera për të cilat ekziston legjislacioni.

Nivelet e taksave duhen përcaktuar në atë mënyrë që të sigurojnë një frenim real dhe të genëshëm të importit dhe përdorimit të automjeteve të vjetra dhe joefikase.

Kostot e administratës publike për imponimin e këtyre masave janë të vogla, meqenëse ato efektivisht janë një amendament i një sistemi ekzistues të kontrollit, i cili tanimë monitorohet nga administrata. Megjithatë, këto masa do të kenë ndikimet e tyre financiare mbi sektorin publik që zotëron automjete si dhe mbi sektorin privat. Kostot e përdorimit të automjeteve më të vjetra dhe më pak efikase do të shtohen. Pakësimi i këtyre kostove operacionale do të kërkojë investime. Sidoqoftë, nëse investime të tilla janë bërë ashtu siç duhet, kostot pasuese për operatorin e automjeteve do të ulen si pasojë e një mirëmbajtje me kosto më të ulët dhe konsumimit të karburantit e shoqëruar me përdorimin e një automjeti më të ri dhe më efikas.

Publiciteti me këto masa duhet koordinuar me fushatat e përmendura në këtë drejtim të CA2.2 më lart.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA2.4	Zhvillimi i programit të investimeve të transportit publik për zonën kryesore urbane Tirana – Durrës.	Bashkia e Tiranës MF MB MPPTT MMPAU	III/2007	IV/2008	100	

Problemet më të mprehta me ndotjen e ajrit që shkaktohen nga transporti dhe trafiku më i rënduar, hasen në Tiranë. Aktualisht, niveli i sigurimit të transportit publik është i ulët. Për të trajtuar gjendjen aktuale dhe për të parashikuar kërkesat në rritje nga Tirana në Durrës do të kërkojnë një planifikim të vëmendshëm dhe investime masive. Për këtë arsye, është parashikuar të hartohet një program investimesh për transportin publik në vitet 2007 – 2008. Kjo do të ndërmerret duke përdorur ndihmën financiare të jashtme dhe ekspertizën ndërkombëtare. Rezultati i kësaj mase do të jetë një program i hollësishëm investimesh, zhvillimi dhe veprimi për sigurimin e shërbimeve efektive të transportit publik në rajonin Tiranë – Durrës. Këtu duhen marrë parasysh të gjitha mundësitë e disponueshme për sistemet e transportit urban, përfshirë Autobusët, Transportin e Lehtë Hekurudhor, Metronë dhe Transitin e Shpejtë Personal.

Megjithatë ka një numër hapash të cilat mund të ndërmerren menjëherë për të përmirësuar situatën. Në veçanti shërbimi i autobusëve që vepron tanimë nuk është shumë i përhapur dhe përdor automjete të vjetra, shumicës së të cilave u ka mbaruar koha e përdorimit. Blerja e një numri të madh autobusësh të rinj duhet konsideruar si një prioritet. Për këtë investim do të nevojitet gjithashtu një mbështetje investimesh nga jashtë.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA2.5	Administrimi i trafikut të përmirësuar në zonën urbane Tiranë – Durrës	MMPAU MPPTT Bashkia e Tiranës Policia Rrugore	II/2007	III/2008		

Gjendja e trafikut në zonën Tiranë – Durrës është e rënduar nga nivelet e larta të dyndjes dhe nga vështirësitë në lëvizjen e trafikut. Ndërsa kjo është në pjesën më të madhe rezultat i një numri shumë të madh automjesh, gjendja përkeqësohet akoma më shumë nga kushtet e këqija të parkimit dhe mungesat në sistemin e sinjalizimit dhe kontrolli i nyjeve të kontrollit.

Është i nevojshëm dhe zbatimi i kontrollit ndaj sjelljes së shoferëve. Po ashtu, duhet bërë një fushatë për të pakësuar numrin e shkeljeve të rregullave rrugore. Prandaj, propozohet të ndërmerren masa energjike për një vit në veprimtari të tilla si: parkimi i gabuar, mosrespektimi i tabelave sinjalistike të trafikut, shkelja e kufizimeve të shpejtësisë (rrugët me një kalim) dhe mosrespektimi i kufizimeve të dritave të trafikut (kur kthehesh majtas nga korsia e krahut të djathtë).

Po ashtu, masa shoqëruese janë gjithashtu të nevojshme për të përmirësuar infrastrukturën:

- Përditësimi i rrjetit të sinjalistikës
- Shenja të përmirësuara
- Vijëzime rrugore të përmirësuara

Ashtu siç theksohet më poshtë, nevojiten gjithashtu përmirësime në infrastrukturën e fortë për të rregulluar ecurinë e trafikut, siç janë programi i zgjerimit të urave, i cili po ndërmerret aktualisht për të lejuar një kalim më të mirë mbi “lum”

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA2.6	Pakësimi në kërkesat e transportit – planifikim qendrash të shumta urban dhe hapësinore.	MMPAU MPPTT Bashkia e Tiranës Policia Rrugore				

Kjo masë nuk është specifikuar me data ose kosto meqenëse ajo është një politikë në vazhdimësi, e cila do të zbatohet nëpërmjet masave praktike siç janë ato të diskutuara në CA2.5 dhe në seksionin 3.3.7 më poshtë për administrimin e përdorimit të tokës. Veprimi kyç është të sigurohet përfshirja e mjedisit dhe çështjet e transportit në procesin e planifikimit urban. Kjo do të ofrojë veprime mbështetëse të tilla si: sigurimi i udhëzimeve për planifikuesit hapësinorë për kushtet e sigurimit të një transporti të qëndrueshëm mjedisor brenda planeve hapësinore të përpiluara në bazë të ligjeve të reja për planifikimin hapësinor që po përpilohen nga MPPTT.

### CA3 Kontrolli dhe ulja e nivelit të shkarkimit nga impiantet industriale

Shkarkimet nga impiantet industriale janë pakësuar së tepërmi që prej 1990. Megjithatë, shkarkime të rëndësishme shkaktohen ende nga impiantet individuale. Këto impiante dhe impiantet e mëdha të së ardhmes që do të shkaktjnë shkarkime të rëndësishme duhet t'i nënshtrohen masave të kontrollit, të cilat sigurojnë përputhshmëri me standardet e shkarkimeve limit të specifikuar në legjislacionin shqiptar dhe atë të Komunitetit Europian. Megjithatë, uzinat ekzistuese nuk do të jenë në gjendje t'i arrijnë këto standarde në periudhën afatshkurtër. Për këtë arsye, hapi i parë

është të ndërmerret një shqyrtim i lejeve aktuale që aplikohen në këto impiante dhe të negociohen planet e pakësimit të shkarkimeve me operatorët e këtyre impianteve.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA3.1	Impiantet ekzistuese industriale – planet për uljen e nivelit të shkarkimit për impiantet që kanë prioritet në mënyrë që të arrihen norma të qëndrueshme	MMPAU	II/2007	IV/2008	3	1.7

Burimet aktuale të personelit në MMPAU janë të pamjaftueshme për të përmbushur këtë detyrë në një periudhë afatshkurtër. Për pasojë është e domosdoshme të punësohen dy anëtarë të rinj të personelit në këtë Ministri, të cilët do të jenë përgjegjës për dhënien e lejeve për ndërmarrjet industriale. Rroga dhe kostot operative për këta dy nëpunës janë vlerësuar këtu. Gjithashtu duhet theksuar se një strukturë e revizionuar dhe një organizim i personelit për Ministrinë, shqyrtohet në Kapitullin 4.

Procesi i shqyrtimit do të kërkojë një trajtim hap pas hapi:

- Rishikimi i planeve të paraqitura për shqyrtim nga operatorët, në përputhje me vendimin mbi normat e përkohshme – Vendimi kërkon që të gjithë të pajisurit me leje për impiantet ekzistuese të dorëzojnë një program masash për arritjen e normave të përhershme. Lejet e rishikuara në përputhje me planet.
- Zhvillimi i bisedimeve me operatorët, lidhur me ndryshimet e bëra në planet për uljen e nivelit të shkarkimeve – udhëzime specifike mbi kufijtë e nivelit të shkarkimeve në ajër, për industrinë teknikat dhe teknologjitë ekzistuese për çdo sektor. Operatorët e impianteve duhet të udhëzohen kur të përgatisin planet duke u treguar sesi të arrijnë nivele më të ulëta të shkarkimeve në periudha afatshkurtra dhe afatmesme.
- Amendimi i lejeve, në mënyrë që të kërkoen veprime specifike të përcaktuara në plan – Në bazë të planeve të dorëzuara në Ministri, do të caktohen afatet e lejeve që të arrihen standarde më të rrepta të shkarkimeve në ajër – këto janë të ngjashme me “kushtet e përmirësimit” që përmbajnë lejet e PKIN (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes). Kjo do të jetë një nxitje për operatorët e impianteve, për të përmirësuar shkarkimet ose për t’u përballur me mbylljen e tyre. (Neni 7.2 i Ligjit mbi Mbrojtjen e Ajrit)

Ky proces, ka nevojë të theksohet në kohën e duhur për të zbatuar plotësisht masat e Direktivës së IPPC (96/61/EEC):

- Përkthimi në shqip i dokumenteve të Referencës së Teknikave më të Mira Ekzistuese (TME) për pjesën më të madhe të industrive përkatëse – metalurgjikut, çimentos, prodhimit të energjisë termike.
- Hartimi i legjislacionit mbështetës, që do t’i japë fuqi ligjore standardeve - Rregullorja e KM në zbatim të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit për transpozimin(kalimin) e dispozitave kryesore të Direktivës së PKIN
- Ndërtimi i Kapaciteteve administruese – seminare trajnuese në zbatim të TME për industrinë përkatëse

- Rishikimi i lejeve – analiza e hendekut mes niveleve aktuale të shkarkimeve dhe atyre që aplikohen në bazë të legjislacionit të BE dhe niveli i kërkuar për të plotësuar standardet e BE për cilësinë e ajrit. Ky proces do të kërkojë gjithashtu një vlerësim të detajuar të efektit që kanë impiante të caktuara mbi cilësinë e ajrit vendor – kjo do të lehtësohet nga informacioni i monitorimit i referuar në CA1 më lart.
- Zhvillimi i bisedimeve me operatorët për planet e përmirësimit - arritja e marrëveshjes për planet e përmirësimit, e cila do të çojë në zbatimin e teknologjisë dhe në ndryshime në proces, në mënyrë që niveli i shkarkimit të ulet në nivelin e kërkuar
- Vënja në zbatim i lejeve të rishikuara – në përputhje me planet e rena dakord. Lejet ekzistuese duhen ndryshuar në përputhje me kushtet e reja. Pas zbatimit të planeve monitorimi i shkarkimeve duhet të përputhet me lejet e rishikuara.

Këto masa do të imponojnë kosto të kufizuara për administratën publike. Sidoqoftë, do të përballohen nga operatorët e impianteve të cilët shkaktjnë shkarkime të rëndësishme në ajër. Këto kosto nuk mund të shmangen, por madhësia dhe ndikimi i tyre mund të përmirësohen nëpërmjet procesit të bashkëbisedimeve të cilit iu referuam më sipër. Industritë shqiptare janë në një proces tranzicioni dhe kanë nevojë t'u jepen orientime të qarta të cilat do të shërbejnë si masa për rregulloret e ardhshme, në mënyrë që ata të mund të planifikojnë mbi këtë bazë e, për më tepër, atyre duhet t'u lejohet kohë që të bëjnë një kalim në teknologjitë më të pastra.

#### ***CA4 Kontrolli dhe ulja e nivelit të pluhurit që krijohet nga ndërtimet***

Ndonëse “shkarkimet” nga punimet e ndërtimit nuk monitorohen drejtë për drejtë e për pasojë sasi e tyre nuk mund të përcaktohet, përgjithësisht pranohet që shkarkimet e pluhurit dhe të grimcave nga punime të tilla kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në ndotjen e ajrit në zonat urbane. Do të ishte e papërshtatshme të caktoheshin limite shkarkimi për kantiere të tilla, meqenëse shkarkimet shkaktohen në një mënyrë të përhapur. Prandaj është më e përshtatshme të krijohen dhe zbatohen standarde për veprimtarinë e kantierëve të tilla, në formën e praktikës, i cili specifikon masat që duhen marrë për të minimizuar shpërndarjen dhe krijimin e pluhurit.

Ref.	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shp. Kap.	Shp. Op.
CA4.1	Futja dhe imponimi në praktikë i kodit të industrisë së ndërtimit	MMPAU MPPTT Industria e Ndërtimit	III/2007	IV/2008	4	5

Përgatitja dhe hartimi i një kodi të praktikës do të kërkojë:

- Krijimin e grupit të punës për hartimin e kodit të praktikës;
- Përgatitjen e kodit të praktikës për industrinë e ndërtimit në fushën e punëve publike
- Konsultim dhe publikim.

Spektori publik duhet “të udhëheqë duke dhënë shembull”. Për pasojë, të gjitha kontratat e reja të punimeve publike duhet t'u nënshtrohen kërkesave të administrimit, menaxhimit mjedisor, përfshirë përputhjen me kodin e praktikës. Kjo do të mbështetet nga futja e legjislacionit që do të kërkojë që kodi i praktikës të përfshihet në kushtet e kontratës të punimeve publike.

Futja e kodit të praktikës nuk do të jetë efikas nëse nuk do të ndërmerren masa praktike për të monitoruar zbatimin e kërkesave të kodit. Për pasojë, do të nevojitet një fushatë informacioni e përqendruar në industrinë e ndërtimit e cila ka nevojë të përforcohet nëpërmjet inspektimit të kantierëve të ndërtimit nga autoritetet vendore dhe “policia ndërtimore”.



Kostoja e administratës publike për përgatitjen dhe koston e praktikës janë vlerësuar. Gjithashtu është supozuar se do të duhen kosto shtojcë për inspektimin e veprimeve ndërtimore dhe këto janë prezantuar si shpenzime operative. Kostot, për vetë industrinë e ndërtimit nuk janë vlerësuar, megjithatë duke u nisur nga fakti që masat që do të përdoren nuk do të kërkojnë përdorimin e pajisjeve të sofistikuar ose të shtrenjta, nuk ka gjasa që kostot e industrisë do të jenë të rëndësishme në lidhje me koston e përgjithshme operative të industrisë.

### ***CA5 Kontrolli dhe ulja e nivelit të pluhurit nga burimet e tjera***

Shkarkimet e pluhurit shkaktohen gjithashtu nga transporti rrugor si pasojë e kushteve të këqija të rrugëve ose nga pastrimi i papërshtatshëm i tyre. Zgjidhja e këtyre çështjeve kërkon investime më të mëdha si në fushën e ndërtimit, ashtu dhe në atë të mirëmbajtjes së rrugëve në linjë me Planin Kombëtar të Transportit. Gjithashtu mbështeten masat që gjenden në planin për përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve.

Shkarkimet shkaktohen gjithashtu nga pajisjet joindustriale siç janë pajisjet e djegjes së drurit apo qymyrit në ambientet shtëpijake. Këto shkarkime mund të rregullohen nëpërmjet përdorimit të sistemit të lejeve që përdoren për ambientet industriale. Përdoruesit shtëpiakë dhe të tregëtisë së vogël, duhen inkurajuar të rrisin në maksimum efikasitetin e pajisjeve ngrohëse si psh: nëpërmjet përmirësimit të izolimit të ndërtesave. Masat lidhur me efikasitetin e energjisë janë diskutuar edhe në seksionin e ndryshimeve klimatike.

Shkarkimet e tymrave shkaktohen gjithashtu nga veprimtaritë informale siç janë djegia e mbetjeve. Kontrolli i këtyre është trajtuar në seksionin e menaxhimit të mbetjeve.

### **3.3.2 Ndryshimi i Klimës**

*Ulja e nivelit të çlirimit në atmosferë të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozon-holluese me qëllim që të kontribuohet në parandalimin e ndryshimit të klimës.*

Çlirimi i gazeve të efektit serrë në natyrë ndodh si pasojë e shumë aktiviteteve. Prandaj, instrumenti më i fuqishëm për pakësimin e sasisë së gazeve që çlirohen, është integrimi i objektivit të pakësimit të gazeve të efektit serrë në proceset e vendimmarrjes në një sërë nivelesh:

- Qeveria – në veçanti strategjitë për energjinë, ekonominë dhe transportin duhet të përfshijnë hapa për të kufizuar çlirimin e gazeve në ajër;
- Industria dhe Tregtia – duhet të nxiten që të jenë efikase nga pikëpamja e energjisë dhe të ulin nivelin e çlirimeve në ajër;
- Individët – duhet të binden që ta shohin efikasitetin e energjisë si kriter në veprimet dhe investimet e tyre.

Që të kryhet integrimi, problemi i ngrohjes globale duhet pranuar më gjerë dhe kuptuar më drejt duke përfshirë mundësinë e shfrytëzimit të informacionit dhe marrjes së këshillave. Edhe me këto ndryshime, ka mundësi të ndihet nevoja për stimuj ekonomikë apo rregullatorë përpara se organizatat apo individët të ndryshojnë sjelljen e tyre. Strukturat institucionale janë ngritur tanimë për të trajtuar ndryshimet e klimës, përfshirë:

- Qendra e Efikasitetit të Energjisë në Shqipëri (krijuar 1995) – në vartësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë;
- Njësia e Ndryshimeve Klimatike – në vartësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Tanimë këto institucione kanë ndërmarrë shumë projekte, por roli dhe funksioni i tyre ka nevojë të forcohet. Kjo do të kërkojë përfundimin e masave ligjore, të cilat tanimë janë prezantuar; siç janë

Ligji i Efikasitetit të Energjisë, Aplikimi i Instrumenteve Ekonomikë dhe Masat e Rritjes së Ndërgjegjësimit.

Gjithashtu, qeveria duhet të udhëheqë duke dhënë shembullin e para me praktikën e saj të veprimit. Prandaj, propozohet që mendimet e ndryshme lidhur me efikasitetin e energjisë të integrohen në politikat e prokurimit dhe administrimit të institucioneve qeveritare. Në mënyrë të veçantë, duhet të caktohen nivele minimale për sa i përket efikasitetit të energjisë si kriter për prokurimin e pajisjeve që do të përdoren në institucionet shtetërore. Përveç kësaj, do të realizohet një program për auditimin e shfrytëzimit të energjisë në institucionet shtetërore, në mënyrë që të konstatohen veprimet që mund të ndërmerren për të përmirësuar modelet ekzistuese për përdorimin e energjisë.

Efikasiteti i energjisë do të përfshihet gjithashtu në kriterin e zbatuar gjatë procesit të rishikimit të lejeve për impiantet e kontrolluara. Në bisedimet për kushtet e lejeve të rishikuara për industri të mëdha në veçanti, autoritetet rregullatore do të përpiqen të arrijnë të bëjnë përmirësime në administrimin e energjisë nëpërmjet shfrytëzimit të teknikave për auditimin e konsumit të energjisë.

Megjithatë, këto masa do të mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të aktiviteteve që shkaktojnë çlirim dhe gazeve të efektit serrë. Si rrjedhim, del nevoja e një fushate më të gjerë ndërgjegjësimi dhe për sigurimin e informacionit lidhur me alternativat dhe masat. Kjo fushatë duhet të përmbajë një sërë elementesh të synuar, të cilët përqendrohen në segmente të veçantë të ekonomisë dhe përdorimet e energjisë. Qendra aktuale e Efikasitetit të Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë do të jetë përgjegjëse për ndërmarrjen e kësaj fushate për dhënien e këshillave dhe ekspertizës për të gjithë sektorët e ekonomisë, lidhur me efikasitetin dhe administrimin e energjisë në bashkëpunim me njësinë e Ndryshimeve Klimatike në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Është e nevojshme që këto masa të shoqërohen me instrumente ekonomike nëse kërkohet që të kenë efekt. Masat e mëposhtme janë specifikuar në mënyrë të veçantë:

- Vendosja e një Takse për Karbonin, të ardhurat e së cilës do t'i shkojnë Fondit të Mjedisit (shih Kapitullin 5);
- Fushatë e vazhdueshme për uljen e numrit të lidhjeve të parregullta në sistemin e furnizimit me energji elektrike (nëse konsumatorët nuk paguajnë nuk mund të ketë stimul financiar për të ulur konsumin e energjisë);
- Hartimi dhe botimi i një Strategjie Afatgjatë për Vendosjen e Çmimeve që tregon prirjen e mundshme në çmimet e energjisë në periudhën afatmesme – kjo do të botohet që konsumatorët të ndihmohen që të kuptojnë përfitimet e mundshme në të ardhmen, të investimit në pajisje dhe praktika që nuk konsumojnë shumë energji dhe të zhdukë subvencionet e ndërthurura që ekzistojnë midis sektorit jofamiljar dhe atij familjar.
- Fondi i Efikasitetit të Energjisë – Ky do të jetë një program grant i vogël dhe i mesëm që përdor të ardhurat nga Taksa e Karbonit në Fondin e Mjedisit – projektet do të gjykojnë duke përdorur këshillat që jep Qendra për Efikasitetin e Energjisë.

Realizimit të zotimeve që ka marrë Shqipëria ndaj të dyja Konventave duhet t'i kushtohen burime të mjaftueshme. Do të duhet të zbatohen rekomandimet e projektit në vazhdim për vlerësimin e kapacitetit për zbatimin e konventave të KB-së. Gjithashtu, administrimi i përbashkët i të dy Konventave nga një njësi e vetme, ka të ngjarë të ketë disa avantazhe për efikasitetin e punës së njësisë. Për shembull, pajisjet frigoriferike përbëjnë një çështje shqetësuese në të dyja rastet. Si e

tillë, do të ndërmerret një vlerësim i shkurtër i administrimit të Konventës së Vjenës i ngjashëm me vlerësimin e PZHKB FGM për Konventat e tjera të BE-së.

Ka një sërë masash të veçanta, sikurse janë ato të specifikuara për uljen e nivelit të ndotjes së ajrit të ambientit, që do të kontribuojnë në realizimin e objektivit për uljen e sasisë së gazit të çliruar. Këto jepen të renditura në tabelën e mëposhtme.

### NK1 Minimizimi i shkarkimit të gazeve të efektit serrë

Metoda e kontrollit të shkarkimit të gazeve të efektit serrë përfshin tre elemente kyç:

- Legjislacionin
- Stimujt
- Informacionin dhe komunikimin

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap. <sup>46</sup>	Shpenz. Op. <sup>47</sup>
NK1.1	Zhvillimi in jë bazë të fortë ligjore për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë	Min. Ekon. Treg. Energjisë MPPT Instituti i Standardeve	II/2007	IV/2009		1.3

Baza Ligjore duhet që mbështetet në Ligjin e Ri të Efikasitetit të miratuar kohët e fundit përfshin:

- Legjislacioni përcakton standarde minimum për efikasitetin e energjisë së ndërtesave të reja – legjislacioni sekondar në vijim të Ligjit të Kursimit të Energjisë në Ndërtesat Private dhe Publike<sup>48</sup>
- Legjislacioni kërkon të certifikohet dhe të botohet efikasiteti i pajisjeve për të gjitha grupet e mëdha të pajisjeve shtëpiake – legjislacioni sekondar në vijim të Ligjit të Efikasitetit të Energjisë<sup>49</sup>
- Legjislacioni kërkon etiketimin e efikasitetit të energjisë nga zyra e pajisjeve (Programi i Energjisë) – legjislacioni sekondar në vijim të Ligjit të Efikasitetit të Energjisë
- Amendim i ligjit mbi lejimin e impianteve të kontrolluara (Ligji i Mbrojtjes së Mjedisit) për të lejuar imponimin e kushteve të efikasitetit të Energjisë në lejet mjedisore
- Vendimi i KM që përcakton kërkesat e efikasitetit të energjisë si një kriter brenda praktikave të prokurimeve të administratës publike

<sup>46</sup> Në miliona Lek

<sup>47</sup> Në Milion Lek

<sup>48</sup> Zbatimi i Direktivës 2002/91/KE së Parlamentit European dhe e Këshillit i 16 Dhjetorit 2002 mbi ecurine e energjisë në ndërtesa (OJ L1, 4.1.2003, fq. 65-70)

<sup>49</sup> Masat e zbatimit të skemave të etiketimit të Komunitetit European siç është Direktiva e Komisionit 2003/66/KE e 3 qershorit 2003 që amendon Direktivën 94/2/KE, e cila zbaton Direktivën e Këshillit 92/75/EEC lidhur me etiketimin e energjisë në frigoriferët elektrikë shtëpiake, ngrirësve dhe kombinimeve të tyre, duhet theksuar se direktivat e tjera janë në fuqi lidhur me pajisjet e tjera përfshirë sobat, kondicionerët, llampat etj. – për një listë më të plotë referojuni: [http://ec.europa.eu/energy/demand/legislation/domestic\\_en.htm](http://ec.europa.eu/energy/demand/legislation/domestic_en.htm)

Do të nevojitet kapacitet ligjor shtojcë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë për të ndërmarrë këtë punë. Këtu rekomandohen 2 punonjës të tjerë të personelit me kohë të plotë

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
NK1.2	Vendosja e Stimujve për efikasitet energjie	Min. Ekon. Treg. Energj. Qendra e Efikasitetit të Energjisë <b>MMPAU</b>	II/2007	IV/2009	37	1.3

Stimujt ekonomikë që duhen futur janë:

- Vendosja e një takse të Karbonit, të ardhurat e të cilës do të kalojnë në Fondin e Mjedisit
- Krijimi i një skeme të grantit të Efikasitetit të Energjisë brenda Fondit të Mjedisit për të mbështetur projektet e vogla dhe të mesme
- Fushatë e vazhdueshme për rregullimin e lidhjeve joformale në rrjetin e furnizimit me energji elektrike
- Shqyrtim i politikave të caktimit të çmimit të energjisë dhe politikave duke pasur parasysh zhvillimin e një politike të stimujve të bazuar mbi çmimin, që çrrenjos subvencionet e ndërthurura aktuale, duke filluar me konsumatorët jo-shtëpiakë deri tek ata shtëpiakë – një heqje e tillë e subvencioneve të ndërthurura do të kërkojë gjithashtu vendosjen e një “rrjeti të sigurt” për të mbrojtur familjet më të varfra nga rritja e çmimeve të elektriciteti për familjarët, që do të ndodhë
- Botimi i parashikimeve afatmesme dhe afatgjata për çmimet e energjisë dhe këshillim për gjithë sektorët lidhur me efikasitetin e energjisë – fillimi i dokumentit për punën e Qendrës së Efikasitetit të Energjisë

Përveç kësaj duhet të realizohet në faza një program auditimi për energjinë për institucionet qeveritare duke u marrë së pari me konsumatorët më të mëdhenj.

Kostot administrative për administratën publike për këto masa janë vlerësuar këtu. Megjithatë, koston kryesore për këto masa do të përballohet nga ekonomia. . Rritja e çmimit të energjisë, taksat shtojcë si dhe rregullimi i lidhjeve elektrike, të gjitha këto do t'i shtojnë kostot që do të përballohen nga publiku dhe privatët për energji. Kjo do të ketë një ndikim negativ mbi ritmet e zhvillimit ekonomik, por është një kusht paraprak për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe për zbatimin e parimit: “*ndotësi paguan*”.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
NK1.3	Pakësimi i shkarkimeve të gazit të efektit serrë nga sektori i Industrisë	ME,Treg. Ener.. MMPAU Qendra e Efikasitetit të Energjisë	II/2007	IV/2009	4	

Masat kryesore që kërkohen për periudhën afatshkurtër janë:

- Përfshirja e efikasitetit dhe masat e auditimit të energjisë në lejet e rishqyrtuara për impiantet e kontrolluara

- Fushata për të promovuar efikasitetin e energjisë në industri duke ndjekur punën e ndërmarrë tanimë nga Qendra e Efikasitetit të Energjisë përfshirë: :
  - o Përdorimi i kaldajave më efikase;
  - o Përdorimi i motorëve elektrikë efikasë;
  - o Përdorimi efikas i ndriçimit.

Në këtë dokument janë vlerësuar kostot administrative të këtyre masave për administratën publike. Procesi i shqyrtimit të lejeve do të ndërmerret nga MMPAU – burime shtojcë tanimë janë i alokuar seksionit të cilësisë së ajrit, me qëllim shqyrtimin e lejeve. Kostoja kapitale është e shoqëruar me ndërmarrjen e fushatës përfshirë edhe botimin e një njoftimi këshillimor. Megjithatë, kostot kryesore të këtyre masave do të përballohen nga sektori industrial . Ka gjasa që procesi i bërjes më efikas në energji, do të kërkojë fillimisht një barrë investimesh nga ana e industrisë, por me kalimin e kohës këto investime do të jenë me një kosto operative më të ulët e, për pasojë do të jenë të dobishme nga ana ekonomike

#### Fushatat e Efikasitetit të Energjisë

Përveç stimujve ekonomikë, është vendimtare që njerëzve dhe biznesit t'i sigurohet informacioni, këshillimi dhe inkurajimi për të zbatuar masat e duhura në drejtim të efikasitetit të energjisë. Synohet që të ndërmerren një sërë fushatash për të informuar, edukuar dhe ndihmuar përdoruesit shtëpiakë dhe tregtarë që të marrin vendime të informuara për përdorimin e energjisë së tyre. Duke u nisur nga projekti i kohëve të fundit i financuar nga USAID/ASE organizuar nga Qendra e Efikasitetit të Energjisë, e cila përfshinte edhe një Fushatë Ndërgjegjësimi Publik për Përfitimet nga Izolimi Termik i Ndërtesave, janë planifikuar edhe fushata të tjera.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
NK1.4	Fushata për të inkurajuar blerjen e pajisjeve efikase në energji (e parashikuar të përputhet në të njëjtën kohë me kërkesat për etiketimin)	M.Ek.Treg.Energj. MMPAU Qendra e Efikasitetit të Energjisë	II/2007	II/2008	12.5	
NK1.5	Fushata e dytë për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm familjar përfshirë ndriçim efikas, sisteme kontrolli për pajisjet ngrohëse dhe ftohëse - kosto mesatare	M.Ek.Treg.Energj. MMPAU Qendra e Efikasitetit të Energjisë	III/2009	IV/2010	12.5	
NK1.6	Fushatë për të nxitur përdorimin e sistemit të ngrohjes së ujit me solar në shtëpi dhe në Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme	M.Ek.Treg.Energj. MMPAU Qendra e Efikasitetit të Energjisë	I/2011	IV/2012	12.5	

#### Sektorët Specifikë

Kontributi i sektorit të transportit në shkarkimin e gazeve të efektit serrë është i rëndësishëm dhe sa vjen e po shtohet. Një sërë masash, që kanë lidhje me sektorin e transportit janë përfshirë në seksionin e cilësisë së ajrit më sipër. Ato do të ndihmojnë në minimizimin e shkarkimeve të gazeve të efektit serrë nga transporti.

Niveli i tanishëm i shkarkimeve nga sektori i transformimit të energjisë është i ulët si pasojë e mbështetjes tek energjia hidro-elektrike. Megjithatë, niveli aktual i kapaciteteve prodhuese është i pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat aktuale. Kjo ka çuar në ndërprerje të energjisë vitet e fundit. Përgjigja ndaj këtyre ndërprerjeve të energjisë ka qenë përdorimi i madh i gjeneratorëve me naftë ose benzinë, të cilët e ndotin atmosferën dhe ndihmojnë në ngarkesën totale të shkarkimit të gazeve të efektit serrë. Synohet që të instalohen impiante të prodhimit të kapaciteteve termale të energjisë. Kjo masë mbështetet nga kjo strategji, meqenëse ajo do të shpjerë në një pakësim të përgjithshëm të shkarkimeve të gazeve në ajër. Sidoqoftë, do të jetë gjithashtu e rëndësishme të vazhdohet të kërkohen burime të reja të energjisë së ripërtëritshme për sigurimin e kapaciteteve prodhuese. Në veçanti puna e Qendrës së Efikasitetit të Energjisë, po jep mbështetje për skemën e hidrocentraleve të vegjël (fondi i KfW për të mbështetur investime private në skemat e hidrocentraleve) dhe shfrytëzimi i energjisë diellore për ngrohje (projekti i PNUD-GEF-it për ngrohjen e ujit me panele diellore) ka nevojë të vazhdojë dhe të përforcohet.

Për këtë arsye propozohet që Qendra e Efikasitetit të Energjisë të përforcohet me një personel shtojcë prej 3 vetash.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
NK1.6	Përforcim i rolit të Qendrës së Efikasitetit të Energjisë	M Ek.Treg.Energj. Qendra e Efikasitetit të Energjisë	II/2007	IV/2009	1	1.8

Përveç çliruesve të gazeve të efektit serrë, po ashtu gropat e qymyrit të drurit duhen marrë parasysh veçanërisht në pylltari. Përforcimi i sektorit të pyjeve dhe masat për të shtuar sipërfaqet e mbuluara me pyje, cilësinë e pyjeve dhe rimbjelljet janë identifikuar në Strategjinë e Pyjeve të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Strategjia përfshin pakësimin e shkarkimeve të gazeve të efektit serrë si një objektivi. Shërbimi pyjor do të vazhdojë të sigurojë udhëheqjen në drejtim të plotësimit të objektivave të shkarkimeve për autoritetet që përgatisin Plani e Administrimit të Pyjeve. Siç u tha edhe më lart, vendosja e një Takse të Karbonit do të sjellë të ardhura për Fondin e Mjedisit, i cili mund të përdoret për të siguruar mbështetje shtojcë për mbjelljen e drurëve të rinj. Po ashtu duhet theksuar se masa janë marrë edhe në seksionet e tokës dhe biodiversitetit të kësaj strategjie lidhur me administrimin e pyjeve.

Veprimtaritë bujqësore mund të shkaktojnë gjithashtu shkarkime të gazeve të efektit serrë dhe mund të shërbejnë për të absorbuar karbonin nga atmosfera. MMPAU do të bashkëpunojë me Ministrinë e Bujqësisë për të përfshirë këshillimin e pakësimeve të shkarkimeve të gazeve në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore dhe masat e programeve të shoqëruara me subvencione përfshirë masat për:

- Administrim më i mirë i kullotave dhe vlerësimi i intensitetit të ngarkesës së numrit të krerëve për njësi të sipërfaqes;
- Përmirësim i tretshmërisë së ushqimit për ripërtypësit.

NK2 Administrim dhe pakësim i shkarkimeve të lëndëve ozon-holluese në përputhje me klauzolat e Konventës së Vienës dhe instrumentet e saj shoqëruar.

Tre veprimet kryesore, të cilët duhen ndërmarrë për të siguruar zbatimin e këtyre zotimeve janë:

- Përmirësim i Bazës Ligjore;
- Sigurimi i kapacitetit administrativ;
- Program i masave për të pakësuar shkarkimet nga gjithë burimet.

Përmirësimi i bazës ligjore do të kërkojë:

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
NK2.1	Vendimi i Këshillit të Ministrave për ratifikimin e amendimeve të Konventës së Vjenës – Projekt Ligji - “Mbi ratifikimin e amendimeve të Londrës, Kopenhagës dhe Pekinit për mbrojtjen e shtresës së ozonit në kuadrin e Protokollit të Montrealit “Për Zhvendosjen e lëndëve ozon-holluese””	MMPAU Këshilli i Ministrave	II/2007	III/2008		
NK2.2	Vendimi i Këshillit të ministrave për imponimin e kufizimeve për importin e prodhimeve që përmbajnë lëndë ozon-holluese	MMPAU M Ek.Treg. Energj.	II/2007	III/2008		
NK2.3	Vendimi i Këshillit të Ministrave për specifikimin e kërkesave për hedhjen e prodhimeve të mbetjeve që përmbajnë lëndë ozon-holluese	MMPAU M Ek. Treg. Energj. MPPTT	II/2007	III/2008		

Kostot administrative për përgatitjen dhe institucionalizimit të legjislacionit duhet të përballohen nga administrata ekzistuese si pjesë e një zotimi në vazhdimësi të administratës për transpozimin e legjislacionit të BE<sup>së</sup>. Megjithatë, duhet të theksohet se masat do të kenë një ndikim ekonomik, i cili në përgjithësi do të rezultojë në një rritje në çmimet e prodhimeve dhe në kostot e hedhjes së mbetjeve.

Sigurimi i kapacitetit administrativ për zbatim do të detyrojë riprodhimin e kapaciteteve të nevojshme për vetëvlerësim të ndërmarrë për konventat e tjera të OKB: Vëmendje do t’i kushtohet krijimit të një administrate/njësi teknike të përbashkët e vetme për zbatimin e konventave të Vjenës dhe të UNFCCC.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
NK 2.4	Krijimi i një administrate të përbashkët/njësi teknike për konventat e Vjenës dhe të UNFCCC.	MMPAU	II/2008	II/2009	8	4

Parashikimet janë bërë për krijimin e një njësie prej 7 vetash. Kostot përfshijnë ato të shoqëruara me krijimin e një njësie të vaçantë. Megjithatë, nëse Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave do t’i sigurohet një sektor shtojcë, kjo kosto do të përfshihet në kostot e këtij sektori.

Pakësimi i shkarkime nga të gjithë burimet.

Veprimi i parë i njësisë do të jetë të përditësojë programin Kombëtar për heqjen e lëndëve ozon-holluese në përputhje me kërkesat e Konventës së Vjenës dhe Protokollit të Montrealit. Kostot e programit, aktualisht nuk mund të vlerësohen. Megjithatë, duhet theksuar se masat do të përfshihen në seksionin e administrimit të mbetjeve, në mënyrë që të sigurohemi për faktin që do të mundësojmë një depozitim të sigurt të mbetjeve që përmbajnë lëndë ozon-holluese.

### **3.3.3 Administrimi i Mbetjeve**

*Përmirësimi i administrimit të mbetjeve me qëllim që të pakësohen rreziqet ndaj shëndetit të njeriut, mjedisit dhe biznesit duke përmbushur kërkesat e BE*

Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel shumë të ulët. Megjithëse nivelet e gjenerimit të mbetjeve janë nën mesataren, sistemet e grumbullimit dhe hedhjes në vendin e caktuar janë ende të dobëta dhe, si rrjedhim, dëmi mjedisor që rezulton nga kontrolli i dobët i këtyre sistemeve është relativisht i lartë. Niveli aktual i riciklimit është shumë i ulët.

Ndryshimi i situatës do të kërkojë shumë kohë, përpjekje dhe investime. Një ndërmarrje e tillë duhet të planifikohet mirë në nivelet vendore, rajonale dhe kombëtare. Prandaj fokusi kryesor i synimeve të shpejta/aft-shkurtra për këtë sektor është zbatimi i një sistemi planifikues të thjeshtë por efikas. Këto plane do të identifikojnë nevojat afatshkurtra dhe afat-mesme për investime dhe mbështetje. Më pas këto mund të formulohen në projekte që do të financohen nëpërmjet sektorit të projekteve të burimeve të Fondit të Mjedisit. Synimet afatshkurtra të identifikuar për mbetjet përqendrohen në aspektet e nevojshme për të mbështetur investimet në lidhje me alternativat e mundshme për vendin e grumbullimit të mbetjeve në të ardhmen.

Duke marrë parasysh nivelin e punës që kërkohet për të arritur standardet e Komunitetit Europian, procesi i planifikimit është ndarë në dy faza. Faza e parë përfshin përgatitjen e planeve vendore dhe rajonale për t'iu përgjigjur nevojave afatshkurtra dhe afatgjata. Respektimi i plotë i legjislacionit të Komunitetit Europian nuk do të jetë i mundur në këtë fazë të parë. Kjo fazë e parë do të sigurojë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për fazën e dytë e cila do të nisët nga një Plan Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve. Ky Plan Kombëtar do të krijojë bazën e nevojshme për një version të dytë të planeve vendore dhe rajonale. Ky version, do të çojë detyrimisht në zbatimin e plotë të legjislacionit të Komunitetit Europian lidhur me administrimin e mbetjeve. Procesi i zhvillimit të planeve për administrimin e mbetjeve është ndarë në tri faza ku secila fazë përfshin 4 rajone. Rajoni i Korçës tashmë po e zhvillon një plan të tillë me ndihmën e projektit SIDA për administrimin e mbetjeve.

Megjithatë, nuk mjafton vetëm që autoriteteve vendore t'u kërkohej me ngulm hartimi i planeve. Autoriteteve vendore duhet t'u ofrohen udhëzime, standarde të përshtatshme (për grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve), projekte të standardizuara si dhe mbështetje teknike në mënyrë që ato të marrin masa që planet të jenë të një cilësie të pranueshme dhe që rezultatet e tyre të jenë të krahasueshme. Puna që ka ndërmarrë aktualisht projekti i administrimit të mbetjeve në Korçë financuar nga SIDA, do të sigurojë bazën e kësaj mbështetjeje të nevojshme.

Realizimi i planeve do të kërkojë që identifikimi i detyrave prioritare të kryhet nëpërmjet mekanizmit të projekteve. Zbatimi i projektit do të kryhet në 4 faza. Faza e parë do të konsistojë në zbatimin e projekteve ekzistuese prioritare për të cilat janë bërë përgatitjet e nevojshme sipas një standardi të pranueshëm. Më pas, projektet do të identifikohen mbi bazën e rezultatit në realizimin e planeve për administrimin e mbetjeve, të zhvilluar në nivel vendor dhe rajonal.

Për momentin, legjislacioni i Komunitetit Europian përqendrohet në zbatimin e rreptë të hierarkisë<sup>1</sup> së mbetjeve dhe ndryshimin e metodës së punës që ndiqet, sipas së cilës fusha e grumbullimit të mbetjeve është vendi i vetëm ku duhet të përfundojnë plehrat. Edhe pse objektivi afatgjatë i kësaj strategjie duhet të jetë përmbushja e këtyre kërkesave, në periudhën afat-shkurtër - afat-mesme, kërkohet një zgjidhje pragmatike dhe me kosto më të ulët. Në këtë mënyrë rekomandohet që për periudhën deri në 2020, ndërtimi i fushave të grumbullimit të mbetjeve do të jetë metoda kryesore

---

<sup>1</sup> Reduktim, Ripërdorim, Riciklim, Asgjësim pa rrezik – sipas preferencës



për grumbullimin e mbetjeve urbane. Gjatë kësaj kohe do të duhet të hartohen dhe zbatohen plane për të pakësuar deri në një minimum të mundshëm, sasinë e mbetjeve që duhet të hidhen, si dhe të mendohet për mënyra alternative të depozitimit të mbetjeve. Kjo çështje do të zgjidhet nëpërmjet Planit të dytë Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta (plani i parë është përgatitur në 1996). Ashtu siç thuhet edhe më sipër, ky plan i dytë do të formojë më pas kuadrin e nevojshëm për përmirësime dhe ndryshime në planet vendore dhe rajonale.

Gjithashtu është e rëndësishme që të aplikohet një metodë realiste në përcaktimin e standardeve të vendgrumbullimeve, të përshtatshme për kushtet e Shqipërisë. Edhe pse ndërtimi i këtyre vendgrumbullimeve moderne të pajisur plotësisht dhe me të gjitha mjetet e duhura dhe më moderne të Europës (si për shembull sistemet e përpunimit me anë të riciklimit, sistemet e trajtimit, sistemet e grumbullimit të gazeve dhe prodhimi i bio-energjisë prej tyre) mund të arrihet të realizohet në një numër të vogël zonash që janë pranë zonave të mëdha urbane, projekte të tilla nuk do të jenë realiste në zonat e largëta dhe me dendësi të vogël të popullsisë. Propozimet e mëparshme kanë sugjeruar ndërtimin e pesë vendgrumbullimeve të mëdha për të gjithë Shqipërinë. Megjithatë, duke marrë parasysh gjendjen aktuale të infrastrukturës së transportit në Shqipëri nuk është e mundshme që mbetjet e zonave të largëta të transportohen në distanca të mëdha. Kështu, këto pesë vendgrumbullime të mëdha do të duhet të mbështeten nga një numër më i vogël vendgrumbullimesh që do të jenë në shërbim të këtyre zonave të largëta. Nuk do të jetë praktike që të zbatohet e njëjta shkallë automatizimi për vendgrumbullimet e vogla, sikurse ajo për pikat e mëdha të grumbullimit. Prandaj, rekomandohet që për ndërtimin e vendgrumbullimeve më të vogla, të përdoret një standard praktik. Kjo, për shembull, do të përfshinte aplikimin e sistemeve të trajtimit ekstensiv (sikurse janë ligatinat artificiale) për përmirësimin e rrjedhjeve të këtyre vendgrumbullimeve të mbetjeve.

Përveç zhvillimit të sistemeve dhe pajisjeve e lehtësirave për grumbullimin e mbetjeve të prodhuara në 15 vitet e ardhshme, autoritetet vendore do t'u kërkohet që të përfshijnë në planet e administrimit të mbetjeve, projekte për të pastruar vendet e paautorizuara për hedhjen e mbetjeve dhe për të marrë masa për riparimin e vendeve të autorizuara. Por kjo çështje kërkon edhe asistencë teknike, për të evituar gabimet e mundshme.

Mbetjet e rrezikshme përbëjnë një problem të veçantë dhe që duhet zgjidhur në rang kombëtar. Projektet ekzistuese për sa i përket fushës së grumbullimit apo groposjes së Mbetjeve të Rrezikshme duhet të përfundohen urgjentisht. Paralelisht dhe mundësisht sa më shpejt që të jetë e mundur, duhet të miratohet Projekt-Strategjia për Mbetjet e Rrezikshme si fazë e parë e planifikimit të Administrimit të Mbetjeve të Rrezikshme. Në periudhën afatmesme kjo do të shndërrohet më tej në një Plan të plotë Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme. Duke patur parasysh ngarkesën e punës që kërkohet për këtë, rekomandohet të përdoret një metodë e ndarë në faza, në mënyrë që kategori të veçanta mbetjesh si mbetjet vajore, mbetjet klinike, mbetjet industriale, mbetjet nga serviset dhe pikat e çmontimit të automjeteve, mbetjet nga rehabilitimi i tokave të ndotura, mbetjet nga ndërtimet, mbetjet nga aktivitetet bujqësore, blegtorale e agro-industriale dhe mbetjet familjare të trajtohen si komponentë të Planit.

Përprojeket e fundit për ndërtimin e një vend-grumbullimi të mbetjeve të rrezikshme rezultuan të pasuksesshme. Prandaj duhet të tentohet për të gjetur ndonjë mundësi alternative.

Zbatimi i hierarkisë së mbetjeve është gjithashtu thelbësor për qëndrueshmërinë e administrimit të mbetjeve në Shqipëri. Në praktikë, kjo do të kërkojë një nivel shumë më të lartë të organizimit duke përfshirë edhe dispozita për kthimin e produktit për ripërdorim apo riciklim (siç kërkohet edhe nga Direktiva e Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike për Mbetjet – 2002/96/BE), përzgjedhja e mbetjeve në burim dhe pranimi i standardeve të produktit për materialet që vijnë nga mbetjet e ripërpunuara (siç është, për shembull, përdorimi i mbetjeve të copëtuara nga prishja e ndërtimeve për të shtruar

bazamentin e rrugëve). Suksesi i sistemeve të tillë, varet gjerësisht nga sjellja e individëve dhe kompanive, që nga ana tjetër ndikohet nga mënyra se si e kuptojnë ata dëmin e krijuar nga administrimi i dobët i mbetjeve dhe nga mundësitë që ekzistojnë për t'i ndryshuar mbetjet dhe për t'i shndërruar ato nga të dëmshme në të dobishme.

Si rrjedhim, një nga masat e menjëhershme që duhet të merret është zhvillimi i një fushate të koordinuar të ndërgjegjësimit. Fushata do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit në përgjithësi, për pasojat e hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve si dhe për djegien e mbetjeve në vende të hapura, duke rrezikuar shëndetin por dhe duke pakësuar mundësitë për zhvillimin ekonomik si për shembull zhvillimin e turizmit. Një aspekt tjetër i fushatës do të përqendrohet në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes së popullatës, në zonat dhe në momentin që do të instalohen pajisjet e reja të grumbullimit, përzgjedhjes dhe riciklimit të mbetjeve. Gjithashtu propozohet që fushata për rritjen e ndërgjegjësimit të pasohet nga një fushatë detyruese e shtrënguese kundër hedhjeve të paligjshme.

Urgjentisht duhet të trajtohen disa kategori specifike mbetjesh, dhe në mënyrë të veçantë:

Mbetjet e rrezikshme duke përfshirë Mbetjet Klinike (Direktiva 1991/689/KEE);

Vajrat e përdorur (Direktiva 75/439/KEE);

Automjetet jashtë përdorimit (2000/53/KE);

Gjatë kësaj kohe do të duhet të konsiderohen edhe kategori të tjera specifike mbetjesh, që trajtohen në legjislacionin e Komunitetit European, duke përfshirë:

Bateritë (91/157/KEE);

Ambalazhet (94/62/KE);

Mbetje DPK (Di-fenilet e Poli Klorinuar) (1996/59/KE);

Pajisjet Elektrike dhe Elektronike (2002/95/KE)

Themelet e punës për trajtimin e këtyre çështjeve do të hidhen në periudhën afatshkurtër, ndërsa zbatimi i tyre i plotë do të ndërmerret në periudhën afatmesme.

### AM1 Përkufizimi i praktikës më të mirë për administrimin e mbetjeve në periudhën afatmesme

Me qëllim që autoritetet vendore të jenë në gjendje të përgatisin plane të administrimit të mbetjeve dhe projekte shoqëruese investimesh, ata kanë nevojë për drejtim dhe mbështetje. Kjo do të jetë në formën e një manuali të planifikimit të administrimit të mbetjeve e mbështetur nga trajnimi dhe emërimi i ekspertëve shtesë. Ky personel duhet vendosur në një nga tri Ministrinë bashkëpunuese, në atë të Brendshme, Punëve Publike ose të Mjedisit.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenzimet Kapitale <sup>2</sup>	Shpenzimet Kapitale Vjetore <sup>3</sup>
AM1.1	Udhëzime mbi përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve nga autoritetet vendore dhe rajonale dhe për standardet që duhen zbatuar në përgatitjen e projekteve të administrimit të mbetjeve	MMPAU MPPTT Ministria e Brendshme	II/2007	II/2008	10	3

Udhëzime për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve do të përfshijnë:

Udhëzime mbi vlerësimin e sasive të mbetjeve dhe tipet e tyre;

<sup>2</sup> Në miliona Lek

<sup>3</sup> Në miliona Lek

Udhëzime mbi vlerësimin e potencialit të riciklimit;

Udhëzime mbi sistemet e planifikimit të grumbullimit të mbetjeve të ngurta dhe optimizimi i tyre;

Udhëzime mbi vlerësimin e nevojave të depozitimit të mbetjeve për një periudhë 15 vjeçare;

Udhëzime mbi administrimin e vendhedhjeve ekzistuese të mbetjeve;

Udhëzime mbi përmirësimin dhe restaurimin e vendhedhjeve ekzistuese të mbetjeve;

Udhëzime mbi përzgjedhjen e vendhedhjeve për nevojat e depozitimit në të ardhmen, përfshirë pajisjet e përbashkëta;

Udhëzime mbi projektet teknike të vendhedhjeve të reja përfshirë edhe paketat standarde dhe kostot;

Udhëzime mbi përcaktimin e nevojave për infrastukturë për veprimtarinë ricikluese dhe përpunuese;

Udhëzime mbi nevojat operative për aktivitetet e riciklimit dhe përpunimit përfshirë ndarjen, përzgjedhjen dhe kushtet e tregut.

Do të jetë e nevojshme shpërndarja e këtyre udhëzimeve dhe trajnimi mbi përdorimin e tyre, përfshirë shembuj nga veprimtari të suksesshme. Shumë nga shpenzimet kapitale të identifikuar këtu janë të shoqëruar me botimin edhe shpërndarjen e udhëzimeve dhe trainimin e autoriteve vendore në përdorimin e tyre.

## AM2 Sistemi i Planifikimit të Administrimit të Mbetjeve në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM2.1	Legjislacioni përcakton një sistem të planifikimit e të administrimit të mbetjeve vendore.	MMPAU MPPTT Min. Brend. Projekti SIDA	I/2006	II/2007		
AM2.2	Përgatitja e planeve për administrimin e mbetjeve vendore dhe rajonale përfshirë identifikimin e investimeve prioritare në grumbullimin, riciklimin dhe hedhjen e mbetjeve të ngurta urbane në linjë me udhëzimet , të cilave iu referohet në AM 1	Autoritetet Vendore Autoritetet Rajonale MMPAU MPPTT Min. Brend.	II/2008	IV/2009	11	9
AM2.3	Përgatitja e Planit Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve (edicioni i dytë)	MMPAU MPPTT Min. Brend.	IV/2009	IV/2010	12	1.5

Legjislacioni për të vendosur sistemin e planifikimit të administrimit të mbetjeve vendore, tanimë është përgatitur. Nuk ka pasur kosto shtesë në futjen në fuqi të këtij legjislacioni.

Procesi i planifikimit dhe administrimit të mbetjeve është në pjesën më të madhe të tij një proces analitik dhe administrativ, i cili ia hedh një barrë të koston, administratës publike. Do të nevojiten burime shtesë të personelit në nivel vendor/rajonal për ta mbështetur këtë proces. Tanimë është bërë një vlerësim i këtyre kostove. Përveç kësaj, planet do të kërkojnë kosto “kapitale” ose “të jashtëzakonshme” për përgatitjen e tyre.

Synohet që përgatitja e Planit Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve të mbështetet nga një projekt i asistencës së huaj teknike (përfshirë në Shpenz. Kap.) dhe nga emërimi i 2 nëpunësve shtesë (Shpenz. Oper.).

AM3 Zbatimi i Projekteve Prioritare për Administrimin e Mbetjeve – Faza I

Lista e Projekteve Prioritare të Investimeve Mjedisore është marrë nga informacioni i botuar nga Qendra Mjedisore Rajonale në vijim të projektit të financuar nga Komisioni Europian “Hartimi i një Programi Investimesh Prioritare Mjedisore për Europën Juglindore”.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM3.1	Sigurohet financim dhe zbatohen Projektet Prioritare të Investimeve Mjedisore për projektet e vendhedhjeve të mbetjeve – Faza I Vend Grumbullim i mbetjeve/Landfille në: Al-2 Elbasan (1.53 m Euro) Al-3 Fier (1.6 m Euro) Al-8 Shkodër (1.55 m Euro) Al16 – Laç (1 m Euro) Al 19 – Ballsh (1m Euro) Al 21 – Vlorë (1m Euro) Al 22 – Sarandë (1m Euro) Al23 – Tiranë dhe Durres (e pa specifikuar – vlerësohet 10m Euro)	MMPAU MPPTT Autoritetet Rajonale Relevante Autoritetet Vendore Relevante Asistencë Teknike e Huaj	II/2007	IV/2010	2 300	

Kostot e këtyre projekteve janë nxjerrë nga informacioni që gjendet në dokumentin e Projekteve Prioritare të Investimeve Mjedisore (PPIM) me përjashtim të të dhënave për Tiranë-Durrësin, i cili është një vlerësim i marrë nga adoptimi i një kostoje proporcionale për madhësinë e popullsisë. Kostot e përgjithshme të këtyre investimeve nuk mund të përballohen nga buxheti publik i tanishëm. Për të zbatuar këto projekte do të nevojitet mbështetje e jashtme. Kjo çështje është shqyrtuar më tej në kapitujt pasues të dokumentit.

Procesi i zbatimit të këtyre projekteve do të kërkojë:

Përfundimin e studimeve të fizibilitetit për të gjithë projektet (disa prej tyre tanimë janë përfunduar)

Dokumentacioni i zbatimit të projekteve iu paraqitet donatorëve potencialë

Sigurimi i mjeteve financiare për financimin e projektit nëpërmjet aplikimit tek Fondit i Mjedisit dhe organizimi i tenderave.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM3.2	Sigurim i financimit dhe zbatimi i Projekteve Prioritare të Investimeve Mjedisore për projekte të riciklimit të mbetjeve – Faza I  Zbatim i projekteve pilot të ndarjes dhe riciklimit në përputhje me Strategjinë Vendore për një Mjedis të Shëndetshëm në Qytetin e Tiranës 2005-2008 (Shih Planin e Veprimit Pjesa 1)  Zbatim i projekteve pilot të ndarjes dhe riciklimit në rajonin e Korçës në përputhje me projektin e financuar nga SIDA për administrimin e mbetjeve	MMPAU MPPTT  Autoritetet Relevante Rajonale  Autoritetet Relevante Vendore  Astencë Teknike	II/2007	IV/2008	14	

Financimi i këtyre projekteve sigurohet nëpërmjet burimeve ekzistuese

#### AM4 Zbatimi i Projekteve Prioritare për Administrimin e Mbetjeve - Fazat II dhe III

Zbatimi i fazës së parë për projektet e investimeve prioritare për administrimin e mbetjeve do ta përmirësojë gjendjen. Megjithatë, do të nevojiten investime të shumta të mëtejshme për të siguruar administrimin e mbetjeve në shkallë vendi. Natyra e saktë dhe kostot e këtyre investimeve të mëtejshme do të përcaktohen nga procesi i planifikimit të administrimit të mbetjeve, i përmendur më sipër. Është synuar që të planifikohen faza dy deri tre vjeçare investimesh. Për qëllimet e një orientimi afatgjatë, është supozuar që do të ketë kosto të njëjta për të tri fazat si ato të Fazës 1.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM4.1	Sigurimi i financimit dhe zbatimi i Projekteve Prioritare për Investimet Mjedisore për projektet për depozitimin e mbetjeve - Faza II	MMPAU MPPTT Autoritet Relevante Rajonale Autoritetet Relevante Vendore Asistencë Teknike	I/2011	IV/2013	2 500	
AM4.2	Sigurimi i financimit dhe zbatimi i Projekteve Prioritare për Investimet Mjedisore për projektet për depozitimin e mbetjeve - Faza III	MMPAU MPPTT Autoritet Relevante Rajonale Autoritetet Relevante Vendore Asistencë Teknike	I/2014	IV/2016	2 500	

#### AM5 Administrimi i mbetjeve të rrezikshme

Administrimi i mbetjeve të rrezikshme është në një nivel shumë të ulët. Propozimi për të ngritur një vend groposjeje të vetme për mbetjet e rrezikshme të të gjithë vendit, deri tani nuk ka qenë i suksesshëm. Për pasojë, duhet marrë në shqyrtim një strategji alternative. Duke pasur parasysh një gjë të tillë, propozohet që informacioni i përgatitur nga projekti i kohëve të fundit për mbetjet e rrezikshme i financuar nga Programi CARDS si dhe nga studimet e tokave/zonave të ndotura në kantieret e braktisur industriale në Fier, Vlorë, Elbasan dhe Laç janë përdorur si bazë për hartimin e propozimeve për projekte për kthimin e tokave të ndotura të këtyre kantierëve në zona të destinuar për depozitimin e tokave të ndotura dhe mbetjeve të rrezikshme. Ku është e mundur këto projekte mund të kombinohen me krijimin e vendgroposjeve të mbetjeve të ngurta, siç u përshkrua më sipër.

Ky koncept lidhet me mundësinë e ndërtimit të gropave të mëdha izoluese në secilin prej kantierëve të ndotur dhe këto gropa izoluese të përdoren për hedhjen si të gërmimeve të ndotura ashtu edhe për shkatërrimin e mbetjeve që krijohen nga restaurimi i kantierit si dhe për hedhjen e mbetjeve të rrezikshme që gjenden në rajonin e kantierit.

Meqenëse fizibiliteti i kësaj mundësie ende nuk është përcaktuar, kostot e një studimi të fizibilitetit janë përfshirë këtu. Megjithatë, ka shumë gjasa që kostot e çdo projekti do të jenë të njëjtës shkallë me ato të vendgroposjeve, të përmendura më lart. Për përgatitjen dhe zbatimin e këtyre projekteve, synohet të kërkohet asistencë ndërkombëtare.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM5.1	Studimi i fizibilitetit dhe hartimi i projektit për krijimin e lehtësirave izoluese në Fier, Vlorë, Elbasan , Durrës dhe Laç	MMPAU MPPTT Autoritet Relevante Rajonale Autoritetet Relevante Vendore Asistencë Teknike	I/2011	IV/2013	100	
AM5.2	Administrimi i mbetjeve të rrezikshme – zbatimi i fazës së parë të rregulloreve të reja	MMPAU MPPTT M. Ek. Treg. Energj. Autoritetet Relevante Rajonale	II/2007	IV/2008	0.7	0.75
AM5.3	Plani Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve të Rrezikshme	MMPAU M. Ek. Treg. Energj. MPPTT	II/2007	IV/2008	10	0.75

Faza e parë e zbatimit të legjislacionit të ri të mbetjeve të rrezikshme do të kërkojë:

Publikimi i informacionit mbi kushtet e regjistrimit të mbetjeve të rrezikshme dhe dekretimi i legjislacionit përkatës mbi këtë çështje (shih Nenin 7 dhe klauzolat shoqëruese).

Udhëzimet teknike mbi identifikimin e mbetjeve të rrezikshme lëshuar autoriteteve vendore dhe njësisive industriale.

Krijimin e regjistrit të gjeneruesve të mbetjeve të rrezikshme.

Mbledhjen dhe sistemim informacioni mbi praktikat aktuale të hedhjes së mbetjeve të rrezikshme.

Parashikimi për punësimin e një eksperti në Njësinë e Administrimit të Mbetjeve të Drejtorisë së Parandalimit të Ndotjes në MMPAU është përfshirë në kostot operative. Po ashtu është parashikuar edhe botimi i udhëzimeve përkatëse. Kosto të tjera të shoqëruara me këtë punë janë marrë parasysh të jenë në “vazhdimësi” dhe pjesë e biznesit si një rast i zakonshëm. Kjo kërkon punë, e cila duhet ndërmarrë në procesin e rishqyrtimit të lejeve mjedisore, të përmendur më sipër, ku tipet dhe sasi të mbetjeve (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) të gjeneruara nga impiante të mëdha industriale do të regjistrohen dhe raportohen si parakusht për dhënien e lejeve.

Ndonëse jo i plotë, synohet që ky plan fillestar Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme (bazuar në strategjinë e projektit CARDS të BE) të fillojë të vihet në jetë, në mënyrë që të mund të kemi një pikënisje për zhvillime të mëtejshme. Pikërisht për të ndihmuar në zbatimin e strategjisë brenda një periudhe afatshkurtër, do të kërkohej edhe shtimi i një specialisti në ministri. Përgjegjësitë e tyre do të përfshijnë hartimin e planeve të hollësishme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve specifike:

Mbetjet e vajrave dhe mbetjeve të tjera të rrezikshme nga mirëmbajtja dhe çmontimit i automjeteve (psh. bateritë);

Mbetjet e rrezikshme industriale;

Mbetjet klinike;

Mbetjet e rrezikshme nga përmirësimet e tokave të ndotura dhe nga ndërtimi;

Administrimi i mbetjeve të rrezikshme bujqësore;

Administrimi i mbetjeve të rrezikshme shtëpiake.

AM6 Kompletimi i kuadrit ligjor për administrimin e mbetjeve

Sikurse është theksuar edhe në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit, prioritetet afatshkurtra për legjislacionin në këtë nënsektor dhe iniciativat legjislative pasuese, që adresojnë prioritetet afatshkurtra janë:

Përpilimi dhe aprovimi, nga Ministrat e MMPAU dhe MPPTT, i rregulloreve për administrimin e mbetjeve të ndërtimit me qëllim që të zbatohet Ligji No. 9010 i datës 11.02.2003 “Mbi Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”;

Përpilimi dhe miratimi i rregulloreve të ndryshme, formularët e aplikimit dhe regjistrat për zbatimin e Ligjit No. 9537 të datës 18.5.2006 “Mbi Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme”;

Përpilimi dhe miratimi i një Projektligji “Mbi Amendamentet e Ligjit No. 9010 i datës 11.02.2003 “Mbi Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta” dhe të Projekt Aktit Normativ “Mbi Miratimin e Rregullave, Procedurave dhe Afateve për Planet Vendore për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta”;

Përpilimi dhe miratimi i Projekt Aktit “Mbi Miratimin e Rregullave, Procedurave dhe Afateve për Planet Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”;

Përpilimi dhe miratimi i Projekt Aktit Normativ “Mbi Listën e Mbetjeve që Lejohet të Importohen për Qëllime Përpunimi dhe Riciklimi”;

Përpilimi dhe miratimi i Projekt Aktit Normativ “Mbi Miratimin e Rregullave, Procedurave dhe Afateve për Planin Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta”;

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM6.1	Prioritetet afatshkurtëra për transpozimin e legjislacionit në nënsektorin e administrimit të mbetjeve	MMPAU MPPTT	I/2007	II/2008	2	1.5
AM6.2	Prioritetet afatmesme për transpozimin e legjislacionit në nënsektorin e administrimit të mbetjeve	MMPAU MPPTT	III/2008	IV/2009		Si më sipër
AM6.3	Prioritetet afatgjata për transpozimin e legjislacionit në nënsektorin e administrimit të mbetjeve	MMPAU MPPTT	I/2010	IV/2012		Si më sipër

Në MMPAU ka nevojë për personel shtesë për të ndërmarrë përgatitjen e këtij legjislacioni. Trajnimi (i parashikuar në zërin Shpenzime Kapitale) do të jetë gjithashtu i nevojshëm për këta anëtarë të rinj të personelit.

Prioritetet Afatmesme për legjislacionin në këtë nënsektor janë:

Projekt Akti Normativ “Mbi Vendgrumbullimin e Mbetjeve/Landfillet”

Projekt Akti Normativ “Mbi Kompostimin e Mbetjeve”

Projekt Ligji “Mbi Ndotësit Organikë të Qendrueshëm”;

Projekt Ligji “Mbi Miratimin e Planit Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve”;

Në një periudhë më afatgjatë transpozimi do të përfundojë me përgatitjen e:

Projekt Aktit Normativ “Mbi Ambalazhimin dhe Mbetjet e krijuara nga ambalazhet e përdorur”;

Projekt Aktit Normativ “Mbi Mbetjet e krijuara nga zmontimi i automjeteve jashtë përdorimit”;

## Objektivat dhe Masat Përkatëse

Projekt Aktit Normativ “Mbi Mbetjet Industriale të Dioksidit të Titanit”;

Projekt Aktit Normativ “Mbi Raportet, Formularët e Aplikimit, Çertifikatat e Depozitimit dhe Grumbullimin e të Dhënave mbi Mbetjet”.

### AM 7 Rritja e ndërgjegjësimit mbi çështjen e mbetjeve për të nxitur dhe inkurajuar sjelljen e përgjegjshme

Është jetike, që ndërsa krijohen të gjitha lehtësirat për administrimin e mbetjeve, gjeneruesit e tyre, si tregtarë ashtu edhe familjarë, duhet t’u përgjigjen pozitivisht këtyre masave. Për pasojë, duhen bërë përpjekje të mëdha për të rritur ndërgjegjësimin e të gjitha kategorive të gjeneruesve të mbetjeve dhe të informohen ato për veprimet që duhen ndërmarrë për të arritur një administrim më të qëndrueshëm të mbetjeve. Për pasojë, gjatë viteve të ardhshme do të bëhen një sërë fushatash për të nxitur, mbështetur dhe promovuar një administrim të qëndrueshëm të mbetjeve.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
AM7.1	Fushata për të promovuar një administrim të përmirësuar të mbetjeve - faza e parë: 2007 - 2008	MMPAU MPPTT	I/2007	II/2008	6	1.5
AM7.1	Fushata për të promovuar një administrim të përmirësuar të mbetjeve - faza e dytë: 2009-2010	MMPAU MPPTT	I/2007	II/2008	6	si më sipër
AM7.1	Fushata për të promovuar një administrim të përmirësuar të mbetjeve - faza e tretë: 2011-12	MMPAU MPPTT	I/2007	II/2008	6	si më sipër

Organizimi i fushatave të tilla do të kërkojë personel shtesë në Departamentin e Komunikimit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Po ashtu do të kërkojen shpenzime të mëdha kapitale për materialet dhe anghazhimin e fuqishëm të medias.





### 3.3.4 Administrimi i Burimeve Ujore

#### *Sigurimi i mundësisë së furnizimit me ujë të pijshëm për të gjithë popullsinë*

##### *Ruajtja e të gjitha burimeve ujore mb i- dhe nëntokësore*

Sektori i ujit është një nga aspektet më të rëndësishëm të administrimit të mjedisit. Kërkesat për një administrim të mirë të ujit, pa dëmtuar mjedisin, janë komplekse, të vështira nga ana teknike dhe të kushtueshme. Situata në këtë sektor është e ngjashme me atë të administrimit të mbetjeve të ngurta, edhe për faktin që përgjegjësia për sigurimin e shërbimeve komunale është duke u transferuar nën administrimin e pushtetit vendor. Megjithatë, ka një sërë dallimesh të rëndësishme që duhen marrë parasysh:

Tashmë (2003) janë botuar Strategjitë e Qeverisë lidhur me furnizimin me ujë dhe kanalizimet, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale;

Tashmë janë kryer investime të konsiderueshme në sektorin e ujit. Projektet e renditur në PKPL, tregojnë se shpenzimet totale të projektit në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet është përafërsisht 200 milion Euro për periudhën 2000 – 2006;

Janë ndërmarre një varg aktivitete trajnuese, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore, për Ndërmarrjet e Ujësjetës – Kanalizimeve;

Inventarizimi i infrastrukturës dhe asetëve është kryer tashmë dhe një pjesë e tyre, por jo të gjitha janë transferuar tek pushteti vendor;

Një sërë iniciativash komercializimi dhe privatizimi janë kryer tashmë, me anë të të cilave shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimet kryhet, në emër të pushtetit vendor nga kontraktorë privatë.

Për më tepër, nëpërmjet krijimit të Agjencive Rajonale për Administrimin e Baseneve të Lumenjve dhe Këshillit Kombëtar të Ujit është vendosur një strukturë administrative për planifikimin e shfrytëzimit dhe administrimin e baseneve të lumenjve.

Si rrjedhim, masat që përcaktohen këtu duhet të shihen si konsolidim i përmirësimeve që po bëhen.

Qëllimi i parë është sigurimi i administrimit efikas dhe të qëndrueshëm të sektorit të ujërave. Pa ekspertizën e duhur dhe kuadrin e planifikimit të projekteve, përmirësimet që janë bërë deri tani nuk do të mund të manifestojnë vlerën e tyre maksimale dhe mbase edhe nuk do të mund të vazhdohen. Zbatimi i “masave konkrete” për arritjen e qëllimeve të përgjithshme, nuk do të jetë i mundur pa këtë përforsim institucional, administrativ dhe ligjor. Duke pasur parasysh delegimin e përgjegjësive në nivel vendor, duhet të sigurohet kapaciteti dhe mbështetja e mjaftueshme për autoritetet vendore dhe Ndërmarrjet e Ujësjetës-Kanalizimeve. Kjo gjë do të kërkojë vazhdimin e trajnimit, tashmë të ofruar. Kjo do të rritet me dhënien e udhëzimit formal për të përforsuar praktikën e mira që janë aplikuar në shumë zona si rezultat i këtyre trajnimeve.

Në një periudhë më afatgjatë, administrata e planifikimit të baseneve të lumenjve do të jetë drejtuesi kryesor për administrimin e ujërave. Hapat e parë drejt një sistemi të tillë janë krijimi i një kuadri ligjor për planifikimin e administrimit të baseneve të lumenjve dhe përmirësimin e sistemit ekzistues të dhënies së lejeve për nxjerrjen e ujit nga pusët dhe shkarkimeve në ujë. Vetëm nëpërmjet funksionimit të lejeve efikase (kushtet e të cilave duhet të respektohen me rigorozitet), do të mund të zbatohen vendimet e marra gjatë procesit të planifikimit të administrimit të baseneve të lumenjve.

Megjithatë, roli i sistemit të lejeve është vendimtar për zbatimin e strategjive aktuale për kanalizimet. Kriteret për përcaktimin e nevojës urgjente dhe përfitimit të një projekti për uljen e nivelit të ndotjes, përfshijnë si shëndetin e njeriut ashtu edhe mjedisin. Kriteret për mbrojtjen e

mjedisit, duhet të përfshihen në lejet për shkarkimin e ujërave të zeza, në formën e kushteve të përmirësimit. Nevoja urgjente për zbatimin e projektit pasqyrohet në nevojën urgjente të kushteve të lejeve. Duke qenë kështu, lejet duhet të jepen mbi bazën e sigurimit të plotësimit, në vendet më delikate, të standardeve më të rëndësishme për cilësinë e mjedisit, si psh kriteret e ngarkesës mikrobike të ujit të zonave ujore që shfrytëzohen nga njerëzit për të bërë plazh, të cilat kanë si pasojë shëndetësore ashtu edhe ekonomike. Si rrjedhim, procesi i rishikimit të lejeve referuar në Kapitullin 5, do të zbatohet gjithashtu për të gjithë shkarkimet e rëndësishme<sup>4</sup> të ujërave të zeza. Aktualisht, burimet e disponueshme për zbatimin e këtij programi janë të kufizuara, prandaj ne nuk mund të merremi me të gjitha burimet e ndotjes apo të gjithë sistemet e ujit të pijshëm në të njëjtin nivel detajesh. Megjithatë, sistemet e vegjël nuk mund të injorohen krejtësisht. Si masë e përkohshme do t'u jepet udhëzim operatorëve të sistemeve të vegjël (vendbanimeve të largëta dhe banesave të largëta individuale) lidhur me masat me kosto të ulët, të cilat mund të merren për të minimizuar rrezikun e ndotjes së ujit të pijshëm dhe për të ulur nivelin e ndotjes që shkaktohet nga shkarkimet e ujërave të zeza.

Përmirësimet konkrete në sektorin e ujit janë shprehur në lidhje me arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillim. Këto specifikohen me hollësi në tabelën që gjendet në fund të seksionit. Janë siguruar gjithashtu llogaritjet e përgjithshme të kostos për investimet që kërkohen për realizimin e këtyre qëllimeve.

Strategjia e përgjithshme e përdorur këtu në lidhje me furnizimin e zonave urbane dhe rurale me ujë dhe lidhur me ujërat e zeza është:

Zbatim në vazhdimësi i strategjive të furnizimit me ujë (2003) për zonat urbane dhe rurale, në periudhën afatshkurtër – përmirësimet në vazhdimësi duke përdorur projektet ekzistuese dhe projekte të rinj (të përgatitur);

Kalimi në metodën e “Linjës së Projekteve” paralelisht me zbatimin në vazhdimësi të strategjisë ekzistuese, duke përfshirë futjen në përdorim të Fondit të Mjedisit dhe procedura e lidhura me të;

Identifikimi i vazhdueshëm i projekteve të kërkuar, sipas udhëzimeve të rishikuar dhe sigurimi i një mbështetjeje më të madhe teknike, sidomos për zonat rurale;

Zbatimi i metodës së “Linjës së Projekteve” dhe rishikimi i strategjive ekzistuese të ndërmarra në fund të periudhës afatshkurtër;

Sistemi i rishikuar i hartimit, aplikimit për financim dhe zbatimit të projekteve të prezantuar për here të parë në vitin 2009.

Për të qenë të saktë, masat për secilin element (furnizimi me ujë dhe kanalizimet) nuk janë përsëritur. Megjithatë, ia vlen të thuhet se, megjithëse procesi i identifikimit të projektit përfytyrohet si një proces i integruar (furnizimi me ujë dhe kanalizimet), masat janë identifikuar të ndara, pasi niveli i burimeve në dispozicion për këtë punë mund të jetë i tillë, që të dy elementët trajtohen në kohë pak të ndryshme nga njëri-tjetri.

Burimet e tjerë janë si pika të përqendruara ashtu edhe të shpërndara. Ulja e nivelit të ndotjes së ujërave sipërfaqësore nga burimet e zonave jo urbane të ndotjes, përfshirë linjat e përpunimit të produkteve industriale dhe/ose bujqësore, do të arrihet nëpërmjet procesit të rishikimit të lejeve dhe bisedimeve për kushtet e përmirësimit të situatës me operatorët. Reduktimi i ndotjes së ujërave mbitokësore, nga burimet e përqendruara apo të shpërndarë të shkaktuar nga aktivitetet e

---

<sup>4</sup> Termi “i rëndësishëm” përdoret këtu për të dalluar mes shkarkimeve shumë të vogla të cilat nuk kanë nevojë për leje. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, duhet të supozohet që termi aplikohet në të njëjtën mënyrë si Neni 3.2.b i Direktivës së Ujit të Pijshëm (98/83/KE) i cili vë një kufi prej 50 njerëzish.

administrimit të mbetjeve, do të realizohet nëpërmjet aplikimit të masave për administrimin e mbetjeve, identifikuar më lart.

Reduktimi i ndotjes së ujërave mbitokësore, nga burimet e shpërndarë, do të kërkojë bashkëpunim me sektorët kryesorë, përfshirë bujqësinë dhe shfrytëzimin e pyjeve. Masat në këta sektorë do të drejtohen kryesisht nëpërmjet përshtatjes dhe nxitjes së aplikimit të Kodeve të Praktikës së Mirë (pjesërisht nëpërmjet subvencionimit të kushtëzuar). Dy burimet e tjera kyç të ndotjes së shpërndarë; depozitimi i substancave ndotëse, që përhapen në rrugë ajrore, dhe ndotja nga tokat e ndotura (dëmi mjedisor), do të trajtohet përmes prioritarizimit të masave të identifikuar në mënyrë të ndarë për këta komponentë.

Duke patur parasysh varësinë e madhe për sigurimin e ujit të pijshëm nga ujërat nëntokësore është shumë e rëndësishme të mbrohen burimet e ujit nëntokësor si nga ndotja ashtu edhe nxjerrja e tepërt e ujit (mbishfrytëzimi pa kriter i rezervave). Në këtë kuadër, kërkohen tre hapa specifikë:

Krijimi i një baze të fortë ligjore për mbrojtjen e ujit nëntokësor, që do të shërbejë për të siguruar/mbuluar nevojat e popullatës për ujë të pijshëm në të ardhmen;

Përmirësimi i të dhënave dhe informacionit ekzistues, në shërbim të administrimit të ujërave nëntokësore, në mënyrë që të mund të mbështetet procesi i planifikimit të administrimit të baseneve të lumenjve në të ardhmen;

Ndërmarrja e veprimeve prioritare në fushën e mbrojtjes së burimeve të ujit nëntokësor – edhe pse zhvillimi i bazës për veprimet e administrimit në të ardhmen është i një rëndësie kritike, ekzistojnë tregues të problemeve serioze, që kanë të bëjnë me ndotjen e disa burimeve të ujërave nëntokësore dhe tej-shfrytëzimit të rezervave ujore tek të tjerët. Këto probleme duhen zgjidhur brenda periudhës afatshkurtër.

### ABU1 Sistemet efikase dhe të qëndrueshme të administrimit të sektorit të ujit

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap. <sup>5</sup>	Shpenz. Op. Vjetore <sup>6</sup>
ABU1.1	Programi i krijimit të kapaciteteve për të siguruar mbështetje për autoritet vendore dhe Ndërmarrjet e Ujësllës - Kanalizimeve	MMPAU MPPTT M. Ekon. Treg. Energj. Min. Brend.	II/2007	II/2009	37	9
ABU1.2	Krijimi i Agjencisë Rurale të Ujësllës - Kanalizimeve	MPPTT	...	IV/2007	92 <sup>7</sup>	
ABU1.3	Krijimi i Qendrës së Vetëfinancuar të Trainimit Profesional	MPPTT MASH M. Brend. MMPAU	...	IV/2007	21.5 <sup>8</sup>	
ABU1.4	Mbështetje për programet e Ndërgjegjësimit të Publikut dhe Edukimit të Komunitetit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Administrimin e Burimeve Ujore	MPPTT MMPAU	I/2007	IV/2012	6 <sup>9</sup>	

Programi i ndërtimit të kapaciteteve qëndron në:

<sup>5</sup> Në milionë Lek

<sup>6</sup> Në milionë Lek

<sup>7</sup> Vlerësim nga Strategjia Shqiptare e Ujërave të Mbeturave dhe Furnizimit më Ujë (2003)

<sup>8</sup> Vlerësim nga Strategjia Shqiptare e Ujërave të Mbeturave dhe Furnizimit më Ujë (2003)

<sup>9</sup> Vlerësim nga Strategjia Shqiptare e Ujërave të Mbeturave dhe Furnizimit më Ujë (2003)

Udhëzime ministrore për autoritetet vendore për mirëmbajtjen e regjistrave të aseteve për furnizimin me ujë dhe kanalizimet përfshirë edhe formatet e standardizuara dhe procedurat;

Udhëzime ministrore për autoritetet vendore për proceset dhe procedurat për komercializimin ose privatizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë përfshirë përgatitjen dhe administrimin e kontratave;

Krijimi i Agjencisë Rurale të Ujësjetës-Kanalizimeve (ARUK) për të siguruar mbështetje me ekspertizë për autoritetet e komunave në çështjet e administrimit të ujërave;

Përgatitja e një Manuali Udhëzues për administrimin e ujit në nivel komune, përfshirë këshillimin për administrimin dhe zhvillimin e infrastrukturës, me projekte model dhe vlerësimin e kostove për elementët e infrastrukturës së administrimit të ujit;

Program trajnimi mbi zbatimin e udhëzimeve për autoritetet vendore dhe Ndërmarrjet e Ujësjetës-Kanalizimeve.

Programi do të mbështesë procesin e vazhdueshëm të decentralizimit, ku përgjegjësia për shërbimet e furnizimit me ujë i është dhënë autoriteteve vendore.

Rritja e kapacitetit të autoriteteve vendore mund gjithashtu të kërkojë shtim në numrin e personelit të ekspertëve që punësohen brenda autoriteteve. Këtu nuk janë paraqitur kostos e çdo rritjeje të tillë, por mund të jenë të rëndësishme.

Masat edukimit dhe ndërgjegjësimit do të përfshijnë:

Përgatitjen dhe botimin e një broshure këshillimore për banorët e vendbanimeve të largëta, që me masa të një kostoje të ulët të mund të minimizojnë rrezikun e ndotjes së ujit të pijshëm.

Përgatitjen dhe botimin e një broshure këshillimore për banorët e vendbanimeve të largëta, që me masa të një kostoje të ulët të mund të realizojnë administrimin e ujërave të bardha e të zezafamiljare.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU1.5	Kuadri ligjor për administrimin e baseneve të lumenjve – Faza I (periudha afatshkurtër) – vendosja e detyrimeve dhe formatit për përgatitjen e planeve të para për administrimin e baseneve të lumenjve	MMPAU/ELPA MPPTT M. Ek. Treg. Energj. M. Brend.	II/2007	IV/2008		
ABU1.6	Kuadri ligjor për administrimin e baseneve të lumenjve – Faza II (periudha afatmesme) – harmonizim i mëtejshëm me legjislacionin e Komunitetit Europian	MMPAU MPPTT Min. Ek. Treg. Energj.	I/2009	IV/2010		
ABU1.7	Kuadri ligjor për administrimin e baseneve të lumenjve – Faza III (periudha afatgjatë) – përfundimi i transpozimit të legjislacionit të Komunitetit Europian për ujin	MMPAU MPPTT Min. Ek. Treg. Energj. M. Brend.	I/2011	IV/2012		

Elementi i parë për procesin e përafrimit ligjor do të kërkojë shqyrtimin e ligjeve ekzistuese për ujin siç është propozuar nga Projekti ELPA. Kjo do të përcaktojë kërkesat për përgatitjen e grupit të parë të planeve të administrimit të baseneve të lumenjve. Zbatimi i kësaj kërkesë do të imponojë përforsimin e Autoriteteve të Baseneve të Lumenjve, siç do të diskutohet më poshtë.

Siç është pohuar në NPAL, iniciativat legjislative të mëposhtme do të ndërmerren për të adresuar prioritetet e periudhës afatmesme:

Projektligji “Mbi krijimin e Rrjetit të Aktivitetit të Politikës Ujore”, e cila do të harmonizohet me Direktivën 2000/60/ECC me qëllim që të vendoset bashkëpunim midis nivelit vendor dhe atij publik:

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU1.8	Përforcimi i Autoriteteve të Baseneve të Lumenjve me qëllim që të lehtësohet përgatitja e grupit të parë të planeve të administrimit të baseneve të lumenjve në bashkëpunim me institucionet e ekspertizës, përfshirë Institutin e Gjeologjisë (M. Ek. Treg. Energj.), Institutin e Hidrometeorologjisë dhe të tjera	MMPAU/ELPA MPPTT M. Ek. Treg. Energj. M.Brend.	II/2007	IV/2008	5	7.2

Synohet që çdo Autoritet i baseneve të Lumenjve të shtohet me një personel (mesatarisht) prej 3 – 5 vetash: Kjo do të kërkojë një rritje në kostot operative dhe një kosto fillestare të shoqëruar me trajnim dhe sigurimin e pajisjeve bazë për këtë personel (Shpenz. Kap.) Po ashtu synohet të realizohet edhe një projekt i vogël ndërkombëtar demonstrues për Planifikimin e Administrimit të Baseneve të Lumenjve dhe ky të financohet nga mbështetja e donatorëve. Si pjesë e përfortimit të tij, synohet gjithashtu që Autoriteteve të Baseneve të Lumenjve t’iu jepen kompetenca dhe burime për të përmirësuar sistemin e lejeve për nxjerrjen e ujit përfshirë edhe krijimin e një baze të dhënash elektronike me akses publik për këto nxjerrje. Në këtë kapacitet ato do të veprojnë në emër të Këshillit Kombëtar të Ujit.



ABU2 Zbatimi i projekteve prioritare në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të mbetura

Masat e përshkruara më sipër do të ndihmojnë të krijohet një sistem planifikimi dhe kontrolli në sektorin e ujit, por ato nuk detyrojnë sigurimin e masave “konkrete” për përmirësimin e infrastrukturës. Hapi i parë në këtë drejtim duhet të jetë zbatimi i projekteve prioritare të investimeve mjedisore.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 2.1	Zbatimi i projekteve prioritare në fushën e ujit të pijshëm dhe ujërave të mbetura. AL-1: Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve për qytetin e Durrësit (4.9 milionë Euro) AL-9: Rehabilitimi i furnizimit me ujë në Bashkinë e Vlorës (20 milionë Euro) AL-10: Sistemi i kanalizimeve për qytetin e Fierit (2 Milionë Euro) AL-11: Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve për qytetin e Lezhës (1.7 milionë Euro) AL-12: Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve për qytetin e Sarandës (i pa identifikuar) AL-13: Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Koplikut (5 milionë Euro) AL-14: Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Velipojës (5 milionë Euro) AL-15: Punime për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Laçit (5 milionë Euro) AL-17: Ndërtimi i impiantit të përbashkët për trajtimin e ujërave të zeza për Tiranën dhe rrethinat (70 milionë Euro) AL-19: Punime për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Ballshit (4 milionë Euro)	MMPAU MPPTT METE MB	II/2007	IV/2009	15 000	

Duhet theksuar se projektet e listuara këtu :

Nuk përfshijnë të gjithë projektet prioritarë të identifikuar në strategjisë për ujin dhe kanalizimet e zonave urbane dhe rurale.

Janë niveli minimum i investimeve të domosdoshme – në shumë raste ky nivel nuk do të arrijë përputhshmërinë me Standardet e Komunitetit European

Niveli i investimeve është jashtë kapaciteteve aktuale të administratës publike. Shpenzimi kapital aktual i Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për ujin e pijshëm është 2.3 miliardë Lekë në vit dhe për kanalizimet është përafërsisht 0.4 miliardë Lekë në vit. Për këtë arsye do të jetë e nevojshme për ndihmë të jashtme për t'i bërë këto investime. Kjo shtjellohet më hollësisht në Kapitullin 5.

## ABU2 Zbatimi i projekteve prioritare në sektorët e ujit të pijshëm dhe ujërave të mbetura

Masat e përshkruara më sipër do të ndihmojnë të krijohet një sistem planifikimi dhe kontrolli në sektorin e ujit, por ato nuk detyrojnë sigurimin e masave “konkrete” për përmirësimin e infrastrukturës. Hapi i parë në këtë drejtim duhet të jetë zbatimi i projekteve prioritare të investimeve mjedisore.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 2.1	<p>Zbatimi i projekteve prioritare në fushën e ujit të pijshëm dhe ujërave të mbetura.</p> <p>AL-1: Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve për qytetin e Durrësit (4.9 milionë Euro)</p> <p>AL-9: Rehabilitimi i furnizimit me ujë në Bashkinë e Vlorës (20 milionë Euro)</p> <p>AL-10: Sistemi i kanalizimeve për qytetin e Fierit (2 Milionë Euro)</p> <p>AL-11: Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve për qytetin e Lezhës (1.7 milionë Euro)</p> <p>AL-12: Rehabilitimi dhe zgjerimi i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve për qytetin e Sarandës (i pa identifikuar)</p> <p>AL-13: Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Koplikut (5 milionë Euro)</p> <p>AL-14: Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Velipojës (5 milionë Euro)</p> <p>AL-15: Punime për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Laçit (5 milionë Euro)</p> <p>AL-17: Ndërtimi i impiantit të përbashkët për trajtimin e ujërave të zeza për Tiranën dhe rrethinat (70 milionë Euro)</p> <p>AL-19: Punime për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza për qytetin e Ballshit (4 milionë Euro)</p>	MMPAU MPPTT METE MB	II/2007	IV/2009	15 000	

Duhet theksuar se projektet e listuara këtu :

Nuk përfshijnë të gjithë projektet prioritare të identifikuar në strategjisë për ujin dhe kanalizimet e zonave urbane dhe rurale.

Janë niveli minimum i investimeve të domosdoshme – në shumë raste ky nivel nuk do të arrijë përputhshmërinë me Standardet e Komunitetit Europian

Niveli i investimeve është jashtë kapaciteteve aktuale të administratës publike. Shpenzimi kapital aktual i Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për ujin e pijshëm është 2.3 miliardë Lekë në vit dhe për kanalizimet është përafërsisht 0.4 miliardë Lekë në vit. Për këtë arsye do të jetë e nevojshme për ndihmë të jashtme për t'i bërë këto investime. Kjo shtjellohet më hollësisht në Kapitullin 5.

ABU3 Hartimi i një programi afatgjatë investimesh, strategji financiare dhe mekanizëm i fuqishëm zbatimi për sektorët e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve.

Me qëllim që të sigurohet furnizimi me ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin dhe një nivel i përshtatshëm i përpunimit të ujërave të mbetura urbane, do të duhen investime masive gjatë 15-20 vjetëve të ardhshme. Ndërsa kjo është një detyrë e guximshme, ajo mund të arrihet, siç na tregon përparimi që është bërë nga shtetet që kohët e fundit aspirojnë në hyjnë në BE. Megjithatë, për ta bërë këtë është e domosdoshme të vendoset një sistem të sigurt për identifikimin e investimeve prioritare dhe për zbatimin e tyre.

Synohet që kjo të arrihet në një cikël 3 vjeçar, i cili do të fillojë më 2010. Para kësaj kohe problematika do të përqendrohet në:

përgatitjen e synimeve të projektit dhe vendosja e sistemit

zbatimin e investimeve prioritare, të cilave iu është referuar në ABU2

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 3.1	Hartimi i një programi afatgjatë të investimeve, strategjisë financiare dhe mekanizëm të fuqishëm zbatimi për sektorët e ujës-jellës-kanalizimeve	MMPAU MPPTT M.Ek.Treg. Energj. M. Brend.	II/2007	IV/2009		

Kuadri për krijimin e programit të investimeve ekziston tanimë në formën e strategjive të hartuara më 2003. Ai ka nevojë për përditësim dhe pasurim dhe zbatim të rekomandimeve që gjenden në Strategjinë Rurale për arritjen e synimeve të projekteve. Kjo do të mbështetet nëpërmjet krijimit të Agjencisë së Ujës-jellës-Kanalizimeve për Zonat Rurale, të përmendur më sipër.

Më pas, kjo ka nevojë të pasohet nga katër apo pesë cikle investimesh, që do të përfundojnë në një program me jetëgjatësi 12-15 vjeçare. Kostot e këtyre cikleve do të jenë të qenësishme, ashtu siç tregohet nga vlerësimi i përgjithshëm i kostove të investimeve e paraqitur në tabelën më poshtë. Synimi i përgjithshëm i këtyre programeve të investimeve do të jetë të arrihet përputhshmëri me Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe për pasojë, të përputhet me kërkesat e legjislacionit të Komunitetit Europian.

ABU4 Pakësimi në pikat e ndotjes së burimeve të ujërave mbitokësore

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 4.1	Kushtet e imponuara mbi të gjithë shkarkimet industriale dhe përpunimi të ujërave të mbetura para se ato të shkarkohen – përmirësim i kushteve që duhen negociuar me mbajtësit e lejeve si pjesë e procesit të rishqyrtimit të lejeve me objekt paratrajtimin e të gjithë ujërave të mbetura më 2015	MMPAU MPPTT M. Ek. Treg. Energj. Min. Brend.	II/2007	IV/2009	12	1.5

Kjo masë do të integrohet në rishqyrtimin e lejeve. Megjithatë, do të jetë e nevojshme të përforcohet Drejtoria e Parandalimit të Ndotjes në Ministrinë e Mjedisit për ta rritur këtë gjë. Parashikimi është bërë për një personel shtesë prej 2 vetash dhe për trajnimin e tyre.



Përveç rishqyrtimit të kontrolleve të shkarkimit të ujërave të mbetura në lejet ekzistuese, puna e këtij personeli do të përfshijë:

Botimin e njoftimeve këshillimore për përpunuesit industrialë dhe bujqësorë me teknika trajtimi me kosto të ulët (përfshirë në Shpnez. Kap.)

Instruksiione dhe drejtim ministror për autoritetet vendore për gjetjen e vendeve të pranueshme për vendosjen e veprimtarive përpunuese industriale dhe bujqësore në zonat ku nuk ka grumbullim të ujërave të mbetura.

Kostot “ekonomike” të këtyre masave nuk janë vlerësuar, por nuk ka asnjë dyshim që ato do të imponojnë një barrë shtesë të kostove mbi njësitë tregtare dhe industriale. Megjithatë, kjo barrë do të krijohet gjatë një kohe të gjatë dhe do të përfundojë në një përfitim të përgjithshëm ekonomik në tërësi.

Masat që gjenden në seksionin e administrimit të mbetjeve të kësaj strategjie do të kontribuojnë në pakësimin e ndotjes së ujit.

### ABU5 Pakësim i ndotjes të burimeve të shpërndara mbi ujërat mbitokësore

Përveç ndotjes nga pikat e shkarkimit, cilësia e ujit preket nga burime të shpërndara siç janë, bujqësia, pyjtaria, toka e ndotur dhe ndotjesit që përmbahen në ajër. Masat për të pakësuar ndotjen e shkaktuar nga shumë nga këto burime, trajtohen diku tjetër në strategji.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 5.1	Adoptimi i Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore (KPMB) për ujin përfshirë edhe çështjet e përmendura si dhe efikasiteti i përdorimit të ujit për vaditje	MMPAU MBUMK	II/2007	II/2008	5	
ABU 5.2	Zbatim i programit të promovimit të KPMB nëpërmjet Shërbimit Këshillimor	Shërbimi Këshillimor	III/2008	IV/2010	10	

Ka shumë shembuj të Kodeve të Praktikave së Mirë Bujqësore në gjithë Europën, që mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin e një Kodi të njëjtë në Shqipëri. Shumica e këtyre Kodeve janë vullnetarë. Zbatimi i tyre është i nxitur nga shërbimet këshillimore.

### ABU 6 Mbrojtja e Ujërave Nëntokësore

Duke pasur parasysh sigurinë pothuajse të plotë në ujërat nëntokësore për ujë të pijshëm, është jetike që burimet nëntokësore të mbrohen si nga ndotja ashtu edhe nga nxjerrja e tij e tepruar. Duke u nisur nga ndërlikimet e administrimit të ujërave nëntokësore, do të nevojitet një mbështetje e gjerë nga institucionet e specializuara, veçanërisht nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (M.Ek.Treg.Energj.).

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 6.1	Amendim i legjislacionit ekzistues për të siguruar bazën ligjore për krijimin e zonave të mbrojtjes së ujërave nëntokësore dhe për specifikimin e kufizimeve në çdo klasë të zonës	MMPAU MPPTT Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	II/2007	IV/2008	2	

Synohet gjithashtu që elementët teknikë të legjislacionit të përgatiten nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, i cili është organizata kryesore e ekspertëve në këtë çështje. Kostoja e një projekti të vogël është përfshirë për përgatitjen e legjislacionit. Parashikohet që kjo punë do të kërkojë:

Amendim fillestar për legjislacionin ekzistues për të siguruar bazën ligjore për krijimin e zonave të mbrojtura të ujërave nëntokësore dhe për specifikimin e kufizimeve për aktivitet në çdo klasë të zonës.

Projekt për të përfunduar politikën fillestare të mbrojtjes së ujërave nëntokësore, përfshirë përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe propozimet për kufizimet për aktivitet.

Përfundimi i amendimit të legjislacionit, përfshirë adoptimin e politikës së mbrojtjes së ujërave nëntokësore nga legjislacioni sekondar dhe Transpozimi i Direktivës së Ujërave Nëntokësore i Komunitetit Europian 80/68/KE.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 6.2	Krijimi i të dhënave dhe sistemit të informimit për administrimin e ujërave nëntokësore - i integruar me Sistemin e Administrimit të Informacionit Mjedisor SAIM	MMPAU M:Ek.Treg.Energj. MPPTT Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	II/2008	IV/2009	15	

Parashikohet që të dhënat dhe sistemi informacionit do të kërkojnë hapat e mëposhtëm:

Krijimin e një grupi të përbashkët pune për ujërat nëntokësore (GPPUN) me një marrëveshje ndër-ministore, ku përfshihen ekspertë gjeologjie, minierash, të tokave dhe të hidrologjisë; Ndërmarrjen dhe rishikimin e të dhënave për ujërat nëntokësorë përfshirë zhvillimin e standardeve të të dhënave dhe shkëmbimin e mekanizmave për krijimin e komponentit të ujërave nëntokësorë të SAIM dhe analizën e boshllëqeve;

Zbatimin e standardeve të të dhënave dhe hedhjen e informacionit ekzistues në SAIM;

Të parashikohen veprimet e nevojshme për të kryer kërkimet e duhura për të pakësuar boshllëqet në informacionin e ujërave nëntokësore.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 6.3	Ndërmarrje e veprimeve prioritare në fushën e mbrojtjes të ujërave nëntokësore	MMPAU M:Ek.Treg.Energj. MPPTT Shërbimi Gjeologjik Shqiptar Autoritetet Planifikuese	II/2007	IV/2008		

Me përfundimin e politikës së mbrojtjes fillestare të ujërave nëntokësore, të cilës iu referuam më lart, do të nevojiten hapa për të zbatuar këtë politikë. Këtu do të përfshihen:

Adresimi i problemeve prioritare të administrimit të mbetjeve – Mbi bazën e njohurive ekzistuese të kushteve të ujërave nëntokësore dhe të ndikimeve të ndotjes, masat e përfshira në planet e administrimit të mbetjeve dhe në programet e përmirësimit të dëmtimeve mjedisore do të prioritarizohen në lidhje me kontributin e tyre për mbrojtjen e ujërave nëntokësore.

Adresimi i problemeve prioritare me tokat e ndotura.

Adresimi i problemeve prioritare me mbi/tej shfrytëzimin e burimeve – Si pjesë e procesit të rishikimit të lejeve, të cilave iu referohemi këtu dhe në Kapitullin 5, nxjerrjet nga pusët që dihet se shfaqin probleme (siç janë tërheqja e ujërave të kripura) do të kufizohen menjëherë në nivelin e tanishëm të autorizuar dhe të pakësohet me kalimin e kohës

Këtyre masave nuk iu janë caktuar kostot, meqenëse ato janë vlerësuar veçmas në seksione të tjera të strategjisë.

ABU7 Monitorimi i ujit

Si për monitorimin e sipërfaqësor ashtu edhe për atë nëntokësor duhen vendosur rrjetet përkatëse të komunikimit. Projekti CARDS i BE "Përforcimi i Monitorimit Mjedisor në Shqipëri" (StEMA) është duke zhvilluar programe të reja për një monitorim të tillë. Tanimë duhen caktuar kostot dhe afatet e shoqëruara me këto rekomandime.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
ABU 7	Implementimi i rekomandimeve të projektit StEMA në fushën e monitorimit të ujit.	MMPAU METE MPPTT Shërbimi Gjeologjik Shqiptar Autoritetet Planifikuese	II/2009	...		

Objektivat për Ujësjellës - Kanalizimet Urbane dhe Rurale

Objektivat	Treguesit e Rezultateve	2002	2004	2010	2015	2020
		Faza Fillestare			OMZH	
<b>Uji në Zonat Urbane</b>						
I. Të arrihen synimet e OMZH-së në Shqipëri: Mundësi e qëndrueshme për furnizimin me ujë të pastër dhe mundësi për përmirësimin e situatës në fushën e kanalizimeve.	(a) <b>Cilësia e ujit</b>	80	85	95	98	98
	Përqindja e popullatës së shërbyer e cila furnizohet me ujë të pastër (në përputhje me standardet e Shqipërisë për koliformet)					
	(b) <b>Sasia minimale</b>	3	4	12	18	20
	Numri mesatar i orëve të furnizimit me ujë në ditë					
	(c) <b>Sistem i Përmirësuar i Kanalizimeve</b>	68	70	78	85	90
	Përqindja e popullsisë e lidhur me rrjetin e kanalizimeve/shkarkimit të ujërave të zeza					
	(d) <b>Trajtimi i Ujërave të Zeza</b>		2	25	58	90
	Përqindja e popullsisë që lidhet me pajisjet e trajtimit të ujërave të zeza në përputhje me standardet e trajtimit të DTUZ.					
<b>Uji në Zonat Rurale</b>						
I. Të arrihen synimet e OMZH-së Shqipëri: Mundësi e qëndrueshme për furnizimin me ujë të pastër dhe mundësi për shfrytëzimin e sistemit të kanalizimeve.	(a) <b>Cilësia e ujit</b>			86	90	95
	Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pastër (në përputhje me standardet e Shqipërisë për koliformet)					
	(b) <b>Sasia minimale</b>	3	4	7	10	12
	Numri mesatar i orëve të furnizimit me ujë në ditë					
	(c) <b>Higjienë më e lartë</b>	37	40	55	65	75
Përqindja e popullsisë e lidhur me rrjetin e kanalizimit të shkarkimit të ujërave të zeza ose sistemet septike.						

**Kostot e Llogaritura të Programit**

Më poshtë jepen disa llogaritje të përafërta të kostos së mundshme (llogaritur me çmimet aktuale) të zbatimit të këtij programi. Këto përllogaritje duhet të shqyrtohen me kujdes pasi metoda e përdorur për të nxjerrë vlerat e dhëna në këtë tabelë ka bërë shumë supozime të thjeshtuara që do të kenë çuar në pasaktësi në këto përllogaritje.

Sektori	2006-2010	2011-2015	2016-2020	Gjithsej
	Milion,€			
<b>Ujërat në zonat Urbane</b>				
Lidhja me rrjetin e kanaleve të shkarkimit të ujërave të zeza	63.8	33.5	14.7	112
Pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza që i përmbushin standardet bazë të DTUZ (Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane).	72.7	79.4	82.3	234
<b>Ujërat në zonat Rurale</b>				
Lidhja me rrjetin e furnizimit me ujë	28.0	14.7	21.0	64
Përmirësimi i shërbimit (rritje e kohës së furnizimit me ujë)	72.7	75.6	79.8	228
<b>Shuma e Përgjithshme në Total për Programet e Ujërave, në milion €</b>				<b>638</b>
<b>Ujërat në Zonat Urbane</b>				
Lidhja me rrjetin e kanaleve të shkarkimit të ujërave të zeza	60.6	60.5	79.9	201
Pajisjet për trajtimin e ujërave të zeza që i përmbushin standardet bazë të DTUZ (Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane).	71.0	120.0	135.0	326
Lidhja me rrjetin e kanaleve të shkarkimit të ujërave të zeza ose sisteme të kënaqshme të gropave septike	80.7	117.0	101.6	299
<b>Totali i Përgjithshëm për Programet e Ujërave të Mbetura, në milion €</b>				<b>826</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>				<b>1464</b>



### 3.3.5 Mbrojtja e Tokës

*Mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së tokës në mënyrë që të maksimizohet pjelloria dhe të minimizohet erozioni dhe të parandalohet ndotja*

Sikurse është diskutuar në Komunikatën e Komisionit Europian “Drejt një Strategjie Tematike për Mbrojtjen e Tokës”<sup>10</sup> çështjet kyçe për mbrojtjen dhe administrimin e tokës mund të përshkruhen si më poshtë:

- Erozioni;
- Lënda organike;
- Kontaminimi i tokës;
- Ulja e përshkueshmërisë së tokës;
- Ngjeshja e tokës;
- Rënia e biodiversitetit të tokës;
- Kritja e përqendrimit të kripës;
- Përmbytjet dhe Rrëshqitjet e tokës.

Të gjitha këto çështje lidhen me Shqipërinë dhe të gjitha kërkojnë zgjidhje në periudhën afatmesme.

Duhet theksuar që aktualisht nuk ka një kuadër ligjor koherent brenda Bashkimit Europian për mbrojtjen e tokave. Strategjia e Komisionit Europian është që të bëhet një propozim për hartimin e një Direktive Kuadër për Tokën. Megjithatë, kjo ende nuk është bërë. Një sërë masash specifike marrin parasysh çështje të kontaminimit të tokës, përfshirë Direktivën (86/278/KEE), mbi hedhjen e pjesës së ngurtë apo gjysmë të ngurtë të ujërave të zeza në tokat bujqësore. Në ndryshimet e bëra në Politikën e Përbashkët Bujqësore, përfshihen më shumë dispozita të përgjithshme, sidomos dispozita të plotësimit reciprok, në bazë të të cilave, mirëmbajtja e tokës bujqësore në kushte të mira prodhimi dhe mjedisore, subvencionohet nga shteti.

Tani për tani, zhvillimi i një strategjie të veçantë për tokën në mënyrë që të zgjidhen këto probleme nuk konsiderohet prioritet, por duhet pranuar si kërkesë që duhet plotësuar në periudhën afatmesme. Një strategji e tillë duhet të pasqyrojë rezultatin e zhvillimeve ligjore në Komunitetin Europian. Edhe pse biodiversiteti i tokës njihet e pranohet si çështje e rëndësishme, tani për tani, ende nuk ka burime të mjaftueshme për të trajtuar plotësisht këtë çështje. Në të ardhmen, kjo do të shqyrtohet në Strategjinë për Tokat dhe në zbatimin e Strategjisë për Biodiversitetin dhe Planin e Veprimit.

Të tetë çështjet kyçe janë bashkuar në tre objektiva kryesore për mbrojtjen e drejtpërdrejtë të tokës dhe një objektiv që zgjidh nevojën për informacion:

- MT1 - Ulja e nivelit të erozionit të tokës dhe dëmeve që vijnë prej tij;
- MT2 - Mbajtja në gjendje të mirë prodhimi dhe mjedisore i tokave bujqësore;
- MT3 - Ulja e nivelit të ndotjes së tokave;
- MT4 – Vënia në dispozicion dhe publikim i të dhënave për administrimin e tokës.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, janë të rëndësishme një sërë masash të përfshira në seksionet e tjera të Strategjisë, por që janë referuar këtu. Në mënyrë të veçantë masat në lidhje me cilësinë e ajrit dhe administrimin e mbetjeve duhet të ndihmojnë në uljen e kontaminimit të tokave. Lidhja mes mbrojtjes së tokës dhe administrimit të burimeve të ujit është më e drejtpërdrejtë, sidomos në

<sup>10</sup> Bruksel, 16.4.2002 - KM(2002) 179 final

lidhje me praktikat e ujitjes. Në një periudhë më afatgjatë, nevojat për ujitje do duhet të balancohen me objektivat e caktuara në Planet për Administrimin e Baseneve të Lumenjve. Megjithatë, kjo nuk është e zbatueshme për momentin. Në periudhën afatshkurtër, duhet të përdoret sistemi i lejeve për hapjen e puseve të ujit për vaditje, që të mund të kontrollohen kështu, praktikat e papërshtatshme të vaditjes. Në zonat ku uji është i përshtatshëm për vaditje, lejet duhet të kufizohen në mënyrë që të inkurajohet përdorimi efikas i ujit dhe minimizimi i problemeve të kripëzimit. Në zonat ku uji nuk është i përshtatshëm për vaditje, lejet për hapjen e puseve për nxjerrjen e ujit, edhe nëse janë dhënë, do të duhet të anulohen ose pezullohen përkohësisht, në pritje të përmirësimeve të cilësisë së ujit. Kjo do të ketë efekt negativ mbi pronarët e tokave në ato zona, të cilët do kenë nevojë të inkurajohen dhe të përkrahen për të gjetur praktika alternative për të mbjellat e tyre.

Në rastin e erozionit është bërë një dallim mes erozionit në zonat e larta malore dhe erozionit në zonat e ulëta fushore. Edhe pse kjo “ndarje” nuk është aspak e përsosur ajo duhet kuptuar si e tillë, që përfshin një dallim mes zonave me pjerrësi të madhe dhe zonave me pjerrësi më të vogël. Në përgjithësi të parat përfshijnë pyje e zona pyjore kurse të fundit janë kryesisht bujqësore.

Instrumenti kryesor për administrimin e pyjeve dhe zonave pyjore (në zona të larta malore) janë Planet për Administrimin e Pyjeve. Zhvillimi dhe zbatimi i tyre nuk do të ndërpritet. Megjithatë, në zonat që përbëjnë prioritet, ndihet nevoja për të shpejtuar zhvillimin e tyre. Prandaj, do të futet në përdorim një sistem me plane të thjeshtuara. Ato duhet të zhvillohen me shpejtësi dhe masat që përmbajnë ato të zbatohen menjëherë. Në mënyrë të veçantë këto plane do duhet të trajtojnë:

Prerjen e paligjshme të druve për qëllime tregtie – kjo do të zgjidhet nëpërmjet masave kontrolluese dhe ndëshkuese për shkelësit e ligjit, të ngjashme me masat që përkrahen në lidhje me gjuetinë e paligjshme;

Prerjen e paligjshme për dru zjarri – kjo praktikë duhet ç’inkurajuar. Planet duhet të identifikojnë zonat ku sigurimi i burimeve alternative e të subvencionuar të lëndës djegëse, mund të përdoren për të ndihmuar komunitetet lokale që t’i japin fund kësaj praktike;

Duhet të hartohen gjithashtu projektet e nevojshëm që lidhen me planet për stabilizimin e tokës që është e rrezikuar nga rrëshqitjet dhe projektet për rimbjelljen e pemëve – këto do të bëhen nëpërmjet një procesi të shpejtuar e të mbështetur nga Fondi i Mjedisit.

Në periudhën afatgjatë këto plane do duhet të merren me objektivat për biodiversitetin dhe administrimin e qëndrueshëm afatgjatë të pyjeve pa dëmtuar mjedisin, por në periudhën afatshkurtër ndihet nevoja urgjente për të stabilizuar tokën dhe dheun në zonat më të prekura. Në këto kushte, do të inkurajohet përdorimi për gjelbërim i llojeve të barit, shkurreve dhe pemëve me rritje të shpejtë.

Në zonat e ulëta, ku prodhimi bujqësor është më intensiv, prezantimi dhe nxitja e aplikimit të “Kodit të Praktikës së Mirë Bujqësore” është e nevojshme për minimizimin e erozionit. Ky Kod do të mbulojë gjithashtu çështje të mirëmbajtjes së tokës dhe të përdorimit të inputeve agro-kimike. Bujqësia nuk është shkak i vetëm i erozionit në zonat e ulëta fushore dhe pylltaria nuk është i vetmi shkak në zonat e larta malore. Praktikrat e ndërtimit, që përfshijnë ndërtime rrugësh dhe ndërtesash, çojnë gjithashtu në probleme erozioni, sidomos nëpërmjet projektimit dhe zbatimit të dobët të kërkesave të kullimit. Prandaj, do të duhen gjithashtu një sërë dokumentesh udhëzuese për t’i dhënë një zgjidhje këtyre çështjeve. Meqë kanë zbatim të përgjithshëm, ato renditen këtu si masa të ndara:

- Udhëzime për minimizimin e Erozionit të Tokës të shkaktuar nga Ndërtimi i Autostradave – këto udhëzime do të duhet të hartohen në bashkëpunim me MPPTT-së – udhëzimet

duhet të sqarojnë dhe drejtojnë planifikimin e rrugëve, projektimin dhe ndërtimin e tyre. Këto udhëzime duhet të përfshihen në dokumentet e tenderave për ndërtimin e rrugëve. Kjo masë duhet të përfundojë brenda dy vjetësh nga dita e miratimit të kësaj SKM-je.

- Udhëzime për minimizimin e erozionit të tokës të shkaktuar nga ndërtimet e ndërtesave – kjo gjithashtu do të kërkojë bashkëpunimin e MPPTT-së – udhëzimet duhet të merren me pozicionimin, projektimin dhe ndërtimin e ndërtesave. Dispozitat e Kodit duhet t'u shpërndahen autoriteteve vendore, inspektorëve të ndërtimit dhe industrisë së ndërtimit. Kur të vijë koha, këto dispozita do të duhet të përfshihen në standardet e ndërtimit dhe duhet të bëhen kusht detyrues për lejet e ndërtimit. Kodi duhet të plotësohet dhe botohet brenda dy viteve nga miratimi i kësaj SKM-je.

Përmbytjet nuk janë trajtuar drejtpërsëdrejti në masat që përshkruhen këtu. Megjithatë, masat që lidhen me erozionin dhe ri-gjelbërimin e zonave të larta malore duhet të kontribuojnë ndjeshëm në zvogëlimin e efektit të “qarkut të shkurtër” që vjen si rezultat i tokës së zhveshur dhe kapacitetit të dobët mbajtës të saj, në zonat e larta malore të drenazhim-kullimit. Duke u siguruar që toka është e mbuluar më bimësi, uji i shirave mbledhet më me efikasitet në rezervuarë dhe rrjedhjet fuqishme ulen. Në një periudhë më afatgjatë, çështja e administrimit të rrezikut të përmbytjeve dhe parandalimi i tyre, duhet të trajtohet plotësisht nëpërmjet Sistemit të Planifikimit të Administrimit të Baseneve të Lumenjve, të përmendur e përshkruar në seksionin e ujit.

Monitorimi i tokës është tashmë një punë në proces dhe rezulton të jetë punë e një standardi të mirë. Megjithatë, ashtu si edhe programet e tjera të monitorimit, programi aktual ka nevojë të rishikohet dhe përmirësohet në maksimum. Përveç kësaj, duhet përmirësuar sistemi i administrimit dhe shpërndarjes së informacionit mbi gjendjen e tokave. Për trajtimin e kësaj çështjeje janë përfshirë e propozuar edhe masa konkrete.

### MT1 Ulja e nivelit të erozionit të tokës dhe dëmet që lidhen me të

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap. <sup>11</sup>	Shpenz. Op. Vjet. <sup>12</sup>
MT1.1	Programe fillestare për pakësimin e erozionit të brigjeve dhe shtretërve të lumenjve	MMPAU MPPTT Autoritetet Vendore dhe Rajonale Fondi Mjedisor	II/2007	II/2009		

Programi synon të përbëhet nga hapat e mëposhtëm:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave për vendosjen e brezave mbrojtës përgjatë lumenjve kryesorë – veprimtaritë ndërtimore në brezat mbrojtës duhet t'i nënshtrohen ndalimit ose kontrollit të rreptë
- Instruksione Ministrore të përbashkëta për ndalimin e lejeve të mëtejshme që duhen lëshuar për nxjerrjen e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve, përderisa ato të mos miratohen nga Ministri i MMPAU.

<sup>11</sup> Në milionë Lek

<sup>12</sup> Në milionë Lek

- Fushatë imponuese për të parandaluar nxjerrjen e paligjshme të zhavorrit nga shtretërit e lumenjve nga veprimtari joligjore, përfshirë përdorimin e gjobave, ndjekjeve penale si dhe publicitetin e politikës “turp të keni, por me emër”
- Përpilimi i inventarëve të zonave të erozionit të brigjeve dhe shtretërve të rëndësishëm të lumenjve duke përdorur të dhëna ekzistuese dhe vëzhgimeve të autoriteteve vendore
- Prioritarizim i zonave të erozionit të lumenjve dhe përgatitja e projekteve me synim përmirësimin për t’ia paraqitur Fondit Mjedisor

Kostot e masave ligjore që gjenden në programin fillestar nuk janë identifikuar veçmas. Megjithatë, ndërmarra e fushatës së imponimit dhe ajo e hartimit të inventarit do të kërkojnë punë shtesë për Agjencitë Rajonale Mjedisore dhe Autoritetet Vendore

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
MT1.2	Vendosja e sistemit të thjeshtësuar të Planeve prioritare të Pyjtarisë dhe të Administrimit të Kullotave malore (PPAPK) për krijuar mundësinë për zbatim të shpejtë të rimbjelljes dhe të masave të emergjencës për t’iu adresuar zonat e prekura më keq	MMPAU MPPTT Autoritetet Vendore dhe Rajonale Fondi i Mjedisit	II/2007	II/2009		

Vendosja e këtij sistemi do të kërkojë::

- Udhëzime për autoritetet vendore dhe Shërbimin e ndaj Pyjeve për zhvillimin e Planeve Prioritare të Pyjtarisë dhe të Administrimit të Kullotave malore (PPAPK) të thjeshtësuar përfshirë parandalimin e prerjet kundërligjore, masat për rimbjellje e përmirësim për të siguruar qëndrueshmërinë e tokës;
- Hartimi i inventarit për zonat të prekura më keq dhe prioritetet për zbatimin e sistemin e thjeshtësuar të PPAPK;
- Zhvillim i përbashkët i PPAPK -ve prioritare të thjeshtësuar për zonat prioritare përfshirë përgatitjen e synimeve të projekteve për masat urgjente të përmirësimit;
- Krijim i rrymave prioritare për projektet e administrimit urgjent të pyjtarisë brenda Fondit Mjedisor;
- Përpilim dhe zbatim i projekteve prioritare nëpërmjet Fondit Mjedisor.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
MT1.3	Pakësim i erozionit të ultësirave nëpërmjet përfshirjes së masave për të minimizuar erozionin e tokës në Kodin e Praktikës së Mirë Bujqësore	MMPAU MBUMK Shërbimi Këshillimor Fondi i Mjedisit	II/2007	II/2009		



Që kjo masë të jetë e suksesshme Kodi ka nevojë të promovohet nga Shërbimi i Këshillimor.

Ndonëse konsiderohet se ka pak gjasa që të ketë nevojë për zbatimin e masave në zonat e prekura më keq në vendet e ulëta, prapëseprapë do të jetë e rëndësishme të:

- Kompilohen inventarë të zonave të prekura më keq të ultësirave dhe të bëhet prioritarizimi për zhvillimin e synimeve të projektit për përmirësim
- Përpilim dhe zbatim i projekteve prioritare nëpërmjet Fondit Mjedisor

## MT2 Mirëmbajtja e tokave në kushte të mira mjedisore dhe bujqësore

Termi “kushte të mira mjedisore dhe bujqësore” është marrë nga rregullorja e re e Komunitetit Europian që përcakton masat e subvencioneve të pasqyruara në “Politikën e Përbashkët Bujqësore”.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
MT2.1	Përcaktimi i Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore për administrimin e tokave dhe në veçanti lidhur me strukturën e tokave dhe praktikën e mira të plugimit – përfshirë kultivimin në shpatet për të trajtuar erozionin	MMPAU MBUMK Shërbimi Këshillimor Fondi i Mjedisit	II/2007	II/2009		
MT2.2	Zbatimi i dispozitave për riciklimin dhe kompostimin për shfrytëzimin e mbetjeve organike (qofshin ato urbane, ujëra të mbetura, bujqësore, apo industriale) dhe përdorimi i tyre si përmirësues të cilësisë së tokës në zonat me përmbajtje të ulët të lëndëve organike – projektet do të identifikohen në kuadrin për planifikimin dhe administrimin e mbetjeve.	MMPAU MBUMK MPPTT Shërbimi Këshillimor Fondi i Mjedisit	IV/2009	IV/2011		
MT2.3	Kufizimet lidhur me nivelet e lejuara të nxjerrjes së ujit për vaditje në zonat e prekura, me qëllim që të nxitet efikasiteti i ujitjes – një gjë e tillë do të kërkojë veprim të koordinuar nga shërbimi këshillimor dhe autoritetet e dhënies së lejeve si pjesë e procesit të rishikimit të lejeve për ujin.	MMPAU MBUMK Shërbimi Këshillimor Fondi i Mjedisit	II/2010	...		

Përveç çështjeve të trajtimit të erozionit të tokave, ky aspekt i Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore do të trajtojë edhe çështjet e :

- Lëndës Organike të Tokës; ruajtja dhe shtimi i saj;
- Strukturës së Tokës; parandalimi i ngjeshjes;

- Kripëzimi i Tokës; optimizim i ujitjes dhe kullimi për të minimizuar rreziqet e kripëzimit;
- Që futja e Kodit të jetë efikase, duhet të shoqërohet me një fushatë këshillimore për të nxitur praktikatat e mira të kultivimit në zonat e ndjeshme ndaj erozionit dhe ngjeshjes. Kjo ka nevojë të trajtohet nga Shërbimi Këshillimor.

### MT3 Ulja e kontaminimit të tokës

Nuk janë propozuar masa specifike përveç atyre, të cilat tanimë janë identifikuar në seksione të tjera të kësaj Strategjie.

Ndotja nga depozitimet e transmetuara me rrugë ajrore do të sigurohet nëpërmjet masave për të përmirësuar cilësinë e ajrit në përgjithësi. Ndotja e tokave nga si pasojë e mbeturinave, copërave dhe hedhjeve jashtëligjore të mbetjeve do të trajtohet nëpërmjet masave të Administrimit të Mbetjeve të specifikuara më lart, ndërsa ndotja e tokave nga përdorimi i papërshtatshëm i lëndëve agrokimike do të jenë një temat e Kodit të Praktikës së Mirë Bujqësore (përfshirë kimikatet bujqësore). Meqenëse ndotja e ujit në ujërat mbitokësore është pakësuar nga vendosja e lejeve më të rrepta dhe ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të mbetura, rreziku i ndotjes nga ujërat e ujitjes do të pakësohet së tepërmi. Ndërkohë ka nevojë të vendosen kufizime për nxjerrjen e ujërave të ndotura për ujitje në zonat e prekura – kjo do të kërkojë veprime të koordinuara nga shërbimi këshillimor dhe autoritetet lejedhëse si pjesë e procesit të rishikimit të lejeve për ujin (shih më lart dhe Kapitullin 5).

### MT4 Sistemi i Informacionit për Tokën

Në periudhën afatgjatë informacioni për tokën do të jetë shumë i vlefshëm. Për pasojë, është e rëndësishme që programi i monitorimit të tokave ekzistuese duhet të vazhdojë. Synohet që një rishikim i dispozitave ekzistuese për monitorimin e tokave dhe zhvillimi i një programi të revizionuar 3 vjeçar për monitorimin e tokave, përfshirë specifikimin e metodave, vendndodhjeve dhe parametrat të ndërmerren në të ardhmen. Kjo do të përfshijë zhvillimin dhe marrëveshje të një formati për regjistrimin dhe ruajtjen në formë elektronike të të gjithë të dhënave të monitorimit të tokave, në atë mënyrë që ajo mund të integrohet në Sistemin e Administrimit të Informacionit Mjedisor.



### 3.3.6 Biodiversiteti

*Mbrojtja dhe pasurimi i biodiversitetit, zonave të mbrojtura dhe specieve, në mënyrë që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë, për të përmbusur angazhimet tona në nivel European dhe ndërkombëtar.*

Mbrojtja e biodiversitetit është një nga elementet kyç të zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) është miratuar në 1999. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin është dokumenti kryesor që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat për administrimin e biodiversitetit në Shqipëri, për periudhën 2000 - 2015 dhe kjo gjen pasqyrim në këtë Strategji Kombëtare të Mjedisit. Siç shpjegohet në përmbledhjen ekzekutive të kësaj Strategjie Kombëtare për Mjedisin, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin është një komponent bazë i politikës së përgjithshme të mjedisit. SPVB është një nga nënsektorët e shumëve specifike të programeve të veprimit të cilët nevojiten për të shoqëruar SKM në mënyrë që të sigurohet arritja e objektivave të saj. Nuk është praktike që këtë dokument të përfshihen të gjitha veprimet dhe masat nga SPVB. Elementët kyç të SPVB që janë pasqyruara këtu, kanë nevojë të shikohen në kontekstin e SPVB në tërësi.

Megjithëse është bërë progres i konsiderueshëm në zbatimin e Strategjisë së Biodiversitetit, është e nevojshme që akoma të ndërmerren disa veprime kyçe. Këto veprime janë edhe fokusi i synimeve dhe masave të përcaktuara këtu.

Shqipëria ka një numër të madh ligatinash dhe lagunash bregdetare. Ligatinat janë shumë të rëndësishme për biodiversitetin, administrimin e ujit dhe qëllimet ekonomike (përfshirë turizmin). Ato duhet të ruhen, administrohen në mënyrë të qëndrueshme dhe në disa raste dhe të rehabilitohen. Për të treguar rëndësinë e tyre, në vitin 2005 u miratua Strategjia e Ligatinave. Zbatimi i Strategjisë së Ligatinave përbën gjithashtu fokusin kryesor të synimeve dhe masave të përcaktuara këtu. Megjithatë, ashtu si dhe në rastin e SPVB masat e pasqyruara në SKM, duhen parë në kontekstin e Strategjisë së Ligatinave si të tërë dhe si pjesë e zbatimit të vazhdueshëm të programit tërësorë që gjendet në Strategjinë e Ligatinave.

Qëllimet thelbësore për ruajtjen e biodiversitetit janë :

- Përfaqësim i të gjithë komuniteteve të ndryshme natyrore, brenda rrjeteve të ruajtjes së peisazheve dhe zonave të mbrojtura ;
- Ruajtja e proceseve ekologjike dhe evoluese që krijojnë dhe mbështesin biodiversitetin;
- Ruajtja e popullatave të specieve ekzistuese;
- Ruajtja e blloqeve të habitateve natyrore, të cilët janë të një madhësie të tillë, që të mund të përballojnë çrregullimeve si në shkallë të gjerë dhe të çrregullt, ashtu edhe atyre afatgjata.

Rezultatet kyçe që duhen arritur për realizimin e këtyre qëllimeve:

- Përmirësimi i administrimit të zonave të mbrojtura ekzistuese dhe i llojeve, për t'u siguruar që objektivat e vëna në këto fusha janë arritur ;
- Zgjerimi i rrjetit të zonave të mbrojtura, me qëllim që të mbulohen të gjitha habitatet përfaqësuese detare, bregdetare dhe tokësore;
- Të përmirësohet përputhja e dispozitave ligjore ekzistuese mbi mbrojtjen e biodiversitetit;
- Të përmirësohet informacioni dhe të dhënat mbi administrimin e biodiversitetit.

SPVB-ja ka përdorur kriteret e mëposhtme për identifikimin e prioritetëve për planet e veprimit dhe zgjidhjet që kanë të bëjnë me speciet dhe habitatet e tyre:

1. Speciet dhe habitatet e rrezikuara me rëndësi globale, rajonale dhe kombëtare;
2. Habitatet që përmbajnë specie endemike apo vlera të larta të biodiversiteti;
3. Speciet apo habitatet që rrezikojnë zhdukjen e plotë;
4. Speciet apo habitatet që nga të cilat do të nxirreshin fitime ekonomike lokale dhe kombëtare;
5. Speciet apo habitatet për përfitime edukative në nivel lokal dhe kombëtare ;
6. Speciet ose habitatet e rrezikuara, të cilat mund të mbrohen më mirë nëpërmjet politikave më të përshtatshme dhe shfrytëzimit më me kriter;
7. Veprimet nga të cilat mund të nxirren përfitime ekonomike, ekologjike dhe sociale.

Për të caktuar prioritetet brenda kësaj Strategjie Kombëtare për Mjedisin, janë përdorur kriteret e mëposhtme për të identifikuar problemet mjedisore më prioritare që lidhen me biodiversitetin dhe peisazhin:

Lloji, numri dhe statusi i burimit(eve) që rrezikohet(n)- mbështetur në kriteret 1 dhe 2 të SPVB, por gjithashtu duke marrë parasysh edhe statusin e habitateve/specieve;

Tipi i ndikimit apo ndikimi i mundshëm – bazuar në kriterin 3 të SPVB;

Kostoja e ndikimit apo ndikimi i mundshëm mjedisor, shoqëror dhe ekonomik - mbështetur në kriteret 4, 5 dhe 7 të SPVB;

Detyrimet ligjore për të ndërmarrë hapa për zbutjen e ndikimeve (në përputhje me ligjet e vendit ose konventat ndërkombëtare, etj);

Megjithatë, duhet marrë parasysh edhe realizimi i ndërhyrjeve që kërkohet të bëhen. Në këtë kontekst, kjo lidhet me:

Koston e veprimit;

Shkallën. e përfitimit nga kostoja mjedisore, sociale dhe ekonomike që del nga veprimi i ndërmarrë;

Gjasat e suksesit (p.sh. kriteri 6 i SPVB).

Një shkallë shumë e gjerë aktivitetesh rrisin ndikimin mbi biodiversitetin. Si rrjedhim, nevojitet të ndërmerret një shkallë e gjerë masash. Prandaj, për përmbushjen e objektivave për mbrojtjen e biodiversitetit, nevojiten një numër i madh masash të cilat janë përfshirë në seksionet e tjera të kësaj strategjie, përfshirë:

- Administrimin e Integruar të Zonës Bregdetare – për peisazhin;
- Planifikimi për Administrimin e Basenit të Lumenjve – në administrimin e burimeve ujore;
- Nxjerrja dhe ndotja e ujit – në administrimin e burimeve ujore;
- Planifikimi për përdorimin e Tokës dhe kufizimet përkatëse – në peisazhet
- Administrimi i mbetjeve – në administrimin e mbetjeve

Integrimi i prioriteteve mbi biodiversitetin dhe marrja e tyre në konsideratë në këto fusha , është shumë i rëndësishëm. Prandaj, i është dhënë një rëndësi e veçantë rinovimit dhe përmirësimit të iniciativave të mëparshme për të siguruar këtë integrim. Në mënyrë të veçantë është theksuar sigurimi i informacionit dhe udhëzimeve jo-teknike dhe informacion për organet shtetërore, duke i ndihmuar ata për të mbështetur objektivat mbi biodiverstetin.

Është arritur një progres i konsiderueshëm me caktimin e zonave të mbrojtura, , por nevojitet të ndërmerren hapa të mëtejshme në këtë drejtim, të cilat përshkruhen këtu.

Megjithatë, caktimi i zonave të mbrojtura nuk mjafton për të siguruar mbrojtjen e tyre. Planet e administrimit dhe zbatimi i dispozitave të këtyre planeve është çështje kyçe. Kërkohej një zbatim urgjent dhe i koordinuar i dispozitave kryesore dhe për mekanizmat që do ta realizojnë këtë janë përfshirë projekt propozime.

Do të nevojiten burime shtesë brenda Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të cilat do të ndërmarrin shumë nga masat që përfshihen në këtë Strategji. Edhe pse këtu nuk përfshihen si masa specifike, ato do të luajnë rol thelbësor për të siguruar zbatimin e menjëhershëm të rekomandimeve të bëra në Vetë-Vlerësimin e Nevojave për Kapacitete për Konventën mbi Biodiversitetin (projekt i PZHKB- FGM). Këto rekomandime do të sigurojnë masat kryesore që nevojiten. Megjithatë, përfshihet një masë e veçantë që duhet të zbatohet sido që të vijë puna. Është specifikuar si masë për periudhën afatshkurtër – afatmesme, krijimi i një organi ekspertësh , që të mbështesë punën e MMPAU. . Ky institut do të jetë pjesë e Institutit të Mjedisit.

Këtu përfshihen gjithashtu edhe dispozita për zhvillimin e projekteve për biodiversitetin që do të financohen nga Fondi i Mjedisit. Një kapitull i veçantë do t'i kushtohet Mbrojtjes së Natyrës brenda fondit. Ekzistojnë shumë shembuj të mirë të projekteve të asistencës së huaj (psh. Projekti i Lagunës së Karavastasë) i cili do të përdoret për të hartuar udhëzime për Komitetin e Zonave të Mbrojtura dhe administratën që merret me administrimin e Parkut Kombëtar, lidhur me përgatitjen e projekteve.

Monitorimi i Biodiversitetit është thelbësor për administrimin e zonave të mbrojtura dhe zbatimin e planeve të veprimit për speciet. Pa informacionin e nxjerrë nga ky monitorim nuk mund të vlerësohet efikasiteti i planeve dhe masave, nuk mund të përcaktohet statusi i ruajtjes së tyre.

Megjithatë, në rast se informacioni i marrë nga një monitorim i tillë dhe të dhënat e tjera që kanë lidhje me mbrojtjen e biodiversitetit nuk administrohen me efikasitet dhe nuk shpërndahen, atëherë do të kenë vetëm një vlerë të kufizuar. Prandaj, është parashikuar zhvillimi i elementit specifik për biodiversitetin në Sistemin e Administrimit të Informacionit për Mjedisin (SAIM).

Është e nevojshme të merren një grup masash të veçanta, përtë mbështetur vënien në zbatim të sistemit të ri për Planifikimin e Administrimit të Peshkimit.

Është e nevojshme të ekzaminohen masa të veçanta për rehabilitimin e zonave jo-të mbrojtura të cilat kontribuojnë në eko-korridoret. .

#### B1 Forcimi i Kuadrit Ligjor për Mbrojtjen e Natyrës

Detyrimet që lindin nga konventat ndërkombëtare dhe harmonizimi me legjislacionin e Komunitetit Europian. Siç është deklaruar dhe në PKPL masat legjislative afatshkurtra përfshijnë (deri në fund të 2007) :

Ligjin “Mbi Mbrojtjen e Biodiversitetit” – përafrim i pjesshëm i Direktivës mbi Habitatet dhe Natyrën, 2000;

Vendim i Këshillit të Ministrave “Mbi Shpalljen e Zonave të Mbrojtura” – përafrim i pjesshëm i Direktivës për Habitatet dhe Natyrën, 2000 – do të shpallë zona të reja të mbrojtura, me synimin që 14 përqind e territorit të vendit të jetë shpallur deri më 2009;

Projektligji “Mbi Tregtinë e Llojeve” në përafrim të pjesshëm të Direktivës 83/129/EEC, Rregullorja 348/81/EEC, 1771/94/KE, 348/81/KE;

Ligji Nr. 8906 i datës 06.06.2002 "Mbi Zonat e Mbrojtura" do të mbështetet nga aktet e mëposhtme::

"Mbi Përdorimin e Rezervave të Menaxhuara Natyrore nga Turistët";

"Rregullorja mbi Monumentet e Natyrës të Shqipërisë ";

Në periudhën 2008 – 2010 prioritetet legislative do të jenë:

Projektligji "Mbi Mbrojtjen e Zogjve të Egër", në përputhje me Direktivën 79/409/EEC dhe amendamentet ;

Rregullorja mbi "Tregtinë e Llojeve";

Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura ;

Në periudhën afatgjatë (pas 2010) prioritetet legislative do të jenë:

Projektligji "Mbi Mbrojtjen e Kafshëve në Kopshtet Zoologjike dhe Përdorimin e tyre për Qëllime Eksperimentale dhe Shkencore" në përputhje me Direktivat 2003/65/KE, 1999/22/KE, 86/609/KE dhe Vendimet e Komisionit 90/67/EEC, 1999/575/KE;

Projektligji "Mbi Tregtinë e Gëzofëve" në përputhje me Direktivën 83/129/EEC

Këto masa ligjore do të përgatiten duke përdorur personelin aktual të Drejtorisë për Mbrojtjen e Natyrës në MMPAU, por kjo do të kërkojnë trajnim, asistencë teknike dhe kosto të shumta të shoqëruara me futjen e legjislacionit. Kostot për ndërtimin e kapaciteteve dhe përgatitjen e legjislacionit deri më 2009 janë vlerësuar këtu:

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucioni (et) Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenzimet Kapitale <sup>13</sup>	Shpenzimet Operacionale Vjetore. <sup>14</sup>
B1.1	Përmirësimet afatshkurtra në legjislacionin e mbrojtjes së natyrës	MMPAU	I/2007	IV/2008	4	
B1.2	Vënia në zbatim e ligjit të Biodiversitetit, përfshirë trajnimin CITES	MMPAU	I/2007	IV/2007	3.8	
B1.3	Vënia në zbatim e Direktivës së Zogjve	MMPAU	I/2009	IV/2009	2.5	

Sidoqoftë, futja e legjislacionit ka nevojë të shoqërohet me rritjen e kapaciteteve të administrimit dhe vënies në zbatim . Në veçanti, duhet të përcaktohen rregullimet për anën institucionale në periudhën afatmesme, përfshirë:

Përgatitjen e një kuadri institucional për një Autoritet Shkencor dhe Administrimi për të zbatuar Konventën CITES në Shqipëri;

Përcaktimin e një organi inspektues kompetent për monitorimin e aktivitetit tregtar me Llojet e Faunës dhe Florës së Egër; Hartimi i Planit zbatues CITES;

<sup>13</sup> Në milionë Lek

<sup>14</sup> Në milionë Lek

Në periudhën afatmesme, do të jetë gjithashtu e domosdoshme të vendoset një skemë e rreptë licensimi e detyrueshme për importimin dhe eksportimin e llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër, përfshirë vendosjen e skemës së inspektimit doganor gjatë transportit..

Në periudhën afatgjatë duhen trajtuar çështjet e mëposhtme :

Krijimi i një organi kompetent për licensimin e kopshteve zoologjike;

Krijimi i një sistemi për monitorimin e licensave, inspektimit dhe vënies në zbatim;

Krijimi i një Komiteti Këshillimor për mbrojtjen e kafshëve që përdoren për qëllime shkencore;

Krijimi i një sistemi monitorues për kontrollin e përdorimit të kafshëve për qëllime shkencore dhe eksperimentale.

Në periudhën më afatgjatë, përcaktimi i zonave të mbrojtura do të rritet gradualisht duke pasur si pikësypnim të sigurohen që:

të gjitha tipet e ekosistemeve të jenë të përfaqësuara në rrjetin e zonave të mbrojtura

rrjeti të jetë koherent dhe të mbështesë objektivat e Planit të Veprimit për Llojet

Përcaktimet e zonave të mbuluara nga Natura 2000 të arrijnë <sup>15</sup> një minimum prej 11% në 2011 dhe shkojnë në 15% në 2015 dhe në 18% në 2020.

## B2 Përforsimi i Administratave të Administrimit të Mbrojtjes së Natyrës

Administrimi i zonave të mbrojtura duhet të përforsohet me qëllim që të sigurohet përgatitja dhe zbatimi i planeve të administrimit për këto zona, dhe të sigurohet që ato të arrijnë statusin e ruajtjes së favorshme , siç kërkohet nga ligji. Masat për përforsimin e administratës në periudhën deri në fund të 2009 janë specifikuar këtu:

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenzimet Kapitale	Shpenzimet Operacionale
B2.1	Përforsimi i administratës së 'Zonave të Mbrojtura të Dajtit dhe Divjakës' (5 persona)	MMPAU	I/2007	IV/2007	1.3	1.5
B2.2	Përforsimi i administratës së 'Zonave të Mbrojtura të 'Llogarait dhe Kunes' (3 persona)	MMPAU	I/2007	IV/2007	1.3	0.9
B2.3	Përforsimi i administratës së 'Zonave të Mbrojtura Tomorr, Rajcë Shebenik' (punësohen 2 persona të rinj)	MMPAU	I/2008	IV/2008	1.3	0.6
B2.4	Përforsimi i administratës së 'Zonave të Mbrojtura Hotova dhe Lura Bredhi' (2 persona)	MMPAU	I/2009	IV/2009	1.3	0.6

<sup>15</sup> Duhet theksuar se vendndodhjet e Natura 2000 janë përcaktuar në vijim të Direktivës së Habitave dhe përfaqësojnë vetëm një pjesë të rrjetit të zonave të mbrojtura

Këto kosto lidhen vetëm me ndikimin në administratën publike. Administrimi i përmirësuar i zonave të mbrojtura do të çojë në një rritje të vlerës së tyre ekonomike për turizmin dhe për ekonominë në përgjithësi.

Ndërsa përforcimi i Administratave të Mbrojtjes së Natyrës do të ndihmojë që të sigurohet administrimi i tyre ashtu siç duhet, Administratat do të kenë nevojë të ndihmohen nga autoritete të tjera, me qëllim që të sigurohet vënia në zbatim e kufizimeve dhe kontrolleve të nevojshme në zonat e mbrojtura. Prandaj, MMPAU synon të diskutojë një marrëveshje Ndërminstrore (midis Agjencive) për mbikëqyrjen e Planeve të Administrimit të Zonave të Mbrojtura, me të gjitha agjencitë rregullatore përkatëse, përfshirë policinë dhe inspektorate të tjera, që të rrisë në maksimum zbatimin e kufizimeve dhe kontrolleve të Zonave të Mbrojtura (ZM). Kjo do të kërkojë:

Krijimin e mekanizmit raportues dhe koordinues për mbikëqyrjen e planeve të kufizimit të Zonave të Mbrojtura (ZM) në vijim të marrëveshjes Ndërminstrore

Botimi i udhëzimeve në vijim të marrëveshjes Ndërminstrore për të drejtuar agjencitë rregullatore për vënien në zbatim të kufizimeve të planit të ZM

Hartimi i një udhëzuesi Ndërminstrore për autoritetet kryesore vendore për respektimin e kufizimeve dhe kontrolleve, që kanë të bëjnë me zhvillimet e paautorizuar në zonat e mbrojtura, duke përforcuar regjimin e imponimit

### B3 Zhvillimi i planeve të administrimit për të gjitha zonat e mbrojtura

Pas përcaktimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura, hapi tjetër është zhvillimi i planeve të administrimit për të siguruar arritjen e statusit të të ruajtjes së favorshme për elementët e mbrojtur.

Kjo është faza e parë në përmirësimin e administrimit të zonave të mbrojtura, dhe kërkon që të ndërmerren hapat e mëposhtme:

Botimin e formatit të thjeshtësuar për versionet fillestare të planeve të administrimit të zonave e mbrojtura për të trajtuar kërkesat bazë.

Sigurimin e ngritjes së Komiteteve për çdo zonë të mbrojtur

Zhvillimi i programeve për përfundimin e versioneve fillestare të planeve të administrimit për çdo Zonë të Mbrojtur (ZM)

Vënia në zbatim e programit për administrimin e planeve të zhvillimit

Kjo do të kërkojë emërimin e një personeli shtesë në Administratat e Zonave të Mbrojtura, siç u tha më sipër. Administratat duhet të punojnë me Komitetet e Zonave të Mbrojtura për zhvillimin e planeve të administrimit. Faza e parë e planeve të administrimit do të përfundojë për zonat e përcaktuara aktualisht deri në fund të vitit 2009.

Në kohën e duhur duhet të hartohen plane më të detajuara për këto zona dhe duhen hartuar planet për zonat e përcaktuara kohët e fundit. Synohet që gjithë vendndodhjet, të cilat janë caktuar para fundit të vitit 2012 do të kenë plane të plota zhvillimi në fund të vitit 2015.



**B4 Forcimi i Masave të Administrimit të Llojeve të Mbrojtura**

Ashtu si edhe me zonat e përcaktuara, është e nevojshme që të përgatiten dhe planet e administrimit për llojet, të cilat janë shpallur si të mbrojtura. Ashtu si edhe me zonat e mbrojtura do të ndërmerret një trajtim hap pas hapi për zhvillimin e këtyre planeve përfshirë:

Botimin e formatit të thjeshtësuar për versionet fillestare të planeve të administrimit, në mënyrë që të trajtohen kërkesat bazë

Zhvillimi i programeve për përfundimin e versioneve fillestare të planeve menaxhuese për çdo lloj të mbrojtur më 2012

Ngritja e grupve të punës ad hoc me kohë të kufizuar për përgatitjen e planeve të veprimit mbi llojet, në përputhje me programet

Vënia në zbatim e programit për zhvillimin e planit të veprimit për llojet

Hartim i programeve për rishikimin e planeve të veprimit për llojet dhe përfundimi i versioneve të plota të planeve më 2018

Kryerja e këtyre detyrave do të kërkojë përforcimin e Drejtorisë së Mbrojtjes së Natyrës. Synohet që kjo të shtyhet deri më 2010 duke i dhënë përparësi në periudhën afatshkurtër, përforcimit të administratave të zonave të mbrojtura.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenzimet Kapitale	Shpenzimet Operacionale
B4.1	Përforcim i Drejtorisë së Mbrojtjes së Natyrës (2 persona)	MMPAU	I/2010	IV/2010	1.3	1.1

Megjithatë, veprimi për të mbrojtur llojet e caktuara nuk mund të vonohet. Për pasojë synohet që marrëveshja Ndërminstrore, të cilës iu referuam më sipër, duhet të përfshijë gjithashtu mbrojtjen e llojeve. Kjo do të kërkojë hartimin e udhëzimeve për agjencitë rregullatore, mbi zbatimin e masave për llojet e mbrojtura. Në veçanti, mbrojtja e faunës nga gjuetia dhe kapja ilegale është një çështje serioze, e cila duhet trajtuar me urgjencë. Ndonëse mbeten paqartësi të konsiderueshme në lidhje me masat praktike, të cilat mund të ndërmerren, MMPAU do të propozojë për miratim metodën e mëposhtme, si pjesë e marrëveshjes Ndërminstrore:

Të ndërmerret fushata për pakësimin e numrit të armëve të zjarrit të palicencuara përfshirë:

1. Amnisti për dorëzimin e armëve të zjarrit të palicencuara
  2. Auditim i furnizuesve me armë zjarri për të pakësuar shitjen e armëve të zjarrit të palicencuara
  3. Mbikëqyrje e synuar dhe detyruese
  4. Publicitet për masat detyruese
- Të ndërmerret një fushatë koordinuese për të pakësuar nivelet e gjuetisë ilegale përfshirë:
1. Mbikëqyrje e synuar dhe detyruese
  2. Publicitet për masat detyruese të cilat kanë rezultuar të suksesshme, duke i përfshirë në artikuj në shtypin kombëtar, vendor dhe atë të specializuar – fushatë demaskuese
  3. Një linjë telefonike anonime “falas” për raportimin e veprimtarive ilegale të gjuetisë

### B5 Zbatim i Planeve të Administrimit të Zonave dhe Llojeve të Mbrojtura

Ndërsa hartimi i planeve të administrimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura është një hap kyç, i cili po të shoqërohet me përforcimin e strukturave institucionale do të ndihmojë shumë në ruajtjen e trashëgimisë natyrore të Shqipërisë, po ashtu duhen bërë përgatitje për të marrë masat për investime kapitale të identifikuar në këto plane administrimi, në të kundërt ato nuk do të jenë efektive. Kostot e sakta të investimeve të parashikuara në planet e administrimit nuk mund të përcaktohen, derisa ato të përgatiten. Megjithatë, synohet që një komponent specifik i Fondit të Mjedisit t'i kushtohet zonave dhe llojeve të mbrojtura.

Për krijimin e këtij komponenti të Fondit të Mjedisit do të jetë e nevojshme të:

Jepen udhëzimet për Komitetet e ZM dhe organeve menaxhuese të Parkut Kombëtar, mbi përgatitjen e synimeve të projektit për vënien në zbatim të iniciativave të planit menaxhues të ZM

Krijimi i një programi rregullator trevjeçar për identifikimin e projektit, prioritarizimin dhe vënien në zbatim të projekteve të Zonave të Mbrojtura, brenda skemës së përgjithshme të Fondit të Mjedisit

Të sigurohet që objektivat e administrimit të zonave të mbrojtura, janë përfshirë si kriter kyç në udhëzimin e Administrimit të Mbetjeve dhe kriteret e përzgjedhjes së projekteve

Të sigurohet që objektivat e administrimit të zonave të mbrojtura janë përfshirë si një kriter kyç në udhëzimin e Kanalizimeve dhe në kriteret e përzgjedhjes së projekteve

Të hartohen kriteret brenda procedurave të Fondit të Mjedisit për përzgjedhjen e projekteve, në mënyrë që tu jepen prioritetet e duhura, projekteve që mbështesin arritjen e objektivave të Planit të Administrimit të Zonave të Mbrojtura

Në kohën e duhur, do të merret parasysh krijimi i njësive administrative të Zonave të Mbrojtura, që do të veprojnë si njësi me buxhet financiar të "pavarur" që buron nga të ardhurat e krijuara nga Zonat e Mbrojtura dhe nga mbështetja qendrore.

### B6 Integrimi i objektivave të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin në politikën shtetërore

Vlerësimi Strategjik Mjedisor, i strategjive të sektorëve kyç, të mëposhtëm, në përputhje me masat e specifikuar në seksionin e Integritit (Kapitulli 5) janë të nevojshme në mënyrë që të sigurohemi që ato të mos bien ndesh me Strategjinë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin:

\_ - Bujqësia

Energjia

Transporti

Turizmi

Në praktikë kjo do të kërkojë nga MMPAU që të nxjerrë një përmbledhje të instruksioneve Ministrore (jo-teknike), si udhëzime për Ministrinë kyçe, duke i ndihmuar ato në realizimin e integritit të objektivave të biodiversitetit në strategjitë sektoriale, si pjesë e procesit të rishikimit të VSM. Përveç kësaj, MMPAU do të nxjerrë nëpërmjet Instruksionit Ministror një udhëzues (jo-teknik) për autoritetet vendore, mbi masat që ato duhet të marrin, për përgatitjen e planeve hapësinore vendore dhe të zhvillimit (ose të integruara), për të kontribuar në përmbushjen e objektivave të SPVB.

**B7 Monitorimi i Biodiversitetit dhe Administrimi i Informacionit**

Tashmë është bërë një punë e konsiderueshme për të krijuar një baza të dhënash dhe regjistrime mbi biodiversitetin në Shqipëri. Megjithatë, përsëri kërkohet punë shtesë për t'u siguruar që janë të disponueshme të dhënat për zhvillimin e planeve të përshtatshme të administrimit dhe që të përputhen me kërkesat e legjislacionit kombëtar, të Komunitetit European dhe atij ndërkombëtar.

Për pasojë, synohet të krijohet një njësi ekspertësh brenda së Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit, e cila do të sigurojë mbështetjen teknike për Drejtorinë e Mbrojtjes së Natyrës në MMPAU.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenzimet Kapitale	Shpenzimet Operacionale
B6.1	Ngritja e Njesisë për Mbrojtjen e Natyrës brenda Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit	MMPAU	I/2008	IV/2009	15	7

Njësia do të veprojë si një qendër ekspertize për biodiversitetin, e cila do të sigurojë mbështetje dhe këshillim si për Ministrinë ashtu edhe për autoritetet vendore. Megjithatë, një nga prioritetet e para të Njesisë do të jetë hartimi dhe vënia në zbatim të programit të monitorimit të biodiversitetit, në vijim të Vendimit 103 të 31.03.2002. Faza e parë e këtij programi do të përqendrohet në vlerësimin e zonave dhe llojeve të mbrojtura, për të cilat planet janë tashmë gati. Në kohën e duhur programet e monitorimit do të jenë subjekt për të mbuluar në mënyrë optimale të gjitha zonat dhe llojet e mbrojtura. Detyra tjetër bazë e Njesisë do të jetë përpilimi i të dhënave dhe informacionit të sistemit të administrimit për biodiversitetin në fazën e parë të sistemit si pjesë e SAIM. Kjo do të kërkojë:

Grumbulimin, vlerësimin e cilësisë dhe të dhënat hyrëse për të përfunduar krijimin e sistemit të informacionit mbi biodiversitetin për fazën e parë.

Masa për të krijuar të drejtën për të hyrë në sistemin e informacionit të biodiversitetit duke mbështetur integrimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit - Internet dhe prezantime të bazuara në CD në të dy nivelet (në atë publik dhe administrativ).



### **3.3.7 Planifikimi dhe Administrimi i Përdorimit të Tokës**

*Një sistem i integruar dhe efikas i planifikimit dhe zhvillimit hapësinor, i cili merr parasysh objektivat ekonomikë, shoqërorë dhe mjedisorë në një mënyrë të ekuilibruar*

Planifikimi dhe administrimi i përdorimit të tokës ka si qëllim kryesor të sigurojë, që secila zonë do të përdoret në mënyrë të tillë që të mund të ofrojë maksimumin e përfitimeve shoqërore, në veçanti në lidhje me prodhimin e ushqimit, pa dëmtuar burimet e tokës. Kërkesat për përdorimin e tokës janë të shumta dhe të ndryshme, por për momentin fushat kyçe të zhvillimeve në Shqipëri, që dominojnë dhe shtojnë ndryshimet e përdorimit të tokës, janë ndërtimet për shtëpi për imigrantët nga rajonet malore dhe turizmi. Ky "lulëzim ndërtimi" shoqërohet nga kërkesa të tjera më pak dominuese, por të rëndësishme për industrinë dhe tregtinë, si për shembull industri të reja, zhvillime të bizneseve me pakicë dhe nxjerrja e materialeve inerte për ndërtime, kryesisht nga guroret. Qëllimi i një sistemi efikas për administrimin e përdorimit të tokës nuk është për të parandaluar këto zhvillime, por të nxisë, që këto të bëhen në mënyrë të tillë që të maksimizojnë përfitimet për të gjithë, ndërkohë duhet ruajtur edhe mjedisi për të ardhmen.

Në vitet e fundit ka pasur një migrim të madh të popullsisë nga zonat malore drejt bregdetit. Kjo është shkaktuar nga ndryshimet ekonomike që solli fundi i komunizmit dhe rënia pasuese e ekonomisë rurale. Dështimet e kaluara për mirëmbajtjen e rrugëve rurale e kanë acaruar varfërinë rurale. Ky shpopullim ka çuar në një përkeqësim të infrastrukturës, shkollave, klinikave dhe strehimit në zonat rurale. Është e nevojshme të krijohen plane specifike sektoriale për të stimuluar ekonominë rurale dhe planet e administrimit për shfrytëzimin e tokës duhen rishikuar për të mbështetur zhvillimin. Ka një potencial për rritjen e turizmit në zonat malore rurale të përzgjedhura dhe po ashtu duhen zhvilluar plane të përshtatshme për shfrytëzimin e tokave, përfshirë masa kontrolli më të rrepta të zhvillimit për të siguruar një zhvillim miqësor ndaj mjedisit për të mbrojtur pikat tërheqëse turistike, ndërsa në të njëjtën kohë duhet stimuluar ekonomia vendore.

Kjo prirje në migrimin e popullsisë nga zonat malore drejt bregdetit ka pasur një ndikim të madh mbi zhvillimin e vendit përgjatë bregdetit, përfshirë tokën më të mirë bujqësore dhe zonat rurale bregdetare jashtë zonave urbane të miratuara. Niveli i mbrojtjes së tokave më të mira bujqësore për kultivim dhe për mbrojtjen e objekteve apo zonave të trashëgimisë kulturore përgjatë bregdetit ka nevojë të përforcohet.

Ka nevojë të trajtohet edhe mbizotërimi i zhvillimit informal, si ai ekzistues ashtu dhe ai i të ardhmes. Rritja e kërkesës për materiale ndërtimi, e cila është nxitur nga zhvillimi informal, është një aset i rëndësishëm ekonomik, me kusht që kostot mjedisorë të ndotjes të krijuara nga mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe e infrastrukturës ujore, të mos jenë frenuese. Qeveria ka theksuar se legjislatiioni është rruga më e preferuar. Ashtu siç theksohet në Programin 2005 – 2009:

- Qeveria do të përfundojë procesin e legalizimit të shtëpive, veçanërisht në zonat urbane të krijuara rishtas. Qytetarët duhet të paguajnë rreth 100-400 mijë lekë për legalizimin e shtëpive dhe të drejtën e pronësisë për tokën. Ky proces do të favorizojë më shumë, njerëzit në nevojë. Qeveria është e angazhuar për kompensimin e pronarëve të tokës. Legalizimi i ndërtimeve në vende, që nuk ishin të autorizuar me lejen e parë të ndërtimit, do të bëhet duke vënë një gjorbë prej 4% të çmimit të tregut për objektin e ndërtuar. Zonat e ndërtimeve të paligjshme do të zhvillohen dhe urbanizohen nëpërmjet investimeve në infrastrukturë dhe shërbimeve parësore, sikurse janë shëndetësia dhe arsimiti. Gjatë gjithë procesit do të bëhet një dallim midis ndërtimeve të paligjshme për nevoja social-kulturore dhe atyre për qëllime private dhe përfitimi, duke ndëshkuar këto të fundit.

Një sërë iniciativash të suksesshme janë ndërmarrë për të negociuar legalizimin e vendbanimeve, si për shembull, dispozitat për sigurimin e zhvillimit të infrastrukturës, siç është e përmendur edhe në Programin e Qeverisë. Megjithatë, këto negociata kanë qenë relativisht të gjata dhe kanë përfunduar në një përparim me hapa të ngadaltë. Kostot mjedisore të ndotjes së bregdetit dhe humbja e tokës bujqësore duhen marrë parasysh si pjesë e këtij procesi. Si rrjedhojë, është e nevojshme të kemi një strategji më të fortë dhe më të efektshme, me qëllim që të mundësojmë zbatimin e politikave të shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokave.

Si një çështje urgjente këto hapa duhet të shoqërohen me masa për të ndaluar zhvillimet e mëtejshme informale në të ardhmen, që ndër të tjera përbëjnë një dhunim të politikave të përdorimit të qëndrueshëm dhe me kriter të tokës. Ndalimi i zhvillimeve informale të mëtejshme është diçka thelbësore, nëse nuk duam që përpjekjet e përgatitjes së planit hapësinor dhe përgatitjes së legjislacionit për zhvillimet ekzistuese informale të na shkojnë kot. Programi ekzistues i Qeverisë ka si qëllim, maksimizimin e vlerës së zhvillimeve aktuale jo formale, por politikave duhet të forcohen duke u zbatuar rreptësisht dhe pa asnjë tolerancë ndaj zhvillimeve të reja/të mundshme informale, përndryshe procesi i legalizimit nuk do të mund të mbarojë kurrë dhe nuk do të ketë ndonjë të ardhme për administrimin e qëndrueshëm të përdorimit të tokës. Një veprim prioritar dhe kyç i SKM-së është nisja e një fushate të bashkërenduar dhe të mirë-publikuar, mbi masat shtrënguese ndaj zhvillimeve të paligjshme, siç janë: gjobat, shemmbjet demonstrative të transmetimetuara në televizion, si ato që u kryen në Tiranë, etj. Këto masa janë të nevojshme për rritur ndërgjegjësimin që zhvillimi ilegal nuk do të tolerohet më. Po ashtu këtu kërkohet edhe një rishikim emergjent i statusit të planeve ekzistuese dhe shtrirja e zhvillimit informal në/dhe brenda këtyre zonave, në mënyrë të tillë që të përcaktohen zonat e veprimit për kontrollime më të forta. Kjo duhet mbështetur nga një fushata komunikimi me publikun për të shpjeguar arsyet pse zhvillimi informal dëmton mjedisin dhe eventualisht edhe ekonominë.

Planifikimi dhe administrimi i shfrytëzimit të tokës është i rëndësishëm si në zonat rurale ashtu dhe në ato urbane. Programi i Qeverisë për 2005 – 2009 citon objektivat lidhur me të dyja:

Mbrojtja e mjedisit dhe e tokës, rritja e aksesit dhe nivelit të shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore nga komunitetet dhe individët në këto zona, do të jetë një tjetër prioritet në mbështetje të zhvillimit të integruar të zonave rurale dhe malore të vendit;

Zhvillimi urban do të mbështetet në trajtimin e zhvillimit të integruar dhe të qëndrueshëm, i plotësuar me shfrytëzimin efektiv të territorit urban, zhvillimin e teknologjisë urbane dhe përforcimin e kulturës qytetare të jetesës në qytet.

Planifikimi dhe administrimi efikas i shfrytëzimit të tokës, përfaqësojnë një nga sfidat më të rëndësishme dhe më të vështira për Shqipërinë duke pasur parasysh ndarjen në zona për të rritur në maksimum potencialin e zhvillimit dhe kufizimet që rrjedhin nga mbrojtja e mjedisit, të cilat kufizojnë lirinë e pronarëve të tokës, duke i detyruar ato që të ndërmarrin vetëm projekte tip të të zhvillimit në tokën<sup>16</sup> e tyre. Kjo është e zakonshme dhe e pranueshme në Europën Perëndimore, por relativisht e re për Shqipërinë. Imponimi i kufizimeve për mënyrën se si duhet përdorur toka, nuk përfaqëson një pengesë për zhvillim nëse do të kishte një treg plotësisht funksional për shitblerjen e tokës dhe pronave. Megjithatë, deri tani në Shqipëri tregu plotësisht funksional nuk është përfunduar ende. Ndërsa zgjidhja e kësaj çështjeje është jashtë synimeve të kësaj strategjie, ajo duhet njohur si një pengesë për adoptimin e politikave të administrimit efikas të shfrytëzimit të

<sup>16</sup> Megjithatë nuk ka mjete dhe kapacitet planifikues të mjaftueshëm për ta monitoruar dhe kontrolluar atë.

tokës dhe së fundi për zhvillimin e qëndrueshëm. Për pasojë, kjo Strategji kërkon që të bëhen përpjekje për të zgjidhur këtë çështje duke e përshpejtuar e përforcuar atë.

Që planet e qëndrueshme të shfrytëzimit të tokës të jenë efikase dhe të pranueshme për të gjithë grupet vendorë të interesit, duhet bërë një rishikim gjithëpërfshirës i sistemit shqiptar të Planifikimit. Ky rishikim ka nevojë të mbështetet nga ndërtimi i kapaciteteve brenda niveleve vendore, rajonale dhe kombëtare për t'i dhënë mundësi personelit planifikues të përgatisë, monitorojë dhe imponojë planet në një ekonomi tregu, nëpërmjet një procesi planifikimi dhe konsultimi transparent dhe të përgjegjshëm. Prandaj, SKM ka si qëllim krijimin e kushteve për trajnim më intensiv të planifikuesve dhe rishikime të kuadrit ligjor të shoqëruar me ndryshime institucionale të domosdoshme për të rritur kapacitetin.

Të gjithë proceset e planifikimit që janë transparente dhe të përgjegjshëm, përhijjnë konsultimin e të gjithë grupeve të interesit, që jetojnë apo punojnë në zonën e mbuluar nga Plani. Këto grupe interesi kanë nevojë të kuptojnë shkakun themelor të përdorur nga planifikuesit dhe pse janë propozuar zonat e përzgjedhura. Kjo kërkesë është shpalosur gjithashtu edhe në Direktivën e Komunitetit Europian për Vlerësimin Strategjik Mjedisor 2001/42/KE. Po ashtu ka nevojë të krijohet edhe një procedurë e apelit publik për grupet e interesit me ankesa për politikën e adoptuara të planifikimit.

Në disa raste planet mund të ripunohen me qëllim që të minimizohen ndikimet negative për ata që kanë ankime, duke ruajtur njëkohësisht politikën e zhvillimit dhe ato të mbrojtjes së mjedisit të adoptuara nga Plani. Në raste të tjera, ka nevojë të krijohet një procedurë për kompensimin e tokës së marrë nga pronarët privatë ose të tjerëve, të cilët po humbasin asete apo mjete jetese të përfituara me ligj, për shkak të politikave të planit. Vetëm pas miratimit zyrtar të çdo plani nga Këshilli i Rregullimit të Territorit, mund të paguhet kompensimi i miratuar.

Shkalla me të cilën përgjegjësitë e planifikimit për shfrytëzimin e tokës duhet t'u kalojnë autoriteteve vendore, aktualisht është duke u diskutuar. Bashkitë kanë më shumë pushtet se Komunat. Sidoqoftë, duhen zbatuar më shumë kontrole ndaj zhvillimit informal në komuna.

Në përgjithësi, qeveritë vendore kanë nevojë të kenë kapacitetin e mjaftueshëm për të nxitur dhe ndikuar mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të realizuar një konsultim të gjërë me publikun, ndërsa njëkohësisht, të jenë më përgjegjëse dhe transparente në veprimet e tyre. Këto të fundit mund të arrihen duke imponuar konsultimin me publikun, duke krijuar mekanizma për lidhjet e përmirësuar me qeverinë rajonale dhe qendrore, si vertikalisht ashtu edhe horizontalisht.

Përveç planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të strehimit, lehtësirave turistike, industrisë dhe tregtisë, klinikave dhe shkollave, ka nevojë edhe për planifikim të mbrojtjes dhe administrimit të mjedisit, përfshirë:

- Biodiversitetin
- Administrimin e mbetjeve (siç është trajtuar në planet e administrimit të mbetjeve vendore)
- Grumbullimin dhe depozitimin e ujërave të zeza e të bardha;
- Administrimin e rreziqeve të përmytjeve;
- Sistemet e Qëndrueshme të Kanalizimit Urban (SQU);
- Mbrojtjen e peizazhit (përfshirë edhe pikat turistike);
- Konservimin e trashëgimisë kulturore.

Planifikimi i mbrojtjes mjedisore shpesh ka nevojë të koordinohet midis kufijve administrativë. Termi "planifikim i integruar" ka nevojë të bëhet realitet. Kjo kërkon pjesëmarrjen e grupeve formale të interesit, nëpërmjet të formimit të grupeve të punës prej ekspertësh dhe mekanizma të

tjera, që t'iu vihen në dispozicion autoriteteve vendore dhe të miratohen prej tyre. Mjetet më praktike të kryerjes së kësaj procedure janë sigurimi i udhëzimeve dhe mbështetja teknike. Dokumentet e udhëzimeve për biodiversitetin, administrimin e mbetjeve dhe administrimin e ujit tanimë janë identifikuar si përfundim i masave të programit SKM. Sidoqoftë, autoritetet Vendore kanë gjithashtu nevojë për pajisjen me aftësitë trajnuese dhe manuale udhëzimesh për transportin, turizmin, pjesëmarrjen e grupeve të interesit për vlerësimin mjedisor dhe metodat e integritit të këtyre çështjeve në një plan të vetëm e në mënyrë të balancuar.

Për shembull:

- Planet e Integruar të Administrimit të Zonave Bregdetare (siç është ai i hartuar kohët e fundit për Gjirin e Drinit nga programi CARDS i BE dhe për zonën bregdetare jugore nga Banka Botërore;
- Planet e Administrimit të Baseneve të Lumenjve;
- Plani Kombëtar i Transportit.

Ky kalim në trajtimin e ri ka nevojë të drejtohet dhe do të hajë kohë, kështu që programet e zhvillimit me faza për këto plane të integruara shtrihen deri më 2013.

Megjithatë, ka edhe një nevojë të menjëhershme për të pasur në dorë planet e shfrytëzimit të tokave si pjesë e mekanizmit për të kontrolluar zhvillimin informal, joefikas dhe të dëmshëm. Zyrtarisht zhvillimi nuk lejohet në zonat, të cilat nuk kanë plane të shfrytëzimit të tokave. Në zonat rurale nuk ka kontrole ligjore të mjaftueshme dhe janë përgatitur shumë pak plane zhvillimi. Duke pasur parasysh këtë gjë, një sistem dy fazash për planifikimin vendor, shikohet si real. Me qëllim që strategjitë e zhvillimit sektorial të integrohen në planet e shfrytëzimit të tokës dhe të shoqërohen me masat e administrimit dhe konservimit të mjedisit, duhet krijuar hierarkia e planeve dhe kontrolleve.

Planet sektoriale të zhvillimit do të identifikojnë rajonet, ku duhet vendosur theksi për zhvillimin e sektorëve të përzgjedhur, p. sh. aty ku duhen ndërtuar rrugë, porte ose centrale të mëdhenj. Njëkohësisht, me qëllim që të zbatohet direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për shqyrtimin mjedisor të mundësive, kriteret dhe metodat e administrimit mjedisor, do të kenë nevojë të integrohen në planet sektoriale dhe të zbatohen në të gjitha rajonet.

Strategjitë sektoriale do të shndërrohen në plane strategjike të shfrytëzimit të tokave në nivel rajonal dhe duhet të përfshijnë planet e ndarjes në zona të bashkëngjitura me politikat e zhvillimit dhe konservimit. Përsëri, si pjesë e Direktivës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor, të gjitha propozimet e zhvillimit do të shqyrtohen dhe përshtaten me qëllim që të minimizohet degradimi mjedisor duke përdorur procedurën e VSM për plane në shkallë të madhe dhe procedurën e VNM për zhvillimin e zonave specifike.

Sektori i turizmit që është një sektor i investimeve të fuqishme në ndërtim, ka gjithashtu nevojë të shqyrtohet nga ana mjedisore. Ndërsa Strategjia aktuale e Turizmit përcakton si një nga objektivat e saj: *"... arritjen e realizimit të një turizmi të qëndrueshëm mjedisor..."*, udhëzimet e hollësishme për autoritetet vendore dhe politikat e zhvillimit për këtë çështje kanë nevojë të përmirësohen. Për pasojë, Vlerësimi Strategjik Mjedisor e kësaj Strategjie, është identifikuar gjithashtu si një masë e nevojshme, së bashku me ndërtimin e kapaciteteve për "administrimin e destinacionit të turizmit".

Sipërfaqet më të mëdha të tokës në vend shfrytëzohen për bujqësi dhe pylltari. Toka në shpatet e maleve është e subjekt i erozionit dhe jo shumë prodhimtare. Prerja e paautorizuar e drurëve e acarën këtë problem. Nga ana tjetër, tokat më të mira/pjellore bujqësore në zonat bregdetare, po pakësohen, duke u orientuar drejt destinacioneve të ndryshme të zhvillimit urban. Nevoja për Planifikim të Administrimit të Pyjeve dhe vendosja e Kodit të Praktikave të Mira Bujqësore,

trajtohet në seksionin mbi tokat. Prerja e paautorizuar e drurëve, ka nevojë të kontrollohet më mirë. Madje edhe me futjen e kodeve të praktikave të mira dhe masave shoqëruese, përsëri mbetet mundësia që për shkak të këtyre praktikave, të shkojmë drejt varfërimit, si të peizazhit ashtu dhe të biodiversitetit. Politikat e strategjive të zhvillimit për sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë, duhet të jenë të qëndrueshme, si nga ana ekonomike ashtu dhe ajo mjedisore. Kushtet e tregut bujqësor, po ndryshojnë dhe do të vazhdojnë të ndryshojnë në drejtim të subvencioneve më të pakëta dhe proteksionizmit në zonën e Euros e në mbarë botën. Ndryshime të tilla nuk do të favorizojnë më transformimin e zonave jashtë qytetit në fabrika të ndërtuara në zona të hapura. Për këtë arsye, duhet ndërmarrë një vlerësim strategjik mjedisor i politikës bujqësore dhe sistemeve të subvencionimit.

Një numër kategorish dhe sektorësh të përdorimit të tokës u nënshtrohen lejeve specifike siç janë minierat, guroret dhe administrimi i mbetjeve. Aplikimet për aktivitete të reja duhet t'i nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Kjo procedurë duhet të sigurojë faktin që, si lejet e shfrytëzimit të tokës, ashtu dhe lejet specifike, të marrin plotësisht në konsideratë kushtet mjedisore dhe objektivat; po kjo procedurë nuk do të prekë problemet e shoqëruara me veprimtaritë ekzistuese. Për pasojë, një rishikim i lejeve për guroret dhe minierat, është përfshirë gjithashtu si një masë. Kushtet lidhur me shkarkimet në ajër dhe ujë kanë nevojë të rishikohen, ashtu siç do të rishikohen edhe çështjet e restaurimit përfundimtar dhe përgjegjësitë mjedisore. Vendndodhjet e administrimit të mbetjeve do të trajtohen nëpërmjet masave të përfshira në seksionin e administrimit të mbetjeve.

Në një numër rastesh, sigurimi i shërbimeve të centralizuar komunale (ujësjellës-kanalizimet), nuk do të jetë ekonomikisht efektiv dhe as realist. Ashtu siç është theksuar në seksionin e administrimit të ujit, pronarëve të tokave u duhen dhënë këshilla dhe udhëzime për t'i ndihmuar ata në pakësimin e risqeve të ndotjes së ujit.

### **Zbatimi administrativ ndër-kufitar**

Shumë elementë të administrimit mjedisor dhe sigurimit të shërbimeve, nuk mund të trajtohen plotësisht në shkallë rajonale, e për pasojë disa plane duhet të kapërcejnë kufijtë administrativë. Duhet krijuar gjithashtu grupe pune ndër-kufitare së bashku me mbështetjen e nevojshme institucionale dhe legjislatonin e duhur për të zbatuar këto tipa të planeve strategjike.

Ndërkohë, kohët e fundit, janë hartuar një numër planesh strategjike të këtij tipi, që përfshijnë:

Administrimin e Integruar të Zonave Bregdetare (Zonat Bregdetare Jugore dhe Veriore)

- Planet e Administrimit të Baseneve të Lumenjve për Liqenet e Ohrit dhe Shkodrës.
- Plani i Veprimit Mjedisor Rajonal për rajonin Lezhë – Shkodër.

### **Planet Urbane të Bashkëurbanizimit**

Për planifikimin dhe administrimin e zonave të mëdha urbane kërkohen kontrole dhe politika të hollësishme. Këto plane shpesh i kapërcejnë kufijtë administrativë. Rajoni Tiranë–Durrës është bashkëurbanizimi më i madh në Shqipëri dhe duke patur përafërsisht çerekun e të gjithë popullsisë së vendit, kërkon masa dhe azhurnime të veçanta të planifikimit. Projekti i financuar kohët e fundit nga Banka Botërore për Planin Urban të Tiranës përfshinte zhvillimin e një sistemi gjeografik të informacionit, si dhe një bazë të dhënash për infrastrukturën. Projektet e mëtejshme mbi planifikimin urban, duhet të përfitojnë nga përvoja e nxjerrë nga ky projekt “lege artis”. Në veçanti, planifikimi urban ka nevojë që të adoptojë metoda që do të trajtojnë çështjen e intensifikimit të vrullshëm të transportit dhe të ndotjes së ajrit të shoqëruar me të. Kjo çështje është trajtuar në seksionin lidhur me ndotjen e ajrit.



## Legjislacioni

Baza ligjore për të gjithë planet e mësipërme është përgatitja e planeve në bazë të Ligjit të Planifikimit Urban. Megjithatë, ky theksim vetëm i aspekteve të planifikimit të zhvillimit urban nuk çon në planifikimin e integruar të shfrytëzimit të tokës. Kërkohej një bazë e re ligjore që u jep të njëjtën peshë të gjithë përdorimeve të tokave dhe interesave të zhvillimit, përfshirë administrimin e ujit, mjedisit, mbrojtjes së natyrës, mbrojtjes së tokave bujqësore të cilësisë së lartë dhe pyjeve; mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe pikave turistike natyrore etj. Tani për tani nuk ka një bazë ligjore për një proces të planifikimit strategjik rajonal; kjo ka nevojë të vendoset si një kërkesë ligjore.

Planet e nivelit vendor (si të Bashkive ashtu dhe të Komunave) duhet të marrin parasysh planet strategjike dhe t'i zbatojnë ato në nivel vendor. Në disa raste, zhvillimi informal, shtrihet përtej kufijve të planeve urbane dhe kalon në komuna fqinje, të cilat kanë kontroll më të pakët të planifikimit. Në nivel vendor, zbatimi i planit dhe monitorimi, përfshin masa për zhvillimet sektoriale, të cilat lidhen me zona administrative specifike psh:

- Ruajtjen e habitatit duke përfshirë Strategjinë e Biodiversitetit dhe Planin e Veprimit;
- Zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit duke përfshirë Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Turizmit;
- Mundësitë e komunikimit – Plani dhe Politikat Kombëtare të Transportit;
- Ujin - Strategjitë e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet në zonat Urbane/Rurale;
- Planet e Integruara të Administrimit të Zonës Bregdetare, aty ku janë të mundshme;
- Planet Rajonale të Veprimit në Mjedis, aty ku janë të mundshme.

Duke u nisur nga sfida që përballon Shqipëria, për të zhvilluar një sistem funksional të planifikimit të qëndrueshëm në ekonominë e re të tregut dhe iniciativat aktuale të cilat janë duke u ndërmarrë nga MPPTT për të shqyrtuar sistemin ekzistues, propozimet për administrimin dhe planifikimin e shfrytëzimit të tokës janë përqendruar në:

Periudhën Afatshkurtër deri Afatmesme mbi:

Krijimin e mundësive fillestare për ndërtimin e kapaciteteve për bazat e të dhënave për qeverinë qendrore, rajonale dhe vendore; trainim i personelit;

Rishikimin e kuadrit ligjor dhe ligjeve që kanë lidhje me zhvillimin urban, zhvillimin e turizmit dhe të konservimit të trashëgimisë kulturore mbështetur nga reforma institucionale;

Përgatitjen e dokumente udhëzuese për integrimin e administrimit mjedisor në planet e zhvillimit sektorial (Turizëm, Transport, Bujqësi etj.);

Masat emergjente për rishikimin e planeve vendore për kontrollin e zhvillimit informal bregdetar;

Planifikim strategjik në nivel rajonal.

Periudhën Afatmesme deri në Afatgjatë mbi:

Zhvillimin e planeve strategjike rajonale;

- Rishikimin e planeve vendore;
- Krijimin e një cikli për monitorimin dhe rishikimin i planeve.

**Masat e Planifikimit të Shfrytëzimit të Tokës për Projektstrategjinë Kombëtare Mjedisore**

Ref	Objektivat	Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Kërkesat Buxhetore (Milion Lekë)
T1	Sistemi i planifikimit të qëndrueshëm të shfrytëzimit të tokës – faza e krijimit	T1.1	Furnizim i gjithë institucioneve qeveritare të zhvillimit me harta nëpërmjet të EIMS <sup>17</sup> dhe sistemet shoqëruese	Min. Brend. MPPTT MMPAU	IV/2006	II/2007	
		T1.2	Planifikimi i Bazës së të Dhënave Shqyrtim dhe regjistrim i të dhënave të planifikimit standard: Duke filluar me të gjithë zonën bregdetare përfshirë: Tipi i ndërtimit dhe struktura Moshë e ndërtimit dhe kushtet e tij Klasifikimi i përdorimit të ndërtimit Klasifikimi i përdorimit të tokës Lejet e ndërtimit (numri i referencës) Hollësitë e infrastrukturës (ujësjellës, kanalizime, rrugët) Indeksi i pronësisë së tokës Vendndodhjet e trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Ndarja në zona (aty ku është e zbatueshme) Studimet e Planifikimeve në Vazhdimësi dhe planet, përfshirë edhe veprimtaritë e financuara nga donatorët.	MPPTT + institutet	IV/2006	Zona bregdetare I/2008  Rajone të tjera  I/2010	
		T1.3	Sigurimi i burimeve dhe caktimi i përgjegjëseve për përditësimin e rregullt çdo 2 vjet të bazës së të dhënave (mund të reduktohet në çdo 5 vjet, kur të sigurohet më shumë kontroll)	MPPTT	II/2007	Në vazhdim	
		T1.4	Përsheptim i regjistrimit të tokës dhe kompletimi i bazës së të dhënave mbi planifikimin urban, me qëllim që të arrihet përfundimi i saj në vitin 2013.	Ministria e Brendshme	Në vazhdim	IV/2013	
		T1.5	Planifikimi i të dhënave të ngastrave në një sistem GIS që përputhet me sistemin EIMS	MPPTT	IV/2006	Në vazhdim	

---

<sup>17</sup> Sistemi i Administrimit të Informacionit Mjedisor

Ref	Objektivat	Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Kërkesat Buxhetore (Milion Lekë)
		T1.6	Sigurimi i aksesit online për bazën e të dhënave për autoritetet Planifikuese (në të gjithë nivelet qeveritare)	MPPTT	IV/2007	Në vazhdim	
		T1.7	Përmirësim i ekspertizës së planifikimit dhe zhvillimit për të gjitha autoritetet vendore dhe rajonale: Planifikimi Strategjik Planifikimi i administrimit të zonës bregdetare, përfshirë ndarjen në zona të gjithë tokës Planifikimi i administrimit të baseneve të lumenjve Administrim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës Procedurat dhe metodologjitë e VSM-së Metodologjitë e VNM-së Parashikimi i prireje të zhvillimit Analiza e politikës së planifikimit Analiza e tregut të tokës Analiza social-ekonomike dhe planifikimi Planifikimi i Transportit Administrimi i destinacionit të turizmit të qëndrueshëm Planifikimi i qendrave të pushimit Administrimi i zonave të mbrojtura Konsultim publik dhe aftësi pjesëmarrëse	MPPTT dhe Ministria e Brendshme (Qeveria Vendore) me asistencën e donatorëve	I/2007 prioritet zonat bregdetare	IV/2011	
		T1.8	Rishikim i masave të strukturave institucionale për planifikimin e shfrytëzimit të tokës dhe propozimi i përmirësimeve	MB, MPPTT	Në vazhdim	III/2007	
		T1.9	Zbatimi i reformave institucionale	MB, MPPTT Autoritetet vendore	III/2007	IV/2010	
		T1.10	Rishikim dhe përforcim i ligjit të planifikimit urban për të pasqyruar nevojën për një planifikim modern për hartim dhe imponim të qëndrueshëm. Në të gjithë territorin (urban dhe rural)	Grupi i Punës: MPPTT/ Ministria e Turizmit/ MMPAU/Ministria e Kulturës/ Ministria e Brendshme (Qeveria Vendore/ Autoritetet Rajonale)	III/2006	IV/2007	(Personeli ekzistues në MMPAU në drejtorinë e VNM)
		T1.11	Futja e masave dhe rregulloreve për kompensimin e tokave	MB, Min. Fin, MPPTT	I/2007	IV/2007	

Ref	Objektivat	Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Kërkesat Buxhetore (Milion Lekë)
		T1.12	Rishikim i Ligjit për Turizmin – për të siguruar administrimin e qëndrueshëm të destinacionit e lidhur kjo me planifikimin e infrastrukturës	Grupi i Punës: MPPTT/ Ministria e Turizmit/ MMPAU/ Ministria e Kulturës/ Ministria e Brendshme (Qeveria Vendore/ Autoritetet Rajonale)	IV/2006	III/2007	(Personeli ekzistues në MMPAU në drejtorinë e VNM)
		T1.13	Rishikim dhe përmirësim i ligjit të konservimit të trashëgimisë kulturore dhe rregulloret për të përmirësuar zbatimin e tyre	Grupi i Punës: MPPTT/ Ministria e Turizmit/ MMPAU/ Ministria e Kulturës/ Ministria e Brendshme (Qeveria Vendore/ Autoritetet Rajonale)	IV/2006	III/2007	(Personeli ekzistues në MMPAU në drejtorinë e VNM)
T2	Planifikim i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës: - Masat Emergjente për mbrojtjen e Zonës Bregdetare	T2.1	Parandalimi i zhvillimeve të ardhshme informale: Propozim i masave emergjente afatshkurtra për të kontrolluar zhvillimet informale përgjatë bregdetit; Marrëveshje ndërminstrore mbi sistemin e përbashkët të imponimit të zbatimit të ligjit mbi kontrollin e zhvillimit, përfshirë inspektorët e autoriteteve vendore ARM dhe Policinë; Fushatë imponimi e një profili të lartë kundër zhvillimit të vazhdueshëm informal. Përfshirë mbrojtjen e objekteve dhe zonave të trashëgimisë kulturore dhe zonat e mbrojtura.	Komiteti i përbashkët i zbatimit; MPPTT MMPAU Ministria e Brendshme Agjencitë e Imponimit Autoritetet Vendore	IV/2006	II/2007	(Personeli ekzistues në MMPAU në drejtorinë e VNM)
		T2.2	Zbatimi i masave emergjente	Komiteti i përbashkët i zbatimit; MPPTT MMPAU Ministria e Brendshme Agjencitë e Imponimit Autoritetet Vendore	II/2007	II/2010	(Personeli ekzistues në MMPAU në drejtorinë e VNM)

Ref	Objektivat	Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Kërkesat Buxhetore (Milion Lekë)
		T2.3	Monitorim i zbatimit dhe raportim çdo gjashtëmuaj tek Kryeministri.	Komiteti i përbashkët i zbatimit; MPPTT MMPAU Ministria e Brendshme Agjencitë e Imponimit Autoritetet Vendore	III/2007	Në vazhdim	(Personeli ekzistues në drejtorinë e VNM së MMPAU)
		T2.4	Plani i administrimit të integruar të Zonës Bregdetare i kompletuar me VSM dhe konsultimin e publikut. Mekanizma për ngritjen e koordinimit funksionues ndër-rajonal.	Grupi i Punës: MPPTT/ MMPAU/ Qeveria vendore dhe rajonale/ stajkholderat privatë	Lezhë/ Shkodër dhe Sarandë filluar 2006	IV/2010	Personeli ekzistues në drejtorinë e VNM së MMPAU)
		T2.5	Planet rajonale të përfunduar dhe programet për monitorimin e zbatimit dhe përditësimi i politikës së planifikimit rajonal i specifikuar.	Grupi i Punës: MPPTT/ MMPAU/ Qeveria vendore dhe rajonale/ stajkholderat privatë	IV/2010	IV/2014	Personeli ekzistues në drejtorinë e VNM së MMPAU)
		T 2.6	Fillimi i ciklit strategjik të ndarjes në zona të Planeve Rajonale të monitorimit dhe shqyrtimit, duke filluar me rajonet që ndodhen nën tryzni për zhvillim.	Grupi i Punës: MPPTT/ MMPAU/ Qeveria vendore dhe rajonale/ stajkholderat privatë	I/2015	IV/2020	
		T2.7	Shqyrtim i planeve ekzistuese vendore për qëllim të kontrollit të zhvillimit. Masa të përkohëshme kontrolli, të miratuara gjatë shqyrtimit të planeve gjithëpërfshirëse.	Grupi i Punës: MPPTT/ MMPAU/ Qeveria vendore dhe rajonale	I/2012	IV/2014	Personeli ekzistues në drejtorinë e VNM së MMPAU)
		T2.8	Përpilimi në nivel vendor i Planeve të Ndarjes në Zona të lidhura me politikën vendore për zonat rurale, duke filluar me zonat nën tryzni për zhvillim.	Grupi i Punës: MPPTT/ MMPAU/ Qeveria vendore dhe rajonale	III/2014	IV/2020	
		T2.9	Fillimi i Ciklit të monitorimeve dhe shqyrtimeve të Planeve Vendore (për Bashkitë dhe Komunat), duke filluar me zonat administrative nën tryzni për zhvillim.	Grupi i Punës: MPPTT/ MMPAU/ Qeveria vendore dhe rajonale	IV/2014	IV/2020	
T3	Kontroll i shtuar i aktiviteteve të tjera ekzistuese të shfrytëzimit të tokës.	T3.1	Rishikim i lejeve ekzistuese mjedisore për veprimtari të guroreve.	MMPAU ARM	I/2007	I/2009	
		T3.2	Rishikim i kushteve të restaurimit për guroret.	Min. Ek. Inspektorati i Minierave dhe Guroreve Autoritetet vendore	I/2007	I/2009	

Ref	Objektivat	Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Kërkesat Buxhetore (Million Lekë)
		T3.3	Përgatitja e Projektsynimit për restaurimin e gurorëve të braktisura dhe paraqitja në Fondin e Mjedisit për planifikimin bazë të shfrytëzimit të tokave – shih gjithashtu seksionin e dëmtimit të Mjedisit.	Autoritetet vendore	I/2008	III/2010	
		T3.4	Rishikim i lejeve ekzistuese për lejet mjedisore për veprimtaritë e minierave.	MMPAU ARM	I/2007	I/2009	
		T3.5	Rishikim i kushteve ekzistuese të restaurimit të minierave.	Ministria e Ekonomisë Inspektorati i Minierave dhe Gurorëve Autoritetet vendor	I/2007	I/2009	
		T3.6	Përgatitja e Projektsynimit për restaurimin e minierave të braktisura dhe paraqitja në Fondin e Mjedisit për planifikimin bazë të shfrytëzimit të tokave.	Autoritetet Vendor	I/2008	III/2010	

### 3.3.8 Dëmi Mjedisor

*Riparimi dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme të zonave me mjedis të dëmtuar në mënyrë që të eliminohen rreziqet që i kanosen shëndetit publik dhe biodiversitetit nga ky dëm*

#### Hyrje

Termi “dëm mjedisor” përdoret për sipërfaqe toke, nëntoke, shtresa të nëndheshme, apo shtratin e detit të cilat kanë pësuar ndryshime të mëdha, pasojat e të cilëve po sjellin probleme që vënë në rrezik shëndetin e njeriut apo ekologjinë. Forma më e zakonshme në të cilën shfaqet ky dëm është ndotja e tokës me substanca me përmbajtje të lartë toksike – pikërisht këto zona quhen ndryshe edhe “pika të nxehta”. Megjithatë, këtu kemi parasysh një shtrirje më e gjerë e dëmit. Në pjesën më të madhe të rasteve dëmi shkaktohet nga aktivitetet industriale, shumica e të cilëve janë braktisur tashmë. Ky seksion nuk merret me kontrollin e dëmit të vazhdueshëm të shkaktuar nga industrinë që funksionojnë ende, pasi kjo duhet trajtuar nëpërmjet masave të kontrollit të specifikuar në seksionet e tjera të kësaj strategjie. Ky seksion merret me “riparimin” më shumë sesa me parandalimin.

Burimet kryesore të dëmit mjedisor janë pajisjet e braktisura industriale që përfshijnë:

- Minierat – e qymyrit dhe mineraleve nga nëntoka;
- Nxjerrja nga nëntoka – naftë, gaz, ujë;
- Guroret – nxjerrja e mineraleve nga sipërfaqja e tokës;
- Fabrikat ose uzinat e përpunimit;
- Vendet e grumbullimit të plehrave përfshirë vendin e hedhjes së mbetjeve nga fabrikat, depozitime të mineraleve të mbetur nga punimet minerare dhe të ngjashme me to.

Për sa i përket vendeve të grumbullimit të mbetjeve, kjo Strategji bën dallim mes vendeve të përdorur për një industri a aktivitet të caktuar dhe vendeve për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane të përdorur kryesisht për hedhjen e mbetjeve jo-toksike shtëpiake dhe mbetjeve tregtare. Rikthimi në gjendjen e mëparshme të fushave të plehrave “urbane” shqyrtohet në seksionin e administrimit të mbetjeve.

Përmbledhtazi, hapat që duhen ndërmarrë për riparimin e çfarëdoq vendi që ka pësuar dëm mjedisor mund të konsiderohet si:

- Analizë e shtrirjes dhe natyrës së problemit – llogaritja e riskut;
- Shqyrtimi i alternativave që çojnë në një metodë të pëlqyer – vlerësimi i alternativave;
- Hartim i detajuar i projektit që çon në një specifikim tenderi – përgatitja për programin e pastrimit;
- Lidhja e kontratës dhe zbatimi i saj – pastrimi.

Disa prej këtyre hapave tashmë janë ndërmarrë për sa i përket “pikave të nxehta” më të rëndësishme. Megjithatë, nuk është trajtuar plotësisht një element thelbësor paraprak; caktimi i objektivave. Duhet të theksohet se nuk ka asnjë pjesë të legjislacionit mjedisor të Komunitetit Europian që të merret drejtpërdrejtë me përcaktimin e standardeve për pastrim të tokës së ndotur. Efektet dëmtuese të tokës së ndotur mbi ujën trajtohen direkt nëpërmjet Direktivës Kuadër të Ujit dhe Direktivës së Ujërave Nëntokësorë, por nuk janë vendosur standardet në *acquis* për nivelin e ndotjes së tokës apo nëntokës që të konsiderohet si e pranueshme për klasa a tipa të ndryshme zhvillimi. Shtetet Anëtare të BE-së kanë miratuar standarde që i përshtaten nevojave të tyre. Për arritjen e objektivit të politikës së ndjekur mund të përdoren dy metoda bazë:

- Vlerësimi i zonave mbi bazën e rrezikut që sjellin të gjithë shfrytëzimet e mundshme në të ardhmen (“shumë–funksionaliteti”), ose
- Vlerësimi i zonave mbi bazën e një përdorimi të veçantë (“të përshtatshme për përdorim”)

Nuk është mirë të merren standardet e një vendi tjetër pa i rishikuar, ashtu siç nuk është veprim i matur të injorohet puna që kanë bërë të tjerët. Prandaj, do të duhet të ndërmerret një studim i shkurtër paraprak nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Instituti i Shëndetit Publik dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, për t’u informuar mbi caktimin e vlerave orientuese për pastrimin e tokave të ndotura. Këto, më pas, do të shërbejnë si pikënisje për fazat e mëtejshme të vlerësimit të rrezikut dhe ciklit të pastrimit.

Standarde të tilla janë të zbatueshme për kushtet kimike të tokës, por jo për qëndrueshmërinë e saj fizike. Si të tilla, ato nuk do të zgjidhin problemet e fundosjes, paqëndrueshmërisë dhe rrëshqitjeve që shkaktohen në minierat dhe guroret. Ashtu siç është vepruar me zonat e ndotura ku ndodhen fabrika, janë ndërmarrë një sërë studimesh dhe projektesh rikuperuese edhe për këto zona, por në shumë raste rehabilitimi ka qenë i paplotë.

### **Masat**

Masat që përshkruhen në këtë seksion synojnë kryesisht të zgjidhin problemin e dëmit ekzistues. Masat e paraqitura në seksionet e tjera të kësaj strategjie merren me parandalimin e ndotjeve në të ardhmen.

Lidhur me rehabilitimin është parashtruar një metodë që përmban dy hapa. Hapi i parë duhet të shërbejë për minimizimin e rrezikut ekzistues për shëndetin që paraqesin këto zona. Disa janë zaptuar nga pronarë shtëpish të cilët tashmë janë vendosur në këto zona. Do të ishte e pëlqyeshme që këto pronarë të zhvendoseshin menjëherë dhe aty ku është e mundur, kjo gjë do të bëhet. Megjithatë, në një sërë rastesh një gjë e tillë mund të mos jetë e realizueshme. Në raste të tilla, pronarëve të këtyre shtëpive duhet t’u jepen këshilla dhe t’u ofrohet mbështetje për të ulur rrezikun që i kanoset shëndetit të tyre dhe të fëmijëve të tyre nga që jetojnë në këto vende. Masa të tilla mbështetëse mund të përfshijnë ndërrimin e shtresës së sipërme të ndotur të tokës në afërsi të këtyre shtëpive. Një hap kritik do të jetë marrja e masave që këto familje të furnizohen me ujë të pijshëm të pastër. Uji që nxirret nga pusët e cekëta ka të ngjarë të jetë i ndotur rëndë. Aty ku nuk është i mundur furnizimi direkt me ujë, do të sigurohen rezerva të përkohshme. Duhet theksuar se në shumë raste këto familje duhen shpërngulur ose përkohësisht ose përgjithmonë si pjesë e programit të pastrimit.

Duhet gjithashtu të zgjidhet edhe çështja e sigurimit të zonës, në mënyrë që të minimizohet rreziku i ngritjes së vendbanimeve të tjera në këto vende që do të çonte në përkeqësim të problemit.

Kërkohet një program afatgjatë i strukturuar për rehabilitimin përfundimtar të zonave me mjedis të dëmtuar përfshirë zonat industriale dhe minierat.

Tashmë është ndërmarrë një punë e madhe për studimin e shumë zonave, përgatitjen e planeve të veprimeve rehabilituese dhe në disa raste është arritur rehabilitim i pjesshëm. Tani është e rëndësishme të përfitohet sa më shumë nga kjo punë dhe të përgatitet programi formal i bazuar në të dhënat që disponohen. Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, pranohet se për përgatitjen dhe zbatimin e programit kërkohet të ketë një pikë fokusimi. Për të përmbushur këtë rol do të krijohet posti i veçantë i Ekspertit të Tokës së Ndotur. Ky ekspert, i vetëm, nuk do të jetë në gjendje të marrë përsipër të gjithë punën që kërkohet të bëhet, si rrjedhim do të ngrihet një Grup Ndërinstitucional Ekspertësh, për të mbështetur këtë ekspert në punën e tij.

Efektivisht, programi zyrtar do të përmbajë tri faza:



- Zbatimin e projekteve ekzistuese për të cilët janë siguruar fondet;
- Faza e Parë e programit të ri – kryerja e punimeve për rehabilitim për ata projekte që kanë plane rehabilitimi dhe hartimi i planeve të rehabilitimit për ata që nuk kanë;
- Faza e Dytë e programit të ri – kryerja e punimeve për rehabilitim në ato zona që nuk përfshihen në Fazën I.

Synimi afatgjatë është të merren masa që të gjitha zonat e mëdha, të ndotura, të jenë në gjendje të rehabilitohen dhe të mund përdoren për qëllime përfitimi brenda 10 viteve të ardhshme. Ky është një synim ambicioz dhe do të kërkojë mbështetje të madhe financiare. Do të krijohet një komponent specifik në Fondin e Mjedisit, për t'iu përgjigjur pikërisht nevojave bazë për financim nga brenda dhe jashtë të këtyre punimeve.

Ky program synon të trajtojë zonat më të dëmtuara nga pikëpamja mjedisore. Megjithatë, po krijohen zona me tokë të ndotur që janë më të vogla e më pak të prekura, por gjithsesi të rëndësishme, si rezultat i një sërë aktivitetesh, përfshirë këtu hedhjen e mbetjeve të ngurta urbane, rrjedhjet nga rezervat e karburantit, naftës dhe kimikateve, çmontimin e automjeteve si dhe njësi të tjera tregtare dhe industriale të cilat përdorin substanca shumë ndotëse. Mungon kapaciteti i mjaftueshëm për t'u marrë me të gjitha këto zona në një periudhë afatshkurtër. Megjithatë, duhet nisur një program, faza e parë e të cilit është grumbullimi i informacionit për të krijuar një regjistër të tokave të ndotura. Ky do të përfshihet në komponentin e tokave në Sistemin e Administrimit të Informacionit Mjedisor.



DM1 Vendosja e standardeve për rizhvillimin e tokave të ndotura në Shqipëri.

Siç u theksua më lart, kuadri ligjor aktual mbi zhvillimin e tokave në Shqipëri, nuk përfshin standarde, që specifikojnë nivelin e pranueshëm të ndotjes së tokës me destinacione të ndryshme përdorimi, si industriale, tregtare dhe/apo për zona banimi. Kjo mungesë duhet të korrigjohet me qëllim që të përcaktohen objektivat për rizhvillimin e zonave ekzistuese të ndotura.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap. <sup>18</sup>	Shpenz. Op. Vjet <sup>19</sup>
DM1.1	Përgatitja e Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe dokumentacionit teknik mbështetës, që specifikon vlerat e synuara për dekontaminimin e sipërfaqes dhe nënshtresës së tokave për qëllime specifike përfshirë destinacionet industriale, tregtare dhe të banimit.	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	II/2008	10	
DM1.2	Përgatitja e dokumentit udhëzues për veçimin në vend, të materialeve të ndotura përfshirë standardet për kufizimin në vende specifike, veçanërisht lidhur me mbrojtjen e ujërave nëntokësore.	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2008	IV/2009	10	

Kostot kapitale të identifikuara këtu synojnë të mbështesin një metodë të bazuar në projekte për zhvillimin e standardeve dhe udhëzimeve. Janë marrë masa që institutet e specializuara të angazhohen në asistencën teknike dhe të marrin mostra të zonave dhe ti analizojnë.

DM2 Minimizimi i riskut, që zonat e ndotura ekzistuese, paraqesin për shëndetin e popullatës

Për momentin, publiku ka mundësi vendosjeje në shumë nga këto zona të ndotura. Në disa raste, në këto zona janë ndërtuar qendra banimi. Njerëzit që banojnë në ose pranë këtyre zonave janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të mëdha shëndetësore. Sikurse theksohet edhe në Programin e Qeverisë, duhen ndërmarrë veprime konkrete për të minimizuar këto rreziqe.

Për këtë do të zbatohet një paketë masash, përfshirë:

- Masa të shtuara sigurimi në zonat e ndotura për të minimizuar rrezikun e futjes së popullatës në to.
- Zhvendosje, aty ku është e mundur, e njerëzve që banojnë në këto zona.
- Udhëzime dhe mbështetje për njerëzit që jetojnë në këto zona, por që nuk janë në gjendje të zhvendosen.
- Ndalimi i kullotjes së kafshëve dhe rritjes së prodhimeve ushqimore në zonat e ndotura.
- Ndalimi i nxjerrjes së ujit të pijshëm në zonat e prekura nga ndotja.

<sup>18</sup> Në miliona Lek

<sup>19</sup> Në miliona Lek

- Sigurimi i furnizimit të përkohshëm me ujë të pijshëm në zonat ku nuk ka furnizim të drejtpërdrejtë me ujë.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
DM2.1	Sigurimi i perimetrit të zonave të ndotura ekzistuese	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	IV/2009	25	
DM2.2	Zhvendosje e familjeve që janë vendosur në zonat e ndotura	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	IV/2009	50	

Kostoja e këtyre masave është e vështirë për t'u vlerësuar, meqenëse ka një sasi të pakët të dhënash të besueshme lidhur me kushtet e këtyre zonave ose nivelin e okupimit të tyre. Megjithatë, është e qartë që nevojitet një angazhim i madh financiar për të parandaluar vendosjen në këto zona si dhe të zhvendosjen e familjeve që tashmë janë vendosur në to.

### DM3 Zbatimi i Projekteve Prioritare të Restaurimit

Sipas programit të Projekteve Prioritare të Investimeve Mjedisore, janë identifikuar si prioritarë tre projekte restaurimi të zonave të ndotura.

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
DM3.1	Studimi i fizibilitetit dhe rehabilitimit mjedisor për "pikën e nxehtë" në kompleksin metalurgjik në Elbasan.	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	IV/2009	31 700	
DM3.2	Studimi i fizibilitetit dhe rehabilitimit mjedisor për "pikën e nxehtë" në uzinën e superfosfatit në Laç.	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	IV/2009	19 300	

## Objektivat dhe Masat Përkatëse

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
DM3.3	Studimi i fizibilitetit dhe rehabilitimit mjedisor për "pikën e nxehtë" në uzinën e dikurshme metalurgjike – në Rubik.	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	IV/2009	12 185	

Programi i Projekteve Prioritare të Investimeve Mjedisore (PPPIM) nuk i identifikon kostot e mundshme që shoqërojnë rehabilitimin e zonave të tilla. Vlerësimet e këtushme janë bërë mbi idenë e mundësisë së projektimit dhe realizimit të izolimit të mbetjeve në vendet ku ato ndodhen aktualisht. Aty ku do të jetë e mundshme që këto "izolatorë" apo konteinerë të ndërtohen, ato do të mund të vazhdojnë të funksionojnë për hedhjen e mbetjeve të rrezikshme të rajonit ku ato ndodhen. Duke u nisur nga sasia e mbetjeve të rrezikshme të prodhuara në Elbasan, një metodë e tillë do të ishte e përshtatshme për këtë zonë.

### DM4 Zhvillimi i projekteve të restaurimit në të ardhmen

Masat prioritare të restaurimit janë identifikuar më sipër. Megjithatë, ka edhe zona të tjera, të cilat kanë nevojë të restaurohen. Për këtë, kërkohet një program afatgjatë. Gjatë periudhës së zbatimit të projekteve të para prioritare duhet të përfundohen studimet e fizibilitetit dhe projektet përkatëse të restaurimit për fazën e dytë të këtij aktiviteti.

Programi ka nevojë të përfshijë projekte për të trajtuar restaurimin jo vetëm të komplekseve industriale, por edhe të minierave dhe gurorëve të braktisura. Do të jetë vendimtare të përdoret asistencë ekspertësh nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Instituti i Minierave në përgatitjen e projekteve të përshtatshme.

Përveç kësaj:

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap.	Shpenz. Op.
DM3.1	Zhvillimi i programeve të restaurimit të tokës për periudhën 2010 – 2014 përfshirë përfundimin e studimeve të fizibilitetit dhe përgatitjen e propozimeve për projekte për rehabilitimin e: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zonave të ndotura;</li> <li>- Minierave dhe Gurorëve të braktisura;</li> <li>- Depozitimet e braktisura të mbetjeve.</li> </ul>	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	IV/2009	150	



Kostoja e saktë e përgatitjes së programit nuk mund të specifikohet me hollësi, porse këtu është bërë një vlerësim mbi bazën e informacionit të marrë nga institucione të specializuara, të cilët kanë patur një mbështetje të fortë nga projektet. Një projekt i tillë nuk do të bazohet në asistencën teknike tradicionale, por do të jetë një formë “binjakëzimi”, ku puna e projektit do të drejtohet nga institucionet teknike shqiptare, të cilët më pas do të jenë përgjegjës për të “kërkuar ndihmën” e konsulentëve të jashtëm dhe ekspertëve ndërkombëtarë, sipas nevojës për zgjidhjen e problemeve specifike.

Eshtë propozuar që projekti të përdoret për të përgatitur projekte për 20 zona “të mëdha” dhe 20 zona “të vogla”.

#### DM4 Regjistri i Tokave të ndotura dhe Administrimit të Informacionit

Megjithëse nuk është i mundshëm ose një prioritet, në periudhën afatshkurtër është e domosdoshme të hartohet një regjistër për vendndodhjen e zonave potencialisht ose të njohura si të ndotura, si pjesë e strategjisë për mbrojtjen e tokave dhe të ujërave nëntokësorë. Për pasojë, propozohet që në periudhën afatmesme, 2010 – 2013, është e nevojshme të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Përgatitja e legjislacionit të nevojshëm për të hartuar një regjistër të tokave të ndotura, përfshirë kërkesat për autoritetet vendore që të identifikojnë dhe njoftojnë për zonat potencialisht të ndotura.
- Të jepen udhëzime për autoritetet vendore për identifikimin i zonave potencialisht të ndotura, përfshirë depot e karburanteve dhe kimikateve.
- Vëzhgim i autoriteteve vendore dhe identifikim i zonave potencialisht të ndotura.
- Mbledhja dhe verifikimi i të dhënave nga autoritetet vendore përfshirë informacionin nga planet e administrimit të mbetjeve.
- Botimi i regjistrit të tokave të ndotura.

Regjistri i tokave të ndotura duhet të përfshihet në Sistemin e Administrimit të Informacionit Mjedisor (SAIM) së bashku me:

- Masat për regjistrimin, ruajtjen dhe korrigjimin e të dhënave për tokat e ndotura të trajtuara në komponentet e tokave në Sistemin e Administrimit të Informacionit Mjedisor.
- Shqyrtimi dhe hedhja e të dhënave të disponueshme në sistem.
- Vendosja e mekanizmave për botimin e të dhënave dhe shpërndarja e tyre nëpërmjet internetit dhe CD-ve.



### **3.3.9 Zhurma dhe Rrezatimi**

*Kontrolli i nivelit të zhurmave dhe i rrezatimit me të cilat përballet popullsia, duhet të jenë në nivele optimale e të sigurta për shëndetin e njeriut*

#### **Zhurma**

Nivelet e zhurmës përfshihen në treguesit e studiuar nga Programi Kombëtar i Monitorimit (Vendimi Nr.103, i datës 31/03/2003). Nivelet e zhurmave janë monitoruar në shtatë qytete. Përgjithësisht këto nivelet janë poshtë atyre që konsiderohen të dëmshme për shëndetin. Megjithatë, në pjesën më të madhe të qyteteve, niveli i zhurmave gjatë ditës e tejkalon cakun optimal. Gjatë natës, nivelet e zhurmave janë përgjithësisht poshtë caktimit optimal, me përjashtim të Tiranës.

Niveli i zhurmës brenda ndërtesave varet gjithashtu nga struktura e ndërtimit. Parandalimi i zhurmës përgjithësisht nuk merret parasysh kur bëhet projektimi dhe specifikimi i ndërtesave. Deri tani është bërë një punë shumë e kufizuar për trajtimin e çështjeve që lidhen me zhurmat. Nuk janë vendosur standarde të zhurmës për makineri të veçanta apo për aktivitete specifike, me përjashtim të aviacionit. Shqipëria është palë kontraktuese e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, e cila është organi ndërkombëtar kyç për rregullimin e operacioneve aeroportuale. Në veçanti, nën termat e programit të privatizimit për aeroportin e Tiranës, operatorit të aeroportit i kërkohet të zhvillojë konsulta të rregullta për çështjet e zhurmës me Departamentin e Përgjithshëm të Aviacionit Civil dhe me linjat ajrore, po ashtu të monitorojë periodikisht nivelet e zhurmës në zonat e prekura, me qëllim që të projektojë procedurat dhe masat e nevojshme për pakësimin e zhurmave.

Me përjashtim të aviacionit, ndotja akustike (nga zhurmat) nuk është e rregulluar mirë.

Meqë efektet e niveleve aktuale të zhurmave nuk janë aq të lartë sa faktorët e tjerë të mjedisit që ndikojnë në shëndet kjo çështje, në periudhën afatshkurtër, nuk konsiderohet si prioritare. Megjithatë, gjatë kontrollit periodik të makinave, do të duhet të merren masa për të kontrolluar zhurmat nga automjetet që lëvizin në rrugë, si pjesë e masave që identifikohen në seksionin për cilësinë e ajrit.

Legjislacioni dhe sistemet për kontrollin e zhurmave nga burime të tjera, do të duhet të zgjidhen nëpërmjet me ligj në periudhat afatshkurtra dhe afatmesme. Megjithatë, përpara se të zbatohet një legjislacion i tillë, do të duhet të përgatitet kapaciteti i duhur administrativ.

Në periudhën afatshkurtër do të merren masat e mëposhtme:

- Përpilimi i një Projekt Akti "Mbi Nivelet e Pranueshme të Zhurmave Urbane" (të shkaktuara qoftë nga automjetet, motoçikletat ose transporti hekurudhor.);
- Monitorim i vazhdueshëm i zhurmave urbane i realizuar nga institucionet kombëtare;
- Punësim i një specialisti për zhurmat.

MMPAU nuk ka një specialist të zhurmave. Për pasojë, një specialist duhet të punësohet nga Drejtoria e Politikave të Parandalimit të Ndotjeve që të ndihmojë me ngarkesën e punës lidhur me zbatimin e përafrimit të legjislacionit në këtë fushë;

Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap <sup>20</sup>	Shpenz. Op. Vjet. <sup>21</sup>
NR1.1	Punësim dhe trajnim i specialistit të zhurmave, në Drejtorinë e Parandalimit të Ndotjes së MMPAU	MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik	I/2007	II/2008	1.2	0.7

Në periudhën afatmesme, prioritetet për këtë nën-sektor janë:

- Përpilimi i një Projektligji “Mbi Vlerësimin dhe Administrimin Mjedisor të Zhurmave”;
- Përforsim i mëtejshëm i kapaciteteve të Drejtorisë së Parandalimit të Ndotjeve në këtë fushë;
- Përcaktimi i autoriteteve kompetente për zhurmat dhe automjetet

Në periudhën afatgjatë, do të merren masa për të përfunduar transpozimin e legjislacionit të Komunitetit Europian në fushën e administrimit të zhurmave.

Legjislacioni mbi zhurmat duhet të trajtojë:

- Nivelin e lejueshëm të zhurmave dhe shkarkimeve nga skapamentot/marmitat e automjeteve;
- Sistemin e kontrollit teknik për inspektimin e zhurmave nga automjetet rrugore përfshirë udhëzimet mbi metodat e testimit dhe pajisjet për inspektimin në anë të rrugëve – kjo do të integrohet në masat e përcaktuara në CA 2.3 lidhur me kontrollin e automjeteve.
- Integrimin e çështjes së zhurmave në procesin e projektimit dhe ndërtimit të rrugëve, duke përfshirë edhe masat e nevojshme përmirësuese (zbutjen e zhurmave).
- Kufizimi i zhurmave nga pajisjet që punojnë në abjente të hapura.
- Zbatimi i masave për kontrollin e zhurmave nga pajisjet që punojnë në abjente të hapura, përfshirë monitorimin dhe regjimin e masave detyruese.
- Zhurma nga pajisjet shtëpiake.

Në elementët kyç të *acquis-it* që duhen trajtuar përfshijnë:

- Direktiva 2000/14/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Europës, ndryshuar me Direktivën 2005/88/KE, e cila përcakton si kufijtë e zhurmës ashtu edhe kërkesat për etiketimin e një sërë makinash/pajesjesh të destinuara për përdorim në ambiente të hapura.
- Avionë Subsonikë - 80/51/KEE, Avionë reaktivë Subsonikë - 89/629/KEE, Kufizim i Aktivitetit të Aeroplanëve - 92/14/KEE, Kufizime të aktivitetit të tyre në aeroportet e Komunitetit - 2002/30/KE.
- Direktiva 2002/49/KE mbi Zhurmat Mjedisore.
- Direktiva 1986/594 mbi zhurmat që përhapen me anë të ajrit dhe që shkaktohen nga pajisjet shtëpiake.

### **Rrezatimi**

Sikurse thuhet në Planin Kombëtar oër Përafrimin e Legjislacionit:

<sup>20</sup> Në miliona Lek

<sup>21</sup> Në miliona Lek

“Aktualisht, për shkak të mungesës së prodhimit në vend të materialeve radioaktive dhe burimeve shumë të kufizuara radioaktive, për qëllime të kujdesit shëndetësor dhe qëllime industriale, siguria bërthamore dhe mbrojtja nga radioaktiviteti nuk kanë qenë prioritet në Shqipëri. Legjislacioni në këtë fushë është i kufizuar dhe Konventa për Sigurinë bërthamore nuk është ratifikuar.”

Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi (KMRr) i drejtuar nga Ministri i Shëndetësisë është një komision ndër-ministor që përgjigjet për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese. Autoriteti ekzekutiv i Komisionit është Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi. Është përgjegjësia e saj të përgatisë dhe përditësojë inventarin e burimeve të mbetjeve ose të burimeve të përdorshme të rrezatimit, që gjenden në Shqipëri. Instituti i Fizikës Bërthamore është qendra e vetme që merret me mbetjet radioaktive. Këto dispozita kanë nevojë të përditësohen në periudhën afatshkurtër, ndërsa në periudhën afatmesme, duhet të arrihet të kryhet plotësisht transpozimi i legjislacionit të Komunitetit Europian.

Ekspozimi ndaj rrezatimit që vjen nga kërkimet për uranium tashmë është trajtuar nga një projekt i Bashkimit Europian (1999):

Hartimi i një metode gjithëpërfshirëse për vlerësimin e ndikimit që kanë ekspozimet më të vogla ndaj uraniumit dhe zbatimi i saj mbi efektet radiologjike që krijohen gjatë kërkimit për uranium në Shqipëri. Institucionet drejtuese: Komisioni i Mbrojtjes së Mjedisit (KMM). Kohëzgjatja: 16 muaj. Donatorët: Bashkimi Europian. Buxheti: 125,000 euro. Objektivi: hartimi dhe zbatimi i një metode gjithëpërfshirëse dhe sistematike për vlerësimin e ekspozimeve më të vogla ndaj uraniumit dhe efektin që kanë ato në shëndetin publik dhe në mjedis. Statusi: Afati i përfundimit në 1999.

Megjithatë, ka një çështje më shqetësuese në lidhje me rrezatimin. Një sërë zonash janë të predispozuar për t'u prekur nga çlirimi i gazit Radon nga toka. Shtimi i sasisë së këtij gazi në banesa mund të shkaktojë doza të papranueshme rrezatimi dhe tani njihet si një nga shkaktarët kryesorë të kancerit në mushkëri<sup>22</sup>. Sikurse deklarohet në raportin e Performancës Mjedisore të përgatitur nga Komisioni Ekonomik për Europën i Kombeve të Bashkuara (KEEKB):

“... në fillim të viteve 1990, Studimi Gjeologjik vlerësoi rrezikun e mundshëm që përbën radoni në fushën perëndimore të Shqipërisë. Ky studim, i kryer në 5 për qind të territorit të vendit, vërtetoi që ky rrezik ekzistonte në sajë të përqendrimit të lartë të radonit në tokë.

Pas këtij studimi, në një grup shtëpish që u studjuan në Tiranë u gjenden nivele mesatare të radonit prej 150 Bq/m<sup>3</sup> (vlera orientuese e OBSH-së: 100 Bq/m<sup>3</sup>). Shtëpitë e vendosura në një zonë të rrezikut të lartë (në parkun kombëtar të Dajtit) shfaqën nivele shqetësuese që varionin nga 1000 deri në 4000 Bq/m<sup>3</sup>. Studimi u kufizua vetëm në matjen e nivelit të radonit dhe hedhjen në hartë të rrezikut të radonit në zonën e studiuar. Pas kësaj, u zbuluan dy zona afër Shkodrës dhe Tiranës që kishin nivele të larta këtij elementi. Megjithatë, nuk janë bërë përpjekje për të vlerësuar efektet e mundshme mbi shëndetin në zonat me rrezik të lartë.”

Masat për përditësimin e këtij studimi dhe marrja e masave për mbrojtjen e popullsisë në zonat e prekura propozohen në periudhën afatshkurtër.

Legjislacioni në fushën e rrezatimit nevojitet të harmonizohet me atë të Komunitetit Europian. Prioritetet afatshkurtra për legjislacionin janë :

- Amendimi i Ligjit Nr. 8025 i datës 09.11.1995 "Mbi Mbrojtjen nga Rrezatimi" në përputhje me DCM 96/29 të datës 13.05.1996;

---

<sup>22</sup> <http://www.who.int/mediacentre/news/notes/2005/np15/en/index.html>



- Amendimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave "Mbi Importin dhe Eksportin e Materialeve Radioaktive në Republikën e Shqipërisë" në përputhje me Marrëveshjet Ndërkombëtare mbi Ndikimin në Mjedis (MNNM) - kodi/IAEA/2004;
- Përditësimi i Planit të Emergjencës Radiologjike përfshirë shqyrtimin e zbatimit të masave.
- Rivlerësim i Rregullores "Mbi Licensimin dhe Inspektimin", përfshirë caktimin e përgjegjësive institucionale.

Në prioritetet e periudhës afatmesme dhe afatgjatë, masat ligjore janë:

- Rivlerësimi dhe amendimi i rregulloreve për transportin e materialeve dhe mbetjeve radioaktive përfshirë edhe masat e zbatimit:
  - o Përcaktimi i autoritetit kompetent për të rregulluar transportin e lëndëve radioaktive.
  - o Hartimi dhe zbatimi i një sistemi të njoftimit paraprak dhe dokumentacioni lidhur me transportin e lëndëve radioaktive.
  - o Vendosja e një sistemi të raportimit tek autoritetet kombëtare dhe Komisioni Europian.
- Projektligj "Mbi Ekspozimin në Mjekësi" përfshirë masat zbatuese.
  - o Procedurat për të kufizuar ekspozimin e personelit mjekësor ndaj rrezatimeve jonizuese.
  - o Vendosja e një sistemi kontrolli për të siguruar përdorimin e sigurt të pajisjeve radiologjike.
  - o Vendosja e një sistemi raportimi të BE.
- Përforcimi i Komisionit për Mbrojtjen nga Rrezatimi.
- Ligji për ushqimet e ndotura nga radioaktiviteti, përfshirë zbatimin e masave mbrojtëse:
  - o Përcaktimi i autoriteteve kompetente që do të merren me ushqimet dhe lëndët ushqyese të ndotura nga rrezatimi.
  - o Vendosja e një sistemi monitorimi të ushqimeve të ndotur nga rrezatimi, qofshin ato për njerëzit edhe/ose për blegtorinë.
  - o Zbatimi i rregullave që ndalojnë tregëtimin dhe eksportin e ushqimeve dhe lëndëve ushqyese të ndotura nga rrezatimi.
  - o Përpilimi i një sistemi për të imponuar zbatimin e ligjit në rast shkeljeje.
  - o Vendosje e sistemit të raportimit në BE.

Ndonëse një numër masash "konkrete" do të lindin si pasojë e amendimeve të legjislacionit, synohet të ndërmerren një numër veprimesh urgjente pavarësisht nga afati për harmonizimin me legjislacionin e Komunitetit Europian.



Ref	Masat Publike Prioritare	Institucionet Përgjegjëse	Fillimi	Mbarimi	Shpenz. Kap <sup>23</sup>	Shpenz. Kap. Vjet. <sup>24</sup>
NR2.1	Vlerësimi i rreziqeve dhe plani i veprimit për të kontrolluar ekspozimin ndaj rrezatimit nga gazi radon në ndërtesa	METE, përfshirë Shërbimin Gjeologjik Shqiptar MMPAU, përfshirë Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve Ministria e Shëndetësisë, përfshirë Institutin e Shëndetit Publik Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi MPPTT Asistenca Teknike	I/2007	II/2009	20	20

Përlllogaritja e kostove përkatëse (Shpenzimet Kapitale) është bërë për marrjen e masave të mëposhtme:

Vlerësim i rrisqeve fillestare mbi bazën e të dhënave ekzistuese të monitorimit dhe informacionit të ekspertëve nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar;

Zbatim i programit të monitorimit për vlerësimin e pronave që ndodhen në rrezik;

Botim i udhëzimeve për ndërtimin e shtëpive në zonat në rrezik, përfshirë instalimin e membranave dhe ventilimit nën dysheme;

Fushatë vendore për nxitjen e marrjes së masave prapavepruese (riparimin e banesave ekzistuese) nëpërmjet skemash të granteve të vogla.

Përveç koston kapitale të kësaj mase, janë parashikuar shpenzime operative për të krijuar një skemë grantesh të vogla nën administrimin e Fondit të Mjedisit për të mbështetur masat përmirësuese në pronat që kërkojnë masa prapavepruese.

<sup>23</sup> Në miliona Lek

<sup>24</sup> Në miliona Lek





## 4. Mjetet e Arritjes së Objektivave

Në Kapitullin 3 janë përcaktuar objektivat dhe masat specifike sipas sektorëve në përgjigje të çështjeve mjedisore të identifikuara në Kapitullin 2. Ky kapitull prezanton mjetet me anë të të cilëve mund të arrihen këto objektiva. Kapitulli 5 përcakton një numër masash horizontale të cilat duhet të ndërmerren përveç veprimeve specifike sipas sektorëve. Janë krijuar një sërë mekanizmash, por shumë prej tyre kanë nevojë të përmirësohen. Duhet të krijohen gjithashtu mekanizma të rinj në mënyrë që të ecet si drejt zhvillimit të qëndrueshëm ashtu edhe drejt integritimit Europian.

Çelësi qëndron tek administrimi mjedisor.

*“Administrim Mjedisor”* ky term i referohet sistemeve që ndihmojnë në kontrollin dhe uljen e dëmeve që aktivitetet tona mund t'i shkaktojnë botës ku ne jetojmë.

Një administrim i mirë mjedisor u shërben shumë qëllimeve. Ai ndihmon në ruajtjen e burimeve, ul ndotjen, dhe kontribuon në përmirësimin e shëndetit të popullatës. Përsa u përket uljes/reduktimit të masës së mbetjeve dhe çlirimeve të ndotësve në atmosferë, ai kontribuon në efikasitetin dhe si rrjedhojë edhe në konkurrencën e industrisë. Në lidhje me mbrojtjen e habitateve dhe biodiversitetit, ai kontribuon në kapacitetet mbajtëse të tokës dhe e bën atë më tërheqëse, gjë që është thelbësore për një bujqësi të shëndetshme ose për një industri të begatë të turizmi.

Një administrim i mirë mjedisor kërkon praktika të mira zhvillimi nga ana e qeverisë, autoriteteve vendore, sektorit privat dhe popullsisë në tërësi. Kjo mbështetet në:

- të kuptuarit nga ana e vendim-marrësve të çështjeve mjedisore dhe *përfshirjen* e shqetësimeve mjedisore në politikat dhe sistemet e tyre të administrimit operacional;
- një kuadër të *legjislativ* të shëndoshë;
- *mekanizma* të efektshme të *zbatimit* të politikave dhe ligjit, ku përfshihen proceset detyruese të zbatimit të ligjit, *instrumentet ekonomike dhe planifikimi financiar*;
- mbështetje nëpërmjet *edukimit, trajnimit, informacionit* dhe mjeteve të tjera; dhe
- mjetet e vlerësimit të cilat nëpërmjet organizimit të sistemit të *monitorimit dhe raportimit* përcaktojnë nëse strategjia dhe veprimet janë të efektshme.

*Investimi* është gjithashtu thelbësor dhe ai do të jetë edhe më i efektshëm nëse administrohet mirë.

Ky kapitull përcakton parimet e një administrimi të mirë. Duke u bazuar mbi këto parime dhe mbi një vlerësim të situatës aktuale në Shqipëri, Kapitulli 5 përcakton masat që duhen ndërmarrë.

### 4.1. Përfshirja i Çështjeve Mjedisore në Procesin e Zhvillimit

Duke *përfshirë konsideratat mjedisore* në politikat dhe veprimet e veta, qeveria bën të sigurtë faktin që kupton dhe administron efektet mjedisore të këtyre politikave në një mënyrë më pak të kushtueshme dhe ekonomikisht eficiente. Vendimet do të jenë më të mirë informuara dhe do të ketë më shumë të ngjarë që ato të plotësojnë nevojat afat-gjata të vendit si dhe të priten mirë si nga popullata ashtu edhe nga investitorët.

Institucionet qeveritare për të cilët përfshirja është veçanërisht e rëndësishme janë ato institucione, politikat e të cilëve:

- kanë një efekt direkt mbi mjedisin; të tilla si punët publike, bujqësia, transporti, energjitika, industria, ose
- mund të nxisin praktikatat e mira mjedisore, të tilla si planifikimi fizik i territorit.

Mund të duket sikur fusha të caktuara të politikave kanë një efekt të ulët mbi mjedisin. Por edhe në këtë rast, ato mund të jenë të rëndësishme për mbrojtjen mjedisore për shkak të rolit që kanë në shoqëri. Arsimi është një shembull i qartë dhe drejtësia është një shembull tjetër. Edukimi i fëmijëve dhe i publikut të gjerë për të kuptuar efektet e sjelljes së tyre në mjedis do të influencojë në mënyrë të përhershme vendim-marrjet individuale. Deri më tani mënyra se si operon sistemi gjyqësor, ka shumë pak efekt mbi ndotjen por kur gjykatat të fillojnë t'u vënë gjoba të rënda ndotësve, atëherë edhe ato do të mund të ndihmojnë mjedisin duke iu kundërvënë krimin mjedisor.

#### Integrimi Strategjik Mjedisor – Një shembull nga Komuniteti European<sup>1</sup>

*Programi i 6-të Mjedisor i Veprimit* të Komunitetit European përmban objektivin e "Reduktimit të rreziqeve ndaj shëndetit dhe mjedisit të krijuara nga bujqësia". Mekanizmi kryesor për arritjen e këtij objekti ka qenë përfshirja e çështjeve mjedisore në Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB).

Sipas rregulloreve<sup>2</sup> të reja të PPB-së pagesat për aktivitetin bujqësor dhe ndihmat e tjera direkte do të jepen pasi të arrihen kushte të përshtatshme bujqësore dhe mjedisore (përputhja e kryqëzuar). Rregulloret e reja rrisin gjithashtu rolin e politikave të zhvillimit rural mbi mjedisin, me një bashkëfinancim më të madh për masat agro-mjedisore dhe mbështetje për shërbimet këshillimore ndaj aktivitetit bujqësor.

Sipas rregullores së re, kërkesat e përputhjes së kryqëzuar përfshijnë respektimin e Direktivave për Shpendët e Egër dhe për Habitatet si dhe masat për mirëmbajtjen e habitateve dhe peizazhit. Është siguruar një nivel në rritje i mbështetjes ndaj praktikave bujqësore dhe administrimit, i cili është në përputhje me mbrojtjen e biodiversitetit të vendeve të klasifikuara në "Natura 2000"

#### Integrimi Mjedisor në Nivelin e Projektit – Projektimi i Rrugëve dhe Urave<sup>3</sup>

Megjithëse ka vite që skemat e transportit rrugor u janë nënshtruar vlerësimeve të efektit mjedisor, këto vlerësime janë ndërmarrë zakonisht në përfundim të procesit të projektimit, p.sh. pasi është marrë vendimi kryesor në lidhje me projektimin dhe vendndodhjen e rrugëve. Si rezultat kjo metodë ka sjellë identifikimin e çështjeve mjedisore vetëm në fazat përmbyllëse të projektimit. Kjo shpesh ka sjellë si rezultat ndryshimin e skemave pasi është kryer pjesa më e madhe e punës projektuese, me gjithë shpenzimet dhe vonesat që kjo sjell me vete. I parë nga ky këndvështrim, Manuali i Projektimit të Mbretërisë së Bashkuar për Rrugët dhe Urat u ndryshua për të integruar vlerësimin mjedisor në zhvillimin e skemave të propozuara qysh në fillim të procesit. Manuali synon të sigurojë marrjen plotësisht në konsideratë të efekteve eventuale mjedisore të skemave të mundshme, kështu që vendimet të mund të merren duke qenë në dijeni të pasojave të tyre mjedisore, përfshi këtu vendimin nëse duhet vazhduar ose jo me zhvillimin e mëtejshëm të një skeme dhe nëse duhet vazhduar, të ndihmojmë në identifikimin e mënyrave me anë të të cilave efektet mjedisore mund të minimizoheshin nëpërmjet zgjedhjes së mjeteve dhe masave të tjera.

Është e nevojshme që çështjet mjedisore të përfshihen brenda politikave, programeve ose projekteve konkrete që nga fillimi i tyre deri në realizimin përfundimtar dhe futjen në veprim të tyre. Ekzistojnë mjete që mbështesin këtë proces përfshirjeje në përgatitjen e politikave dhe projekteve si dhe mjete që ndihmojnë në vlerësimin e projekteve. Secili prej tyre i nënshtrohet legjislacionit të Bashkimit European.

*Vlerësimi i Ndikimit mbi Mjedisin* për projekte specifike (VNM e projektit) është një mjet që përdoret gjërësisht sot në Shqipëri. Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) trajtohet në Kapitullin II të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit, por ky kuadër ligjor ka nevojë të forcohet dhe mbështetet nga strukturat e duhura zbatuese.

<sup>1</sup> Përshtatur nga COM (2004) 394 versioni final (Dokument Pune i Komisionit, Bruksel, 01.06.2004) Integrimi i konsideratave mjedisore në fusha të tjera të politikave – një vlerësim i procesit të Kardifit

<sup>2</sup> 1782/2003/KE

<sup>3</sup> <http://www.standardsforhighways.co.uk/dmrb/index.htm>

Kapitulli II i Ligjit mbi Mbrojtjen Mjedisore gjithashtu identifikon nevojën për *konsultime* dhe negociata, si mjete të integrit të çështjeve mjedisore. Sidoqoftë integrimi ka nevojë të forcohet nëpërmjet zbatimit të disa praktikave aktualisht të përdorura nga Vendet Anëtare të BE (dhe Komisioni Europian), të cilat i përdorin proceset e *konsultimeve* dhe negociatave si një mjet për t'u siguruar se objektivat e tyre mjedisore janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të politikave.

Konsultimi dhe për rrjedhojë edhe përfshirja duhet të nxiten në tre fusha kyçe të politikës:

- *Industria dhe tregtia*, duke përfshirë të gjithë aktivitetet ekonomike që mund të shkaktojnë dëme të theksuara mjedisore, përfshirë operacionet ekzistuese dhe të propozuara që çlirojnë ndotës ose gjenerojnë mbetje dhe ku vijueshmëria e aktiviteteve administruese ka nevojë të përforcohet.
- *Planifikimi dhe ndërtimi*, ku tashmë janë zbatuar procedura të sakta, por ku parimet mjedisore kanë nevojë të zbatohen në praktikë nëpërmjet një bashkëpunimi më të mirë midis autoriteteve planifikuese dhe institucioneve mjedisore. Një theks i veçantë duhet vënë mbi zonat e aktivitetit me rritje më të shpejtë: ndërtesat e banimit, turizmi dhe transporti (në veçanti ndërtimi i rrugëve)
- *Bujqësia, pyjet dhe peshkimi*, veçanërisht atje ku ato çënojnë mbrojtjen e peizazhit, habitatit dhe biodiversitetit dhe ku praktikatat e administrimit kanë gjithashtu nevojë të përmirësohen.

Me pak fjalë, sapo popullsia në tërësi, përfshirë personelin e ministrive, industrialistët dhe grupet e tjerë të përfshirë në biznes, të kuptojnë nevojën dhe vlerën e përfshirjes mjedisore, zbatimi i programeve të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore do të jetë më i lehtë. *Arsimimi* në të gjitha nivelet, përfshirë trajnimin dhe ri-trajnimin e të rriturve, është një komponent thelbësor për integrimin. Më poshtë diskutohet më në detaje rreth administrimit të arsimimit dhe informacionit në sektorin mjedisor.

## 4.2 Legjislacioni

Legjislacioni dhe zbatimi i tij e mbajnë shoqërinë të bashkuar. Në drejtimin e një shteti modern brenda një komuniteti ndërkombëtar, është thelbësore që të ketë një kuadër ligjor të shkruar mirë, i cili është kuptuar drejtë dhe zbatohet efektivisht.

### 4.2.1 Situata Ekzistuese

Brenda një periudhe relativisht të shkurtër, Legjislatura të njëpasnjëshme kanë miratuar një numër mbresëlënës ligjesh mjedisore, duke mbuluar një fushë të gjerë çështjesh, përfshi këtu parandalimin e ndotjes, administrimin e mbetjeve, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (tokës, ujërave, produkteve të detit dhe të pyjeve) dhe ruajtjen e habitateve dhe biodiversitetit të specieve.

Komisioni parlamentar për Shëndetin dhe Mjedisin shqyrton projekt-ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të formuluar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve, dhe Administrimit të Ujërave përpara se t'ia paraqesë ato parlamentit për miratim

Legjislacioni bazohet kryesisht mbi metodën e *komandës dhe kontrollit*.

Elementi i *komandës* ka të bëjë me vendosjen e rregullave, të mbështetura me ligj, që duhen zbatuar detyrimisht. Këto mund të jenë përgjithësisht ose pjesërisht të zbatueshme, mund të ndalojnë aktivitete specifike ose mund të kërkojnë që aktivitetet të ndërmerren në një mënyrë specifike ose vetëm në përputhje me një leje individuale.

Pjesa e metodës që i takon *kontrollit* ka të bëjë me imponimin nga ana e shtetit të standardeve, nëpërmjet vënies në zbatim të sanksioneve penale ose administrative mbi shkeljet.

Një rishikim i kohëve të fundit mbi kuadrin ekzistues ligjor mjedisor nxori në pah një gamë të gjerë problemesh në lidhje me formën e legjislacionit ekzistues, gjë që e bën të vështirë, madje të pamundur zbatimin efektiv të tij. Problemet më kryesore kanë të bëjnë me mungesën e dispozitave të zbatueshme praktike dhe një marrëdhënie të paqartë midis ligjeve të ndryshme që mbulojnë çështje të ngjashme.

Ligji nuk praktikohet njësoj kudo dhe në disa raste ai madje nuk merret në konsideratë. Një fushë veçanërisht problematike është fusha e lejeve mjedisore. Për të qenë të efektshme, lejet duhet të përmbajnë kushte të qarta, të përcaktuara mirë dhe të zbatueshme, të cilat specifikojnë sesi duhet ndërmarrë një aktivitet si dhe nivelin maksimal të dëmit mjedisor që mund të rezultojë nga aktiviteti. Aktualisht, as legjislacioni dhe as procesi i dhënies së lejeve nuk e mundësojnë këtë gjë.

Legjislacioni ofron gjithashtu një bazë të dobët për zbatueshmërinë e dispozitave për mbrojtjen mjedisore. Ai u jep fuqi të kufizuar inspektorëve mjedisorë, shkeljet administrative hartohen me terminologji të pasaktë dhe shkeljet mjedisore të parashikuara nga Kodi Penal janë shumë të vështira për t'u ndjekur penalisht në mënyrë të suksesshme.

Madje edhe kur shkeljet administrative të ligjit mjedisor janë provuar dhe janë vënë gjoba mbi shkelësit, mungesa e një mekanizmi zyrtar të mbledhjes së këtyre gjobave ka rezultuar në mospagesën e shumicës së tyre (p.sh. 80% në vitin 2004).

Zbatimi dhe respektimi efektiv i legjislacionit pengohen nga mungesa e burimeve njerëzore si dhe e burimeve të tjera, por kjo nuk duhet të kthehet në një justifikim për të mos trajtuar problemet që kanë të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e vetë legjislacionit. Nëse nuk u jepet zgjidhje problemeve me ligjet aktuale brenda një periudhe afat-shkurtër, atëherë legjislacioni mjedisor shqiptar as nuk do të mbrojë mjedisin dhe as nuk do të hedhë bazat për *përafrimin* dhe aderimin në BE.

#### **4.2.2 Përmirësimi i situatës**

Përafrimi përbën detyrimin e shteteve anëtare që aspirojnë anëtarësimin në BE, që të përshtasin ligjet, rregullat dhe procedurat e tyre me kuadrin ligjor të Komunitetit Europian i njohur si *Acquis Communautaire*. Procesi kërkon zhvillimin e një kuadri ligjor, i cili pasqyron standardet dhe metodat ndërkombëtare në shumicën e fushave. Duke qenë se për të arritur përafrimin, në Shqipëri do të ketë nevojë të ndryshojnë shumë ligje, atëherë ekziston mundësia që gjatë procesit të përafrimit të kapërcehen shumë dobësi të kuadrit ekzistues ligjor.

Është adoptuar<sup>4</sup>, një Plan Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL) i cili përcakton objektivat për një periudhë dhjetë vjeçare deri në vitin 2015. Seksioni 3.2.3 i PKPL-së trajton ligjin mjedisor ose "*acquis* mjedisor".

Procesi i përafrimit ka tre dimensione të veçantë, të cilët janë të lidhura ngushtësisht me njëri-tjetrin. Ata janë:

- përfshirja zyrtare e detyrimeve që përmban *acqui,s* brenda kuadrit ligjor kombëtar, ose *transpozimi*;
- *zbatimi* i detyrimeve, duke kërkuar planifikim institucional dhe buxhetor për të siguruar që ligji zbatohet dhe se mund të realizohen investimet e nevojshme për të siguruar standardet që parashikon ligji; dhe
- *detyrimi*, që ka të bëjë me marrjen e masave të nevojshme për të zbuluar shkeljet e legjislacionit të rishikuar dhe për të ndërmarrë hapat përkatës në sanksionimin dhe korrigjimin e mospërputhjeve me ligjin.

<sup>4</sup> Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë, 2005



Megjithëse *acquis* mbulon një gamë të gjerë çështjesh, disa nga fushat e administrimit mjedisor dhe shumë procedura zbatuese specifike lihen në kompetencën e Shteteve Anëtare individuale. Për këtë arsye, Shqipëria do të ketë nevojë të vazhdojë përshtatjen e legjislacionit të saj specifik si dhe transpozimin e detyrimeve ndaj BE-së me qëllim arritjen e një kuadri vërtet gjithëpërfshirës të legjislacionit mjedisor.

### 4.3 Zbatimi

Problemet me zbatimin e legjislacionit nuk shfaqen vetëm si rezultat i mangësive në legjislacion. Vlerësimi i vitit 2002 i KEKBE (Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën) për situatën mjedisore të Shqipërisë shprehet se ka një

*“...mungesë respekti për ligjin, që i ka rrënjët në vitet kur Shqipëria vuante nën regjimin shtypës e diktatorial, mungesë aftësie për të matur dhe monitoruar përputhshmërinë me ligjin, procedura të dobëta të imponimit të ligjit, mungesë kapaciteti institucional dhe një shpërndarje jo-funksionale të kompetencave ndërmjet ministrive.”<sup>5</sup>*

Megjithëse që prej asaj periudhe janë bërë përparime, ka ende çështje që janë zgjidhur vetëm pjesërisht.

Legjislacioni nuk gjen përdorim nëse ai nuk zbatohet në praktikë. Ai duhet zbatuar njëllë në të gjithë vendin dhe mbi këdo. Ai duhet zbatuar në mënyrë efektive me qëllim që të arrijë objektivat e veta. Kjo gjë kërkon institucione dhe mekanizma institucionalë të aftë dhe të fuqishëm si dhe procedura të duhura. Me pak fjalë, është e nevojshme të vihet në përdorim një *cikël* efektiv i *administrimit mjedisor* përfshirë dhënien e lejeve, sistemet e inspektimit dhe verifikimit si dhe funksionet e monitorimit dhe raportimit.

#### 4.3.1 Pajisja me Personel e Sektorit të Administrimit Mjedisor

##### Situata ekzistuese

Shqipëria nisi zhvillimin e sistemeve të mbrojtjes së mjedisit në fillimet e viteve 90-të, përfshirë krijimin e Agjencive Rajonale të Mjedisit. Megjithatë, vetëm në vitin 2001 u krijua Ministria e Mjedisit si një administratë e pavarur. Kjo u pasua me Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit (No. 8934, 2002) dhe Planin e azhornuar Kombëtar të Veprimit Mjedisor. Në vitin 2005, Ministria u zgjerua dhe u fuqizua me përfshirjen brenda fushave të saj të kompetencave, të çështjeve të administrimit të pyjeve, peshkimit, ujërave dhe administrimit të zonave të mbrojtura mjedisore.

Megjithëse e fuqizuar, ministria vuan nga dy vështirësi kryesore: personel të pamjaftueshëm për të mbuluar ngarkesën në rritje të punës dhe përballjen me një popullatë e cila shpesh nuk kupton se përse vendosen kufizime të karakterit të mbrojtjes mjedisore mbi aktivitetet e saj.

Problemet kryesore institucionale të Ministrisë janë:

- Mungesë kapacitetesh për një hartim efektiv të legjislacionit;
- Burime të pamjaftueshme për të siguruar zbatim të legjislacionit;
- Mungesë informacioni dhe sistemesh me anë të të cilave të zbatohet cikli i administrimit mjedisor; dhe
- Kapacitete të pamjaftueshme programimi, projektimi dhe vlerësimi për të identifikuar dhe zhvilluar projekte të infrastrukturës mjedisore të nevojshme për të siguruar një nivel të kënaqshëm shërbimesh ndaj popullatës dhe në përputhje me detyrimet e *acquis*.

<sup>5</sup> Analiza e Performancës Mjedisore për Shqipërinë nga UNECE, 2002

## Nevoja

Struktura administrative aktuale nuk mund të përmbushë kërkesat e saj të momentit apo të ardhshme. Fuqizimi i saj përbën një prioritet të lartë. Bazuar në eksperiencën e vendeve të ngjashme nga madhësia dhe kushtet, do të jetë e nevojshme që brenda vitit 2015 numri i njerëzve të përfshirë në mënyrë direkte në administrimin mjedisor të *paktën të trefishohet*, me qëllim përmbushjen e kërkesave praktike të ligjit, të nevojshme për zbatimin e *acquis*.

**Tabela 4-1 Nivelet e personelit në Sektorin e Mjedisit**

### Një krahasim i nivelit të personelit në sektorin e mbrojtjes së mjedisit në vende të ndryshme

Është e rëndësishme të kuptojmë se qëllimi i mbrojtjes së mjedisit dhe shpërndarja e personelit midis institucioneve janë të ndryshme në vende të ndryshme Europiane; gjithashtu informacioni i paraqitur u referohet viteve të ndryshme, kështu që është e vështirë të bëhen krahasime direkte. Kjo tabelë përpiqet që t'i bëjë shifrat sa më të krahasueshme që të jetë e mundur.

	<i>Shqipëria</i> 2005	<i>Estonia</i> 1999	<i>Lituania</i> 2002	<i>Hungaria</i> 2002	<i>Bullgaria</i> 2003
Popullsia (në milionë)	3.4	1.6	2.4	10	8.5
Personeli i Ministrisë (vetëm sektori i mjedisit)	60	150	139	435	267
Inspektorati	39	210	79	1264*	682**
Personel tjetër administrues	+/-100***	250	533	693	579
<b>Totali</b>	<b>+/-200</b>	<b>610</b>	<b>741</b>	<b>2392</b>	<b>1528</b>
Përqindja e personelit të administrimit mjedisor ndaj numrit total të popullsisë	<b>1 : 17 000</b>	<b>1 : 2 623</b>	<b>1 : 3 239</b>	<b>1 : 4 180</b>	<b>1 : 5 663</b>
* përfshi dhënien e lejeve dhe shumë funksione të tjera					
** përfshi dhënien e lejeve dhe laboratorët rajonale					
*** një parashikim i personelit të mbrojtjes së natyrës dhe administrimit të ujërave (21 persona)					

Sikurse theksohet edhe në PKPL:

*“Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është krejtësisht e ndërgjegjshme për faktin që niveli aktual i personelit të strukturave të saj është i pamjaftueshëm për t’u përballur me situatën mjedisore të vendit dhe me sfidën e Integritimit European si dhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë arsye, një masë e parashikuar në të gjithë kapitujt mjedisorë, është punësimi i personelit shtesë dhe kualifikimi i tij”.*

### **4.3.2 Zbatimi i Ciklit të Administrimit Mjedisor**

Cikli fillon me legjislacionin që mundëson dhënien e *lejeve* të aktiviteteve. Përputhja me këto *kushte* duhet të *verifikohet* dhe *zbatohet*. Cikli vazhdon me *monitorimin* e mënyrës së operimit të këtyre aktiviteteve dhe përfundon me *raportimin* mbi përputhjen, veprimtarinë dhe efektet mjedisore. Raportet përdoren për të përcaktuar mënyrën se si të *përshatsim* politikën dhe ligjin sipas nevojave. Funksionimi i ciklit ka gjithashtu nevojë për mbështetje teknike përfshirë kapacitetet laboratorike dhe analitike dhe një sistem funksional hetimi, penalizimi, apelimi dhe stimuluese për praktika pozitive.

### **Situata ekzistuese**

Ministria e Mjedisit e zbaton politikën e saj në mënyrë direkte si nëpërmjet institucioneve kombëtare ashtu edhe agjencive rajonale. Aktiviteti i çdo institucioni rregullohet nga ligji përkatës ose legjislacioni plotësues i cili përcakton në detaje përgjegjësitë dhe detyrat.

Ministria luan një rol dominues në zbatimin praktik. Ajo është përgjegjëse për formulimin e politikës, hartimin e legjislacionit, përgatitjen e projektit, përgatitjen e lejeve për t'u firmosur nga Ministri, inspektimin qendror, si dhe funksionet administruese të zbatimit dhe monitorimit në të gjitha fushat kryesore mjedisore.

Dymbëdhjetë Agjencitë Rajonale të Mjedisit – ARM – janë përgjegjëse për përgatitjen paraprake të informacionit mbi lejet, i cili i transmetohet Ministrisë. Ato gjithashtu lëshojnë autorizime për aktivitete të një shkalle më të vogël të karakterit lokal. Ato japin pëlqimin e tyre për të gjitha lejet e shesheve të ndërtimit, bazuar në informacionin standard të siguruar nga prezantuesit e një projekti. Ato inspektojnë aktivitetet brenda zonës së tyre në përputhje me një plan pune, për të cilin është rënë dakord me inspektorët kombëtar.

Pavarësisht se lejet duhet të përmbajnë disa tregues standard, as Ministria dhe as ARM<sup>te</sup> nuk kanë burime të mjaftueshme për të vendosur standarde specifike zonale për ndonjë aktivitet specifik. Metoda e përdorur më shpesh me lejet, është ajo e referimit ndaj detyrimit për të vepruar në përputhje me ligje specifike, në krahasim metodën e përcaktimit të standardeve specifike zonale.

Autoritetet gjithashtu kanë mungesa në mjetet e verifikimit të zbatimit të standardeve. Ata kanë në dispozicion shumë pak pajisje për marrjen e mostrave ose testimin si dhe kapacitete të kufizuara laboratorike. Funksioni i kontrollit të ndotjes nga ana e inspektorëve zakonisht mjaftohet me kontrollin e regjistrave të vetë-monitorimit të impianteve industriale. Marrja e mostrave dhe analizat kryhet nga strukturat e përshtatshme ose konsulentët, zakonisht një nga institutet të cilët disponojnë laboratore.

### Nevojat për Përmirësime

Nevojat në këtë fushë janë të konsiderueshme jo vetëm përsa i përket personelit, pajisjeve dhe trajnimit por edhe në lidhje me organizimin: përcaktimi i shpërndarjes së duhur të fuqive vendim-marrëse është veçanërisht i rëndësishëm në momentin kur është duke u zbatuar politika qeveritare e decentralizimit të përgjegjësive administrative. Pyetja mund të ngrihet shumë thjesht: kush duhet të jetë përgjegjës për detyrat e ndryshme të përshkruara më poshtë?

*Dhënia e lejeve* është kyçi i sistemit të administrimit mjedisor dhe kushtet që përfshihen në leje përcaktojnë efektivitetin e tyre. Këto kushte duhen specifikuar në një mënyrë të qartë dhe të pa asnjë dyshim, në mënyrë që përputhja me to të mund të verifikohet dhe zbatohet. Ato mund të përfshijnë detyrimet për vetë-monitorim, të cilat janë një mënyrë e mirë për të ndihmuar autoritetet e inspektimit gjatë përcaktimit të përputhjes.

Aktivitetet mbi të cilat zbatohen lejet duhet të jenë të njohur dhe të publikohen: si pjesë e procesit të dhënies dhe rinovimit të lejeve, duhet që të krijohet një regjistër i impianteve të kontrolluar, i cili të jetë i hapur për publikun. Ky regjistër duhet të jetë një dokument publik, në përputhje edhe me Nenin 56 të Kushtetutës, Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit (Neni 54 e në vazhdim), Konventën<sup>6</sup> e Aarhus<sup>it</sup> si dhe kërkesat e legjislacionit të Komunitetit Europian (Direktiva 2003/04/BE për të drejtën mbi informacionin mjedisor).

Duhet ndërmarrë *inspektimi* i respektimit të kushteve të përcaktuara në leje. Matjet, marrja e mostrave dhe analizat e respektimit të këtyre kushteve duhet të jenë të realizueshme dhe realiste. Metodatat e zakonshme analitike duhet t'u bëhen të ditura si atyre që kryejnë kontrollin ashtu edhe atyre që kontrollohen.

<sup>6</sup> Konventa mbi të Drejtën për Informim, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-Marrje dhe e Drejta për Drejtësi në Çështje Mjedisore, Aarhus, Danimark, 25 Qershor 1998 – e ratifikuar nga Shqipëria në 27/06/1991

Elementi kyç në këtë proces është një rrjet *laboratorësh*, ngritja e të cilit duhet marrë në konsideratë të veçantë. Ai duhet projektuar për të mbështetur nevojat më të gjera të Shqipërisë për monitorim mjedisor si edhe për kontrollin dhe parandalimin e ndotjes.

Shkeljet e verifikuara të kushteve të lejes, duhet të korrigjohen dhe duhet të ekzistojnë mekanizmat *detyruese* për këtë gjë. Është e nevojshme të krijohet një regjim i përshtatshëm sanksionesh të zbatueshme. Kjo kërkon që procedurat administrative dhe penale t'u vihen në dispozicion inspektorëve ose personave të tjerë të ngarkuar me hetimin e shkeljeve si dhe të ekzistojnë mjetet për të vjelur gjobat ose për të administruar masa të tjera të marra në çdo rast, përfshirë urdhra që kërkojnë ndërprerjen e aktivitetit, marrjen e masave korrigjuese ose programe përmirësimi.

Konventa e Aarhus<sup>it</sup> kërkon që çdo vendim administrativ në fushën e mjedisit të lejojë mundësinë e apelimit ndaj tij. Është e rëndësishme të vendoset një *sistem* efikas *apelimi*, i cili të jetë i sigurt dhe i paanshëm, efektiv nga pikëpamja e kostove dhe i shpejtë në veprim, duke shmangur sa më shumë që të jetë e mundur procedurat e zgjata dhe të shtrenjta gjyqësore. Por si një parandalim më i fuqishëm duhet të ekzistojë edhe mundësia e procedimit penal (e cila mund të gjykohe vetëm në gjykatë).

Qeveria dhe publiku kanë gjithashtu nevojë të dinë nëse sistemi po arrin rezultatet e dëshiruara. Për këtë arsye sistemi ka nevojë të shoqërohet edhe me një *sistem monitorimi* që siguron informacione nevojshme me të cilin mund të krahasohen dhe vlerësohen rezultatet. Është thelbësore të dihet nëse janë arritur përmirësimet e pritura në cilësinë e mjedisit, me qëllim që të vendoset nëse duhet të ndërmerren veprime të mëtejshme.

Rezultatet e aktiviteteve të përshkruara më sipër duhet të përdoren për të vlerësuar dhe rishikuar efektivitetin e politikave dhe ligjeve. P.sh. një nga arsyet prej të cilave përmirësimet nuk po arrihen (ose nuk po arrihen aq shpejt sa duhet) është se lejet ose kushtet që ato përmbajnë, bazuar mbi këto ligje, nuk janë të përsheshmë, janë shumë tolerante ose nuk mbulojnë të gjithë elementet e duhur.

### 4.3.3 Mbështetja ndaj ciklit të administrimit

Jo të gjitha objektivat mjedisore mund të arrihen nëpërmjet zplikimit të sistemit të Komandës dhe Kontrollit. Të tjera mjete dhe procedura mund dhe duhet të përdoren për të mbështetur dhe fuqizuar ciklin e administrimit mjedisor. Instrumentet ekonomike, të cilët përshkruhen në seksionin që vijon, janë një mekanizëm thelbësor mbështetës.

Sa më tepër që *publiku* të jetë i ndërgjegjësuar mbi problemet mjedisore, aq më e madhe do të jetë dëshira e tij për të ndikuar në zgjidhjen e këtyre problemeve. Programet me karakter edukativ janë një mjet kyç në këtë proces, edhe pse shumë prej tyre janë veprimtari që japin rezultat në periudha afat-gjatë. Rezultate më direkte dhe në periudha afat-shkurtër mund të arrihen nëpërmjet fushatave të përqendruara publicitare, të cilat hedhin dritë mbi çështje specifike. Në procese të tilla OJQ-të luajnë një rol të rëndësishëm.

Në këtë pikë Konventa e Aarhus<sup>it</sup> do të luaj përsëri një rol, sepse sa u tha më sipër kërkon si respektimin e së drejtës së publikut për t'u informuar ashtu edhe pjesëmarrjen e tij në vendim-marrjen për problemet e karakterit mjedisor.

## 4.4 Instrumentat Ekonomike

Instrumentet ekonomike janë një mjet i fuqishëm për adoptimin e mënyrës së operimit të tregjeve, kështu që ndotësit paguajnë për dëmet mjedisore që ata shkaktojnë dhe përdoruesit e burimeve mjedisore paguajnë për përfitimet që ata nxjerrin. Instrumente të tillë përfshijnë tarifën, gjobat ose taksat (si parandalues të sjelljes së papërshtatshme) dhe subvencionet (si nxitës të sjelljes së duhur) madje në disa raste edhe për të njëjtën çështje. Taksat dhe tarifën mund të gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme.

Ky model i zbatimit të parimit *“ndotësi paguan”* është një objektiv thelbësor i Bashkimit Europian, ashtu siç edhe u promovua në Programin e 5-të dhe të 6-të të Mjedisor të Veprimit (1992 dhe 2002).

Aplikimi i tarifave dhe taksave mjedisore mbi përdorimin e burimeve dhe derdhjen e ndotjeve parashikohet në Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit dhe në Programin e Qeverisë për periudhën 2005-2009:

*“Qeveria do të zbatojë një paketë nxitësish pozitive për operatorët ekonomikë dhe individët, në përputhje me parimet e tregut të lirë. Do të zbatohen nxitësit fiskalë me qëllim promovimin e reduktimit të ndotjeve nga bizneset dhe individët, investimeve në teknologji të pastra, ruajtjes së energjisë, përdorimit të efektshëm të burimeve natyrore dhe investimeve në mjedis.”*

Disa nga këto instrumente tashmë ekzistojnë, por ato duhet të përforcohen ndërkohë që duhet të krijohen dhe instrumente të tjera të tjerë.

Do të jetë e mundur të arrihen përfitime më direkte dhe më të dukshme për mjedisin, nëse fondet e grumbulluara nga tarifat, gjobat dhe mekanizmat e tjera të pagesave do të përdoren për të mbështetur projekte për mjedisin. Mënyra më e zakonshme për ta bërë këtë është krijimi i një *fondi për mjedisin*. Qeveria e ka propozuar një gjë të tillë në programin e saj pesë-vjeçar aktual:

*“Qeveria do të krijojë një Fond të veçantë për Mjedisin, i cili do të financohet nga taksat dhe gjobat mjedisore si dhe nga donacionet. Fondi për Mjedisin do të shërbejë për financimin e projekteve për mbrojtjen e mjedisit dhe novacionet teknologjike që përmirësojnë mjedisin.”*

Kjo pason një praktikë të hershme të vendeve më të reja anëtare të Bashkimit Europian si dhe të shumë vendeve të tjera<sup>7</sup>.

#### **4.4.1 Tipat e instrumenteve**

##### **Instrumentet Ekzistues**

Në botë janë në përdorim një gamë e gjerë instrumentesh. Vetëm disa prej tyre janë të përshtatshëm për Shqipërinë. Ato instrumente që janë në përdorim në Shqipëri nuk janë gjithmonë efektivë dhe ekzistojnë mundësitë për zgjerimin e fushës së tyre të zbatimit.

Shkurtimisht, instrumentet që aktualisht përdoren në Shqipëri përfshijnë si më poshtë:

- *Tarifat mbi produktet* që krijojnë ndotje në fazën e prodhimit, konsumimit ose depozitimit të mbetjeve (p.sh. taksa mbi karburantin, taksa e importit që penalizon makinat e vjetra që shkaktojnë më shumë ndotje), skemat e rifinancimit që inkurajojnë riciklimin e produkteve potencialisht ndotëse ose pagesa për kthimin e produktit, skema që parashikojnë pagesën për sende të mbetura por që kanë vlerë, të tilla si kanaçet e birrës (birra Tirana për shishet e saj); mund të përmenden edhe shumë produkte të tjera. Skema të tilla mund të zgjerohen duke përfshirë *zëvendësimin e detyrueshëm*, sipas të cilit një produkt nuk mund të blihet nëse nuk kthehet një i përdorur, siç ndodh me bombolat e gazit; në këtë kategori mund të merren në konsideratë gomat dhe bateritë e makinave.
- *Tarifat për shfrytëzimin e burimeve natyrore* janë për shembull tarifat që zbatohen për prerjen e pemëve, nxjerrjen e mineraleve ose inerteve. Ato kanë nevojë të rishikohen, me qëllim që të pasqyrojnë dëmet që shkakton ky shfrytëzim; por çdo rishikim me qëllim ngritjen e tarifave ka nevojë të shoqërohet me masa detyruese për të siguruar minimizimin e rasteve të shfrytëzimit të burimeve duke shmangur pagesën e tarifës.

<sup>7</sup> P.sh. shiko: <http://www.sfzp.cz/en/basic-information/role-of-the-fund/>

- **Tarifat e përdoruesve** janë pagesa për përdorimin e zakonshëm të shërbimeve mjedisore. Në Shqipëri zbatohet një tarifë prej 2% të kostos së një ndërtese të re në shpërblim të ngritjes së infrastrukturës, megjithëse është e qartë se jo gjithmonë këto para përdoren për këtë qëllim. Përveç kësaj, në disa qytete, paguhet si furnizimi me ujë ashtu edhe grumbullimi i mbetjeve të ngurta. Tarifa hyrjeje zbatohet për zonat e mbrojtura (Mali i Dajtit) ose për hyrjen në plazhe (Kune-Vaini, Divjaka, etj.). Ekziston një mundësi shumë më e madhe për rritjen e nivelit të tarifave si dhe sasisë dhe llojit të aplikimit.
- **Gjobat:** janë pagesat për mos-zbatim/respektim të standardeve ose për shkelje të ligjit; ato mund të klasifikohen si instrumente ekonomike vetëm kur madhësia e gjobës është në proporcion me shkallën e mos-zbatimit ose me seriozitetin e shkeljes; ato parashikohen në shumë ligje, por janë jashtëzakonisht jo-efektive, sepse vetë ligjet janë ndonjëherë të pazbatueshëm, gjobat janë jo-elastike, shumë të ulëta dhe nuk mund të mblidhen; përmirësimet në këtë fushë janë disa nga kërkesat thelbësore për forcimin e sistemit të administrimit mjedisor të përshkruar në seksionet pararendëse.
- **Pagesat për kthimin/riciklimin e produkteve:** Këto janë pagesa që u bëhen njerëzve për t'i nxitur ata të kthejnë një produkt pas përdorimit të tij. Ka disa shembuj në Shqipëri ku njerëzit paguhet për të mbledhur kanaçe alumini dhe metale për eksport ose ripërdorim. Ky koncept duhet të zbatohet gjithashtu edhe i kombinuar me taksën mbi produktin, që do të thotë se një pjesë e taksës mbi produktin u rikthehet atyre që kthejnë produktin e përdorur (p.sh. bateritë) në pikat e caktuara të grumbullimit.

### Instrumentet e Reja

Më poshtë janë përmendur disa instrumente të cilët janë në përdorim në vende të tjera dhe që do të merren në konsideratë për t'u futur në përdorim në një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Të tjera mundësi ekzistojnë për një periudhë afat-gjatë.

- **Tarifat e ndotjes** bazohen mbi sasinë dhe/ose cilësinë e shkarkimeve në ajër ose të mbetjeve të hedhura nga industria. Ligji shqiptar lejon zbatimin e taksave për çlirimet në ajër, por ende nuk është zbatuar ndonjë e tillë. Këto taksa mund të shtrihen edhe për ujërat dhe produktet e tjerë të ndotur dhe janë një burim thelbësor të ardhurash në shumë vende. Zbatimi i tyre varet nga përkufizimi i qartë i standardeve në lejet e dhëna si dhe nga ekzistenca e një sistemi të saktë të monitorimit dhe proceset e duhur analitike. Deri në momentin që jetë përfunduar procesi i rishikimit të lejeve i diskutuar më poshtë, zbatimi i tarifave të tilla nuk është i realizueshëm.
- **Subvencionet dhe lehtësimi tatimor.** Skemat e subvencionimit mjedisor, të cilat inkurajojnë një mjedis më të pastër, përdoren në shkallë të gjerë. Ato përfshijnë grante, kredi të buta, garanci për kredimarrje dhe lehtësira tatimore. Ato mund të përdoren për të nxitur zbatimin e teknologjive të pastra, trajtimin dhe grumbullimin e mbetjeve, riciklimin e mbetjeve, procese dhe produkte efçente nga pikëpamja e konsumit të energjisë si dhe lëndë të para të padëmshme për mjedisin (midis të tjerave edhe për bujqësinë dhe industrinë). Stimujt tatimorë, mund të ofrohen në zona industriale për të siguruar shërbime të zakonshme, të tilla si ato të trajtimit të ujit të ndotur.
- **Taksat turistike** janë tarifa të detyrueshme të zbatuara gjatë hyrjes në një vend ose në formën e një takse qëndrimi, e zbatuar për çdo natë qëndrimi në vend. Megjithëse ekzistojnë në Shqipëri, ato nuk mund të konsiderohen si instrumente efektive mjedisore, përderisa të ardhurat prej tyre shkojnë në buxhetin qendror. Ato mund të ktheheshin në instrumente të tillë, nëse paratë e grumbulluara prej tyre, do të përdoren për infrastrukturën në shërbim të

mjedisit. Megjithatë është e nevojshme të tregohet kujdes në lidhje me masën e tarifës në mënyrë që të mos ç'inkurajohet ardhja e turistëve.

- **Garancitë e performancës:** Këto janë pagesa (ose garanci) që shërbejnë si kompensim në rastet e mospërputhjeve me ligjin ose dëmeve mjedisore. Ato janë të rikthyeshme pasi është arritur dhe është verifikuar përputhja. Ato përdoren me sukses në Kanada në formën e depozitave siguruese për shfrytëzimin e burimeve dhe bonifikimin e tokës bazuar në sipërfaqen e prekur të tokës dhe kostot e vlerësuara të rehabilitimit. Këto garanci duhet të zbatohen mbi disa aktivitete të tilla si minierat, impiantet e prodhimit të inerteve dhe industrinë potencialisht ndotëse.
- **Kushtet e planifikimit:** Një formë efektive e instrumenteve ekonomike mund të jetë edhe zbatimi në zona me vlerë të lartë i disa kushteve të planifikimit (p.sh. peizazhi i zonave përreth dhe sigurimi i shërbimeve shtesë) mbi projektin e propozuar. P.sh. në disa zona nuk duhet të lejohen projekte të reja derisa zhvilluesi i projektit të bjerë dakord të paguajë për realizimin e infrastrukturës së re. Kjo shpesh është një metodë jozyrtare e bazuar në negociata dhe që është zbatuar me sukses në Tiranë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Duhet analizuar më me kujdes zbatimi i një metode të formalizuar në përcaktimin e kushteve të planifikimit që lidhen me përmirësimet mjedisore.
- **Koncesionet:** Këto janë një formë e kontraktimit të dhënies një biznesi, së të drejtës për të kryer një aktivitet të caktuar, p.sh. brenda një zone të mbrojtur, në këmbim të një tarife fikse ose ndarjes së fitimeve. Koncesionet janë përdorur me sukses në zonat e mbrojtura anembanë botës duke gjeneruar shuma të konsiderueshme të ardhurash nga operatorët a bizneseve të pushimit, çlodhjes dhe argëtimit (p.sh. udhëtimet me anije, operatorët e biznesit të zhytjeve nën ujë), restorantet, hotelet etj. Kufizimi i numrit të operatorëve brenda një zone të mbrojtur do të rrisë përfitimet e atyre që operojnë brenda kësaj zone. Potencialet e zbatimit të koncesioneve brenda zonave të mbrojtura duhen analizuar duke përdorur Malin e Dajtit si një shembull. Duhet të negociohen koncesione për restorante, hotele, aktivitete hipizmi si dhe antena radios.

#### 4.4.2 Prioritarizimi i instrumenteve ekonomike

Me qëllim që të përcaktohen prioritetet e përforcimit ose zhvillimit të instrumenteve ekonomike është e nevojshme që të zbatohen kriteret e mëposhtme:

1. Instrumente ekzistuese që kanë nevojë të forcohen;
2. Kosto e ulët dhe e përballueshme e zbatimit dhe administrimit;
3. Nxitje e kërkesës për zbatimin dhe respektimin e ligjit në të gjitha rastet;
4. Nxitja e përputhshmërisë me strategjitë qeveritare dhe vendore të zhvillimit;
5. Shkalla e përputhjes midis përmirësimeve mjedisore dhe përfitimeve ekonomike;
6. Shuma e të ardhurave që mund të grumbullohen duke pasur në konsideratë se sa të përballueshme janë.
7. Mundësia që një pjesë e të ardhurave të mund të përdoren ekskluzivisht për përfitime mjedisore.

#### 4.4.3 Fondi Mjedisor

Niveli aktual i infrastrukturës mjedisore është i ulët. Pikat e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale janë të pamjaftueshme. Grumbullimi i mbetjeve nga aktiviteti i banorëve, industrisë apo aktiviteteve të tjera është gjithashtu një problem kryesor. Niveli i dëmtimit mjedisor që vjen si rezultat i vetëm këtyre dy problemeve është veçanërisht i lartë. Përgjegjësia për sigurimin e kësaj infrastrukture është në procesin e kalimit nga Ministria e Punëve Publike,

Transportit dhe Telekomunikacionit tek autoritetet vendore (bashkitë dhe komunat). Programi aktual i shpenzimeve kapitale te Ministrisë është paraqitur i përmbledhur më poshtë

	Investime Direkte nga Buxheti	000 Lekë	%
1	Planifikimi dhe Administrimi (Personeli i Ministrisë)	5.00	0%
2	Transporti Rrugor	4,454,510.00	59%
3	Administrimi i Transportit Rrugor (Instituti i Kërkimeve të Transportit)	14,460.00	0%
4	Transporti Detar	190,430.00	3%
5	Transporti Hekurudhor	340,000.00	4%
6	Transporti Ajror	72,500.00	1%
7	Sektori i Furnizimit me Ujë	1,018,815.00	13%
8	Sektori i Kanalizimeve	381,185.00	5%
9	Sektori i Banesave	480,000.00	6%
10	Sektori i Urbanistikës	30,000.00	0%
11	Infrastruktura Turistike	600,000.00	8%
	TOTALI	7,581,905.00	100%

Siç mund të shikohet në tabelë, masa e shpenzimeve për kanalizimet është relativisht e ulët dhe shumë më e ulët se sa masa e nevojshme për të përmbushur nevojat për investime të identifikuar në Kapitullin 3. Nga ana tjetër, autoritetet vendore nuk janë në gjendje të sigurojnë fondet e nevojshme për investime kapitale.

Përveç mungesës së fuqisë financiare, autoritetet vendore kanë gjithashtu edhe probleme administrative dhe teknike të cilat e bëjnë edhe më të vështirë për to zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të kërkuara. Mbi të gjitha, kreditë ose grantet nga donatorët ndërkombëtarë nuk përbëjnë një alternativë realiste për shumë autoritete vendore, sepse niveli i autonomisë së tyre financiare ose i të ardhurave është shpesh i pamjaftueshëm për t'i lejuar ata të marrin pjesë në tendera grantesh. Për më tepër, në shumë raste mungon struktura drejtuese për administrimin e kredive si dhe infrastruktura e nevojshme.

Këtyre problemeve duhet t'u jepet zgjidhje, për të qenë të aftë për të gjetur financimet e duhura për të mbështetur nivelin e nevojshëm të zhvillimit të infrastrukturës. Një instrument kyç në zhvillimin e kapaciteteve të tilla është krijimi i një *Fondi Mjedisor*.

E thënë thjeshtë, qëllimi kryesor i një fondi mjedisor është të veprojë si një pikë qendrore grumbullimi dhe shpërndarjeje për një pjesë ose të gjitha të ardhurat e grumbulluara nga tarifatat, gjatë e taksat mjedisore si dhe nga burime të tjera, duke përfshirë dhe grante nga donatorët. Shpërndarja e fondeve në projekte të ndryshme, më pas mund dhe duhet të bëhet mbi kritere të qarta dhe transparente. Në mënyrë që fondi të funksionojë siç duhet, duhen plotësuar një sërë kushtesh të rëndësishme. Së pari, atij duhet t'i sigurohen të ardhura të mjaftueshme për ta kthyer atë në një kontribut domethënës. Ai gjithashtu duhet të jetë i çliruar nga ndërhyrje të jashtme në procedurat e akordimit të fondeve. Sapo qeveria të ketë përcaktuar prioritetet për përmirësimet mjedisore si dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve, fondi duhet të lihet i lirë të zbatojë këto kritere, pa u bërë pre e influencave politike të pavend. Do të jetë e nevojshme që akordimi i fondeve të tij t'i nënshtrohet një auditimi periodik, përkundërt kritereve të përcaktuara.

Është e qartë se do të jetë e nevojshme që aktivitetet e fondit të mbikëqyren, por megjithatë ai do të jetë një organizatë autonome si çdo bankë. Bordi i tij mbikëqyrës do të përfshijë përfaqësues nga ministritë përkatëse, përfshirë atë të Financave, Punëve Publike, Ministrinë e Brendshme dhe atë të Mjedisit.

Fondi i Mjedisit do të ketë karakteristikat e mëposhtme:



- Do të jetë një strukturë e veçantë, e pavarur nga ministritë;
- Do të mbikëqyret nga një bord i përbërë nga përfaqësues të lartë të ministrive përkatëse (Ministritë së Financave, Punëve Publike, Mjedisit, Ministritë së Brendshme dhe asaj të Bujqësisë) përfshirë edhe përfaqësues nga industria dhe shoqëria civile;
- Do të furnizohet me fonde nga sistemi i përgjithshëm tatimor – një përqindje e caktuar, bazuar në mundësitë financiare dhe politika e qeverisë;
- Do të furnizohet me fonde nga tarifat, pagesat, taksat dhe gjobat e përshkruara më sipër;
- Do të jetë përgjegjës për përcaktimin e nivelit të shpenzimeve brenda direktivave dhe kriterëve të përcaktuara nga politikat dhe strategjitë e qeverisë;
- Do të administrojë zbatimin e listës së prioriteteve në investime; dhe
- Do të jetë përgjegjës për monitorimin e përdorimit të fondit të investimeve.

Është e rëndësishme që sektorët privatë dhe jo-qeveritarë të përfaqësohen në bordin drejtues të fondit, meqenëse janë ata sektorë që ndikohen në mënyrë direkte nga problemet të cilat Fondi synon t'u japë zgjidhje si dhe për arsyen se ata kanë mundësi të sigurojnë informacion dhe mirëkuptim vendor, i cili do të jetë me shumë vlerë për të garantuar që veprimet e fondit të jenë të praktikueshme dhe realiste.

Një nga problemet kryesore në kryerjen e investimeve në infrastrukturën mjedisore komunale në Shqipëri, ka pasur të bëjë me vështirësitë për të tërhequr financime nga donatorët. Krijimi i një fondi mjedisor do t'i japë zgjidhje edhe këtij problemi. Fondi do të jetë gjithashtu përgjegjës për të siguruar një pikë të centralizuar nëpërmjet së cilës donatorët mund të kanalizojnë financimet për projektet prioritare si dhe për të siguruar elementin e nevojshëm shqiptar të bashkë-financimit.

Për më tepër fondi mund të veprojë për të:

- Mbështetur autoritetet vendore në hartimin më të detajuar të projekt propozimeve;
- Mbështetur zbatimin e projekteve, përfshirë rolin si autoritet pagues; dhe
- Administruar procesin në përgjithësi.

Një strukturë e vetme si fondi do të ketë gjithashtu marrëdhënie më të forta me bankat shqiptare dhe të huaja dhe atëherë, kur ta shohë të arsyeshme mund të vendoset në pozicionin e një garantuesi për kreditë për investime të marra nga bashkitë.

Një studim i kohëve të fundit, i realizuar me organet e pushtetit vendor, tregoi një mbështetje të fortë për krijimin e një fondi mjedisor të pavarur, i cili do të mbështesë projektet në sektorin e kanalizimeve. Një mbështetje e madhe u tregua gjithashtu edhe për krijimin e degëve të vogla rajonale të fondit, të cilat do të administrojnë skema të granteve të vogla për projektet vendore. Studimi paraqiti në të njëjtën kohë mbështetje për një përfaqësim të gjerë në Bordin e fondit sikurse u argumentua më sipër.

## 4.5 Investimi në Infrastrukturën Mjedisore

### 4.5.1 Nevojat

E thënë thjeshtë, dy synimet kryesore të Shqipërisë aktualisht janë: nxitja e zhvillimit (me qëllim uljen e nivelit të varfërisë) dhe integrimi European. Të dy objektivat kanë lidhje me njëri-tjetrin, sepse procesi i integritimit do të sjellë më shumë mundësi zhvillimi nëpërmjet lehtësirave më të mëdha për hyrjen e produkteve shqiptare në tregjet Europiane. Megjithatë detyrimet për anëtarësim, të Bashkimit European, kërkojnë që zhvillimi të jetë *“harmonik, i balancuar dhe i qëndrueshëm”* si dhe t'i nënshtrohet *“një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.”*

Kjo do të kërkojë përmirësime thelbësore në

- infrastrukturën mjedisore komunale, veçanërisht në drejtim të mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta; dhe
- performancës mjedisore të të gjitha industrive, duke filluar nga rafineritë e mëdha të naftës e deri tek operatorët më të vegjël të nënprodukteve të qumështit ose furrave të gëlqeres.

Investimet e kërkuar për të arritur përputhshmërinë me *acquis*, vlerësohen të jenë më shumë se 1 miliardë Euro (125 miliardë lekë). Ky nivel nuk është i mundur të realizohet brenda një periudhe afat-shkurtër, por do të ketë nevojë të nisë gradualisht dhe të mbështetet nga donatorët dhe huadhënësit e huaj.

Ky investim do të realizohet vetëm nëse planifikohen mirë dhe bëhen transparente mekanizmat e zbatimit të tij. Këto të fundit do të duhet të mbulojnë identifikimin, projektimin, financimin, prokurimin dhe operimin e infrastrukturës publike si dhe inkurajimin e investimeve të duhura nga ana e industrisë.

#### **4.5.2 Mënyra për Plotësimin e Nevojave**

Është e nevojshme të vendosen objektiva realiste në lidhje me standardet që mund të arrihen brenda një periudhe afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë.

##### **Nevojat thelbësore**

Metodat tradicionale të zhvillimit të infrastrukturës të cilat synojnë plotësimin e të gjithë gamës së standardeve brenda një faze të vetme investimi, kërkojnë nivele të larta kapitalesh dhe kostosh operative dhe nuk janë të arritshme për momentin. Duhet zbatuar një metodë e ndarjes në faza të investimit, e cila kërkon përdorimin e zgjidhjeve të përshtatshme.

Është e rëndësishme që, gjatë përcaktimit se çfarë është më e përshtatshme, të përzgjidhet ajo rrugë që siguron fitim maksimal ekonomik dhe përfitim mjedisor për investimin. Për qëllime planifikimi dhe për të llogaritur kostot e përafërta, mund të hartohet një listë e përmbledhur e metodave më të mira. Mund të gjenerohen paketa standarde të projektimit të infrastrukturës, të cilat mund t'u përshtaten kushteve aktuale në zona të ndryshme të vendit.

Është e nevojshme të hartohet një listë me llojet e investimeve prioritare. Kjo do të mbulojë përshkrimin bazë të projektit dhe vlerësimin e sektorëve mjedisorë prioritarë, të identifikuar në Kapitullin 3. Çdo përshkrim bazë i projektit do të jetë në një format standard dhe do të përdorë procedura standarde të llogaritjes së kostove për të siguruar mundësinë e krahasimit si dhe një shkallë e arsyeshme saktësie. Çdo përshkrim projekti do të japë një përshkrim përmbledhës të infrastrukturës dhe kushteve të punës dhe do të përcaktojë nivelin e pritur të përmirësimeve si dhe përligjjen ekonomike të skemës.

##### **Nevoja të tjera**

Nevojat thelbësore të identifikuar në seksionin e prioriteteve nuk janë të vetmet nevoja për investim në lidhje me përmirësimin e mjedisit dhe zbatimin e *acquis*. Zbatimi i standardeve të cilësisë së karburantit, reduktimit të shkarkimeve nga impiantet e mëdha industriale, rregullimi i dëmeve të shkaktuara nga erozioni dhe shpyllëzimi do të kenë koston e tyre.

Gjithashtu do të duhet të identifikohen projekte, të bëhet vlerësimi i kostos dhe të përcaktohen prioritetet në këto fusha. Gjithashtu, investimet prioritare në këto fusha do të përfshihen në listën e investimeve potenciale, ku mund të nevojitet një skemë për të zgjidhur një çështje që lidhet me shëndetin publik ose për të bërë të mundur zhvillimin e projekteve me qëllim progresin drejt kushteve të pranueshme mjedisore.

**“Pikat e nxehta”**

Përveç këtyre nevojave për investime, është e rëndësishme të vendosim se si do të trajtojmë ndotjet e jashtëzakonshme ose problemet e tjera mjedisore që ekzistojnë si p.sh. pastrimi i “pikave të nxehta”. Këto projekte do të varen nga ngritja e pikave të grumbullimit, në të cilat do të mund të depozitohen mbetjet prej këtyre zonave. Ato do të përfshijnë masa të veçanta për pastrimin e ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore ose do të përfshijnë marrjen e masave të veçanta në drejtim të ruajtjes dhe/ose përmirësimit të shëndetit publik. Është e nevojshme që studimet e fizibilitetit të këtyre rregullimeve të përfundohen dhe të përdoren për të përgatitur paketa projektesh, të gatshme për financim.

**4.5.3 Përcaktimi dhe Zbatimi i Prioriteteve në Investime****Kriteret për identifikimin e projekteve**

Është e nevojshme që të hartohen kriteret të qarta dhe të kuptueshme në lidhje me përcaktimin e prioriteteve. Kjo duhet të përfshijë kombinimin e përfitimeve të thjeshta nga pikëpamja e kostove si dhe marrjen në konsideratë të faktorëve mjedisorë bazë si:

- Përcaktimi dhe zgjidhja e problemeve të shëndetit;
- Numri i përfituesve;
- Nëse përfitojnë zonat e mbrojtura;
- Përmirësimet në përdorimin e burimeve ujore;
- Nëse një projekt u shërben edhe politikave të tjera ose objektivave të planit (p.sh. zonat e vlerësuara për turizëm mund të klasifikohen si prioritare për t'u pastruar); dhe
- Nëse përfshihen çështje ndërkufitare ose angazhime ndërkombëtare.

Pas kësaj projektet prioritare do të përfshihen në një program zbatimi shumëvjeçar. Do të jetë e nevojshme që projektet t'u prezantohen institucioneve financiare ndërkombëtare për financim ose bashkë-financim, sipas rastit, me qeverinë qendrore, pushtetin vendor ose sektorin privat.

Procesi i prioritarizimit duhet të sigurojë motivimin e përfituesve të projektit për të hartuar projekte më të mira, për të ofruar më shumë nga fondet e tyre, për të rritur sigurimin e kredisë ose për një mbulim më efektiv të kostove në mënyrë që ata të mund të favorizohen në procesin e vendim-marrjes.

**Përcaktimi i realizueshmërisë**

Do të jetë e nevojshme të ndërmerret një vlerësim i *realizueshmërisë ekonomike* të projekteve prioritare të investimeve për të përcaktuar nëse dhe në çfarë kushtesh mund të realizohen këto projekte dhe nëse mund të paguhet kredia. Do të përcaktohen përfitimet ekonomike nëpërmjet vlerësimit të pasojave të mundshme nga “realizimi” ose “mosrealizimi” i projektit. Përfitimet do të nxirren duke marrë në konsideratë efektin mbi përdoruesit e drejtpërdrejtë dhe përdoruesit dytësorë si dhe rezultatet mjedisore dhe sociale të projektit në një shkallë më të gjerë.

Shumë institucione financiare ndërkombëtare kërkojnë realizimin e disa treguesve të normave ekonomike të kthimit të investimit, përpara se të miratojnë projektin, madje edhe për rastet e infrastrukturës mjedisore ku përfitimet e pamatshme nga ana sasiore mund të jenë domethënëse. Megjithatë sot disponohen një sërë teknikash të zhvilluara relativisht mirë të cilat ndërthurin vlerat e llogaritura monetare me pasojat mjedisore dhe të cilat reduktojnë shkallën e përfitimeve të tilla të pamatshme.

Pas kësaj do të jetë e nevojshme një analizë e *qëndrueshmërisë financiare* për të vlerësuar aftësinë për të grumbulluar kapital dhe të ardhura fillestare, që do të mjaftonin për të mbuluar kostot e ndërtimit,

funksionimit dhe mirëmbajtjes. Nëse hidhet një propozim për financimin e borxhit, analiza do të përfshijë përcaktimin e mundësive për mbulimin e kostove të një financimi të tillë. Identifikimi i mekanizmave të rikuperimit të kostove është një element kyç në këtë proces. Për disa sektorë dhe projekte, mbulimi i pjesshëm i kostove do të mundësohet nëpërmjet mekanizmave ekzistuese të vënies së taksave ose tarifave. Gjatë përcaktimit të potencialeve për rikuperimin e kostove, do të jetë e nevojshme të merren në konsideratë *mundësitë e përballimit të kostove dhe niveli i tarifave*. Për sektorë të tjerë mund të jetë e nevojshme të zhvillohen mekanizma të rinj. Mjetet e nevojshme që duhen marrë në konsideratë, përfshijnë tarifën për lëndët që çlirohen në atmosferë, taksat dhe subvencionet mjedisore ose instrumente të tjerë ekonomikë të diskutuar më parë.

*Vlerësimet teknike dhe mjedisore*, ndërmerren gjithashtu normalisht gjatë kësaj faze. Ato kërkohen përgjithësisht nga agjencitë financuese dhe janë veçanërisht të rëndësishme për identifikimin e mundësive të zhvillimit të projektit si dhe për çështjet mjedisore dhe shoqërore (kufizimet dhe mundësitë), të cilat mund të ndikojnë mbi pranueshmërinë e projektit ose kërkojnë studime të mëtejshme.

Nëpërmjet një *strategjie zbatimi* do të identifikohen veprimet që nevojitet të ndërmerren për zbatimin dhe funksionimin e suksesshëm të projektit, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore brenda të cilëve nevojitet të ndërmerren këto veprime. Elementët kryesorë të saj janë:

- Një plan administrimi mjedisor përfshirë kërkesat për dhënien e lejeve;
- Forcimin institucional dhe mbështetjen teknike për të siguruar rikuperim të mjaftueshëm të kostove; dhe
- Përgatitjen e dokumentacionit të tenderit, kontraktimin dhe mbikëqyrjen.

#### **4.5.4. Roli i Autoriteteve dhe Sektorit Privat**

Është e nevojshme të krijohet një strukturë e qëndrueshme institucionale e pajisur me personelin dhe aftësitë e duhura për të siguruar që projekti do të hartohet, zbatohet dhe administrohet me sukses.

Çdo nivel i qeverisë ka një rol për të luajtur në procesin e identifikimit të konceptit të projektit, përcaktimin e projekteve prioritare dhe përgatitjen e dokumentacionit të duhur. Sektori privat është gjithashtu i përfshirë në këtë proces – bankat, nëpërmjet financimit të kredisë ose industrisë, nëpërmjet teknologjisë së uljes së nivelit të ndotjeve.

##### **Autoritetet**

Është e nevojshme që autoritetet shtetërore të fuqizojnë kapacitetet e tyre në drejtim të *zbatimit të projekteve* si në nivel vendor ashtu edhe në nivel qendror. Kërkohet një marrëdhënie partneriteti midis institucioneve qendrore, autoriteteve vendore dhe fondit të mjedisit. Me kalimin e përgjegjësisë për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve komunale tek autoritetet vendore, këto të fundit duhet të konsiderohen si pikënisje. Megjithatë, ashtu siç u diskutua edhe më sipër atyre u mungojnë kapacitetet. Duhet që institucionet qendrore t'u sigurojnë autoriteteve vendore direktiva, trajnim dhe mbështetje teknike. Kjo mbështetje do të jetë e nevojshme për të zgjeruar kapacitetet administrative dhe teknike vendore në drejtim të identifikimit dhe zhvillimit të projekteve, përfshirë këtu planifikimin, hartimin, administrimin dhe prokurimin e projektit.

##### **Sektori Privat**

Për momentin, potenciali për privatizimin e plotë të shërbimeve të infrastrukturës të tilla si, grumbullimi i mbetjeve ose trajtimi i ujërave të zeza, duket i kufizuar sepse këto shërbime nuk janë strukturuar për të operuar si biznese private, dhe sepse tarifën që ato aktualisht aplikojnë janë shumë të ulëta për të paguar kredinë që nevojitet. Megjithatë, për periudhën afat-gjatë kjo mundësi duhet të

lihet e hapur veçanërisht për arsyen se sektori privat është më i aftë të tërheqë financime për investime dhe sepse është më i aftë të operojë me efektivitet nga pikëpamja e kostos.

Ndërkohë, një pjesë e infrastrukturës mjedisore i është nënshtruar komercializimit, nëpërmjet të cilit asetet e infrastrukturës kanë mbetur në duart e publikut, por funksionimi i tyre i është dhënë me kontratë sektorit privat. Është e nevojshme të merren në konsideratë potencialet për shtrirjen e kësaj metode. Në këtë mënyrë sektori privat mund të luajë një rol të fuqishëm në sigurimin e funksionimit konkurrues dhe efikas të infrastrukturës publike. Megjithatë autoritetet vendore do të kenë ende nevojë për mbështetjen e institucioneve qendrore në sigurimin e një zbatimi efektiv të kësaj metode, veçanërisht në hartimin e kontratave të shërbimeve të tilla për të siguruar përfitimet maksimale të mundshme për shumën e shpenzuar për konsumatorët.

Është e qartë që sektori privat do të ketë gjithashtu nevojë të luajë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e infrastrukturës si edhe në drejtim të shërbimeve projektuese, konsulente dhe financiare.

#### **4.5.5 Zbatimi i një Sistemi investimi**

Nevojitet një administrim sistematik i investimeve, përfshirë këtu administrimin e ciklit dhe krijimin e një linje të zbatimit të projektit në përputhje me parimet e planifikimit, të përcaktuara në kuadrin e planifikimit të Qeverisë miratuar në Nëntor 2005.

Më poshtë, jepet për ilustrim një diagramë konceptuale e një linje zbatimi të një projekti ndërsa kuadrati që vijon përshkruan një mënyrë e mundëshme funksionimi.

#### **Identifikimi i Projektit**

Një sërë projektesh që nevojiten për vënien në zbatim të prioriteteve të kësaj strategjie janë identifikuar tashmë në një numër dokumentesh përfshirë:

- Planin Kombëtar të Veprimit në Mjedis;
- Strategjinë për Biodiversitetin;
- Strategjinë Sektoriale për Ujërat dhe Kanalizimet Urbane;
- Strategjinë Sektoriale për Ujërat dhe Kanalizimet Rurale;
- Planet Rajonale të Veprimit në Mjedis ;
- Planet Hapësinore Rajonale;
- Planet Vendore të Veprimit në Mjedis ;
- Planet Hapësinore Vendore.

Përveç kësaj procesi i planifikimit të administrimit të mbetjeve që do të fillojë në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, do të identifikojë gjithashtu edhe projekte të mëtejshme. Këto projekt-koncepte janë pikënisja e operimit të linjës së projektit. Nevojitet një përpunim i disa prej këtyre koncepteve si dhe identifikimi i projekteve të mëtejshme. Çdo zonë administrimi (zona të mbrojtjes së natyrës, zona të autoritetit vendor) ka nevojë të vlerësohet për të përcaktuar nevojat afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata për investime. Kjo ka nevojë të përshkruhet në një format të standardizuar, i cili përfshin elementet e treguara në diagramë.

- Nevoja për projekt – përcaktimi i problemit;
- Përfitimet potenciale – gjysmë sasiore;
- Paketa konceptuale – përdorimi i modelit standard;
- Kostot e përafërta – metoda standarde.

Përcaktimi i problemit duhet të përfshijë identifikimin e pasojave që sjell situata aktuale mbi shëndetin, mjedisin dhe zhvillimin. Përfitimet nga zgjidhja e problemit (vënia në zbatim e projektit) duhet të specifikohen me terma të paktën gjysmë sasiore.

Siç është theksuar dhe më sipër, kapaciteti i autoriteteve vendore për të hartuar projekte dhe për të bërë një vlerësim të besueshëm të kostove, është i kufizuar. Për këtë arsye, ashtu siç është përshkruar më sipër, propozohet hartimi i një "katalogu" me modele standarde projektsh prej të cilave autoritetet vendore të mund të zgjedhin ato të cilat u përshtaten nevojave të tyre. Modelet standarde të projekteve do të shoqërohen nga faktorë standardë kostosh të cilët do të lejojnë autoritetet vendore të përcaktojnë menjëherë koston e përafërt të programeve të tyre afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë.

Ky proces duhet të kthehet në një praktikë normale edhe nëse autoriteti vendor nuk ka për qëllim të kërkojë mbështetje financiare nëpërmjet mekanizmit të fondit të mjedisit. Promotori i projektit (autoriteti vendor ose administruesit e zonës së mbrojtur natyrore) duhet të detyrohen ta paraqesin projekt-idenë pranë fondit të mjedisit dhe ministrive përkatëse edhe nëse promotori i projektit nuk ka për qëllim të kërkojë mbështetje nga fondi i mjedisit. Në këtë mënyrë linja e zbatimit të projektit shërben gjithashtu për të monitoruar procesin e zbatimit pavarësisht nga mekanizmat e financimit.

Të gjithë projekt-idetë e paraqitura duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi bazë cilësor për t'u siguruar se projektet e propozuara janë në përputhje me politikat, standardet, dispozitat ligjore dhe strategjitë përkatëse. Moskalimi me sukses i këtij "kontrolli të cilësisë" duhet të rezultojë në kthimin e projekt-idesë përsëri tek hartuesi i projektit me rekomandime për ndryshime.

Nëse hartuesi i projektit dëshiron të ketë mbështetjen e fondit të mjedisit, atëherë dokumentacioni i projekt-idesë duhet t'i nënshtrohet një procesi paraprak "filtrues" të klasifikimit të prioriteteve, i cili do të përcaktojë nëse, në parim, projekti është i përshtatshëm për t'u përfshirë në programin aktual apo atë të ardhshëm të investimeve. Pas kësaj, projekt-idetë që konsiderohen të përshtatshme duhet të kalojnë në një fazë të një vlerësimi dhe zhvillimi të detajuar. Nga pikëpamja e administrimit të ciklit të projektit, kjo fazë përmban dy elemente që në diagramë simbolizohen nga dy radhët e kuadrateve. Kjo fazë e parë përfaqëson fazën e realizueshmërisë. Ajo duhet t'i japë përgjigje këtyre pyetjeve:

- A është ky projekt teknikisht i realizueshëm?
- A janë pasojat mjedisore të pranueshme?
- A është projekti me përfitim nga pikëpamja ekonomike?
- A është projekti efektiv nga pikëpamja e kostove?
- A është projekti financiarisht i qëndrueshëm?

Nëse përgjigjet ndaj gjithë këtyre pyetjeve janë pozitive, atëherë projekti mund t'i nënshtrohet një zhvillimi të mëtejshëm i cili do të rezultojë në një projektim teknik dhe një plan financiar zbatimi. Në këtë fazë janë plotësuar të gjithë elementet e nevojshëm për përgatitjen e një aplikimi për financim. Megjithatë, në këtë fazë numri dhe vlera e projekteve mund të tejkalojnë fondin e disponueshëm ose kapacitetet administrative. Për këtë arsye kërkohet një fazë e dytë e përcaktimit të projekteve prioritare. Kjo e fundit do të përzgjedhë projektet bazuar mbi kritere të thjeshta përfshi rezultatet e analizës ekonomike.

Projektet e identifikuar në këtë fazë të dytë do të kalojnë pastaj në fazën e financimit. Pikërisht në këtë fazë do të jetë shumë kritik, aspekti i jashtëm i Fondit Mjedisor. Aftësia për të tërhequr financime për projektet nga donatorët dhe Institucionet Ndërkombëtare të Financimit do të ketë një rëndësi thelbësore në punën e fondit .

Menjëherë pas identifikimit të burimit të financimit, do të vazhdohet me veprimet e detajuar nëpërmjet fazave normale të projektimit të detajuar, tenderimit, kontraktimit dhe zbatimit. Në shumë raste do të jetë e nevojshme, mbështetja për hartuesit e projekteve, nëpërmjet Njësisë së Administrimit të Projekteve pranë Fondit të Mjedisit.




Figura 4-1 Elementet e linjës së përgatitjes dhe dorëzimit të një projekti investimi

#### 4.6 Informacioni dhe Pjesëmarrja

Gjatë gjithë procesit të hartimit të kësaj strategjie, një nga çështjet kryesore të hasura në lidhje me problemet mjedisore është mungesa e përgjithshme e të kuptuarit të marrëdhënieve midis sjelljes së individëve dhe mjedisit. Kjo vjen pjesërisht sepse individët nuk kanë njohuritë ose informacionin e duhur. Në kohët e shkuara kishte çështje të karakterit sekret si ajo e gazit radon, por sot problemi

kryesor qëndron tek mungesa e burimeve teknike me të cilët mund të grumbullohet një informacion i besueshëm. Për më tepër, informacioni i disponueshëm nuk shpërndahet në mënyrë efektive. Informacioni më cilësor dhe shpërndarja më e mirë janë kushte thelbësore për t'u siguruar se ne e kuptojmë dhe e administrojmë marrëdhënien tonë me mjedisin.

Kjo mund të shihet nga disa dimensione të cilët kanë të bëjnë, mbi të gjitha me publikun në kuptimin më të gjerë të fjalës – nëpunësit civilë, industrialistët, mësuesit, fermerët, shitësit dhe fëmijët e shkollave. Është e nevojshme që publikut t'i jepet informacion, ata kanë nevojë të kenë mundësi të marrin informacion, të arsimohen, të edukohen dhe trajnohen, secili sipas qëllimeve dhe aftësive të veta.

#### **4.6.1 Informacioni dhe Komunikimi**

*“Informimi i publikut mbi gjendjen e vërtetë të mjedisit do të ketë një rëndësi të veçantë në programin mjedisor të qeverisë.”<sup>8</sup>*

Është e nevojshme të bëjmë dallimin midis sigurimit të informacionit për publikun dhe dhënies mundësi publikut për të marrë informacion. Të dyja janë të nevojshme në shërbim të respektimit të së drejtës kushtetuese për informim dhe legjislacionin mjedisor përfshi Konventën Aarhus<sup>it</sup>, që publiku gëzon.

Së pari, qeveria ose çdo strukturë tjetër ofrojnë informacion, të cilin ato dëshirojnë ose janë të detyruara t'ia sigurojnë publikut bazuar në dispozitat e politikave ose ligjeve të tyre si p.sh. raportet periodike të Gjendjes së Mjedisit. Si rrjedhojë ato kanë nevojë për mekanizma për grumbullimin, analizimin, përmbledhjen dhe publikimin e materialeve.

Së dyti, qeveria dhe institucionet e saj duhet të jenë në gjendje t'u japin përgjigje kërkesave që vijnë nga publiku, për informacion në lidhje me çështjet mjedisore. Institucionet duhet të jenë të organizuara për të qenë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të tilla. Por ky, në fakt është një drejtim i ri; publiku nuk është mësuar të kërkojë informacion nga organizmat qeveritare.

##### **Informacioni i siguruar**

Shumë organizata përfshihen në prodhimin e informacionit. Ndodh që ky proces të jetë ose kombëtar ose i referohet një zone të caktuar. Ndonjëherë informacioni do të jetë i përgjithshëm, si p.sh. norma e gazeve të ndotur të çliruar nga makinat, dhe herë të tjera ai do të jetë më specifik si p.sh. niveli i ndotjeve nga metalet e rënda në një zonë potenciale zhvillimi.

Përdoruesit do të jenë të ndryshëm, përfshi publikun e gjerë, institucionet ndërkombëtare që publikojnë të dhëna standarde për një sërë vendesh, të tillë si Eurostat (Zyra Europiane e Statistikës), shoqatat e industrive ose operatorët individualë, etj.


Secili institucion që grumbullon informacion në lidhje me këtë strategji ka nevojë të ketë:

- Përgjegjësinë dhe autoritetin për të grumbulluar informacionin e nevojshëm;
- Personelin e mjaftueshëm për ta analizuar, përmbledhur dhe publikuar këtë informacion në forma të ndryshme, sipas kërkesave të përdoruesve; dhe
- Mjetet teknike dhe buxhetin për ta arritur këtë.

---

<sup>8</sup> Programi i Qeverisë, 2005 - 2009





**Figura 4-2 Rrjedha e Informacionit Mjedisor**

Mjetet moderne, na lejojnë që menjëherë pas mbledhjes ta ruajmë, përmbledhim dhe paraqesim informacionin relativisht lehtë e në mënyrë të dobishme, interesante dhe edukuese. Mundësitë e ofruara nga kompjuteri dhe teknologjitë e telekomunikacionit janë të gjera, menjëherë të disponueshme dhe relativisht të lira për t'u përdorur. Ato nuk mund të zëvendësojnë materialet e botuar, por janë plotësues të fuqishëm të tyre.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është në procesin e pajisjes për të kapërcyer sfidat e sigurimit të llojeve të reja dhe tradicionale të informacionit. Ajo vazhdon të publikojë Raporte për Gjendjen e Mjedisit si dhe dokumente të tjerë, por është njëkohësisht duke futur në përdorim një sistem të administrimit të informacionit mjedisor bazuar në GIS<sup>9</sup>. Ky sistem do të mbështetet, përditësohet dhe mirëmbahet nga Agjencia për Mjedisin dhe Pyjet, e sapo krijuar.

Gjatë periudhës së zhvillimit të sistemit do të jetë kritike të sigurohemi që informacioni i mbledhur është i besueshëm. Kjo do t'u kërkojë institucioneve që të:

- Konfirmojnë të dhënat që mbledhin dhe sigurojnë;
- Përdorin përkufizime të standardizuara të të dhënave; dhe
- Bëjnë referime gjeografike për të gjitha të dhënat.

### **Komunikimi dhe dhënja e informacionit**

Kërkesat për disponibilitet e dokumentacionit zyrtar shqiptar, përfshirë dhe ato të Mjedisit, janë përcaktuar në ligjin shqiptar 8503 (i datës 30.06.1999). Ligji kërkon që informacioni të jetë i disponueshëm në nivel vendor. Neni 23, i Kushtetutës së Shqipërisë pohon se "Çdo organ administrativ Shtetëror dhe ent publik është i detyruar të sigurojë dhe japë çdo informacion që ka lidhje me dokumentet zyrtarë".

<sup>9</sup> GIS (Sistemi Gjeografik i Informacionit) është një mjet për hartëzimin e informacionit dhe për të treguar sesi ndryshimet e kushteve kanë pasojë mbi një situatë të caktuar. Bazohet në imazhe satelitare, që japin detaje të bollshme mbi kushtet gjatë një periudhe kohore .

Komunikimi i informacionit është një nga shërbimet bazë që duhet të sigurojnë të gjitha ministrinë.

MMPAU duhet të jetë një ofruer proaktiv i informacionit për të siguruar që informacioni mjedisor të jetë i disponueshëm për të gjithë. Dy janë tipet bazë të informacionit mjedisor që duhen komunikuar nga MMPAU për aktorët dhe publikun. E para është informacioni politik, përfshirë lajmet; e dyta janë rezultatet e të dhënave të grumbulluara për mjedisin.

Informacioni mjedisin që do të grumbullohet nga MMPAU, do të jetë mbi:

- Zhvillimet ndërkombëtar mjedisore nga shoqatat me të cilat kjo ministri është e lidhur dhe bashkëpunon, siç është Agjencia Europiane e Mjedisit, duke përfshirë edhe një shpjegim për mënyrën sesi këto çështje do ta prekin Shqipërinë;
- Objektivat aktuale politike dhe njoftimet për zbatimin e tyre nga MMPAU dhe të gjithë ministrinë e linjës me përgjegjësi mjedisore;
- Njoftime, në të cilat ligjet mjedisore po harmonizohen aktualisht me *acquis communautaire* dhe kohën kur do të zhvillohen konsultimet me aktorët;
- Veprimtari që mbështet Ministria siç është “Paketa e Gjelbër”, e prodhuar për shkollat (REC);
- Fushata të drejtuara nga ministria siç është ajo që lidhet parandalimin e zjarreve në pyjet.

Ky informacion ka nevojë të koordinohet dhe shpërndahet në grupet e interesuar dhe tek publiku duke përdorur të gjithë mjetet e mundshme të komunikimit, veçanërisht median, e cila është e lirë dhe internetin i cili për momentin nuk disponohet kudo në Shqipëri, por është duke u rritur me shpejtësi.

Përsa i përket të dhënave, një sistem i cili publikon vetëm informacion të përzgjedhur, rrezikon të shihet si jo-transparent: si mund ta dimë ne që ajo çfarë thuhet është e vërtetë ose jo? Për këtë arsye është e rëndësishme të vihet në dispozicion i gjithë informacioni. Kjo do t’ju lejojë kureshtarëve të bëjnë më shumë pyetje, të cilat mundet gjithashtu të mbështesin administratën në konfirmimin e të dhënave të saj, dhe mund të sjellë (me raste) korrigjimin nga ana e administratës të informacionit që ajo ka publikuar. Publikimi i një regjistri të plotë i të gjithë informacionit të disponueshëm është gjithashtu i domosdoshëm për administratën, meqenëse do të arrijë të sigurojë të dhëna mbi shqetësimet e qytetarëve ose grupeve të presionit nga shpërndarja e kërkesave, dhe do të jetë në gjendje të përgjigjet siç duhet.

Megjithatë, të dhënat nuk duhet të jenë vetëm të sakta, por ato duhen paraqitur në një mënyrë sa më praktike dhe të kuptueshme për përdoruesit. Dokumentet statistikore nuk kanë shumë kuptim për njerëzit e zakonshëm, të dhënat duhet të analizohen dhe përmbledhen se vetëm kështu ato mund të përdoren dhe kuptohen lehtësisht. Sistemi SAIM, i përshkruar më sipër, do ta ndihmojë Ministrinë të bëjë pikërisht këtë gjë, meqenëse ai i konverton statistikën në harta që lexohen lehtësisht. Kërkimet tregojnë se publiku është i interesuar ta marrë këtë informacion, veçanërisht për cilësinë e ajrit ose të ujit për zonat në të cilat ata jetojnë. MMPAU duhet të sigurojë që publiku ta dijë kur ky informacion është i disponueshëm dhe prej nga do të marrin hollësitë që kërkojnë.

### **Sistemi i Anketimit**

Po aq i rëndësishëm sa është sigurimi i informacionit, po aq është edhe përgjigjja ndaj pyetjeve të publikut për çështjet mjedisore.

Për këtë arsye, në të gjitha nivelet duhen krijuar sisteme për përpunimin e të dhënave shpejt dhe me efikasitet si dhe me objektiva kohore për çdo organ që do t’iu përgjigjet atyre. Në nivel Ministrie, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar përmirësimit të rrjedhjes së informacionit midis ministrive të linjës që duhet t’iu përgjigjen këtyre kërkesave. Shumica e njerëzve do të shkojnë në bashkinë ose komunën e tyre vendore për të kërkuar informacion ose për të bërë pyetje për mjedisin. Këto

autoritete duhet të kenë sistemin e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve në vend si dhe lidhje me MMPAU për t'iu përgjigjur pyetjeve që ata marrin, të cilat janë jashtë kompetencave të këtij autoriteti.

Dy nevojat kryesore për t'u siguruar se një sistem i tillë funksionon janë:

- Një mekanizëm që merr kërkesat, i drejton ato dhe sigurohet se përgjigjet janë dhënë; dhe
- Publiciteti, për t'u siguruar se publiku është në dijeni të informacionit që është i disponueshëm si dhe shërbimit që ofrohet.

Natyra e këtyre sistemeve të përdorura do të ndryshojë gradualisht meqenëse teknologji e përdorur ndryshon dhe avancohet shumë shpejt.

Shumica e kërkesave të të dhënave tani për tani do të trajtohen nëpërmjet përgjigjeve me shkrim, veçanërisht në nivel vendor. Megjithatë, pyetje me email të bazuara në internet dhe lehtësi për t'u përgjigjur të krijuara nga MMPAU, do të përdoren gjithnjë e më shumë e ndërkohë duhet të merret parasysh edhe vendosja e një linje telefonike falas për t'iu përgjigjur kërkesave.

#### **4.6.2 Arsimit dhe Trainimi**

*“Arsimi publik do të mbështetet nga programe specifike që do të realizohen në bashkëpunim me shoqërinë civile.”<sup>10</sup>*

Vizioni i Qeverisë për arsimin bazohet në modelin e arsimit të vazhdueshëm duke u nisur që nga cikli para-shkollor dhe duke vazhduar pastaj gjithë jetën. Objektivi i sistemit të arsimit do të jetë formimi i kapaciteteve dhe aftësive individuale për të fituar dhe përdorur njohuritë. Të kuptuarit e çështjeve të mjedisit është një pjesë thelbësore e saj.

##### **Shkollat**

Strategjia, sipas të cilës konsideratat mjedisore përfshihen në sistemin e edukimit, do të japë rezultate vetëm në një periudhë afat-gjatë, me hyrjen në tregun e punës të fëmijëve me nivel më të lartë ndërgjegjësimi mjedisor se prindërit e tyre. Sa më shpejt ti jepet një dimension mjedisor programit shkollor aq më shpejt do të arrihet ky rezultat. Qeveria është e ndërgjegjshme për këtë dhe Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004 – 2015 e Ministrisë së Arsimit përcakton:

*“Mjedisi në formën e studimeve të veçanta mjedisore do të jetë një lëndë e re në programet e arsimit parauniversitar, por meqenëse ai prek direkt kaq shumë aspekte të jetës së njerëzve dhe të suksesit potencial të Planit Kombëtar të Zhvillimit të Shqipërisë, duhet gjithashtu të merret në konsideratë nga një gamë e gjerë lëndësh që aktualisht janë pjesë e programeve mësimore.”*

Hapa pozitivë janë ndërmarrë. Në vitin 2004 u hartua një kuadër mësimor (curricular) komplet i ri, në të cilin janë bërë përpjekje që të futen çështjet dhe konceptet mjedisore. Megjithatë, përshkak të kufizimeve në resurset u vendos që të mos futen lëndët mjedisore, si lëndë më vete, për të ndiqen si fillim disa metoda të prezantimit ndër-lëndor të këtyre çështjeve, duke i bërë çështjet mjedisore, pjesë të këtyre pesë lëndëve:

- Biologji;
- Sociologji;
- Kimi;
- Fizikë;
- Gjeografi.

Ekziston gjithashtu një lëndë jashtëprogramit (me zgjedhje) mbi “Edukimin Mjedisor”, për nxënësit e moshave 15 – 18 vjeçare, pra të shkollave të mesme.

Për ta bërë efektiv këtë ndryshim, mësuesve do t'u nevojitet të përfshijnë çështjet mjedisore në leksionet/programet e tyre, të zhvillojnë modulet e duhura të mësimdhënies dhe të bëjnë të

<sup>10</sup> Programi i Ri i Qeverisë, 2005

disponueshme të materialeve edukative, ku përfshihet dhe mundësia për të marrë informacionin e duhur për grup-moshat e interesuara.

Ndërkohë që kjo mund të bëhet nga vetë mësuesit dhe trajnuesit, në këto fusha ekziston një eksperiencë e pasur ndërkombëtare, e cila mund të pasurojë përpjekjet në rang kombëtar dhe për këtë arsye është e rëndësishme të përfshihet. Propozohet që Instituti i Studimeve Pedagogjike të zhvillojë një program ndërkombëtar për shkëmbim eksperience.

### Universitetet

Pritet që të ketë një kërkesë në rritje për specializime mbi problemet mjedisore, në fusha të ndryshme, si forcimi i nevojave për administrim mjedisor, si pjesë kjo, e procesit të anëtarësimit në BE, ndërtimi i infrastrukturës hidro-sanitare ose administrimi i një turizmi të qëndrueshëm. Puna në nivel universitetesh ka nisur tashmë me futjen e Departamentit të Agro-Mjedisit të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe hapjen e degës së Inxhinierisë së Mjedisit në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe përgatitjen e pajisjen e studentëve me diploma universitare dhe nivelit master në këto fusha.

Megjithatë është i nevojshëm një zhvillim i mëtejshëm i degëve në të gjitha nivelet si dhe i komponentëve mjedisorë në degë të tjera (ekonomik, inxhinieri, kimi ose shkenca natyrore) për të mbuluar gamën e aftësive profesionale të cilat do të jenë të nevojshme me zhvillimin e ekonomisë shqiptare

### Trajnimi Profesional dhe Trajnimi “Pa Shkëputje nga Puna”

Për momentin ekzistojnë vetëm një numër i vogël mekanizmesh të trajnimit “pa shkëputje nga puna”, të cilët i vijnë në ndihmë ngritjes së kapacitetit profesional të punonjësve të sektorit publik dhe atij privat në fushën e mjedisit. Rritja e kapacitetit profesional është një çështje thelbësore, veçanërisht kur ka të bëjë me procesin e kalimit të përgjegjësive tek autoritetet vendore dhe rajonale. Kurset e shkurtra që mund t’u ofrohen individëve mbi baza të pjesshme ose mbi bazë trajnimi afat-shkurtër, përbëjnë një mekanizëm që ndihmon zhvillimin e kapaciteteve. Këto kurse të shkurtra duhet të ofrohen në formën e “moduleve”, të cilët trajtojnë tema specifike në mënyrë koherente, duke mos nxjerre nevojën për pjesëmarrje në modulet e tjera. Grupi i moduleve që do të prezantohen fillimisht trajton:

- Planifikimin praktik të administrimit të mbetjeve të ngurta
- Industrinë e Ujërave – planifikimin e investimeve, administrimin operacional dhe kontraktimin
- Vlerësimin Strategjik Mjedisor në lidhje me planifikimin fizik dhe hapësinor.

Me kalimin e kohës modulet do të kthehen në një strukturë me gamë të gjerë temash, ndjekja dhe përfundimi i të cilës do t’u krijojë individëve mundësinë për të zbatuar për një kualifikim zyrtar në fushën e administrimit të mjedisit

### **4.6.3 Pjesëmarrja e Publikut dhe e Mundësia për t’ju drejtuar Gjykatës**

*“Do të rishikohen të drejtat ligjore të publikut dhe do të përmirësohen procedurat administrative dhe ankesat gjyqësore”<sup>11</sup>*

- E drejta e publikut për informim;
- Pjesëmarrja e publikut; dhe
- Barazia para ligjit.

<sup>11</sup> Programi i Ri i Qeverisë, 2005

Të treja janë të rëndësishme për t'u siguruar, sepse publiku ka një rol real për të luajtur në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.

### **Pjesëmarrja e publikut**

Sipas politikave dhe ligjeve të BE<sup>së</sup>, ka katër pika kyçe ku publiku përfshihet në ciklin e administrimit mjedisor. E para, ashtu siç përcaktohet edhe në Direktivat e VSM-së, në përgatitjen e planeve, dhe në veçanti në hartimin e planeve për mbetjet e rrezikshme, administrimi i shtretërve të lumenjve dhe administrimi hapësinor. E dyta, bazuar në direktivën e VNM-së, në përgatitjen e projektit ku duhet marrë në konsideratë opinioni i publikut gjatë marrjes së vendimit për një projekt të caktuar. E treta, në përgatitjen e lejeve mjedisore dhe kushteve që ato përmbajnë. Dhe së fundi, rezultatet e vendimeve të inspektimit si dhe çdo iniciativë ndjekjeje penale për shkelje, duhet të bëhen publike.

Një parim bazë i përfshirjes së publikut është se njerëzit në një lokalitet të caktuar ose njerëzit me një interes të veçantë në këtë fushë mund të japin informacion me vlerë për hartuesit e planit dhe projektit si dhe për vendim-marrësit. Një parim i dytë është se njerëzit që ndihen të përfshirë në përgatitjen e një plani ose projekti ka më shumë të ngjarë të pranojnë rezultatet e këtij plani sepse ata arrijnë ta kuptojnë atë më mirë dhe sepse ata ndiejnë se kanë kontribuar në të.

Mund të zbatohen një sërë procedurash, përfshirë kërkesën për dhënien me shkrim të komenteve mbi dokumentet e parë nga një autoritet vendor ose çdo zyre tjetër publike, organizimi i takimeve publike, diskutimi nëpërmjet shtypit, sondazhet e opinionit ose takime me grupe specialistësh. Por në parim, me termin "publik" nënkuptohet kushdo që beson se është i interesuar. Në disa projekte të mëdha ky term mund të nënkuptojë edhe qeverinë ose popullsinë e vendit fqinj. P.sh. nëse fabrika e shkrirjes së aluminit në hyrje të Liqenit të Shkodrës, në Podgoricë, do të ndërtohej sot, do të duhej që vendi fqinj të bënte konsultime me qeverinë shqiptare.

Procedurat e pjesëmarrjes së publikut do të bëhen më të përgjithshme me adoptimin nga ana e Shqipërisë të një shkalle më të lartë të *acquis*. Funksionimi me sukses i këtyre procedurave do të jetë përgjegjësi e qeverisë, e publikut në përgjithësi, OJQ-ve, shoqatave të tregtisë dhe grupeve të tjera të interesit.

### **Mundësia dhe a drejta për t'ju drejtuar Gjykatës**

Parimi i përcaktuar nga ky element i Konventës është se vendimet administrative që ndikojnë mbi një pjesëtar të publiku (pronari ose operatori i një fabrike, dikush të cilit i është refuzuar leja për të parë disa informacione mjedisore, një hotelier i gjobitur për derdhjen e ujërave të zeza të patrajtuara në det) mund të apelojnë. Parimi bazë i apelimit është që personi ose grupi që e dëgjon këtë apelim, duhet të jetë sa më i pavarur që të jetë e mundur, nga ata kanë marrë vendimin kundër personit që po bëhet apelimi, me qëllim sigurimin e pa-anshmërisë.

Në përgjithësi, të paktën në shkallën e parë, është e preferueshme një procedurë apelimi administrativ, gjë që shmang proceset e gjata dhe të kushtueshme gjyqësore.

Kombinimi shqiptar i përgjegjësive të autoriteteve vendore, rajonale dhe qendrore në administrimin mjedisor e bën një apelim administrativ të mundur dhe vërtet tërheqës, por është e nevojshme që nivelet e ndryshme dhe proceset e vendim-marrjes të jenë qartësisht të pavarur dhe të lirë, p.sh. ndaj ndërhyrjeve politike.

Është e qartë se një rrugë e tillë nuk është e përshtatshme në rastin e një ndjekjeje penale që duhet të trajtohet nga një gjykatë penale.



## 5. Zhvillimi i Administrimit Mjedisor

Parimi bazë në themel të objektivave, qëllimeve, synimeve, masave dhe detyrave të propozuara në këtë strategji është se problemi nuk mund të zgjidhet vetëm duke bërë një deklaratë apo duke miratuar një ligj. Është me mjaft rëndësi të identifikohen veprimet praktike, të përcaktohet kush është përgjegjës për të ndërmarrë veprimin si dhe afatin kohor për këtë. Vetëm pasi është ndërmarrë ky veprim, mund të sigurohen fondet e nevojshme dhe duhet të fillojë puna.

Në mënyrë që kjo strategji të gjejë zbatim, duhet të përcaktohen më së miri masat, përgjegjësitë dhe afatet për institucionet e të gjitha niveleve. Për këtë arsye, në Kapitullin 3, janë parashtruar masat dhe përgjegjësitë për çdo element të Mjedisit. Në këtë Kapitull përshkruhen në mënyrë të përgjithshme masat dhe detyrat që duhen ndërmarrë për të aktivizuar aty ku nuk ekziston dhe përmirësuar aty ku ekziston, administrimin mjedisor. Kjo përfshin ato veprime të cilët synojnë të krijojnë kuadrin administrativ dhe ligjor që nevojitet për të siguruar veprimet e nevojshme teknike dhe fizike: këtu përfshihen detyrat procedurale dhe institucionale të cilat përmirësojnë sistemet tona për administrimin e mjedisit.

Ky program zbatimi duhet të përfshihet në programet shumëvjeçare të punës së ministrive dhe institucioneve të tjera të shtetit dhe në të ardhmen të përfshihet në një version të përditësuar të Planit Kombëtar të Veprimit Mjedisor.

Masat që nevojiten për krijimin e kuadrit ligjor dhe administrativ, grupohen në nëntë fusha siç tregohen në tabelën e mëposhtme. Pjesa më e madhe e masave dhe detyrave i përket një afati të shkurtër kohor, megjithëse në disa raste janë identifikuar nisma më afatgjata për të ilustruar mekanizmin për përmbushjen përfundimtare të një qëllimi apo synimi.



Ref	Çështja	Mënyra e Zgjidhjes
5.1	<i>Integrimi</i> Çështjet mjedisore nuk janë zgjidhur siç duhet në strategjitë sektoriale dhe në procesin e zhvillimit në përgjithësi	Procese të funksionale komunikimi dhe konsultimi ndër-institucional në të gjitha nivelet e punës; mekanizma më të mirë të konsultimit të jashtëm; një prezantim formal i vlerësimit strategjik mjedisor; një udhëzim specifik dhe i përgjithshëm sektorial pranë ministrive dhe autoriteteve vendore mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM-në).
5.2	<i>Ligji për mjedisin – përpunim, transpozimi dhe zbatimi i tij.</i> Legjislacioni aktual ka dobësi të mëdha strukturore.	Të ruhet strategjia e integruar e legjislacionit ekzistues por të ndryshohen çështjet kryesore për të siguruar lidhje logjike dhe mundësi reale për t'u zbatuar.
5.3	<i>Përgatitja dhe dhënia e lejeve</i> Lejet janë mjaft të paqarta dhe të pasakta	Të rishikohen strukturat e lejeve në mënyrë që, paralelisht me reformën legjislative, të aplikohen kushte të zbatueshme.
5.4	<i>Verifikimi dhe Inspektimi</i>	Të përmirësohen procedurat, kapaciteti dhe ekspertiza e organeve të inspektimit
5.5	<i>Zbatimi i ligjit dhe apelimet</i>	Të zbatohen procedurat e reformuara të ushtrimit të ligjit duke pasur si qëllim vjeljen/mbledhjen e plotë të taksave dhe gjobave Të gjendet një rrugë e thjeshtë administrativ për apelimet pa qenë nevoja për procedime gjyqësore
5.6	<i>Përforcimi i sistemeve monitoruese</i>	Të zhvillohen projektet aktuale në mënyrë që të krijohet një sistem që do të përmbushë nevojat e <i>acquis</i> dhe të Agjencisë Europiane të Mjedisit.
5.7	<i>Investimi në Infrastrukturën Komunale dhe Fondi për Mjedisin</i>	Të përcaktohet Fondi për Mjedisin dhe dispozitat përkatëse në mënyrë që të mbështeten autoritetet vendore në marrjen e fondeve të nevojshme për infrastrukturën bazë të mjedisit
5.8	<i>Administrimi dhe Raportimi</i>	Të krijohet struktura të një niveli të lartë administrimi dhe raportimi për të mbështetur bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndër-institucional
5.9	<i>Informacioni</i>	Të hartohet një Sistem i Administrimit të Informacionit Mjedisor (SAIM)
5.10	<i>Komunikimi</i>	Të zbatohet Strategjia e Komunikimit për të siguruar një rritje në sensibilizim, të kuptuarit dhe përkushtimin për mjedisin.
5.11	<i>Arsimimi</i>	Të vazhdohet të punohet mbi zhvillimin e kurrikulave arsimore në të gjitha nivelet dhe të sigurohen shërbime ose trajnime profesionale
5.12	<i>Kapacitetit Institucional dhe nevojat për personel</i>	Të përcaktohen dhe zbatohen strukturat e përshtatshme të administrimit, të shtohet personeli. Të përforcohet inspektorati dhe pajisjet e tij, të hartohen planet e inspektimit, të identifikohen procedurat reale të detyrim për zbatimin e ligjitit
5.13	<i>Burimet Financiare</i>	Rritje thelbësore lidhur me përkushtimin ndaj të ardhurave për mbrojtjen mjedisore Fondet e investimit – strategji afatgjatë mbështetur në fondet e shumëllojshme nëpërmjet buxhetit të shtetit, granteve dhe huave.



## 5.1 Integrimi

Dy veprimet kryesore që duhen ndërmarrë për të siguruar integrimin e faktorëve mjedisorë në nivel kombëtar, rajonal, vendor dhe në nivel aktorësh, janë:

- Forcimi i mjeteve të komunikimit dhe koordinimi.
- Përcaktimi i procedurave dhe mekanizmave për ta ekuilibruar mbrojtjen e mjedisit me objektivat specifike sektoriale.
- 

Masat e parashtruara më poshtë synojnë t'i japin drejtim këtyre dy verimeve.

Ref.	Masat	Ref.	Detyrat	Datat	Përgjegjësia
S1.1	Një nëpunës mjedisi, caktuar në çdo Ministri, përgjegjës për komunikimin dhe bashkërendimin e rregullt të çështjeve mjedisore. Nëpunësi i mjedisit i raporton direkt çdo Ministri.	S1.1.1	Të emërohet një nëpunës mjedisi – në disa raste mund të ketë nevojë të krijohet një pozicion i tillë.	2006	Të gjitha Ministrinë Fondet ekzistuese
		S1.1.2	Të trajnohen nëpunësit e mjedisit në fushën e administrimit mjedisor.	2006-2007	MMPAU Burimet ekzistuese
		S1.1.3	Të ngrihet rrjeti i nëpunësve të mjedisit në mënyrë që të mundësohet një shkëmbim më efikas i informacionit dhe pikëpamjeve.	2006	MMPAU Burimet ekzistuese
S1.2	Ngritja e një rrjeti zyrtar të nëpunësve vendorë dhe rajonale të mjedisit, për të forcuar marrëdhëniet e punës me pushtetin rajonal dhe vendor: të përcaktohen mjetet më të mira të mundshme të komunikimit dhe bashkëpunimit mes MMPAU-n dhe niveleve vendorë dhe rajonale të administratës, të ngrihet një sistem për shkëmbim informacioni	S1.2.1	Të emërohet një koordinator në nivel autoriteti vendor brenda MMPAU-së. Ky post do të jetë përgjegjës për bashkërendimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve më të mira me autoritetet rajonale dhe vendore për sa i përket politikave, në lidhje me personelin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit	2006	Një specialist me kohë të plotë (SKP)
		S1.2.2	Të ngrihet në sistem publikimi i buletineve tre-mujorë të mjedisit për autoritetet vendore dhe rajonale – si pjesë e dispozitave të Sistemit të Administrimit të Informacionit Mjedisor për shpërndarjen e informacionit	2006 në vazhdim	Burim shtojcë i një SKP-je
S1.3	Të ngrihen mekanizmat e konsultimit të aktorëve që operojnë në fushat e industrisë dhe shoqërisë civile në mënyrë që në praktikë të administrimit të mjedisit të pasqyrohen pikëpamjet e aktorëve	S1.3.1	Të krijohet forumi zyrtar i industrisë – Ministri për të shkëmbyer pikëpamje bazuar në Grupin e Veprimit Mjedisor.	2006	Brenda strukturave institucionale ekzistuese
		S1.3.2	Të përfshihen përfaqësues të industrisë dhe shoqërisë civile në Bordin e Fondit të Mjedisit	2007	Shiko krijimin e Fondit të Mjedisit më poshtë

Ref.	Masat	Ref.	Detyrat	Datat	Përgjegjësia
S1.4	Të përgatitet legjislacioni i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për zbatim zyrtar në politikat e tjera qeveritare si mjeti kryesor për të siguruar integritimin e faktorëve mjedisorë në politikat sektoriale	S1.4.1	Direktiva VSM të shndërrohet në legjislacion në përputhje me Nenin 9 të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit	2006-2007	Brenda strukturave institucionale ekzistuese – Projekti ELPA dhe Projekti Suedezi IDA
S1.5	T'i sigurohet të gjitha Ministrive udhëzim specifik i përgjithshëm dhe sektorial për VSM	S1.5.1	Udhëzimi i përgjithshëm mbi VSM për të gjitha Ministrinë	2006-2007	Projekti SIDA për VSM
		S1.5.2	Udhëzim specifik sektorial për transportin, industrinë, bujqësinë, dhe pyjet	2006-2007	Projekti SIDA për VSM
S1.6	Të ndërmerren VSM pilot me Ministrinë dhe sektorët më kryesorë: transportin, industrinë, bujqësinë, dhe pyjet	S1.6.1	Të përgatiten termat e referencës për projektet e vlerësimit	2007	Asistencë teknike – projekti SIDA për VSM
		S1.6.2	Zbatimi i projektit sipas termave të referencës	2008	MMPAU
		S1.6.3	Rezultatet të përfshihen në planet dhe programet e ministrisë	2009 në vazhdim	Rrjeti i nëpunësve të mjedisit Të gjitha ministrinë përkatëse brenda burimeve ekzistuese
S1.7	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor (VNM) (niveli i projektit) – përfundimi i masave të transpozimit dhe zbatimit	S1.7.1	Amendimi i legjislacionit ekzistues mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), për t'i dhënë efekt të plotë Direktivës 85/337/EEC e amenduar, duke përfshirë: Në bazë të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit: <ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullore (Mbi përcaktimin e rregullave dhe masave për shpërblimin e specialistëve që do të bëjnë rishikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të VNM-së).</li> <li>Udhëzim (Lehtësirat procedurale në procesin e VNM dhe leja mjedisore e personave fizik dhe juridik që zbatojnë sisteme të certifikuara mjedisore)</li> </ul> Ligji Nr. 8990 datë 23.01.2003 "Mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" duhet të plotësohet me këto akte nën ligjore: <ul style="list-style-type: none"> <li>VKM "Mbi raportin e VNM dhe VSM (Vlerësimin Strategjik Mjedisor)"</li> <li>Udhëzim "Mbi detyrat e ARM-ve në procesin e VNM".</li> <li>Udhëzim "Mbi përcaktimin e aktivitetëve që përjashtohen nga pagesa e tarifës së lejes mjedisore".</li> <li>Udhëzim "Mbi pagesat për specialistët që hartojnë raportet e VNM".</li> <li>Udhëzim "Mbi metodologjinë e përgatitjes së raportit të VNM-së".</li> </ul>	2006	ELPA
S1.8	Të rishikohet baza ligjore mbi mundësinë e aksesit në informacionin mjedisor.	S1.8.1	Ligji "Mbi Informacionin Mjedisor dhe Raportimin në Republikën e Shqipërisë", që të arrihet një harmonizim me kërkesat kryesore të legjislacionit të Komunitetit European.	2009	MMPAU

## Transpozimi i Legjislacionit

Zbatimi i këtyre masave lidhet me dy instrumentet e legjislacionit mjedisor të Komunitetit Europian të cilat identifikohen në PKPL:

- Direktiva 85/337/EEC mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM)
- Direktiva 2001/42/KE mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)

Legjislacioni ekzistues shqiptar i reflektton kërkesat e Direktivës së VNM-së, por zbatimi i saj do të përmirësohet nga përpunimi i legjislacionit. Direktiva mjedisore mbi VSM është reflektuar pjesërisht në legjislacionin ekzistues shqiptar. Transpozimi dhe zbatimi i këtyre instrumenteve do të përfundojë brenda një kohe të shkurtër.

Në një periudhë më afat-gjatë, do të merren një sërë masash ligjore për të përcaktuar kritere të sakta që karakterizojnë produktet “miqësore ndaj mjedisit”, përfshirë këtu kufizimet në përdorimin e disa lëndëve të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike (Direktiva 2002/95/KE).

## Implikimet Burimore

Implikimet burimore të këtyre masave do të kërkojnë ndryshime të mëdha në mënyrën se si kryhet puna ekzistuese, e për pasojë, nuk kanë konsequenca të mëdha. Megjithatë duhet theksuar se në MMPAU duhen të paktën edhe dy poste të tjera.

### 5.2 Ligji mbi Mjedisin – rishikimi, transpozimi dhe zbatimi

Legjislacioni ka lidhje me të gjithë aspektet e kësaj strategjie. Janë identifikuar mjaft masa ligjore sipas elementëve specifikë të kësaj Strategjie, duke përfshirë integrimin, ajrin, ujin, mbetjet dhe elementë të tjerë, të cilët nuk janë përsëritur këtu. Për më tepër, një program më gjithëpërfshirës dhe efikas ndryshimesh ligjore përshkruhet në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit (PKPL). Megjithatë, për sa i përket ligjit mbi mjedisin, duhet gjetur zgjidhje për një sërë çështjesh të përgjithshme. Këto nuk janë specifikuar në sektorë individualë ose në PKPL por janë pjesë e rëndësishme në tërësinë e ligjit mbi mjedisin në Shqipëri dhe janë identifikuar këtu.

Sic është trajtuar në këtë strategji dhe në projekt raportin legjislativ, metoda e “komandës dhe kontrollit” qëndron në thelb të legjislacionit në Shqipëri. Zbatimi efikas i kësaj metode kërkon një sistem efikas të dhënies së lejeve. Në Shqipëri është vënë re një progres i madh në lidhje me zbatimin e sistemit të dhënies së lejeve mjedisore. Megjithatë, kjo situatë duhet përshtatur e përsosur më tej në mënyrë që të lehtësojë zbatimin e kërkesave të *acquis* dhe të zbatimit të ligjit dhe masave respektive që rrjedhin prej tij (lutemi shih më poshtë).

Amendimet në sistemin e dhënies së lejeve do të kenë ndikimin më të madh në ato subjekte që kanë ose u nevojiten lejet, duke përfshirë industrinë, tregtinë dhe autoritetet vendore. Për këtë arsye amendamentet e këtij sistemi do t’i nënshtrohen konsultimeve intensive me këto palë. Kjo do të ndihmojë në atë që aktorët kryesorë të pranojnë procedurat dhe kërkesat e reja.

Zbatimi i PKPL-së për mjedisin është një detyrë komplekse. Vendet e mëparshme kandidatë apo të anëtarësuar në BE kanë adoptuar një sistem “planifikim zbatimi” në mënyrë që të koordinohet procesi i përafrimit. Megjithëse anëtarësimi është ende larg, për të siguruar përmbushjen e

detyrimeve të *acquis* nevojitet një adoptim sistematik i procedurës planifikuese të zbatimit. Për shkak të përmasave të detyrës, për planifikimin e zbatimit është e nevojshme një strategji e ndarë në faza. Faza e parë ka të bëjë me përgatitjen e “përmbledhjes” së planeve të zbatimit. Megjithatë kjo fazë do të jetë më pak e vështirë se sa përgatitja e planeve të plota të zbatimit, sërisht, për katër vitet e ardhshëm, parashikohet të implikohen burime të rëndësishme . Për rrjedhojë këto përmbledhje planesh do të rishikohen, amendohen e përshtaten sipas ecurisë së çdo instrumenti dhe do të zhvillohen si plane me format të plotë, të përdorur në proceset e mëparshme të antarësimit.

Planet përmbledhëse të zbatimit do të:

- sigurojnë një strukturë të qartë për përcaktimin dhe të kuptuarit e detyrimeve të sakta që shoqërojnë çdo instrument të dhënë;
- funksionojnë si një “vatër” për bashkëpunimin dhe bisedimet ndër-institucionale;
- shërbejnë si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të planeve të plota të zbatimit për procesin zyrtar të antarësimit në të ardhmen.

Në Shtojcën III jepet një model formati për planet përmbledhës të zbatimit. Një version i përmbledhur i tij, ka nevojë të përgatitet menjëherë.

Ref.	Masat	Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjësia
S2.1	Rishqyrtimi i kuadrit ligjor , duke përfshirë vlerësimin e përgjegjësiave për dhënien e lejeve	S2.1.1	Raport Analitik dhe Rekomandime duke përfshirë shqyrtim të sistemit ekzistues të lejeve: veprimet e mbuluara, kushtet e vëna dhe procesi i dhënies së lejeve – të përcaktohet përputhja me nevojat e legjislacionit të BE-së	2006	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.2	Amendime të kuadrit të dhënies së lejeve përcaktuar sipas Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit në mënyrë që të fuqizohet sistemi ekzistues dhe të ndihmojë në zbatimin e elementëve sektorialë specifikë të <i>acquis</i> .	2006 - 7	Projekti ELPA dhe MMPAU
S2.2		S2.2.1	Amendimet në Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit	2006 - 7	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.2.2	Amendimet në Ligjin mbi Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	2006 - 7	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.2.3	Amendimet në Ligjin mbi Ndotjen e Ujit	2006 - 7	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.2.4	Udhëzime mbi vlerat e kufizuara vendore për zonat që kërkojnë mbrojtje të veçantë – objektiva mbi cilësinë e mjedisit, të veçanta sipas zonave	2007	MMPAU

Ref.	Masat	Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjësia
S2.2a	Përfshirja e masave për masat e shtuara të detyrimit për zbatimin e ligjitit dhe për procedurat e apelimit.	S2.2.4	Amendimi i legjislacionit ekzistues për të përmirësuar masat në lidhje me vjeljen e gjobave	2006-7	MMPAU Ministria e Financave
		S2.2.5	Prezantimi i procedurave për apelimin kundër vendimeve administrative	2006-7	MMPAU Ministria e Drejtësisë
S2.3	Zbatim praktik i sistemit të rishikuar të dhënies së lejeve.	S2.3.1	Përcaktimi i procedurave të rishikuara të dhënies së lejeve në legjislacionin dytësor dhe udhëzimet e Ministrive duke përfshirë:  Udhëzime mbi përcaktimin e aktiviteteve që janë përjashtuara nga tarifat e lejes mjedisore.	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.3.2	Formularë të standardizuar aplikimi për lejet e integruara mjedisore	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.3.3	Shënime udhëzuese për aplikantët	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.3.4	Arkiva të kushteve model të lejeve	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.3.5	Të caktohen ekspertë për çdo modul (ajër, ujë, mbejtje) që do të vepronë si trajnerë dhe këshilltarë gjatë zbatimit të kushteve të reja të lejeve	2007	MMPAU
S2.4	Aspektet ligjore të Sistemit të Administrimit të Informacionit mbi Mjedisin	S2.4.1	Të ngrihet një arkivë elektronike e legjislacionit shqiptar mbi mjedisin bashkë me udhëzuesin shoqërues (për përdorim publik).	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.4.2	Të ngrihet një arkivë elektronike e përkthimeve në shqip të legjislacionit mjedisor të KE dhe udhëzimet shoqëruese.	2006	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.4.3	Të zbatohet sistemi i Progresit të Redaktimit, për të ndjekur procesin e transpozimit.	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU
		S2.4.4	Aplikimi i lejeve mjedisore dhe ndjekja e bazës së të dhënave	2007	Projekti ELPA dhe MMPAU

Ref.	Masat	Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjësia
S2.5	Përgatitja e planeve përmbledhës të zbatimit për instrumente individuale të <i>acquis</i>	S2.5.1	Të përlogaritet ngarkesa e punës dhe burimet që nevojiten për përgatitjen e planeve përmbledhës të zbatimit për kapitullin e mjedisit në përputhje me prioritetet e përcaktuara në PKPL dhe të përgatiten raportet dhe rekomandimet për programin me dy faza të Komisionit të Mjedisit (shih më poshtë)	2006	MMPAU Min. Brend.
		S2.5.2	Trajnim mbi përgatitjen e planeve të zbatimit duke përfshirë elementë ligjorë, ekonomikë, financiarë dhe këshillimorë	2007	MMPAU Min. Brend.
		S2.5.3	Të implementohet Faza I e përgatitjes së planit përmbledhës të zbatimit	2007-8	MMPAU
		S2.5.4	Të implementohet Faza eII e përgatitjes së planit përmbledhës të zbatimit	2009-10	MMPAU
S2.6	Përgatitja e planeve të plotë të zbatimit për elementë të veçantë të <i>acquis</i> .	S2.6.1	Të përgatiten programet prioritare për përgatitjen e planeve të plota të zbatimit në përputhje me PKPL-në e rishikuar	2010	MMPAU
		S2.6.2	Të implementohet Faza I e përgatitjes së planit përmbledhës të zbatimit	2011-12	MMPAU
		S2.6.3	Të implementohet Faza II e përgatitjes së planit përmbledhës të zbatimit	2013-2014	MMPAU

Amendimet ligjore do të ndryshojnë sistemin aktual të dhënies së lejeve, verifikimit dhe ushtrimit të tyre. Masat institucionale të miratuara nga Shtetet Anëtare për administrimin e këtyre proceseve janë të ndryshme. Disa Shtete Anëtare i ndërthurin institucionet e verifikimit (inspektimit) dhe dhënies së lejeve, ndërsa disa të tjerë i veçojnë ato. Avantazhi i një sistemi të ndërthurur është se inspektorët mund të përdorin me lehtësi këtë sistem dhe si pasojë i kuptojnë më mirë kushtet e dhënies së lejeve si dhe të arsyeve që kanë çuar në dhënien e tyre. Avantazhi i një sistemi të ndarë është që inspektorët shihen si më të pavarur në vlerësimin që i bëjnë veprimtarive dhe në efikasitetin e lejeve të dhëna. Shtetet Anëtare kanë mendime të ndryshme lidhur me pikën se cila alternativë duhet të preferohet më shumë megjithëse ekziston një konsensus që, aty ku është e mundur, është më mirë të ndiqen procedurat e përcaktuara administrative sepse është më e lehtë të kuptohet nga publiku. Për këtë arsye nuk propozohet që përgjegjësitë aktuale institucionale, të ndryshojnë në mënyrë radikale. Në këtë mënyrë Agjencitë Rajonale të Mjedisit do të vazhdojnë të jenë përgjegjëse për:

- Inspektimin e të gjithë impianteve
- Ushtrimin e forcës së ligjit kundër atyre enteve që shkelin legjislacionin e mjedisit apo kushtet e lejeve
- Dhënien e lejeve për impiante të vegjël e të kontrollueshëm.

Dhënia e lejeve për impiantet më të mëdha ngelet në kompetencat e MMPAU-së.

## Transpozimi

Zbatimi i rishikimit të sistemit të dhënies së lejeve, nuk e bën të mundur transpozimin ose zbatimin e plotë të instrumenteve specifike të *acquis*, por përbën një parakusht thelbësor për përaftrimin e një sërë elementësh bazë, përfshirë legjislacionin mbi ajrin, mbetjet, ujin dhe PKIN (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndoftjes). Dispozitat e parashtruara këtu për administrimin e informacionit ndihmojnë në përmbushjen e detyrimeve të *acquis* për sa i përket informacionit mbi mjedisin (Direktiva 2003/04/KE) dhe pjesëmarrjen e publikut (2003/35/KE), ku këto të fundit rrjedhin nga Konventa Aarhus-it, të cilën e ka nënshkruar edhe Shqipëria.

## Implikimet Burimore

Burimet aktuale administrative brenda MMPAU janë të pamjaftueshme për të zbatuar planet e punës ose anën ligjore të tyre të cilat janë përmendur më sipër. Do të jetë e nevojshme të punësohen personel ligjor dhe ekspertë të tjerë. Në periudhën afatshkurtër është parashikuar se nevojiten dy nëpunës për çështjet ligjore dhe tre ekspertë (për ajrin, uji, mbetjet).

### 5.3 Përgatitja dhe dhënia e lejeve

Siç është përmendur dhe më sipër, instrumenti kryesor i metodës së komandës dhe kontrollit për mbrojtjen e mjedisit është sistemi i dhënies së lejeve, i cili shoqërohet me proceset e verifikimit dhe zbatimit. Amendimet ligjore të përmendura më lart do ta fuqizojnë sistemin e dhënies së lejeve. Për prezantimin praktik të këtyre ndryshimeve nevojitet një periudhë përshtatjeje. Për këtë duhet të zbatohet një program për rishikimin e bazës ligjore të dhënies së lejeve, të përgatiten amendimet e nevojshme të ligjit ekzistues dhe pastaj të kalohet në fazën e implementimit.

Procesi i shqyrtimit të lejeve do të përmbajë hapat e mëposhtëm:

- Përgatitja e një aplikimi të ri nga aplikanti duke përdorur formatin e standardizuar
- Vlerësimin e aplikimit duke përfshirë vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Hartimin e kushteve të reja të lejeve duke përfshirë vlerësimet e mëposhtme:
  - Vlerat limit të shkaktimeve që dalin si rezultat i metodës së kombinuar
  - Përgatitja e standardeve dhe vënien në praktikë të “planeve të punës” të përgatitur nga operatori
  - Monitorimi i mjedisit duhet të bëhet nga zotëuesi i lejes
  - Kushtet e përkohshme/kalimtare dhe përmirësimi i tyre.

Leja për një impiant kompleks mund të duhet të rishikohet dhe të azhurnohet në faza të cilat gradualisht arrijnë specifikimet e lejes sipas Direktivës së PKIN (96/61/KE). Do të arrihet një transpozim kompakt i PKIN në rishikimin e Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit.

Në periudha afatgjata, për procesin e shqyrtimit të lejeve duhet edhe vlerësimi i “shpërndarjes së ngarkesës” siç është trajtuar në Kapitullin 4. Megjithatë, në ciklin e parë të shqyrtimit, synimi do të jetë arrija e normave ekzistuese dhe aplikimi i teknologjisë më të mirë të mundshme<sup>1</sup>.

Prioritetet për rishqyrtimin e lejeve do të caktohen mbi bazën e njohurive ekzistuese të autoriteteve kompetente të ndikimit në mjedis të impianteve të veçanta dhe nivelin e përmirësimit që nevojitet, që do të thotë se ndotësit më të mëdhenj do të jenë të parët që do trajtohen.

Këtu nuk specifikohen nevojat burimore të masave të identifikuara më poshtë. Nevojat burimore kanë të bëjnë me kapacitetin administrativ që është trajtuar në seksionin ku flitet për kapacitetin institucional dhe investimet (dhe përmirësimet e tjera) që do të kërkojnë në impiantet e kontrolluara. Para përfundimit të shqyrtimit të lejeve, vlerësimi i këtyre kostove është mjaft spekulativ dhe me një vlerë praktike të vogël. Gjatë implementimit të shqyrtimit të lejeve, do të adoptohet një strategji me faza për një përmirësim gradual dhe të përbalueshëm. Procedurat e vetë-monitorimit ua ngarkojnë operatorëve kostot kapitale dhe operative. Megjithatë, këto ka të ngjarë të jenë relativisht të vogla në krahasim me kostot e përgjithshme që u vihen operatorëve për të arritur standardet e përmirësuarra operationale.

---

<sup>1</sup> Duhet të merret parasysh se koncepti i “të mundshme” në këtë kontekst do të thotë “i mundshëm nga ana ekonomike dhe financiare”. Si i tillë, duhet të ndërmirren konsideratat për të siguruar kushtet ekonomike dhe financiare në Shqipëri, duke përfshirë këtu patijen mundësi të marrjes së huave financiare.



Ref.	Masat	Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjësia
S3.1	Të përgatitet dhe të publikohet programi i shqyrtimit të lejeve që përcakton fazat dhe afatet për shqyrtimin e lejeve për sektorët dhe vendndodhjet, duke përfshirë dhe publikimin e informacionit mbi lejet	S3.1.1	Të hartohet një bazë të dhënash për veprimet që kërkojnë leje bazuar në legjislativonin e ri dhe të rishikuar ("impliante të kontrolluar")	2007	MMPAU
		S3.1.2	Të vlerësohen kërkesat burimore për shqyrtimin e lejeve ekzistuese dhe përpunimin e aplikimeve të reja për leje	2007	MMPAU
		S3.1.3	Konsultime me zotërues aktualë apo të mundshëm lejesh për procesin e propozuar të rishikimit	2007	MMPAU
		S3.1.4	Renditja sipas rëndësisë e kategorive të lejeve për rishikim.	2007	MMPAU
		S3.1.5	Të përgatitet, si pjesë e Sistemit të Administrimit të Informacionit Mjedisor (SAIM) një regjistër elektronik i të gjithë impianteve të kontrolluar, duke përfshirë kushtet që mundësojnë ruajtjen e informacionit mbi lejet, raportet e inspektimit, të dhënat e vetë-monitorimit të ofruara nga operatorët dhe informacione të tjera përkatëse – elementët e këtij regjistri do të jenë të hapur për publikun.	2007	MMPAU (SAIM)
S3.2	Trajnimi në përdorimin e sistemit të ri të lejeve	S3.2.1	Të trajnohen nëpunësit e Ministrisë	2007	MMPAU
S3.3	Shqyrtimi dhe amendimi i lejeve – Faza I	S3.2.2	Të trajnohen punonjësit e ARM-ve	2007	MMPAU
		S3.3.1	Të përgatiten lejet e reja	2007-8	MMPAU, ARM-të
		S3.3.2	Këshillime me zotërues lejesh	2007-8	MMPAU, ARM-të
S3.4	Shqyrtimi dhe amendimi i lejeve – Faza II	S3.3.3	Të zbatohen kërkesat e reja të lejeve në bashkëpunim me zotëruesit e lejeve	2008-10	MMPAU, ARM-të Zotëruesit e lejeve
		S3.4.1	Të përgatiten lejet e reja	2009-10	MMPAU, ARM-të
		S3.4.2	Këshillime me zotërues lejesh	2009-10	MMPAU, ARM-të
S3.5	Shqyrtimi dhe amendimi i lejeve – Faza III	S3.4.3	Të zbatohen kërkesat e reja të lejeve në bashkëpunim me zotëruesit e lejeve	2010-12	MMPAU, ARM-të Zotëruesit e lejeve
		S3.5.1	Të përgatiten lejet e reja	2011-12	MMPAU, ARM-të
		S3.5.2	Këshillime me zotërues lejesh	2011-12	MMPAU, ARM-të
		S3.5.3	Të zbatohen kërkesat e lejeve të reja në bashkëpunim me industrinë.	2012-14	MMPAU, ARM-të Zotëruesit e lejeve

### Implikimet Burimore

Prezantimi i sistemit të ri të lejeve me anë të të cilit lejet do të kenë kushte specifike të aplikueshme për secilin operator, do të krijojë një ngarkesë të konsiderueshme për Ministrinë dhe për Agjencitë Rajonale Mjedisore. Kjo do të kërkojë kapacitete në departamentet e ekspertëve dhe në drejtoritë e lejeve. Kërkesa për rritjen e numrit të ekspertëve janë shprehur dhe në sektorë të tjerë të strategjisë. Duhet marrë masa për dy nëpunës të tjerë në departamentin e lejeve.

## 5.4 Verifikimi dhe Inspektimi

Siç është përmendur dhe më parë, përgjegjësitë aktuale të inspektimit nuk do të ndryshojnë. Një verifikim i suksesshëm ka nevojë për një grup të kualifikuar inspektorësh të pajisur me instrumente për të marrë kampione dhe analizuar shkarkimet e lëndëve nga impiantet e kontrolluar, për të vlerësuar llojet e mbetjeve, për të përcaktuar zonën e mbrojtur dhe zhvillimin e biodiversitetit, për të bashkëpunuar me inspektoratë të tjerë mbi çështje të tilla si cilësia e karburanteve, shkarkimet nga automjetet dhe zhvillimet e reja në këto aspekte. Një nga nevojat e tyre thelbësore është mundësia për të pasur laboratorë apo pajisje analitike të përshtatshme, që do t'i jepnin atyre rezultatet e duhura të mbledhjes së kampioneve. Kjo nevojë trajtohet si këtu ashtu dhe në seksionin më poshtë që ka lidhje me monitorimin.

Ref.	Masat	Detyrat	Data	Përgjegjësia	
S4.1	Planifikimi i përmirësuar për verifikim dhe inspektim	S4.1.1	Rregulloret (mbi organizimin, funksionimin dhe përshtatjen e ARM-ve)	2007	MMPAU
		S4.1.2	Të hartohet një plan inspektimi dhe procedurash zbatimi bazuar në Rekomandimet (2001/331/KE) <sup>2</sup> për inspektimet e planifikuara ose jo të planifikuara të impianteve të kontrolluara.	2007	MMPAU ARM-të
		S4.1.3	Të përcaktohet numri minimal i inspektimeve për të gjithë kategoritë e impianteve të kontrolluar, bazuar në Manualin Shqiptar të Inspektimit Mjedisor	2007	MMPAU
		S4.1.4	Të implementohet plani i inspektimit paralelisht me prezantimin e procedurave të rishqyrtuara për dhënien e lejeve	2007	MMPAU, ARM-të
S4.2	Të standardizohet procesi i inspektimit	S4.2.1	Të rishqyrtohet udhëzuesi ekzistues mbi procedurat e inspektimit, në mënyrë që inspektorët të marrin parasysh ndryshimet në procedurat e dhënies së lejes dhe formatin e rishikuar të lejeve.	2008	MMPAU, ARM-të
		S4.2.2	Format raportues i standardizuar i verifikimit dhe të inspektimit	2008	MMPAU, ARM-të
		S4.2.3	Të krijohet një regjistër raportesh verifikimi dhe inspektimi si pjesë e SAIM	2009	MMPAU, ARM-të Pajisje IT
S4.3	Të fuqizohet kapaciteti veprues i inspektorëve aktualë të ARM-së	S4.3.1	Të sigurohen pajisjet bazë për të gjitha ARM-të duke përfshirë transportin, pajisjet mbrojtëse, pajisjet bazë të teknologjisë së informacionit	2008	MMPAU Kostot e pajisjeve
		S4.3.2	Të vlerësohen nevojat për trajnim të inspektorëve ekzistues dhe të rinj – duke përdorur si pika reference, Manualin Trajnues BERCECEN <sup>3</sup> për Inspektoratet Mjedisore në Europën Juglindore dhe Manualin Shqiptar për Inspektimet Mjedisore.	2007	MMPAU ARM-të
		S4.3.3	Të hartohet dhe implementohet Programi i Aktivizimit dhe Trajnimit në mënyrë që të gjithë inspektorët të marrin nivelin minimal të trajnimit siç specifikohet në manualin BERCECEN	2009	MMPAU ARM-të

<sup>2</sup> REKOMANDIMI I PARLAMENTIT EUROPIAN DHE I KESHILLIT I 4 prillit 2001 lidhur me minimumin e kriterëve për inspektimet mjedisore në Vendet Anëtare (2001/331/KE).

<sup>3</sup> Rrjeti Ballkanik për Ushtrimin dhe Përpunimin dhe Rregullores mbi Mjedisin (RrBUPPrM) (<http://www.rec.org/REC/Programs/REREP/BERCEN/>) tashmë është përfshirë në Rrjetin e Përpunimit dhe Detyrimit për zbatimin e ligjit Mjedisor për Aderim (RrUPMA): (<http://www.rec.org/REC/Programs/REREP/ECENA/Default.html>)

S4.4	Të prezantohet sistemi i monitorimit të auditimit të shkarkimit të lëndëve nga inspektorët për të kontrolluar rezultatet e vetë-monitoruara nga operatorët	S4.4.1	Të hartohet programi i monitorimit të auditimit duke përfshirë identifikimin e impianteve prioritare, parametrave, shpeshhtësisë së auditimit, nevojat për trajnim dhe pajisje	2007	MMPAU Projekti i Monitorimit CARDS
		S4.4.2	Sigurimi i pajisjeve kryesore portative për monitorim në terren dhe për mbledhjen e kampionëve për analiza laboratorike	2008-09	MMPAU ARM-të
		S4.4.3	Të sigurohet trajnim për inspektorë të zgjedhur të ARM-së	2008-09	Nevojitet asistencë teknike
		S4.4.4	Të nisë implementimi i monitorimit të auditimit	2009	

Përforcimi i 12 inspektorateve rajonale kërkohet me urgjencë. Aktualisht në të gjithë vendin ka vetëm 40 inspektorë dhe shumë prej tyre nuk kanë mjete transporti. Inspektoratet kanë nevojë të kenë personel të mjaftueshëm dhe masa zbatimi për të paraqitur një frenues të besueshëm ndaj krimit mjedisor. Niveli i burimeve të personelit që kërkohet të sigurojë një frenues të tillë është i vështirë të vlerësohet, meqenëse ai varet nga shkalla e respektit të ligjit. Krahasimi me numrin e personelit në organizatat e ngjashme në vendet që janë përfshirë në valën aktuale të futjes në BE, sugjeron se një numër minimum personeli prej 10 vetash për çdo rajon, është i përshtatshëm. Kjo do të kërkojë një rritje nga personeli aktual prej 40 vetash në 120 veta. Në periudhën afatshkurtër kjo nuk është e realizueshme, meqenëse një rritje e tillë do të shtojë kostot e personelit tre herë më shumë sesa niveli aktual. Për këtë arsye, propozohet që në fazën e parë të ndërmerret një shtojcë personeli prej 60 vetash. Megjithatë shtimi i numrit të personelit nuk do të jetë i mjaftueshëm. Do të kërkohen pajisjet shtojcë përfshirë automjete, kopjuterat dhe pajisje komunikimi. Kjo do të kërkojë shpenzime kapitale dhe operative shtojcë në vazhdimësi. Një vlerësim i përafërt i kostove totale për përforcimin e 12 njësjve rajonale, është paraqitur më poshtë:

**Tabela 5: Vlerësimet e Kostos për Përforcimin e Agjencive Rajonale të Mjedisit.**

Kategoria	Përfshirë	Totali
Shpenzime kapitale	Automjete, pajisje zyre, pajisje shëndetësore dhe sigurimi	90 milionë Lek
Shpenzime Operative Shtojcë (vjetore)	Pagat, karburanti, mirëmbajtja, administrata	30 milionë Lek

## 5.5 Aplikimi i masave detyruese dhe apelimet

Procesi i verifikimit jep informacion në lidhje me përputhshmërinë me ligjin dhe me kushtet e lëshimit të lejeve. Në rast mospërputhjeje duhet të ekzistojnë mjete efikase për ta korriguar këtë. Tek ushtrimi i masave ndëshkimore mund të futen gjokat, urdhër për ndërprerje të aktivitetit, mbyllje të detyruar të impiantit, afate kohore të negociuara për t'iu përmbajtur ligjit, dhe shtyje për përputhshmëri apo një kombinim të këtyre masave. Karakteristikë e përbashkët e tyre është që, të gjitha duhen parë në praktikë për të pasur efektin më të madh në sjelljen e ushtruesit të aktivitetit si dhe një efekt të veçantë në impiantin ndotës. Duhet të mundësohet si masat administrative ashtu dhe ato penale të zgjidhjes së problemeve.

Në vijim të praktikave të mira dhe në përputhje me Konventën e Aarhus-it, vendimet administrative do të jenë të hapura për apelim në mënyrë që të kemi një sistem transparent dhe të ndershëm. Vendimet këtu përfshijnë detyrimet për lejet si dhe masat ndëshkimore. Në përgjithësi procedurat administrative do të favorizohen në fushën e zbatimit të politikave duke qenë se ato janë më të thjeshta, më pak të kushtueshme dhe më të shpejta se procedurat gjyqësore. Megjithatë do të bëhen të mundur dhe apelimet pranë gjykatave për të zgjidhur çështje të veçanta ligjore.

Ref	Masat	Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjësia
S5.1	Të zbatohen masat ligjore të rishikuara lidhur me detyrim për zbatimin e ligjit.	S5.1.1	Të hartohen procedurat administrative për të ushtruar masat e duhura të detyrimit në kohë për të siguruar përputhjen me kushtet e reja të lejeve dhe pagesën e gjobave.	2008	MMPAU Kostot institucionale përfshirë në masat e mësipërme për stafin
		S5.1.2	Të ofrohet trajnim mbi masat e detyrimit përfshirë mbledhjen dhe paraqitjen e provave	2009	MMPAU Min. Brend. (Policia)
		S5.1.3	Të nisë implementimi i procedurave të përmirësuara të ushtrimit të masave përfshirë publikimin e politikave të detyrimit dhe të informacionit mbi procedurat e reja	2009	MMPAU Masat duhet të jenë vetë-financuese në kuptimin e arkëtimit të përmirësuar të gjobave dhe taksave – nevojitet një jurist i përthershëm
S5.2	Të implementohen dispozitat e rishikuara ligjore për procedurën e apeliemeve	S5.2.1	Të hartohen procedurat administrative për veprimet në proceset e apeliemeve	2008	MMPAU Kostot institucionale përfshirë në masat e mësipërme për stafin

Ref	Masat	Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjësia
S5.3	Të krijohet regjistri i ushtrimit të masave dhe apelimeve si pjesë e SAIM	S5.2.2	Të ofrohet trajnim mbi procedurat e apelimeve	2008	MMPAU
		S5.2.3	Të nisë implementimi i procedurave të apelimeve përfshirë publikimin e politikave të apelimeve dhe të informacionit mbi procedurat e reja	2009	MMPAU
		S5.3.1	Për tu përcaktuar	2012	MMPAU

Për momentin niveli i burimeve të disponueshme në Agjencitë Rajonale të Mjedisit është i pamjaftueshëm për të siguruar një detyrim efikas për zbatimin e ligjit. Fuqizimi i ARM-vë është trajtuar më sipër. Për më tepër nevojitet ekspertizë ligjore shtesë për të trajtuar këto çështje. Kërkohej të paktën një jurist i me kohë të plotë/i përherëshëm.

## 5.6 Përforcimi i sistemeve të monitorimit

Për të llogaritur efikasitetin e kontrolleve duhet të vlerësohen efektet e proceseve të përmirësuar të dhënies së lejeve, inspektimit dhe ushtrimit të legjislacionit të mjedisit. Kjo përfshin vlerësimin e rezultateve të monitorimit të çlirimit të gazeve, dhe ndikimin e këtyre çlirimeve në mjedis. Siç është trajtuar dhe më lart, monitorimi i çlirimeve të gazeve do të jetë një nga kërkesat kryesore të sistemit të lejeve të reja. Kjo do të japë të dhëna mbi presionin që ushtrohet në mjedis, por gjithashtu nevojitet një informacion më i mirë mbi gjendjen e mjedisit.

Të kuptuarit e evolucionit të mjedisit është me rëndësi, pavarësisht nga presioni i ushtruar nga veprimtari i ekonomike: gjithashtu ky zhvillim i përgjigjet ndryshimeve më të mëdha e të ngadalta edhe pse të thella, si ato që mendohet se lidhen për shembull, me ndryshimet klimatike që do të ndikojnë në kapacitetin e tokës për të rritur lloje të veçanta kulturash bujqësore. Këto zhvillime duhet të shënohen dhe të hidhen në harta në ndihmë të vendim-marrësve të cilëve mund t'u nevojitet të ndryshojnë ato standarde ose procedura me anë të të cilave do të zgjidhnin probleme të ndryshme dhe në ndihmë të publikut i cili me kushtetutë ka të drejtë të dijë se ç'po ndodh me mjedisin e tij.

Ref.	Masat	Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësitë
S6.1	Të hartohen procedurat standarde të monitorimit	S6.1.1	Procedurat e monitorimit të cilësisë së ajrit për t'u përdorur në rrjetin e riorganizuar të monitorimit dhe në laboratorë	2007	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.1.2	Procedurat e monitorimit të cilësisë së ujit për t'u përdorur në rrjetin e riorganizuar të monitorimit dhe në laboratorë	2007	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.1.3	Procedurat e monitorimit të tokës për t'u përdorur në rrjetin e riorganizuar të monitorimit dhe në laboratorë	2007	MMPAU, Min. Bujq., StEMA
		S6.1.4	Procedurat e monitorimit të biodiversitetit për t'u përdorur në rrjetin e riorganizuar të monitorimit dhe në laboratorë	2007	MMPAU, Min. Bujq.
S6.2	Të ndërmerret vëzhgimi bazë monitorues për të përcaktuar pikën e referencës për vlerësimin e rezultateve monitoruese në të ardhmen	S6.2.1	Vëzhgimi monitorues bazë i cilësisë së ajrit	2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.2.2	Vëzhgimi monitorues bazë i cilësisë së ujit	2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.2.3	Vëzhgimi monitorues bazë i cilësisë së tokës	2008	MMPAU, Min. Bujq., StEMA
		S6.2.4	Vëzhgimi monitorues bazë i biodiversitetit	2009	MMPAU, Min. Bujq.
S6.3	Të hartohet një rrjet i ri monitorimi	S6.3.1	Rrjeti monitorues i cilësisë së ajrit – për tu paraqitur në faza – Faza I	2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.3.2	Rrjeti monitorues i cilësisë së ujit – për tu paraqitur në faza – Faza I	2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.3.3	Rrjeti monitorues i cilësisë së tokës – për tu paraqitur në faza – Faza I	2008	MMPAU, Min. Bujq., StEMA
		S6.3.4	Specifikimet monitoruese të biodiversitetit – për tu paraqitur në faza – Faza I	2009	MMPAU, Min. Bujq.
S6.4	Të fuqizohet kapaciteti institucional që do të ndërmarrë monitorimin	S6.4.1	Të vlerësohen kapacitetet aktuale institucionale dhe laboratorike që do të monitorojnë dhe të hartohen programet e përmirësimit	2007	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.4.2	Të zbatohet riorganizimi institucional në përputhje me programin e përmirësimit	2007-2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.4.3	Të sigurohen pajisjet e nevojshme laboratorike sipas programit të përmirësimit	2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
		S6.4.4	Të sigurohet trajnim për përdorimin e pajisjeve dhe procedurave të reja (Shiko 6.1)	2008	MMPAU, Min. Shënd., StEMA

Ref.	Masat	Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësitë
		S6.4.5.	Të vihet në përdorim programi për akreditimin e laboratorëve që përdorin procedurat e reja në standarde ndërkombëtare	2009	MMPAU, Min. Shënd., StEMA
S6.5	Të krijohet dhe të plotësohet regjistri i problemeve mjedisore duke përfshirë regjistrin e çlirimit të gazeve ndotës	S6.5.1.	Të krijohet sistemi i informacionit mbi regjistrin e problemeve mjedisore bazuar në GIS si pjesë e SAIM-së duke përfshirë lidhjen me elemente të tjera të SAIM-së përfshirë bazën e të dhënave mbi dhënien e lejeve dhe të dhënat e vetë-monitorimit dhe inspektimit për impiantet e kontrolluara	2007	MMPAU, Projekti ELPA, StEMA
		S6.5.2	Hedhja e të dhënave për problemet që shkaktohen nga instalimet e kontrolluara nëpërmjet lidhjes me bazën e të dhënave të instalimeve të kontrolluara.	2007	MMPAU, Projekti ELPA, StEMA
		S6.5.3	Të përcaktohen protokollat për vlerësimin e problemeve që vijnë nga burime të tjera veç instalimeve të kontrolluara përfshirë burimet difuze dhe sigurimin e të dhënave nga ministritë respektive p.sh të dhëna mbi trafikun dhe automjetet nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit)	2008	MMPAU, StEMA
		S6.5.4	Të hidhen të dhënat mbi presionet që vijnë nga "burime të tjera" për të bërë vlerësimin total të presioneve të ushtruara mbi mjedisin nga të gjitha burimet	2008-09	MMPAU, StEMA
S6.6	Të ngrihet sistemi i mbështetjes për auditimin e monitorimit të ndërmarrë nga ARM-të	S6.6.1	Institucionet përkatëse përgjegjëse për monitorimin do të ofrojnë trajnimin, mbështetjen dhe shërbimet laboratorike në vazhdimësi për ARM-të si pjesë e masës së auditimit të monitorimit treguar në S4.4 më sipër	2008-2009	MMPAU, StEMA, Instituti i Monitorimit Mjedisor
S6.7	Të fuqizohet baza ligjore për mbledhjen dhe botimin e të dhënave mbi mjedisin	S6.7.1	Rregullore ("Mbi mbledhjen e të dhënave mbi gjendjen e mjedisit")	2007-2008	MMPAU, KM
		S6.7.2	Rregullore ("Mbi rregullat dhe procedurat për botimin e të dhënave mbi gjendjen e mjedisit".)	2007-2008	MMPAU, KM

Çështjet e burimeve të monitorimeve shtesë janë trajtuar në vlerësimet sektoriale specifike në Kapitullin 3.

## 5.7

### Investimet në infrastrukturën komunale dhe Fondi për Mjedisin

Niveli i investimeve që kërkohet për të arritur standardet e komunitetit Europian në infrastrukturën komunale në Shqipëri, është mjaft i rëndësishëm. Mund të llogaritet që vetëm investimi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza arrin rreth 1 miliard euro. Një investim me të tilla përmasa nuk mund të bëhet në periudhë afatshkurtyrë por do të duhen shumë vite për t'u vënë në zbatim. Përgjegjësia për shumë nga këto investime po u kalon autoriteteve vendore, atyre u nevojitet si mbështetja teknike ashtu edhe ajo financiare e pushtetit qendror dhe rajonal. Në mbështetje të autoriteteve vendore në hartimin e projekt-investimeve me kosto efektive, duhet të ndërmerren tre veprime kryesore:

- Krijimi i Fondit Shqiptar për Mjedisin;
- Krijimi i një njësie për implementimin dhe administrimin e projektit brenda strukturës së fondit; dhe
- Institucionalizimi i Shërbimit Këshillimor Teknik – Agjencia Rajonale e Mjedisit.

Projektet e hartuar nga autoritetet vendore do të shërbejnë si bazë e strategjive për investime në sektorët përkatës.

Në programin e saj qeveria është zotuar që të krijojë Fondin për Mjedisin. Të tillë fonde janë ngritur në shumë vende që kanë aderuar në BE dhe kanë dhënë rezultate në mbështetjen që i është dhënë investimeve të nevojshme në infrastrukturën komunale, veçanërisht në sektorin e furnizimit me ujë, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza dhe trajtimit të mbeqjeve të ngurta. Megjithatë vetëm krijimi i fondit nuk do të ishte i mjaftueshëm për të siguruar vijueshmërinë e investimeve të nevojshme. Kështu, në mënyrë që projektet e investimeve të hartohen dhe zbatohen ashtu si duhet, autoritetet vendore kanë nevojë për mbështetje teknike dhe administrative.

Rrjedha e ngjarjeve që parashikohet këtu është që autoritetet vendore të nxiten nga Fondi dhe Ministritë përkatëse për të hartuar projekt-identetë për infrastrukturën, që kërkohet sipas procesit të përshkruar në Kapitullin 4. Atyre do tu sigurohet asistencë teknike, e ofruar nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit dhe Ministritë përkatëse. Më pas autoritetet vendore do të aplikojnë në Fondin e Mjedisit. Nëse aplikimi pranohet, atëherë Njësia e implementimit dhe administrimit të projektit do të ndihmojë autoritetin vendor për përgatitjen e detajuar të projektit dhe do të administrojë zbatimin praktik tij.

Në shumicën e rasteve Ministritë përkatëse do të jenë:

- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT)
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
- Ministria e Brendshme

Përdorimi fillestar i fondit (deri në 2009) do të kufizohet në dhënien e mbështetjes për projekte të investimeve publike.



Ref.	Masat	Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësitë <sup>4</sup>
S7.1	Të vendoset baza ligjore dhe administrative për Fondin Shqiptar të Mjedisit	S7.1.1	Një legjislacion primar për të institucionalizuar fondin dhe aktet e nevojshme ligjore e nënligjore, përfshirë kushte dhe procedurat për marrjen e fondeve, shpërndarjen e tyre dhe bordin administrativ	2006	Këshilli i Ministrave Drejton MMPAU
		S7.1.2	Një legjislacion sekondar për të përcaktuar procedurat për marrjen e fondeve dhe shpërndarjen e tyre	2006	Këshilli i Ministrave Drejton MMPAU
		S7.1.3	Udhëzime nga ministritë që përcaktojnë funksionimin e detajuar të fondit përfshirë procedurat për aplikim, lehtësi në përdorimin e informacionit dhe auditimit nga publiku i gjerë	2007	Nën drejtimin e MMPAU-së
S7.2	Krijimi praktik i fondit	S7.2.1	Të sigurohet planifikimi dhe përcaktimi i buxhetit për funksionimin e fondit për periudhën 2007 – 2009	2006-07	KM
		S7.2.2	Emërimi i bordit administrativ	2006-07	KM
		S7.2.3	Të ngrihet fizikisht institucioni/zyra e fondit, përfshirë zyra dhe pajisje	2007	Bordi Administrativ, MMPAU
		S7.2.4	Të rekrutohet personeli	2007	Bordi Administrativ MMPAU
S7.3	Të ngrihet Njësia e Administrimit dhe Zbatimit të Projektit (NJAZP)	S7.2.5	Të trajnohet personeli	2007	MPPTT MMPAU
		S7.2.6	Të nisë funksionimi	Fundi 2007	Fondi për Mjedisin
		S7.3.1	Të sigurohet shpërndarja e buxhetit për funksionimin e NJAZP-së për periudhën 2008 – 2009	2007	Fondi për Mjedisin
		S7.3.2	Të ngrihet fizikisht NJAZP-ja përfshirë zyra dhe pajisje	2008	Fondi për Mjedisin
		S7.3.3	Të rekrutohet personeli	2008	Fondi për Mjedisin
		S7.3.4	Të trajnohet personeli	2008	Fondi për Mjedisin

<sup>4</sup> Në këtë kontekst kur i referohemi një Ministrie duhet të kuptohet gjithashtu dhe si referencë ndaj institucioneve teknike të cilat mbështesin ministrinë për sa i përket monitorimit. Për shembull kur i referohemi Ministrisë së Shëndetësisë duhet kuptuar dhe si referim ndaj Institutit të Shëndetit Publik.

Ref.	Masat	Ref.	Masat	Detyra	Data	Përgjegjësitë <sup>4</sup>
		S7.3.5	Të nisë funksionimi		2008	Fondi për Mjedisin
S7.4	Të ngrihet shërbimi këshillimor teknik brenda strukturës së Agjencisë Rajonale të Mjedisit	S7.4.1	Të shtohet një specialist shtesë, në personelin e çdo ARM-je, përgjegjës për t'i dhënë autoriteteve vendore këshilla teknike		2007	MMPAU ARM-të
		S7.4.2	Të trajnohen Këshilltarët Teknikë		2007	MMPAU MPPTT ARM-të
		S7.4.3	Instalimi praktik i Shërbimit Këshillimor Teknik përfshirë masat për komunikim e koordinim me MPPTT-në dhe autoritetet rajonale		2007	MMPAU MPPTT ARM-të

Nisur nga disponueshmëria e financimit të donatorëve, do të zbatohet një projekt i Asistencës Teknike për të ndihmuar në krijimin e fondit dhe në Zyrë për Administrimin dhe Zbatimin e Projektit.<sup>5</sup> Është parashikuar që projekti i ndihmës teknike të ketë një vlerë prej përafërsisht 350 000 Eurosh dhe që do të zgjasë rreth 18 muaj. Për sigurimin e materialeve të trajnimit për të gjithë personelin përkatës, përfshirë dhe materialet udhëzuese të përgatitur nga të gjithë organizatat kryesore të donatorëve përfshirë dhe Bankën Botërore dhe BERZH, do të përdoren burimet ekzistuese. Një referim i veçantë duhet bërë për Manualin për Financimin Mjedisor botuar nga Komisioni Europian (2004 – Komisioni Europian – [http://europa.eu.int/comm/environment/funding/pdf/handbook\\_funding.pdf](http://europa.eu.int/comm/environment/funding/pdf/handbook_funding.pdf)). Përforcimi i Agjencive Rajonale Mjedisore është trajtuar më sipër.

Krijimi i Fondit të Mjedisit dhe i Njësisë së Zbatimit dhe Administrimit të Projektit, kërkojnë shpenzime të mëdha operative. Në fazën e parë propozohet të krijohet një fond i përbërë nga një personel funksional prej 20 vetash:

- Drejtori
- 4 punonjës mbështetës të administratës
- 13 punonjës të projektit – një për secilin rajon (dhe 2 për Tiranën).
- 2 punonjës për lidhjet me donatorët

<sup>5</sup> Një projekt i ngjashëm u zbatua kohët e fundit në Bosnje-Hercegovinë – asistencë teknike për krijimin e një Fondi të Mjedisit, Referencë: EuropeAid/117171/C/SER/BA, Budget EUR: 320 000

Njësia e Zbatimit dhe Administrimit të Projektit dhe do të krijohet gradualisht mbi bazën e njësisve në grup prej 4 personash. (drejtuesi i grupit, 2 ekspertë, 1 asistent teknik dhe administrativ). Fillimisht propozohet të krijohet një njësi e vogël bërthamë prej 4 personash, e përbërë nga një Menaxher me përvojë, 2 ekspertë dhe një administrator. Kjo ka nevojë të financohet nga buxheti publik, ndërsa grupet e personelit prej 4 vetash do të financohen nga shpenzimet e projektit. Kostot e parashikuara janë si më poshtë:

	Shpenzimet Kapitale (Lek)	Shpenzimet Operative (Lek)
Fondi i Mjedisit	Kostot e krijimit – ambientet, kompjuterët, funksionet bazë	10 milionë
Fondi i Mjedisit	Kostot operative vjetore, shpenzimet e personelit	14 milionë
Administrimi i Projektit dhe Njësia e Zbatimit	Kostot e krijimit – ambientet, kompjuterët, funksionet bazë	2.5 milionë
Administrimi i Projektit dhe Njësia e Zbatimit	Kostot operative vjetore, shpenzimet e personelit	2.8 milionë

### 5.8 Administrimi dhe monitorimi

Shumë nga masat e shqyrtuara në nënseksionet e mësipërme kanë të bëjnë me një sërë institucionesh. Për më tepër shumë nga masat teknike të identifikuar më poshtë kanë nevojë për bashkëpunimin ndër-institucional. Ky bashkëpunim duhet të administrohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Për të siguruar këtë do të përcaktohet me statut Komisioni i Mjedisit. Kjo çështje është me rëndësi të madhe dhe trajtohet më me hollësi në Kapitullin 6.

Ecuria e zbatimit të kësaj strategjie duhet të monitorohet dhe raportohet në mënyrë që të administrohet siç duhet. Edhe kjo trajtohet me hollësi në Kapitullin 6.

Ref.	Masat	Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësitë
S8.1	Të ngrihet Komisioni i Mjedisit dhe strukturat përkatëse	S8.1.1	Të parashtrohet baza statusore-ligjore për Komisionin e Mjedisit, i cili do të përbëhet nga ministria dhe zv/ministra, mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave mjedisore në organet qeveritare	2007	MMPAU KM
		S8.1.2	Të përcaktohen rregullat procedurale për funksionimin e Komisionit të Mjedisit	2007	MMPAU, KM
		S8.1.3	Të krijohet sekretariati në MMPAU dhe të nisë funksionimi i Komisionit të Mjedisit	2007	Të gjitha ministratë, MMPAU
S8.2	Të fuqizohet sistemi i raportimit	S8.2.1	Të përcaktohen treguesit kryesorë të ecurisë së zbatimit të kësaj strategjie në periudhë afatshkurtër	2006	MMPAU Projekti ELPA
		S8.2.2	Të standardizohet formati dhe rrjedhja e informacionit për raportimin e administrimit	2006- 2007	MMPAU Projekti ELPA
		S8.2.3	Të zbatohet sistemi i rishikuar i raportimit të administrimit përfshirë raportimin pranë Komisionit të Mjedisit	2007	MMPAU
		S8.2.4	Rregullore për komunikimin ndërmjet autoriteteve publike të mjedisit dhe organizatave të specializuara të mjedisit		MMPAU

### 5.9 Administrimi i Informacionit

Administrimi efikas i informacionit është me mjaft rëndësi për funksionimin e çdo organizate të madhe. Masat për krijimin e Sistemit të Administrimit të Informacionit Mjedisor (SAIM) janë marrë tashmë nën projektin ELPA. Në seksionet e mëparshme të kësaj strategjie janë propozuar një sërë zhvillimesh të këtij sistemi sipas fushave specifike. Në qoftë se ky informacion nuk është i disponueshëm për përdorim nga institucionet e administrimit mjedisor, institucionet e tjerë të administratës shtetërore dhe aktorë të tjerë, ai nuk do të japë maksimumin e tij. Informimi është vetëm një pjesë e asaj që duhet bërë për të ndërgjegjësuar dhe përfshirë popullsinë në çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin. Një komunikim efikas është me shumë rëndësi.

Ref.	Masat	Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësia
S9.1	Sistemi i Administrimit të Informacionit Mjedisor – afat-shkurtër	S9.1.1	Të ngrihet një SAIM bazë në MMPAU duke përfshirë sistemet e përditësimit përmes institutëve bashkëpunuese (marrëveshjet për nivelin e shërbimit).	2006	MMPAU, ELPA Institutet Bashkëpunuese
		S9.1.2	Komponentët ligjorë të SAIM, duke përfshirë sistemin e administrimit të lejeve.	2007	MMPAU
		S9.1.3	Elementet e SAIM në lidhje me inspektimin, verifikimin dhe detyrimin për zbatimin e ligjitin.	2009	MMPAU, ARM-të
		S9.1.4	Monitorimi i cilësisë së ajrit – sistem i rishikuar për përshtatjen e masave të reja të monitorimit - Shiko CA1.	2008	MMPAU
		S9.1.5	Administrimi i mbetjeve të rrezikshme – kombinim i informacionit dhe regjistrimit – shiko MU4.2.	2008	MMPAU
		S9.1.6	Administrimi i Mbetjeve të Ngurta (jo të rrezikshme) – Sistemi Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve.	2010	MMPAU
		S9.1.7	Administrimi i Burimeve Ujore – sistem i rishikuar për përshtatjen e masave të reja të monitorimit shiko CA1.	2008	MMPAU
		S9.1.8	Përbërësit e tokës– Shiko MT4.2	2009	MMPAU
		S9.1.9	Biodiversiteti – Shiko B3.3	2008	MMPAU
		S9.1.10	Baza e të dhënave për Pikat e Nxehta– Shiko DM4.1	2009	MMPAU
		S9.1.11	Regjistri i tokave të ndotura – Shiko DM4.2	2012	MMPAU
S9.2	Sistemi i Administrimit të Informacionit Mjedisor – afatmesëm	S9.2.1	Rishikim i fazës së parë të zbatimit të SAIM, përfshirë zhvillimin e strategjisë dhe të planit të zbatimit për fazën tjetër.	2010	MMPAU
		S9.2.2	Zhvillimi i aftësive bazë të modelimit mjedisor për të ndihmuar në analizimin e trysnive, ndikimeve dhe gjendjes së lejeve, përfshirë modelimin e cilësisë së ajrit dhe në mbështetje me zhvillimin e planeve për administrimin e shtratit të lumenjve.	2011	MMPAU
		S9.2.3	Zbatim i fazës së dytë të zhvillimit të SAIM, përfshirë prezantime të hartave interaktive GIS dhe e drejta e pasjes së informacionit vendor mbi të dhënat mjedisore.	2011- 2014	MMPAU

Implikimet burimore të proceseve të mbledhjes së informacionit dhe monitorimi mjedisor të përshkruara këtu, trajtohen kryesisht në masat specifike nënsektoriale dhe në përf forcimin e institutëve vepruese (Agjencië Rajonale të Mjedisit, Administratat e Zonave të Mbrojtura, Autoritetet e Baseneve të Lumenjve). Megjithatë, administrimi i informacionit në Ministri duhet të përforcohet me emërimin e dy punonjësve teknikë që do të merren me administrimin e informacionit dhe prezantimin e tij në njësinë e teknologjisë së informacionit. Ky personel është shtesë e personelit që kërkohet për të funksionuar dhe mirëmbajtur shërbimet e rregullta të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ministri (rrjetin e kompiuterave, ndihmën për zyra apo departamente të veçanta, etj.).

Projekti ELPA ka përgatitur një Strategji Komunikimi e cila do të miratohet. Këtu janë paraqitur elementët kryesorë të kësaj strategjie.

#### Përmbledhje e Strategjisë së Komunikimit

Strategjia e Komunikimit ilustron mënyrën sesi duke administruar komunikimin me efikasitet, MMPAU mund të plotësojë “Zotimin për Komunikimin Mjedisor” në programin e Qeverisë Shqiptare dhe t’iu shërbejë nevojave të komunikimit të Ministrisë gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë Kombëtare Mjedisore. Futja kohët e fundit e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, kërkon të përfshijë shumë prej rekomandimeve të Strategjisë së Komunikimit, kur mbahet parasysh se dy dokumentet nuk janë të lidhur në mënyrë shumë të përshtatshme. Strategjia trajton tre sektorë kryesorë:

#### 5.10.1 Administrimi i Komunikimit

Është shumë e rëndësishme të theksojmë që, me qëllim që procesi i komunikimit të fillojë dhe të mirëmbahet, një pjesë e buxhetit të MMPAU duhet t’i alokohet Sektorit të Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit. Vetëm në këtë mënyrë ky sektor do të jetë vërtetë në gjendje t’iu shërbejë të gjithë organeve qeveritare me informacion mjedisor që iu nevojitet, të koordinojnë informacionin nga nivelet vertikale dhe horizontale, të komunikojë informacion mjedisor dhe po ashtu të komunikojë me aktorët dhe publikun. Nevoja për shpenzime kapitale për mjetet bazë të komunikimit për Sektorin e Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit, siç janë linjë telefonike e drejtë për drejtë, printera etj. duhet trajtuar urgjentisht.

Strategjia ilustron se ka nevojë për **përshkrimet e punëve të reja** dhe se niveli aktual i personelit prej tre nëpunësish duhet të rritet gradualisht për t’u marrë me administrimin e përgjegjësi të reja të komunikimit. Duhet shfrytëzuar mjetet bazë për administrimin e komunikimit siç janë **takimet** në të gjithë nivelet. Projekti ELPA ka ndihmuar MMPAU të hartojë një bazë të dhënash me mbi 700 aktorë mjedisorë, i cili përbën **Rrjetin e Komunikimit Mjedisor**. Ky rrjet mund të përdoret së bashku me Rrjetin Lokal ekzistues të Komunikimit dhe intranetin e ri që po futet nga qeveria (fillimisht brenda Ministrive dhe më pas në nivele të tjera të qeverisë) për të transmetuar informacionin tek aktorët ose grupet e aktorëve. **“Koncepti i Shërbimeve”** është futur dhe hollësi për atë sesa mirë mund të realizohet shërbimi ndaj klientëve për të gjithë aktorët, përfshirë dhe publikun e gjërë, gjë që eventualisht do të çojë në futjen e një **karte të shërbimeve ndaj klientëve** dhe **objektivat e performancës së shërbimit ndaj klientëve**. Po ashtu, trajtohet edhe mënyra sesi MMPAU mund të administrojë futjen e ndryshimeve dhe krizave që mund të ndodhin.

## 5.10.2 Komunikimi i Politikës Mjedisore

Sistemi i Planifikimit të Integruar miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave 692 10.11.2005 dhe që tani po zbatohet, propozon dy procese për të organizuar aktivitetin e qeverisë:

- Një proces kombëtar afatmesëm deri afatgjatë për planifikimin strategjik, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) e cila përcakton prioritetet dhe synimet strategjike; dhe
- Një proces afatmesëm buxhetor, programi buxhetor afatmesëm (PBAM) i cili kërkon që çdo Ministri të hartojë një plan tre vjeçar brenda një tavanit shpenzimesh për të arritur objektivat e veta politike në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

SKZHI do të krijojë mbi një strukturë gjithëpërfshirëse të **strategjisë së sektorëve** dhe do të drejtohet nga një strukturë e përzgjedhur e **strategjive të ndërthurura**. Mjedisin është tashmë subjekt si i një strategjie sektoriale, ashtu dhe një strategji ndër-sektoriale.

SKZHI është një instrument madhor, i ri për hartimin e politikave të Qeverisë së Shqipërisë, e cila duhet të rrisë ndjeshëm zbatimin e politikës në nivel Ministrie. Ajo kërkon një komunikim ndërmënyor dhe bashkëpunim dhe konsultim të vazhdueshëm me aktorët gjatë krijimit të çdo strategjie.

SKZHI vërteton parimin e përcaktuar në Strategjinë e Komunikimit që:

- Komunikimi i politikave duhet konsideruar si pjesë e politikës.
- Komunikimi duhet realizuar nga të gjitha palët e përfshira në hartimin e politikës, ndërsa Personelit të Komunikimit duhet t'i përcaktohen taktikat e komunikimit.
- **Për çdo departament dhe sektor** në MMPAU duhet rënë dakord për **objektivat e politikave të periudhës afatshkurtër dhe afatgjatë**.
- Sigurimi i informacionit mjedisor dhe konsultimet e rregullta me aktorët kyç konsolidohet nga krijimi i një Komiteti Ndër-Sektorial, i një Grupi Këshillimor Ndër-Sektorial dhe një Grupi Pune të Asistencës së Jashtme nën drejtimin e SKZHI.
- Personeli i komunikimit duhet të përpilojë **mesazhet kyç** për politikën e Ministrisë dhe reformën e ligjit dhe rregulloret mjedisore.
- Personeli i komunikimit duhet të organizojë **fushatat specifike për objektivat afatshkurtra** dhe angazhimet ndërkombëtare siç është zbatimi i konventës Aarhus
- **Media** duhet shfrytëzuar në maksimum në nivelet kombëtare dhe vendore.
- **Trajnimi i aftësive të komunikimit** duhet të vazhdojë, si për personelin e MMPAU ashtu edhe për autoritetet vendore dhe OJQ-të, përgjigjes për komunikimin e informacionit mjedisor.

## Konsultimi

- Personeli i komunikimit duhet të mundësojë detyrimet e MMPAU për t'u konsultuar me aktorët e tjerë- pjesë e SKZHI dhe në procesin e **përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE**.
- Sektori të Komunikimit i duhen dhënë burimet për të organizuar të gjitha detyrimet konsultative. Vendimmarrësit e MMPAU duhet të punojnë ngushtë me Drejtorin e Sektorit të Komunikimeve që të sigurohen që konsultimet me aktorët të bëhen një praktikë e rregullt.
- Sektori i Komunikimeve duhet të punojë ngushtë me Qendrat e Informacionit Mjedisor pranë autoriteteve vendore për të organizuar konsultime publike në të gjithë Shqipërinë.
- Personeli autoritetit vendor duhet të bëjë trajnim të aftësive të komunikimit, në të cilin përfshihet mënyra sesi do të drejtohen ushtrimet e konsultimit publik për VNM dhe Kontrollin dhe Integruar i Parandalimit të Ndotjes (KIPN), etj.

### 5.10.3 Detyrat e Komunikimit dhe Informacionit Mjedisor

- “Mesazhet Kryesore” duhen përsëritur gjatë gjithë kohës në media duke ua bërë ato të njohur aktorëve dhe publikut.
- Sigurimi i dhe transmetimi i informacionit të formatuar që i nevojitet Komisionit Europian, Agjencisë Europiane të Mjedisit, EUROSTAT, OECD, UNECE, UNFCCC dhe të tjerë që kërkojnë raporte të rregullta dhe statistika për çështje të ndryshme mjedisore dhe ato që kanë lidhje me to.
- Katalogim i të gjithë informacioneve që aktualisht mbahen në Ministri të ndara sipas subjektit dhe tipit që të jenë lehtësisht të disponueshme.
- Përpilim dhe krijim i informacionit që nevojitet dhe kërkohet për audiencat të caktuara – Ministrinë e Linjës, Institutet, ARM-të, Këshillat Rajonale, Bashkitë; Komunitat, Media, Aktorët Kyç dhe Publiku i Përgjithshëm. Pyetjet që bëhen më shpesh, duken publikuar në faqen e internetit
- Përpunim i të dhënave nga monitorimi mjedisor në **formate të kuptueshme për përdoruesit**. Projekti ELPA ka krijuar tashmë një sistem SAIM për Ministrinë, që i vendosur në Ministri, do të japë në harta diagramën e të dhënave mjedisore, përpiluar nga Institutet monitoruese, në mënyrë që të kuptohet lehtësisht nga të gjithë.
- Të hartojë dhe të shpërndajë informacionin mbi të drejtat e qytetarëve për informacionin mjedisor në bazë të ligjit kombëtar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, veçanërisht Konventës së Aarhusit<sup>4</sup>.
- Botimin e **procedurave të ankesave** të disponueshme në bazë të ligjit shqiptar për çdo qytetar. Sektori i Komunikimeve të lehtësojë mjetet, nëpërmjet të të cilëve ankesat mund të përpunohen me efikasitet.



### Shpërndarja e informacionit me anë të:

- Përgatitja e artikujve shkencorë që mund të përdoren në nivel kombëtar dhe vendor.
- Përgatitja e njoftimeve me fakte dhe e fletëpalosjeve që ilustronin mesazhet kryesore për temat specifike.
- Përgatitja e informacioneve mediatike për mesazhe kryesore për aktorët në nivel kombëtar dhe vendor – drejtimet që duhen marrë.
- Intervistat mediatike për aktorët kyç për temat specifike.
- Konferenca shtypi të cilat mund të lokalizohen.
- Pjesëmarrje e aktorëve kyç në programet mediatike
- Prezantimi i “Faqeve me Lajme të Rregullta mbi Mjedisin” duke filluar nga Ministria deri në nivele më të ulëta si Bashkitë dhe Komunitatet.
- Botim i të dhënave mjedisore – shembuj nga informacioni i cilësisë së ajrit ose të ujit për t’u larë për gazetatat vendore dhe radion.
- Udhëzime dhe Seminare

### Grumbullim Informacioni nga:

- Organizimi i studimeve të shpejta dhe në zona të kufizuara;
- Organizimi i Grupeve Fokale;
- Organizimi i grupeve të punës me aktorët kryesorë;
- Mbledhja e mendimeve me sondazhe.

### Faqja e Internetit, Help Line (Seksioni i Ndhmës) dhe Pyetje dhe Përgjigje:

- Riorganizim dhe pasurimi i faqes së Internetit të MMPAU - lehtësim nëpërmjet Helpline dhe mbështetja e nevojshme, ‘Pyetjet më të shpeshta’ të disponueshme nga subjekti, biblioteka elektronike për ligjet, raporte, rregullore, broshura, tabela faktesh të ndara sipas subjektit dhe një seksion lajmesh.
- Futja e një linje telefonike falas dhe mbështetja e nevojshme.
- Publikim i të gjitha detajeve të kontaktit të Ministrisë në Tiranë, ARM<sup>ve</sup>, instituteve, autoriteteve vendore dhe OJF-ve mjedisore.

Komunikim i informacionit në shkallë vendore:

Tirana, si shumë kryeqytete të tjera në këtë rajon, është më e përparuar se sa pjesa tjetër e vendit në shumë aspekte, përfshirë ndërgjegjësimin dhe iniciativat mjedisore dhe personeli i komunikimit duhet të trajtojë këtë gjendje në mënyrë proaktive, duke bërë çdo përpjekje për t’u ofruar **komunikime dhe shërbime gjithë qytetarëve shqiptarë:**

- Ligjet dhe rregulloret mjedisore duhen hedhur në SAIM dhe CD dhe t'iu shpërndahen autoriteteve vendore..
- Duhet ngritur në të gjitha Këshillat e Qarqeve, Bashkive dhe Komunave, që aktualisht nuk e kanë këtë lehtësi, Pikat e Informacionit.
- Personeli i komunikimit duhet të shërbejë në këto pika informacioni duke i furnizuar ato me informacion mjedisor. Personeli i komunikimit duhet të ndihmojë autoritetet vendore t'iu përgjigjen pyetjeve nga biznesi dhe publiku, gjë që nuk mund të trajtohet në shkallë vendore.
- Pikat e Informacionit duhet të punojnë me personelin e komunikimit duke informuar departamentin e informacionit për temat që kërkohen më shpesh, kështu që mund të përgatiten faqe me njoftime, që mund të shpërndahen në këto zona.

### Memorandumi i Mirëkuptimit (MM) me OSBE-në.

Zhvillimi i informacionit dhe administrimi i komunikimit për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Aarhus<sup>it</sup>, do të forcohet më tej nëpërmjet MM, nënshkruar në gusht 2006 nga MMPAU dhe OSBE. Ky memorandum parashikon një bashkëpunim dyvjeçar dhe mbështetje të drejtë për drejtë nëpërmjet asistencës teknike dhe logjistike për përf forcimin e kapaciteteve të informacionit në MMPAU. Prania e OSBE në Shqipëri, do të mbështesë personelin e informacionit dhe do të zgjerojë veprimtaritë e informacionit mjedisor në qarqe të tjera të vendit, duke synuar kështu të ndihmojë MMPAU të sigurojë më shumë informacion për publikun, lidhur me problemet dhe veprimtaritë mjedisore që kanë një ndikim negative mbi mjedisin si dhe të arrijë një pjesëmarrje më të gjerë të publikut në vendimmarrjen për çështjet mjedisore.

### S10.1 Masat Afatshkurtra për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit

Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësia	Veprimet dhe Burimet
S10.1.1	Fillim i Zbatimit të rekomandimeve për Strategjinë e Komunikimit, përgatitur nga projekti ELPA në lidhje me kërkesat e SKZHI dhe masat afatshkurtra të marrat për të ngritur gradualisht kapacitetet e komunikimit të MMPAU	2006	MMPAU ELPA	
S10.1.2	Krijimi i mekanizmave, me anë të të cilave qeveria mund të konsultohet me gjithë aktorët kyç për politikën dhe zhvillimin e ligjit.	Nga 2007	MMPAU	Takime të Rregullta Konsultative dhe komunikimi me aktorët. Zhvillimi i ushtrimeve konsultative rajonale në mbarë vendin. 500,000 Lekë në vit.
S10.1.3	Zhvillimi i mekanizmave për të mundësuar MMPAU të komunikojë në mënyrë efektive me ministrinë e linjës, agjencitë rajonale, qarqet, bashkitë dhe komunat – shih gjithashtu S 1.2. mbi integrimin.	2008		MMPAU konsultim për gjithë politikën e propozuara duke drejtuar grupet fokale 120,000 Lekë për ushtrim
S10.1.4	Zhvillim i kapaciteteve të Sektorit të Komunikimit për të mundësuar shpërndarjen e informacionit mjedisor nga organet qeveritare që zbatojnë ligjin mjedisor dhe bien në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe median.	Nga 2007		Kjo do të kërkojë takime të rregullta në të gjitha nivelet. 12 takime në vit 120,000 Lekë në vit
S10.1.5	Organizimi i një Fushate të madhe Mjedisore në prill të çdo viti, për politikën mjedisore më të rëndësishme të vitit.	2007		Nëse MMPAU duhet të komunikojë, ajo duhet pajisur për një gjë të tillë. IT dhe Sektori i Komunikimit nuk ka linjë telefonike dhe nuk ka pajisje komunikimi dhe riprodhuese. Komunikimet bazë duhen instaluar urgjentisht. . Linjë Telefonike 20 000 Lekë, Fotokopje 200 000 Lekë Faks 30 000 Lekë, Printer lazer 100 000 Lekë
		2010		Kapacitete riprodhimi 2 milionë Lekë për printime të cilësisë mesatare dhe pajisje fotokopimi
		Nga 2007		Duhen përfshirë spote radiofonike dhe televizive dhe debate Televizive si dhe artikuj e intervista për median. 1 milionë Lekë në vit

Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësia	Veprimet dhe Burimet
S10.1.6	Krijimi i mekanizmave për shkëmbim informacioni me gjithë organet qeveritare, paralel me krijimin e intranetit qeveritar.	Nga 2007	MMPAU Ministritë përkatëse	Këtu çelësi i suksesit është modernizimi i ministrisë dhe procedurave ndërmarrëse. Lidhja me Internet me Broadband (Internet të shpejtë) 55 000 Lekë në vit Përditësim/mirëmbajtje e Faqes së Internetit: 10 000 Lekë në vit
S10.1.7	Përforcimi i burimeve njerëzore të MMPAU, IT dhe Sektorit të komunikimeve në masë të tillë sa për të siguruar kapacitet të mjaftueshëm për të zbatuar Strategjinë në mënyrë efektive për shprehje trajnimin e personelit në aftësitë e komunikimit (shih gjithashtu edhe seksionin institucional)	Nga 2008	MMPAU	Duhet ngritur një drejtori komunikimi (personel prej 6 vetash) përfshirë: Një drejtor/kryemenaxher; Dy specialistë komunikimi për të administruar komunikimin me rajonet Një organizues fushatash/ aktivitetesh Një nëpunës shtypi Një nëpunës trajnimi Projekti i ri i OSBE do të vazhdojë më tej trajnimin mbi aftësitë e komunikimit, siç është theksuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me MMPAU (financuar nga OSBE)
S10.1.8	Ngritja e një sistemi për marrjen e të dhënave nga publiku – zhvillim i mekanizmave në nivel ministrie dhe lokal për marrjen e të dhënave nga publiku që të përpunohen shpejt dhe me efikasitet	2008	MMPAU ARM Autoritetet vendore Autoritetet rajonale	Fillimisht duhet filluar një proces për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve me shkrim 150 000 Lekë Meqenëse më shumë njerëz kanë mundësi akses në Internet, kur intraneti të jetë instaluar pranë qarqeve dhe bashkive, ky proces do të bëhet më i lehtë, por duhen siguruar burimet njerëzore për ta administruar këtë sistem. Përfundimisht duhet të ketë një linjë telefonike falas të përkushtuar, për t'iu përgjigjur pyetjeve gjatë orarit zyrtar.
S10.1.9	Pika shërbimi të informacionit në çdo autoritet vendor dhe Qendra e Informacionit Mjedisor me një gamë të gjerë informacioni mjedisor lehtësisht i gjindshëm për audiencën të ndryshme.	Nga 2008	MMPAU ARM Autoritetet vendore e rajonale	Kostot vjetore Fletëpalosje 100,000 – 500 000 Lekë, Fletët e informacionit 50,000 – 200 000 Lekë, Konferenca shtypi kombëtare dhe rajonale dhe paketa Shtypi me Informacioni; 3000 paketa – 250 000 Lekë, CD me lajme për politikën dhe legjisllacionin, CD me informacione konsultimi - 2000 CD – 120 000 Lekë

Kostot e përgjithshme (përfshirë edhe personelin) për vendosjen dhe drejtimin e një Drejtorie të Komunikimeve siç është përmbledhur më poshtë:

Ref	Përshkrimi	Shpenz. Op. (Lekë)	Shpenz. Kap. (Lekë)
S10.1.2	Konsultime	500 000	
S10.1.2	Grupe Fokusi 4 në vit	480,000	
S10.1.3	Takime Koordinimi	120,000	
S10.1.4	Pajisjet Bazë		350,000
S10.1.4	Pajisjet e Riprodhimit		2,000,000
S10.1.5	Media	1,000,000	
S10.1.6	Interneti	65,000	
S10.1.8	Sistemi i Marrjes së të dhënave nga Publiku		150,000
S10.1.9	Publikimet	1,070,000	
	Gjithsej (Përjashto personelin)	3,235,000	2,500,000

#### S10.2 Zbatim i Strategjisë së Komunikimit – Masat Afatmesme

Ref.	Detyra	Data	Përgjegjësia	Veprimet dhe Burimet
S10.4.1	Adoptimi i një “Karte Shërbimi për Klientët” nga MMPAU	2009	MMPAU	Trajnim Fushatë e Vazhdueshme Komunikimi 100 000 Lekë fillimisht
S10.4.2	Paraqitja e Objektivave të Performancës Mjedisore Vjetore të Komunikimeve	2009	MMPAU	Trajnim
S10.4.3	Paraqitja e Kartave të Shërbimeve të Klientëve dhe Treguesit e Performancës Mjedisore për agjencitë rajonale, qarqet, bashkitë dhe komunat.	2010	MMPAU Autoritetet vendore e rajonale	Trajnim Fushatë e Vazhdueshme Komunikimi 100 000 Lekë fillimisht
S10.4.4	Zhvillimi i kapaciteteve për të trajnuar personelin në qarqe dhe bashkive për zbatimin e legjisllacionit dhe rregulloreve të reja mjedisore	2010	MMPAU Autoritetet vendore e rajonale	Trajnim i bashkisë dhe personelit për të organizuar ushtrime konsultimi publik për EIA, IPPC etj. Veç kësaj trajnim për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe planifikim i veprimit mjedisor vendor, ndër kohë që po përshpejtohet decentralizimi – (shih seksionin institucional) Fletë faktesh dhe broshura për aspekte të ndryshme të këtyre proceseve 250 000 Lekë në vit

### 5.11 Arsimit dhe Trajnimet pa shkëputje nga puna

Në nivel para-universitar prioriteti është që Administrimi i Mjedisit të shtohet si një lëndë më vete dhe të trajnohen mësuesit për të dhënë mësim për çështjet e administrimit të mjedisit. Në nivel universitar, duhen futur kurse të reja të specializuara për lëndë të tilla si planifikimi hapsinor e urban, dhe shëndeti e siguria. Për të plotësuar këto kurse dhe kapacitetin e universiteteve bujqësore, duhen futur Modulet e Trajnimit Profesional për Edukimin Mjedisor dhe kapaciteti i universiteteve bujqësore duhet të rritet (shtohet) duke regjistruar më shumë se 17 studentë çdo vit për kurset e masterit – për të përballuar nevojat e tregut të punës. Trajnimi pa shkëputje nga puna duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë punonjësit civilë dhe punonjësit e kontraktuar të shërbimit publik. Kjo deri tani ka qenë e kufizuar për punonjësit civilë në trajnimin e dhënë nga donatorët.

Klasat e ciklit fillor ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për të ngritur ndërgjegjen mjedisore dhe të kuptuarit midis fëmijëve dhe promovuar këto veprime. Objektivat e të mësuarit që kanë lidhje me mjedisin, janë futur kohët e fundit në përputhje me Nenin 29 të konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve. Vitin e kaluar Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përcaktuar dy orë në javë për të trajtuar temat jashtë kurrikulave, nga të cilat një është për mjedisin. Vetë fëmijët janë të hapur për idetë dhe veprimet e reja dhe mund të ushtrojnë një ndikim pozitiv mbi familjet dhe komunitetet e tyre. Duke u nisur nga fakti që fëmijët përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë së Shqipërisë, është jetike për zhvillimin e qëndrueshëm që ndërgjegjësimi mjedisor, kuptimi dhe aftësitë për të vepruar tek fëmijët të përmirësohen. Strategjia Kombëtare e MASH parashikon gjithashtu që orët e çështjeve mjedisore të hyjnë në kurrikulën bazë në vitet pasuese. Testi pilot i një shkalle të vogël për të përmirësuar metodologjinë për krijimin e një teknike arsimore mjedisore dhe për kurrikulat nga klasa e parë deri në të pestën si rritja e kapacitetit të mësuesve për ta trajtuar këtë kurrikul, ka nevojë të zhvillohet dhe të forcohet.

Ref.	Detyrat	Data	Përgjegjës	Veprimet dhe Burimet
S11.1	Përmirësimi i materialeve të edukimit mjedisor në përputhje me kurrikulën arsimore dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të gjithë ofruesve të arsimit– Faza I	2009	MMPAU Ministria e Arsimit Universiteti i Tiranës	Në vitin 2006 përpara përfundimit të paraqitjes së projektit dhe shpërndarjes së SKM në të gjitha shollat dhe Universitet Materiale – 2000, 100 faqe manuale trajnimi mbi mjedisin për mësuesit, kapak të fortë dhe CD 500 000 LEKE Trajnime - për të gjithë mësuesit në lidhje me Çështje të Mjedisit në shkollën e trajnimeve të Institutit Pedagogjik Komunikimi 1000 Euro në vit në vazhdimësi.
S11.2	Paketë e plotë e moduleve mjedisore, përfshirë trajnimin e mësuesve, modulet e sektorëve dhe projektet vendore brenda komunitetit të miratuar nga qeveria dhe të trajtuara në shkollë. Disponueshmëria dhe nisja e kurseve të mjedisit në Universitete	2011	MMPAU Ministria e Arsimit	Materiale – Modulet për të gjitha nivelet p.sh. Module mbi Ajrin, Ujin, Biodiversitetin, Mbetjet dhe Planifikimin të hartuara për të dy nivelet para-universitare. Kursat universitare për Administrimin e Mjedisit dhe Kontrollin e Ndojtes Kurse të Arsimit Profesional dhe kurse të Specializuara në Planifikim Urban dhe Hapësinor, Shëndeti dhe Siguria, Monitorimi dhe Inspektimi etj. Përlllogaritja për çdo modul: Sesionet e Trajnimit – 250 000 LEKE Komunikimet – 65 000 LEKE

S11.3	Zhvillimi i kurseve modulare për trajnimet pa shkëputje nga puna të personelit të pushteti qendror dhe vendor në fushat e: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikimit të Administrimit të Mbejeve</li> <li>- Administrimi i Ujërave</li> <li>- Vlerësimi Strategjik i Mjedisit</li> </ul>	2007-08	MMPAU MPÇSSH Ministria e Arsimit	Kurset duhet të zhvillohen së bashku me MMPAU dhe MoLSA?????. Kostoja e përlogaritur për zhvillimin e kurseve është: 150.000 LEK për modul 1.000.000 LEKE kosto vjetore për zbatimin e kursit
S11.4	Krijimi dhe botimi i udhëzuesit të shkollave fillore, libri i punë së nxënësit dhe çantat për mjedisin.	2007-2010	MASH	Kostot fillestare për programin e zhvillimit nga klasa 1 – 5 për të gjitha shkollat e Shqipërisë. 1,600,000 Euro
S11.5	Trajnimi i mësuesve	2007-2010	MASH	3,000,000 Euro
S11.6	Fonde embrionale për projektet mjedisore të ndërmarra nga shkollat dhe komunitetet.	2007-2010	MASH MMPAU, ARM-të	2,000,000 Euro
S11.7	Avokatia dhe kostot e komunikimeve	2007-2010	MASH	500,000 Euro
S11.8	Asistencë Teknike	2007-2010		300,000Euro
S11.9	Kostot operative në vit		MASH	Gjithsej Kostot Kapitale Fillestare 7,400,000 Euro Trajnimi i mësuesve të rinj, monitorim, përgatitja e materialeve dhe pajisjeve të reja, meqenëse në shkollë hyjnë fëmijë të rinj: 1,500,000 Euro në vit.

### 5.12 Kapaciteti Institucional, nevojat për personel

Masat dhe detyrat, të cilat janë identifikuar në nën-seksionet e mësipërme kërkojnë burime të konsiderueshme, në mënyrë të veçantë personel teknik dhe administrativ brenda institucioneve qeveritare. Që kjo strategji të ketë efekt real, është e rëndësishme të kemi edhe një personel të mjaftueshëm për të ndërmarrë detyrat e administrimit të mjedisit të përcaktuara më lart. Më sipër janë përkthuar masat në lidhje me kapacitetin institucional, në mënyrë që të përcaktohet niveli i burimeve të nevojshme. Duhet të kihet mirë parasysh se nivelet e sakta të nevojave për personel dhe aftësi do të varen nga vendimet në lidhje me shpërndarjen e përgjegjësiave midis institucioneve të ndryshme dhe niveleve të administrimit. Ky është një proces që përsëritet.

Shumica e përgjegjësiave të identifikuara i takojnë MMPAU dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit. Megjithatë, edhe Ministrinë dhe Institucionet e tjera do të jenë të përfshira dhe nevojat e tyre për burime do të merren gjithashtu në konsideratë.

Qëllimi kryesor i ndryshimeve strukturore dhe i personelit të përcaktuara në tabelën e mëparshme është mundësimi i zbatimit të detyrave të administrimit të mjedisit, të nevojshme për të zbatuar legjislationin në praktikë.

Ref.	Masat	Detyrat	Data	Përgjegjës	
S12.1	Krijimi i strukturës më të përshtatshme institucionale për administrimin e mjedisit në periudha afatshkurtra (3 vite)	S12.1.1 S12.1.2	Rishikimi i mundësive për institucionet e administrimit të mjedisit, përfshi ri-organizimin institucional dhe ndryshimet e bëra në institucion. Dërgimi i propozimit të rishikuar dhe financimin për miratim nga ana e qeverisë	2006 2007	MMPAU MMPAU
S12.2	Forcimi i Kapacitetit në MMPAU për të ndërmarrë programe afatshkurtra	S12.2.1 S12.2.2 S12.2.3	Miratimi i strukturës së preferuar dhe vendosja e marrëdhënieve të punës Zgjerimi i njësive të dhënies së lejeve në MMPAU në mënyrë që të ndërmerret masa dhe detyra për lejet e përmendura më sipër Forcimi i departamenteve teknike; kontrolli i ndotjes; biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura Zgjerimi i departamenti ligjor për të trajtuar transpozimin, zbatimin dhe çështjet e apelimeve	2007-09 2007 2007 2007-08	MMPAU MMPAU MMPAU MMPAU
S12.3	Rritja e kapacitetit të Agjencive Rajonale të Mjedisit	S12.2.4 S12.3.1	Zgjerimi i departamentit të komunikimeve për të siguruar një zbatim efektiv të disponueshmërisë dhe shpërndarjes së informacionit mbi mjedisin Punësimi dhe trajnimi i një inspektori shtesë për çdo Agjenci Rajonale të Mjedisit për të ndihmuar inspektorët ekzistues në prezantimin e inspektimit të rishikuar dhe procedurave të raportimit	2007-08	MMPAU ARM-të
		S12.3.2	Punësimi dhe trajnimi i një këshilltari teknik për çdo Agjenci Rajonale të Mjedisit për t'u ofruar mbështetje autoriteteve vendore në identifikimin e projektit	2008-09	MMPAU ARM-të
		S12.3.3	Sigurimi që çdo Agjenci Rajonale e Mjedisit është e pajisur me nevojat bazë të burimeve përfshi për çdo Agjenci dy automjete, dy kompjutera, hapësirë të mjaftueshme zyre dhe telekomunikacioni, pajisje sigurie dhe pajisje monitorimi	2008	MMPAU
S12.4	Krijimi i Fondit të Mjedisit dhe Njësive të Zbatimit të Projektit	S12.4.1	Krijimi i administratës së Fondit të Mjedisit	2007-09	MMPAU, MF, MPPTT, Min. Brend. , METE
S12.5	Rritja e kapacitetit në Agjencinë për Pyjet dhe Mjedisin	S12.5.1	Punësimi i ekspertëve të tjerë (shtesë) për të kryer monitorimin e biodiversitetit dhe mbrojtjen e natyrës dhe dhënien e këshillave të ekspertit të politikës	2007-09	MMPAU
S12.6	Rritja e kapacitetit në Administratat e Zonave të Mbrojtura	12.5.1	Punësimi dhe trajnimi i punonjësve (oficerëve) të tjerë për të punuar në administratat e zonave të mbrojtura	2007-09	MMPAU
S12.5	Krijimi i kapacitetit institucional të nevojshëm për të plotësuar tërësisht detyrimet e <i>acquis</i> dhe angazhimet e tjera ligjore	S12.5.1	Kryerja e vlerësimit të nevojave institucionale në periudha afat-gjata	2009	Kontratë Vendore për Asistencë Teknike
		S12.5.2	Paraqitja tek qeveria të propozimeve për zhvillim afatgjatë të administrimit të mjedisit në Shqipëri	2009	MMPAU



**Efektet e Burimeve të Personelit– rritja e numrit të personelit në periudhën afat-shkurtër (deri në vitin 2009) përfshirë ndryshimet e përcaktuara në PKPL**

Sektori	Drejtoria	2007	2008	2009	Totali
<b>Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave – Personeli Qendror</b>					
Horizontal	VNM dhe Lejet	2	2		4
Ajri	Parandalimi Ndoftjes	2			2
Administrimi i Ujërave	Parandalimi Ndoftjes	2	2	2	6
Administrimi i Ujërave	Uji	2	1		3
Mbrojta e Natyrës	Mbrojtja e Mjedisit			2	2
Mbrojta e Natyrës	Parandalimi Ndoftjes – KIPN	2			2
Kimikatet	Parandalimi Ndoftjes	2		1	3
Zhurmat	Parandalimi Ndoftjes			1	1
Ndryshimi i Klimës	Parandalimi Ndoftjes	7			7
Emergjencat	Emergjencat Civile		2	1	3
Zbatimi	Komunikimet dhe Arsimi	2	1	1	4
Zbatimi	Administrimi i Informacionit dhe Prezantimi		2		2
Zbatimi	Ligjor	2	2		4
	<b>Shuma</b>	<b>23</b>	<b>12</b>	<b>7</b>	<b>43</b>
<b>Personeli i Institucione Mbështetëse dhe Rajonale</b>					
Inspektimi	Agjencitë Rajonale të Mjedisit	6	7	7	20
Biodiversiteti	Administratat e Zonave të Mbrojtura	8	2	2	12
Biodiversiteti	Agjencia për Pyjet dhe Mjedisin		5	5	10
Investimet	Fondi i Mjedisit	10	10		20
Administrimi i Projektit	Administrimi i Projektit dhe Njësia e Zbatimit		4		4
Administrimi i Ujërave	Autoritetet e Baseneve të Lumenjve		5	5	10
	<b>Shuma</b>				<b>76</b>
	<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>				<b>119</b>

### 5.13 Implikimet Burimore dhe Financimi

Implikimet e përgjithshme burimore të Strategjisë duhet të merren në konsideratë të lidhur me llojet e ndryshme të kostove përbërëse:

- Kostot kapitale për forcimin e administratës shtetërore, fushata dhe kostot “unike”;
- Kostot operative (jo të personelit) për forcimin e administratës shtetërore;
- Kostot e rritjes së numrit të personelit për forcimin e administratës shtetërore;
- Kostot kapitale për përmirësimin e infrastrukturës të përbashkët dhe riparimi i dëmeve të mjedisit;

Këto kosto duhet të merren gjithashtu në konsideratë në termat se cili institucion ose sektor mban përgjegjësinë.

Përmbledhja e të gjitha implikimeve të strategjisë gjatë periudhës 2007 – 2009 të llogaritur në seksionet e tjera të strategjisë tregon:

Kategoria e Kostos	Vlerësuar (million Lek)	Koment
Kostot kapitale për forcimin e administratës shtetërore përfshijnë pajisje, asistencë teknike për krijimin e strukturave të përmirësuara institucionale dhe kostot “unike”	980	Totali për periudhën 2007–2009
Kostot (jo për personelin) për forcimin e funksionimit e administratës qendrore shtetërore, përfshi institucionet aktive në fushën e mjedisit	25	Shpenzim vjetor
Kostot e rritjes së numrit të personelit për forcimin e administratës qendrore shtetërore, përfshirë institucionet aktive në fushën e mjedisit	57	Shpenzim vjetor
Kostot kapitale për përmirësimin e infrastrukturës së përbashkët	18 772	Shpenzuar gjatë periudhës 2007 - 2009

Kostot operative do të kërkojnë një rritje prej 9% të buxhetit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Një rritje e tillë është parashikuar për të ardhmen; megjithatë, kjo rritje aplikohet për të gjitha funksionet e Ministrisë. Si e tillë Ministria ka marrë një vendim politik për t’i dhënë fushës së mjedisit 50% të rritjeve të tavanit të shpenzimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme.

Kostot Kapitale për forcimin e administratës shtetërore përfshi pajisjet, asistencën teknike për krijimin e strukturave të përmirësuara institucionale dhe kostot “unike” janë thelbësore dhe nuk mund të realizohen vetëm nëpërmjet akordimeve ekzistuese të shpenzimeve publike. Për rrjedhojë, për këto veprime do të kërkohet asistencë e donatorëve.

Megjithatë, deri tani elementi më i madh i kostos janë nevojat e investimit në infrastrukturën e përbashkët. Nevojat kryesore të investimi janë:

- Furnizimi me ujë të pijshëm – i besueshëm, i mjaftueshëm dhe i një cilësie të garantuar;
- Mbledhja e Ujërave të zeza– kanalizime në të gjitha qytetet me popullsi më të madhe se 20 000 banorë;
- Trajtimi i Ujërave të zeza – trajtim sekondar i Ujërave të zeza të mbledhura në të gjitha qytetet;

- Mbetjet e ngurta – mbledhja, riciklimi dhe largim/hedhje (groposje dhe djegie);
- Zonat e Ndotura – korrigjim i “pikave të nxehta”;
- Përmirësim teknologjik për industrinë në pronësi shtetërore.

Për të trajtuar këto çështje nevojitet një program afatgjatë i investimeve në sektorin publik.

### **Burimet e Financimit**

Burimet e mundshme të financimit për një program të tillë përfshijnë:

- Financimi i pushteti qendror nga buxheti– Ministria e PPTT, MMPAU, Ministria e Brendshme;
- Financimi i pushteti vendor nga buxheti;
- Financimi i pushteti vendor nga të ardhurat e shërbimeve (p.sh tarifat e ujit dhe mbetjeve të ngurta);
- Të ardhurat nga tarifat, pagesat dhe gjrobat në zbatimin e legjislacionit për mjedisin;
- Grantet apo donacionet nga donatorë ndërkombëtarë;
- Donacione ndërkombëtare ose financime me hua bankare;

Programi i shpenzimeve kapitale të pushteti qendror për infrastrukturën administrohet nga MMPAU. Shpenzimet në vitin 2006 janë pak më shumë se 10 miliardë Lekë. Nga kjo shumë rreth 5% janë shpenzuar për rrugë dhe 62% për transportin në tërësi. 23% janë shpenzuar për ujin e pijshëm. Më pak se 4%, afërsisht 380 milion Lekë janë shpenzuar për “higjenë publike” (kombinim i Administrimit të Ujërave të zeza e mbetjeve të ngurta).

Gjatë viteve të fundit, financimet e pushtetit vendor janë rritur nëpërmjet procesit të decentralizimit. Megjithatë, përqindja aktuale e të ardhurave të pushtetit vendor të shpenzuara për higjenë publike është relativisht e ulët. Tarifat aktuale për shërbimet komunale të ujit kontrollohen nga Enti Rregullator i Ujit. Në përgjithësi, niveli i tarifës së vendosur synon të paktën të mbulojë kostot operative, por nuk lejon mundësi për të ardhura të konsiderueshme me të cilat të rinovohet apo të përmirësohet infrastruktura. Situata në sektorin e administrimit të mbetjeve paraqitet e njëjtë.

Të ardhurat nga tarifat dhe pagesat mjedisore aktualisht kalohen në buxhetin qendror dhe nuk fokusohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në shpenzime për mjedisin.

Donatorët ndërkombëtar kanë ofruar grante të konsiderueshme në fushën e mjedisit. Shumë prej projekteve të financuara nga këto grante kanë planifikuar për të rritur kapacitetin e Qeverisë dhe të popullatës për të zbatuar administrimin e mjedisit. Një numër grantesh janë dhënë gjithashtu për të financuar zhvillimin e infrastrukturës, kryesisht nëpërmjet Bashkimit Europian dhe Fondit Global për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, niveli i financimit nga grantet që do të jetë i disponueshëm për infrastrukturën në periudha afatshkurtra deri në periudha afatmesme është ende i paqartë dhe do të varet nga niveli i financimeve të qeverisë dhe aftësisë për të marrë hua nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare.

Gjatë shqyrtimit të implikimeve të kësaj strategjie janë marrë në konsideratë një numër skenarësh të përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Skenarët marrin në konsideratë kontributin nga tre burime Pushteti Qendror, Pushteti Vendor dhe Donatorët. Në të jepet shuma totale e parashikuar për të shpenzuar deri në vitin 2014, si dhe është llogaritur viti në të cilin do të arrihet objektivi për një investimi total prej 1 miliardë Eurosh.

### Skenarët për financimin e investimit

	<b>Pushteti Qendror</b>	<b>Pushteti Vendor</b>	<b>Donatorët</b>	<b>Deri në vitin 2014</b>	<b>1 miliard €</b>
1	3 milion €/vit, 6% rritje/vit	Zero	20 milion €/vit, 3% rritje/vit	238 milion €	2032
2	3 milion €/vit, 18%, 10%, 10% rritje fillestare, 6% rritje/vit	1 milion €/vit, 6% rritje/vit	20 milion €/vit, 3% rritje në vit	255 milion €	2031
3	3 milion €/vit, 18%, 10%, 10% rritje fillestare, 10% rritje/vit	1 milion €/vit, 10% rritje/vit	€ 20m në vit, 6% rritje në vit	285 milion €	2026
4	7.5 milion €/vit, 18%, 10%, 10% rritje fillestare, 5% rritje/vit	1.5 milion €/vit, 10% rritje/vit	€ 20m në vit, 6% rritje në vit	360 milion €	2024
5	7.5 milion €/vit, 18%, 10%, 10% rritje fillestare, 5% rritje/vit	1.5 milion €/vit 10% rritje/vit	25 milion €/vit, 0% rritje/vit deri në 2017 – më pas 60% donatorët: 40% kapital vendas	323 milion €	2027

Në të gjithë këta skenarë, ekziston një besim/mbështetje e fortë në financimet nga donatorët. Në mungesë të financimit nga donatorët, përmbushja e objektivit të investimit prej 1 miliardë Eurosh brenda një afati kohor prej 20 vjetësh, duke supozuar se skenari optimist i rritjes për tavanin e shpenzimeve vazhdon (6% rritje në vit), do të kërkojë që afërsisht 2.4% të shpenzimeve totale publike të drejtohen në investime për higjienën publike gjatë 20 viteve të ardhshme.

Kjo do të bëjë që niveli i investime të jetë i krahasueshëm me atë për rrjetin rrugor, i cili aktualisht zë afërsisht 3.5% të tavanit të shpenzimeve (5.5 miliardë Lek = 45 milion €/vit). Ky nivel i shpenzimeve në investimet e higjienës publike nuk është i mundur në periudhën afatshkurter. Pra, duhet të gjendet një skenar realist që të kërkojë një angazhim të fortë por të përballueshëm nga ana e Qeverisë dhe një nivel realist të mbështetjes nga ana e donatorëve të huaj.

Nga skenarët hipotetik, 1- 3 përfshijnë rritje të vogla të angazhimit nga ana e Qeverisë dhe rritje të vazhdueshme në financimet nga donatorët. Ndoshta këto nuk janë realiste për faktin se donatorët ka shumë të ngjarë të mos vazhdojnë të rrisin kontributet e tyre pa pasur një angazhim të njëjtë nga ana e Qeverisë. Kështu, skenarët 4 dhe 5 janë më tepër realistë. Kjo do të përfshijë një angazhim nga ana e Qeverisë për të rritur pjesën e të ardhurave që do të shpenzohen në investimet për higjienën publike nga niveli aktual prej 0.24% në afërsisht 0.6% (është fakt se shpenzimet aktuale për furnizimin me ujë të pijshëm zënë 1.5% të shpenzimeve totale), pa marrë në konsideratë shlyerjet e borxhit, të cilat janë potencialisht të mëdha.

Skenari 5 synon të marrë në konsideratë mundësinë e anëtarësimit në vitin 2017. Financimet nga donatorët përpara kësaj periudhe do të dominohen nga hua, ndonëse me marrjen e statusit të “shtetit në anëtarësim”, shqiptarët do të kenë akses në fondet e para-anëtarësimit në Bashkimin Europian nëpërmjet Instrumentit të Para-Anëtarësimit (Instrument for Pre Accession (IPA)). Me anëtarësimin në BE pritet që të mund të merret një shumë e konsiderueshme e financimeve të grantit nëpërmjet strukturave të mbështetjes së Bashkimit Europian, të tillë si Fondet Strukturore dhe të Kohezionit.

Niveli i financimit të granteve është i vështirë që të parashikohet, megjithatë, është supozuar se financimi nga grantet për këto investime mund të mbahet në nivelet e mëposhtme:

Periudha	Granti vjetor	Burime
2007 – 2010	5 milion Euro	IPA, GEF, Donatorë bilateralë
2011 – 2017	10 milion Euro	IPA, GEF, Donatorë bilateralë
2018 – 2027	15 milion Euro	Fondet e BE-së, GEF, Donatorë bilateralë

Edhe duke marrë këto supozime si të vërtetë, përsëri do të duhet një shumë e konsiderueshme financimi për shlyerjen e borxhit, në mënyrë që shuma prej 400 milion Eurosh të shlyhet gjatë periudhës së programit të investimit (2007 – 2027). Shlyerja e këtyre borxheve do të vendosë gjithashtu një barrë të konsiderueshme për buxhetin e Qeverisë, e cila kërkon shpenzime në shërbimin e borxhit i cili do të rritet me kalimin e kohës deri në afërsisht 10 – 15 milion Euro në vit dhe të vazhdojë në këtë nivel për 10-20 vjet pas përfundimit të programit. Ndërkohë kjo do të shkaktojë një tension të konsiderueshëm në shpenzimet publike pasi Qeveria ka vendosur që këto investime janë të nevojshme dhe për rrjedhojë është angazhuar që të rrisë shpenzimet vjetore të investimeve për mjedisin, duke përfshirë ujin e pijshëm, nëpërmjet Fondit të Mjedisit, deri në 0.6% të tavanit të shpenzimeve publike, në periudhën 2007 – 2009.



## 6 Koordinimi, Monitorimi dhe Raportimi

Ky dokument përmban veçse fjalë, por mjedisi, ekonomia dhe shëndeti i popullatës do të kenë përfitim, vetëm nëse këto fjalë kthehen në vepra. Në këtë kapitull jepen tre elementët bazë që e bëjnë të mundur një gjë të tillë:

### Koordinimi i politikave dhe veprimeve tona

Të nënvlerësosh rëndësinë e një zhvillimi të qëndrueshëm, ta shikosh mjedisin si një çështje që i përket vetëm ambientalistëve, të mos e pranosh përgjegjësinë që kemi ne të gjithë ndaj gjendjes ku ndodhet ajri, uji dhe toka, të gjitha këto janë gabime të rënda, për të cilët brezat që do të vijnë do të paguajnë një çmim të lartë.

Mjedisi është një çështje që i përket të gjithëve në këtë vend; të gjithë ne duhet të bëjmë pjesën që na takon për administrimin e mjedisit dhe realizimin e objektivave të kësaj strategjie. Ashtu si duhet ta bëjë pjesën që i takon secili prej nesh, po ashtu duhet të veprojë edhe çdo institucion dhe organizëm që gëzon besimin tonë demokratik - përkatësisht institucionet qeveritare. Për të siguruar efektshmërinë e këtij veprimi, institucionet tona duhet t'i koordinojnë politikat e tyre me veprimet në mënyrë që ligji, administrimi dhe investimet tona të jenë koherentë dhe efikasë.

### Monitorimi i zbatimit apo vënjes në jetë të strategjisë

Pjesa më e madhe e veprimeve që identifikohen në këtë strategji janë ndërmarrë kohët e fundit, ose po ndërmerren në shtetet anëtare të reja të BE-së, shtetet aderuese dhe shtetet candidate. Ne mund të mësojmë shumë nga përvoja e tyre. Megjithatë, nuk ka dy vende njësoj, kështu që shumë probleme duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që t'u përgjigjen specifikave të secilit vend. Nuk mund të jemi të sigurt se veprimet e kryera me sukses diku tjetër do të kenë të njejtin sukses edhe në vendin tonë. Prandaj, është e domosdoshme që të monitorohet progresi i arritur dhe efektshmëria e masave të ndërmarra.

Ky monitorim i zbatimit përbëhet nga tre elementë:

- Efikasiteti i zbatimit – monitorim i punës së kryer: a ishin të sakta llogaritjet e bëra për koston?
- Efikasiteti i këtyre veprimeve – monitorim i respektimit të ligjit: a çuan masat tona shtrënguese në respektim të ligjit?
- Identifikimi i nevojave të reja – t'u përgjigjesh ndryshimeve: a po sjellin zhvillimet e paparashikuara probleme të reja të cilave duhet t'u jepet zgjidhje?

Vetëm duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve do të kuptojmë nëse jemi në rrugën e duhur.

### Raportimi i ecurisë tonë

Kjo strategji është dokument publik. Ajo përbën një zotim solemn që ka marrë qeveria ndaj popullit shqiptar. Por nuk do të ketë sukses, nëse qeveria vepron e vetme. Bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe aktorëve të tjerë jo-qeveritarë është thelbësor. Qeveria do të drejtojë duke dhënë shembullin e para; ajo do të publikojë dhe shpjegojë veprimet e saj për t'i treguar publikut angazhimin e saj dhe për ta nxitur e mbështetur publikun që të kontribuojë për zbatimin e kësaj strategjie.

Ecuria do t'i raportohet gjithashtu direkt partnerëve tanë donatorë dhe Komisionit Europian, në mënyrë që të mbahen të informuar lidhur me efikasitetin e mbështetjes së tyre dhe nevojat që mund të kemi në të ardhmen.

## 6.1 Koordinimi

Shumë prej masave, që duhet të merren për zbatimin e kësaj strategjie, përfshijnë punën e një varg ministrish dhe institucioneve mbështetëse. Për shembull, për të siguruar ruajtjen e biodiversitetit duhet të merren masa kryesisht nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, por gjithashtu kërkohet edhe mbështetja e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe institucioneve të tyre mbështetëse. Administrimi i mbetjeve urbane është përgjegjësi e pushtetit vendor, por ata do të kenë nevojë si për ndihmën e Autoriteteve Rajonale ashtu edhe të institucioneve qendrore duke përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe Fondit të Mjedisit.

Këto janë vetëm dy shembuj, të shkëputur nga shumë të tjerë. Ndihet qartë nevoja për bashkëpunim ndërministror dhe ndër-institucional për zbatimin e kësaj strategjie dhe arritjen e dy objektivave kryesore të saj që janë: *Një zhvillim i Qëndrueshëm* dhe *Pranimi në Bashkimin Europian*. Ky koordinim dhe bashkëpunim duhet të realizohet si në nivel lokal, ashtu edhe në atë nivele të larta të hierarkisë zyrtare.

Bashkëpunimi ndër-institucional, aktualisht është i organizuar mbi bazën e grupeve të punës *ad hoc* (me përfaqësues nga institucione të ndryshme) për përgatitjen e Projekt-Ligjeve ose Strategjive, Komitetet Drejtuese të Projekteve, Komitetet Ndër-ministore, sikurse është Komiteti për Zbatimin e Planit të Veprimit për Mjedisin, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dhe të Biodiversitetit, Komiteti i Politikave të Zhvillimit të Turizmit, Komiteti Ndër-ministror i Energjisë, Komisioni Shtetëror i Tokës, Grupi i Koordinimit për Degradimin dhe Shkretëtirizimin e Tokës, etj.

Meqenëse kjo Strategji Kombëtare i kalon kufijtë e Planit Kombëtar të Veprimit në Mjedis (PKVM), dhe në kuadrin e përmirësimeve që i janë bërë strukturave organizative të ministrive, synimi ynë është që konstituimi i grupeve ndër-ministore ekzistuese të punës për PKVM të pushojnë së ekzistuari, dhe një Komision i Mjedisit, të krijohet rishtas, bazuar në Komitetin Ndërministror për Mjedisin, i cili u krijua në vitin 2006, me detyrën e përgatitjes së Startegjisë për Zhvillim dhe Integrim. Kjo do të kërkojë rishikimin e Vendimit Nr. 42, dt. 16.1.2003 të KM mbi: "Krijimin e Komitetit ndër-sektorial për realizimin e Planit Kombëtar të Veprimit në Mjedis".

Komisioni i Mjedisit do të merret me bashkërendimin e punës në nivelet më të larta të strukturave vendim-marrëse të qeverisë. Megjithatë, bashkëpunimi veprues në nivel ekspertësh, ka nevojë të rritet e të forcohet. Prandaj, në çdo ministri, do të duhet të krijohen Njësitë e Administrimit të Mjedisit. Këto njësi, do të variojnë në madhësi dhe në numër, në përputhje me nivelin e përgjegjësive dhe kompetencave për çështjet mjedisore që zotëron dhe gëzon çdo ministri.

Këto masa do të kërkojnë mbështetje ligjore, sikurse është referuar në PKPL;

- Mbi krijimin e Komisionit Mjedisor;
- Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave mjedisore në institucionet qeveritare.

### 6.1.1 Komisioni Mjedisor

Komisioni Mjedisor do të formohet me statut dhe do të ketë rregullat e veta proceduriale të përcaktuara me akte nënligjore. Karakteristikat bazë të Komisionit Mjedisor do të jenë si vijon:

- Pozicioni i kryetarit të Komisionit do të merret përsipër nga Kryeministri, i cili mund t'ia delegojë këtë rol zëvendëskryeministrit;



- Çdo ministër do të jetë Anëtar i Komisionit;
- Ministrat mund t'ia delegojnë të drejtën për të marrë pjesë në takimet e Komisionit një zëvendësministri në ministrinë e tyre në rast se e shohin të nevojshme;
- Komisioni do të mbështetet nga një sekretariat që administrohet nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- Komisioni do të jetë përgjegjës në mënyrë kolegjiale për të mundësuar dhe siguruar zbatimin e kësaj strategjie;
- Duke qenë se Strategjia Kombëtare për Mjedisin përfshin akte legislative, të cilët kërkohen në zbatim të Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit si dhe masat që kërkohen të merren për zbatimin e këtij legjislacioni, Komisioni do të veprojë me efikasitet si autoriteti drejtues për përmbushjen e detyrimeve të Anëtarësimit në Bashkimin Europian në lidhje me Kapitullin mbi Mjedisin të *acquis-it*.

Komisioni Mjedisor është krijuar në mënyrë që të jetë forca shtytëse dhe drejtuese për zbatimin e kësaj strategjie. Ndërkohë që ky Komision nuk duhet në asnjë mënyrë të pengojë punën apo të ndërhyjë në kompetencat e ministrive të veçanta, nga ana tjetër duhet të lejojë që barra e zbatimit të ndahet me të tjerë dhe të kihet parasysh realizimi i niveleve të dëshiruara të efikasitetit. Në mënyrë të veçantë, Komisionit do t'i jepet e drejta e krijimit të Grupeve të Posaçme Ndërministrore të Punës, të cilët do të mbështesin Komisionin dhe ministrat kur ndërmarrin detyra që përbëjnë shqetësim dhe janë brenda kompetencës ligjore të më shumë se një ministrie. Ministrat do të kenë gjithashtu edhe mbështetjen e Njësive të Mjedisit dhe Ekspertëve Mjedisorë brenda ministrive të tyre.

### 6.1.2 Grupet e Posaçme Ndërministrore

Qëllimi i krijimit të grupeve të posaçme ndërministrore është që të sigurohet një zbatim efikas dhe i koordinuar i masave dhe detyrave të identifikuar në këtë Strategji. Grupet e Posaçme të Punës do të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- Grupet e Posaçme Ndërministrore do të krijohen për t'u marrë me zbatimin e masave të identifikuar në këtë strategji, të cilat kërkojnë veprimin, ekspertizën dhe angazhimin e më shumë se një ministrie dhe/ose institucioni ndihmës;
- Grupet e Posaçme të Punës do t'u nënshtrohen Termave të saktë të Referencës të nxjerra nga kjo Strategji dhe nga Kapitulli mbi Mjedisin në Planin Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit;
- Termet e Referencës do të specifikojnë produktet e punës së grupeve të posaçme të punës dhe afatet që duhen respektuar prej tyre;
- Pranimi nga ana e Komisionit të Mjedisit, e produkteve të përfunduara në përputhje me Termet e Referencës së Grupit të Posaçëm të Punës, shënon edhe fundin e misionit të grupit dhe shkrijen e tij;
- Anëtarët e një Grupi të Posaçëm Pune do të emërohen nga anëtarët e Komisionit;
- Çdo anëtar Komisioni do të ketë të drejtë të emërojë një anëtar të një Grupi të Posaçëm Pune, por nuk është i detyruar ta bëjë një gjë të tillë, nëse detyra që do kryhet nuk futet në kompetencat e tij ligjore;
- Drejtuesi i çdo Grupi të Posaçëm Pune do të emërohet nga Kryetari i Komisionit, pasi është konsultuar me ministrant, fusha e kompetencave ligjore të të cilëve përfshihet në këtë mes;
- Numri i Grupeve të Posaçme të Punës në funksionim, në çfarëdo kohe nuk do të jetë më i madh se numri i Anëtarëve të Komisionit;

- Drejtuesi i çdo Grupi të Posaçëm Pune do të jetë përgjegjës për raportimin para Komisionit në kohën e përcaktuar në Termat e Referencës.

### 6.1.3 Njësitë Mjedisore dhe Ekspertët Mjedisorë

Edhe pse MMPAU është ministria kryesore që përgjigjet për administrimin e mjedisit, përgjegjësi po kaq të mëdha bien dhe ndahen edhe në shumë ministri të tjera. Për t'u siguruar se, çdo gjë që është marrë përsipër të kryhet në këtë Strategji, do të zbatohet plotësisht dhe në mënyrë të koordinuar, në çdo ministri do të krijohet një Njësi Mjedisore. Çdo Njësi Mjedisore do të drejtohet nga një Ekspert Mjedisori i cili do t'i raportojë drejtpërsëdrejti Ministrin përkatës ose Sekretarin të Përgjithshëm.

Qëllimi kryesor i çdo Njësie Mjedisore do të jetë mbështetja e zbatimit të masave dhe detyrave të parashtruara në këtë Strategji, brenda ministrive të tyre, nëpërmjet këshillimit me drejtoritë e specializuara, shkëmbimit të informacioneve, monitorimit dhe raportimit. Në këtë kontekst, secili Ekspert Mjedisori do të jetë përgjegjës për sigurimin e mbështetjes së Ministrin në Komisionin Mjedisor. Njësitë Mjedisore do të jenë përgjegjëse për përpilimin e raporteve progresive mbi ecurinë e zbatimit të kësaj Strategjie çdo tre muaj.

Do të ngrihet një rrjet i komunikimit të Njësive Mjedisore, për të marrë masa për shkëmbimin e shpejtë dhe efikas të informacionit në nivel specialistësh, përfshirë kalimin e të dhënave në regjistrat publikë. Ekspertët Mjedisorë do të takohen të paktën një herë në gjashtë muaj me MMPAU për të diskutuar dhe zgjidhur problemet që dalin nga zbatimi i kësaj Strategjie, përfshirë zbatimin e dispozitave të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të dhëna më sipër.

Madhësia e çdo njësie do të jetë në përpjesëtim me shkallën e përgjegjësisë që ka Ministria. Në disa raste mund të jetë e dobishme, që Njësitë e Mjedisit të marrin edhe disa përgjegjësi për probleme të Shëndetit dhe të Sigurisë, brenda ministrisë së tyre. Personeli i këtyre Njësive do të trajnohet dhe mbështetet me asistencë teknike nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

## 6.2 Monitorimi i ecurisë

Kjo strategji është pjesë e sistemit të administrimit të mjedisit. Sikurse është diskutuar edhe në kapitujt pararendës, sistemi i administrimit mjedisor mishëron monitorimin dhe raportimin e ecurisë. Meqë strategjia është pjesë e sistemit, edhe ajo ka nevojë për monitorim. Monitorimi i saj do të ndërmerret duke përdorur një seri indikatorësh:

- Indikatorët e gjendjes së mjedisit;
- Indikatorët e performancës së infrastrukturës mjedisore;
- Indikatorët financiarë;
- Indikatorët administrativë.



## Gjendja e Mjedisit

Treguesi më domethënës i zbatimit të kësaj strategjie do të jetë gjendja e mjedisit. Prandaj dhe grupi i parë i indikatorëve të publikuar në lidhje me këtë strategji synon të na japë një tregues të përgjithshëm të ndryshimeve në gjendjen e mjedisit.

Elementi	Indikatori	Parametrat Bazë
Ajri	Arritja e standardeve përkatës për ajrin e ambientit	Grimca të ngurta, ozon, SO <sub>x</sub> , NO <sub>x</sub> ,
Uji i plazheve	Arritja e standardeve përkatës për ujin e plazheve të zonave bregdetare	Ndotja Bakteriale
Uji i lumenjëve	Arritja e standardeve të përshtatshme për peshqit në ujrat e lumenjëve	Oksigjenimi, Bio-toksiciteti
Biodiversiteti	Përqindja e sipërfaqes së vendit e përcaktuar si Zonë e Mbrojtur	Zonë e Mbrojtur si përqindje e sipërfaqes totale të territorit të vendit
Biodiversiteti	Përqindja e specieve të mbrojtura që janë në rrezik serioz për zhdukje	Përqindja në rrezik

## Indikatorët e Performancës së Infrastrukturës Mjedisore

Një nga sfidat më të mëdha të prezantuara nga kjo startegji dhe nevoja për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm është parashikimi, ndërtimi dhe funksionimi i infrastrukturës komunale. Prandaj, katër indikatorë specifikë, dy për mbetjet e ngurta dhe dy për ato të lëngëta, do të duhet të raportohen çdo vit, për të treguar nivelin e përmirësimit të shërbimit të infrastrukturës komunale.

Elementi	Indikatori <sup>1</sup>
Mbledhja e Ujërave të Zeza	Shkarkimet e ujërave të zeza të popullatës të lidhura me kolektorët qendrorë të grumbullimit të tyre.
Trajtimi i Ujërave të Zeza	Përqindja e ujërave të zeza që i nënshtrohet përpunimit të saktë
Mbetjet	Mbledhja dhe depozitimi i mbetjeve urbane - % e popullatës që e merr këtë shërbim
Mbetjet	Riciklimi i mbetjeve - % e mbetjeve të ricikluara ndaj totalit të atyre të mbledhura

## Indikatorët Financiarë

Natyrisht që është gjithashtu e rëndësishme që të masim/përcaktojmë edhe shkallën e përpjekjeve që bëhen për t'u përballur me sfidën e investimeve të mëdha. Për këtë qëllim, indikatorët e angazhimeve financiare do të publikohen gjithashtu.

Elementi	Indikatori <sup>2</sup>
Ujërat e Zeza	Investimet vjetore (me çmime reale) në infrastrukturën e ujërave të zeza
Administrimi i Mbetjeve	Investimet vjetore (me çmime reale) në infrastrukturën e mbetjeve të ngrta
Zonat/tokat e ndotura	Investimet vjetore (me çmime reale) për restaurimin e zonave të ndotura
Administrimi Mjedisor	Shpenzimet operative vjetore (me çmime reale) në shërbim të mbrojtjes së mjedisit

## Indikatorët Administrativë

Një nga synimet bazë të strategjisë është zbatimi i një sistemi modern në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Është shumë e rëndësishme të dijmë nëse sistemi që kemi në përdorim është funksional. A kemi vënë në dispozicion burime të duhura dhe të mjaftueshme dhe a po aplikohen procedur të drejt në zbatim?

<sup>1</sup> Të dhënat për llogaritjen e këtyre indikatorëve ekzistojnë edhe sot, por nuk raportohen rregullisht.

<sup>2</sup> Të dhënat për raportimin e këtyre indikatorëve mbahen nga qeveria por nuk publikohen.

Informacioni mbi shkallën e funksionimit të sistemit të administrimit është shumë i rëndësishëm, sepse na jep mundësinë ta vlerësojmë efektivitetin e tij dhe mbi këtë bazë të bëjmë vlerësimin e nevojës për përmirësimin apo reformimin e tij. Ky fakt, dikton nevojën për një monitorim të rregullt të “produktivitetit”. Me këtë veprim mbulojmë edhe aspektet e komadës dhe kontrollit të sistemit: dhënjën e lejeve, përditësimin/rinovimin e lejeve, frekuencat e inspektimit, efikasitetin e vjeljes së gjobave, etj. Por, do të duhet gjithashtu për të mbuluar edhe aspekte të tjera të eficiencës sonë administrative, sikurse është kohëzgjatja për përgjigjen ndaj një informacioni të kërkuar nga një antar i publikut, ose koha që na duhet për përgatitjen e një raporti apo informacioni të kërkuar. Performanca e përgjithëshme e administratës në realizimin e kalimit në një standard më të lartë të administrimit mjedisor do të regjistrohet dhe publikohet në formën e indikatorëve që vijojnë:

Elementi	Indikator
Transpozimi i Legjislacionit	Shkalla e përputhshmërisë ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe atij të Komunitetit European <sup>3</sup>
Informacioni dhe Komunikimi Mjedisor	Konsultime të vazhdueshme me grupet e interesit gjatë kohës së hartimit dhe përgatitjes së politikave dhe ligjeve mjedisore. Komunikimi i informacionit mbi politikat tek të gjithë grupet e interesit. MMPAU plotëson të gjitha nevojat e grupeve të interesit për informacion mjedisor.
Gjohat/Masat Shtrënguese	Inspektim sistematik mbi kushte të detajuar që (duhet të) përmbahen në lejet e dhëna. Gjohat të larta për çdëmtim. Dënim i dhënë mbi bazën e Kodit Penal në lidhje me shkeljet më serioze mjedisore të klasifikuar si krime mjedisore.
Edukimi Mjedisor	Mësuesit e trajnuar në lidhje me aftësimin e tyre mbi mësimdhënjen e çështjeve dhe studimeve mjedisore si një lëndë e veçantë brënda programit të lëndëve të shkollave të nivelit parauniversitar. Module të reja të trajnimit profesional mbi problemet mjedisore të përgatitur dhe hedhur në qarkullim çdo vit. Kurse të reja universitare dhe numri i studentëve në kurset ekzistuese, si në universitetin Politeknik ashtu edhe në atë Bujqësor të Tiranës është rritur. Trainim “në punë” i është dhënë si punonjësve të shërbimit civil të ministrive ashtu edhe punonjësve të kontraktuar nga këto ministri. Shkollat Filllore: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i trajnuesve të kualifikuar për të trajnuar mësuesit e shkollave fillore mbi teknikat dhe modulet e edukimit mjedisor;</li> <li>• Numri i shkollave të veprimit mjedisor në funksion;</li> <li>• Numri i mësuesvë të shkollave fillore që japin mësim mbi module të veçantë të lidhur direct me edukimin mjedisor.</li> </ul>

Përveç grupit kryesor të indikatorëve, matje të veçanta do të bëhen edhe për indikatorë të tjerë që eventualisht mund të shfaqen jashtë këtij grupi.

### Efikasiteti i këtyre veprimeve – monitorimi i plotësimit të standardeve

Të dish nëse sistemi i administrimit po funksionon me efikasitet apo jo, është një tregues edhe i performancës së institucioneve të administrimit, por gjithsesi, ky fakt nuk tregon se sa të efektshme janë masat që po zbatohen. Efekti mbi mjedisin apo mbi treguesit e presioneve ka gjithashtu nevojë të matet. Për shembull, nëse vihet një tarifë për bllokim të lëvizjes në qendër të Tiranës, për të ulur nivelet e larta të trafikut, atëherë do të jetë e rëndësishme të monitorohet efekti i tarifës tek numri i automjeteve që hyjnë

<sup>3</sup> Raportimi i saktë i indikatorëve të transpozimit mbase mund të jetë jo praktik në një kuprim afat-shkurtër, sepse kërkon plotësimin e tabelave të konkordancës për shumë çështje të legjislacionit. Pavarësisht nga kjo, përderisa është një kërkesë e procesit të antarësimit dhe përdoret nga Komisioni European për të gjykuar mbi progresin në drejtim të plotësimit të kërkesave për antarësim, implementimi i tij do të duhet të planifikohet.

në qendër të qytetit, me qëllim që tarifa e vendosur të jetë e një niveli të përshtatshëm dhe të ketë efektin e dëshiruar.

### **Identifikimi i nevojave të reja – përgjigja ndaj ndryshimeve**

Gjatë gjithë zbatimit të strategjisë, duhet të ngrihen supozime për sa i përket prirjeve të një sërë faktorësh, përfshirë zhvillimin e popullsisë, industrisë apo konsumit shtëpiak, me qëllim që të përcaktohet, për shembull, shkalla e duhur dhe natyra e projekteve të investimit. Siç ndodh rëndom edhe me supozimet e tjera, nuk mund të jemi plotësisht të sigurt se këto supozime janë të sakta. Ndaj, duhet të jemi vigjilentë kur të shfaqen probleme dhe prirje të reja, si dhe të jemi gati për të analizuar impaktin e tyre në strategjinë tonë.

### **Raportimi i ecurisë**

Informacioni i mbledhur gjatë monitorimit të zbatimit të strategjisë nuk do të ketë vlerë, nëse nuk raportohet me transparencë dhe nuk u jepet edhe të tjerëve.

### **Raportimi dhe komunikimi ndërmjet institucioneve qeveritare**

Kjo strategji kërkon zgjidhjen e disa çështjeve të ndërlikuara që përfshijnë një sërë sektorësh. Me qëllim që t'u jepet një zgjidhje këtyre çështjeve, është e rëndësishme që institucionet të komunikojnë hapur dhe të shkëmbejnë informacionin që kanë.

Vështirësitë praktike dhe teknike kanë qenë pengesë që një gjë e tillë të realizohet me efikasitet në të shkuarën. Sidoqoftë, me përmirësimin e sistemeve të komunikimit ndër-institucional, sidomos nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së re të komunikimit, sikurse është rrjeti i ri komunikimit “Intraneti Qeveritar” këto vështirësi duhet të pakësohen.

Krijimi i Komisionit Ndërmjësor për Mjedisin dhe sistemi i Grupeve të Posaçme të Punës duhet të shërbejnë për të mos lejuar që pengesat që ekzistojnë në shkëmbimin e informacionit të vënë në rrezik zbatimin e kësaj strategjie.

### **Komunikimi me publikun dhe aktorët e tjerë**

Publiku, industria, tregtia, OJQ-të, donatorët dhe agjencitë dhe donatorët ndërkombëtarë janë të gjithë pjesëmarrës të domosdoshëm në këtë strategji. Si mund të shpresojmë që ata të marrin pjesë në mënyrë efikase, nëse nuk u tregojmë në një mënyrë të strukturuar dhe efikase se ç'po ndodh?

Grupit të Veprimit në Mjedis do t'i jepen buletine të rregullt informativë, mbi zbatimin e strategjisë dhe buletine të tjerë informativë mbi gjendjen e mjedisit, përfshirë këtu edhe një raport vjetor.





This document has been prepared by the EU CARDS Environmental Legislation and Planning Project in Albania in Collaboration with the Ministry of Environment, Forestry and Water Administration of Albania. The ELPA project was implemented by Jacobs /Louis Berger SA Joint Venture and based at Rr. "Naim Frashëri", Nr. 75, Tirana.



LOUIS BERGER S.A.S

The contents of this publication is the sole responsibility of Jacobs, London Road, Reading, England and the Ministry of Environment, Forestry and Water Administration of Albania and can in no way be taken to reflect the views of the "European Union".